BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË

6-MUJORI I PARË 2013

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë.
Tel: 355-4-241 93 01/02/ 03; 355-4-241 94 01/2/3;
Faks: 355-4-241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

Editorial
Informacion përmbledhës mbi Nismën e Vjenës II 5

Fjalime e prezantime të administratorëve të Bankës së Shqipërisë
në aktivitete brenda e jashtë vendit 11

Analiza periodike 69
Analiza e ndërmjetësimit financiar, Tremujori I - 2013 70
Erjona Suljoti, Sofika Note, Olta Manjani

Informacion mbi tregues ekonomikë e monetarë të disa vendeve partnere tregtare,
Tremujori I-2013 79
Doriana Lama, Medvin Shehu

Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë, Tremujori IV – 2012 85
Merita Boka, Olti Mitre

Studime e artikuj 97
"Projeksionet afatmesme dhe funksionimi i modelit Gap në vendimmarrje" 98
Evelina Çeliku

Kreditimi i sektorit privat: Analizë e zhvillimeve në vend dhe rajon" 111
Erjona Suljoti, Sofika Note

Performanca dhe rëndësia e sektorit të shërbimeve për aktivitetin ekonomik
vendas" 125
Iris Metani

Status Quo-Ja" e SME-ve në Shqipëri 132
Elona Dushku, Alban Pllaha

Depozitat në valutë dhe tendencat më të fundit të euroizimit" 145
Olta Manjani

Banka e Shqipërisë në harkun kohor, janar-qershor 2013 151

Vendimet e Politikës Monetare 158

Ngjarjet Juridike, janar-qershor 2013 159

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 30 qershor 2013 172

Bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë,
deri në 30 qershor 2013 173

Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të parë
të vitit 2013 177

EDITORIAL
INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI NISMËN E VJENËS II

Nisma e Vjenës II e vijon aktivitetin e saj mbi suksesin e Nismës së Vjenës I, krijuar në kulmin e krizës financiare botërore të periudhës së viteve 2008-2009. Ajo vazhdon të përdorë një platformë të bashkëpunimit privat-publik, që përfshin institucione financiare ndërkombëtare të rëndësishme, Komisionin Evropian (KE) dhe institucione të tjera të Bashkimit Evropian (BE), grupet bankare ndërkombëtare kryesore që operojnë në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJ), si dhe autoritetet e vendeve të origjinës (home) dhe atyre pritëse (host).

Objektivi i Nismës së Vjenës II, është nxitja e koordinimit midis autoriteteve të vendeve të origjinës dhe atyre pritëse në mbështetje të një aktiviteti bankar të qëndrueshëm midis vendeve dhe mbrojtjes nga një proces i çrregullt *deleveraging*. Grupet bankare perëndimore vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë nismë, duke mbështetur përpjekjet për koordinimin dhe duke bërë pjesën e tyre për të shmangur *deleveraging* e çrregullt.

NISMA E VJENËS I

Nisma e Vjenës I u lançua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Ministria e Financave të Austrisë, në kulmin e krizës financiare botërore të viteve 2008-2009, si një platformë e sektorit privat-publik për të siguruar kapital të mjaftueshëm dhe mbështetje me likuiditet nga grupet bankare perëndimore për filialet e tyre në vendet e EQLJ.

Në vijim, Komisioni Evropian vendosi t'i bashkohej nismës, duke e konsideruar atë me rëndësi. Lobimi i vazhdueshëm i FMN-së dhe BERZH-it siguroi pjesëmarrjen e gjerë të autoriteteve publike të vendeve të origjinës dhe pritëse të bankave ndërkombëtare që operojnë në rajonin EQJL. Po ashtu, nisma është përkrahur dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare si Grupi i Bankës Botërore dhe Banka Evropiane për Investime (BEI).[1]

Në kuadër të kësaj nisme, disa banka shumëkombëshe nënshkruan letra angazhimi specifike sipas vendeve, ku ato angazhoheshin të vazhdonin kreditimin e ekonomisë dhe konfirmuan se do t'i mbanin filialet e tyre të mirëkapitalizuar dhe mjaftueshëm likuidë. Në të njëjtën kohë, u ngrit shqetësimi se kjo mund të nxiste bankat shumëkombëshe të mbështetnin këto

[1] *Wolfgang Nitsche, 2010, Working paper 4/2010, The Vienna Initiative/European Bank Coordination Initiative: Assessment and Outlook.*

vende nëpërmjet tërheqjes së fondeve nga vende të tjera me të cilat nuk ishin nënshkruar letra angazhimi. Por, në fakt, nuk u verifikua një tërheqje në shkallë të gjerë dhe e pakoordinuar e bankave nga vendet e Evropës në zhvillim.

Nisma e Vjenës I është perceptuar gjerësisht si një mekanizëm i suksesshëm për koordinimin e sektorit publik-privat gjatë krizës financiare ndërkombëtare. Ajo vlerësohet se ndihmoi në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e disa vendeve, si dhe në ndërtimin e besimit reciprok midis bankave ndërkombëtare, autoriteteve të vendeve të origjinës dhe pritëse dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

NISMA E VJENËS II

Shtetet e EQLJ-së janë vende të rëndësishme pritëse për bankat e huaja, kryesisht me origjinë nga Evropa Perëndimore. Në këtë kuadër, kriza financiare e sidomos kriza e borxheve sovrane në Eurozonë, solli në fokus konfliktet e interesave ndërmjet vendeve të origjinës dhe pritëse të sektorit bankar. Kriza në Eurozonë ka sjellë rrezikun e *deleveraging* të çrregullt të bankave mëma në drejtim të filialeve të tyre në vendet e EQLJ-së dhe ka nxjerrë në pah vështirësi në bashkëpunimin midis autoriteteve të vendeve të origjinës dhe atyre pritëse. Si rezultat, vendet ku filialet ose degët e bankave të huaja janë me rëndësi sistemike, sot ndeshen me sfida të dukshme në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe sigurimit të një oferte të mjaftueshme të kredisë.

Duke marrë në konsideratë këto zhvillime, në muajin janar 2012 Nisma e Vjenës u rilançua me emrin "Vjena II", në përgjigje të rreziqeve që burojnë nga kriza e Eurozonës dhe që kërcënojnë stabilitetin e rajonit.

Më konkretisht, misioni i kësaj Nisme është të:

- shmangë *deleveraging* të çrregullt, që mund të rrezikojë stabilitetin financiar të vendeve pritëse dhe që mund të dëmtojë ekonomitë e vendeve të origjinës dhe atyre pritëse. Qëllimi nuk është të pengohet *deleveraging* në përgjithësi. Disa raste të *deleveraging* sjellin efekte pozitive, pasi mundësojnë struktura financimi më të qëndrueshme, reduktojnë borxhin e jashtëm ose sigurojnë aksionerë më të fuqishëm të bankave. Por procesi *deleveraging* në shkallë të gjerë, të shpejtë dhe të paparashikuar, ka sjellë rreziqe sistemike dhe ka shkurtuar financimin e përgjithshëm të bankave të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore;
- sigurojë zgjidhjen e çështjeve potenciale të stabilitetit financiar ndërkufitar. Kuadri ndërkombëtar ka mangësi, mbivendosje, objektiva konkurrues dhe konflikte interesi midis autoriteteve, çka kërkon një vëmendje të madhe. Grupet bankare do të përfitonin nga progresi në këtë fushë, pasi do të forcoheshin kushtet për një aktivitet të qëndrueshëm dhe të mirëorganizuar bankar ndërkufitar;

- marrë masa efektive kryesisht në fushën mbikëqyrëse, në interesin e përbashkët të vendeve të origjinës dhe atyre pritëse. Kjo gjë kërkon identifikimin reciprok të shqetësimeve të vendeve të origjinës dhe pritëse, duke siguruar që të dëgjohet edhe zëri i vendeve pritëse dhe duke nxitur një klimë besimi midis palëve. Çështjet e zgjidhjes (resolution) kërkojnë pjesëmarrjen në diskutime dhe përfshirjen e fuqishme të autoriteteve përtej mbikëqyrësve dhe bankave qendrore, kryesisht të autoriteteve fiskale.[2]

Edhe Nisma e Vjenës II funksionon si një platformë e sektorit privat-publik që përfshin institucione financiare ndërkombëtare të rëndësishme si: Komisionin Evropian dhe institucione me rëndësi të BE-së, grupet bankare më të rëndësishme me aktivitet ndërkombëtar, si dhe autoritetet e vendeve të origjinës dhe pritëse. Mbulimi gjeografik i kësaj nisme e tejkalon Bashkimin Evropian dhe njëkohësisht përfshin vende të tjera të Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore me një prani të lartë të bankave perëndimore.

Ndërsa Nisma e Vjenës I, përqendrohej në ruajtjen e mbështetjes së grupeve bankare perëndimore për filialet e tyre në vendet e EQLJ-së dhe sigurimin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm, Nisma e Vjenës II është më tepër e orientuar drejt autoriteteve, duke i inkurajuar ato të bashkëpunojnë. Megjithatë, sektori privat ka përsëri një rol të rëndësishëm, sidomos në drejtim të shmangies së një procesi *deleveraging* të çrregullt.

Puna në kuadër të Nismës së Vjenës II synon rezultate praktike nëpërmjet monitorimit dhe raportimit mbi procesin e *deleveraging* dhe nëpërmjet ngritjes së strukturave të përkohshme, ku vendimmarrësit e sektorit privat dhe publik takohen për të shkëmbyer përvojë dhe për të diskutuar veprimet e përshtatshme. Nxjerrja e përfundimeve praktike nga përvoja e vendeve pritëse dhe propozimi i masave rreth këtyre përfundimeve, përfshihen gjithashtu në kuadrin e kompetencave të Nismës së Vjenës II. Axhenda e Nismës përfshin edhe trajtimin e çështjeve makroprudenciale. Në mënyrë të veçantë, Nisma shqyrton edhe zhvillimet e reja rregullative në nivel evropian, të tilla si propozimi i Komisionit Evropian për kuadrin e zgjidhjes dhe për Bashkimin Bankar.

Organet drejtuese të Nismës janë:

1. *Forumi i Plotë*, organ që përbëhet nga të gjithë pjesëmarrësit e nismës, i cili vendos me konsensus prioritetet për aktivitetet e saj dhe miraton planin e punës, si dhe raportet, parimet dhe rekomandimet e zhvilluara në kuadrin e Nismës.
2. *Komiteti Drejtues* i përbërë nga institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH, BEI, FMN, Bankë Botërore), Komisioni Evropian dhe pjesëmarrës të zgjedhur (Italia, Rumani), drejton punën praktike të nismës dhe përgatit vendimet strategjike për Forumin e Plotë. Komiteti Drejtues i raporton Forumit të Plotë gjatë mbledhjeve të këtij të fundit.

[2] *http://vienna-initiative.com/vienna-initiative-part-2/.*

Kryetari i Komitetit është Guvernatori i Bankës Kombëtare të Polonisë, z. Marek Belka. Duke nisur nga viti 2013, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është anëtar i Komitetit Drejtues të Nismës së Vjenës.

Anëtarësimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në forumin më të lartë drejtues të Nismës së Vjenës II përbën një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të përcjelljes më efektive të qëndrimit të Bankës së Shqipërisë pranë autoriteteve të Bashkimit Evropian, institucioneve ndërkombëtare dhe grupeve të mëdha bankare, lidhur me impaktin që kanë në sistemin financiar të vendit zhvillimet në Eurozonë. Sidoqoftë, ky rol nuk kufizohet thjesht në përcjelljen e shqetësimeve të Bankës së Shqipërisë në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës të një vendi pritës. Kjo pjesëmarrje në forumet e Nismës, do të shfrytëzohet për të kontribuar në mënyrë të qenësishme me sugjerimet përkatëse në krijimin e mekanizmave më të frytshëm të bashkëpunimit midis autoriteteve të vendeve të BE-së dhe atyre joanëtare – mekanizma të cilët në afatin e gjatë synohet të sigurojnë stabilitetin e përbashkët të tregjeve financiare tashmë të integruara të Evropës. Në mënyrë konkrete, duke qenë se Shqipëria, është i vetmi vend joanëtar i Bashkimit Evropian, që ka anëtarësi në Komitetin Drejtues të Nismës së Vjenës II, është angazhuar të përfaqësojë interesat e vendeve që aspirojnë të bëhen pjesë e familjes evropiane. Në këtë rol, Shqipëria do të ketë një kontribut të rëndësishëm në nxitjen e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Në kuadrin e Nismës së Vjenës II, Banka e Shqipërisë ka theksuar qartë nevojën për krijimin e kushteve të nevojshme për vijimin e mbështetjes me kreditim të vendeve të EQLJ-së nga ana e grupeve bankare perëndimore dhe adresimin e pasojave të mundshme negative të *deleveraging* në këto vende. Banka e Shqipërisë ka evidentuar gjithashtu nevojën që autoritetet e BE-së të vlerësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet që lidhen me ndërlidhjen midis sistemeve financiare të BE-së/Eurozonës dhe vendeve joanëtare të BE-së, me qëllim hartimin e politikave makroprudenciale të ekuilibruara dhe të qëndrueshme, të cilat duhet të konsiderojnë edhe ndikimet e mundshme mbi vendet pritëse joanëtare të BE-së. Pjesë e qëndrimit të Bankës së Shqipërisë janë edhe sugjerimet në favor të një koordinimi më efektiv të aktivitetit mbikëqyrës, ku mirëfunksionimi i kolegjeve dhe forumeve të tjera të bashkëpunimit mbikëqyrës është me rëndësi themelore.

NISMA E VJENËS II DHE BASHKIMI BANKAR EVROPIAN

Si një nga linjat ku përqendrohet puna e Nismës së Vjenës II, ndjekja e reformave madhore në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare në nivel evropian kanë marrë vëmendjen e duhur edhe nëpërmjet strukturave të veçanta. Kështu, për të vlerësuar efektet e bashkimit bankar evropian në vendet e Evropës në zhvillim, si dhe për të kontribuar në debatin e vazhdueshëm mbi hartimin dhe zbatimin e tij, në kuadrin e Nismës, është krijuar një grup i posaçëm pune, ku Banka e Shqipërisë kontribuon aktivisht.

Fillesat e krijimit të një bashkimi bankar gjenden në samitin e BE-së, organizuar në qershor të vitit 2012, i cili shqyrtoi një raport të përgatitur nga Presidenti i KE-së, ku bënte thirrje për një kuadër të integruar financiar, të mbështetur në tre shtylla kryesore: mbikëqyrjen bankare, zgjidhjen e bankave dhe sigurimin e depozitave në nivel evropian. Për sa i përket shtyllës së parë, samiti nënshkroi krijimin e një Mekanizmi të Vetëm Mbikëqyrës (SSM) me një rol qendror për Bankën Qendrore Evropiane (BQE), ku u theksua se mbikëqyrja efektive, do të krijonte mundësinë për një rikapitalizim të drejtpërdrejtë të bankave në nevojë nëpërmjet Mekanizmit Evropian të Stabilitetit (ESM), duke shmangur efektet negative të rikapitalizimit publik të bankave mbi pozicionin fiskal të vendeve.

Shtylla e dytë, synon si hap final në krijimin e një Autoriteti të Vetëm për Zgjidhjen (SRA) që pritet të lehtësojë zgjidhjen në kohë të bankave dhe të arrijë marrëveshje mbi ndarjen e humbjeve. Shtylla e tretë, ka ende rrugë për të bërë, por ajo thekson nevojën e harmonizimit të një skeme të përbashkët të sigurimit të depozitave.

Konkretisht, Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve mbikëqyrëse dhe ministrive të financave të vendeve të origjinës dhe pritëse (nga Eurozona dhe jashtë saj), përfaqësues të grupeve bankare, FMN, BERZH, Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Investime. Komisioni Evropian nuk është pjesë e Grupit të Punës, por ofron komente dhe sugjerime.

Megjithëse Bashkimi bankar është përqendruar mbi nevojat e Eurozonës, Grupi i Punës ka si qëllim kryesor të konsiderojë edhe implikimet për vendet e Evropës në zhvillim, ku filialet e bankave të Eurozonës shpesh dominojnë sistemet lokale bankare.

Nëpërmjet kontributit në këtë grup, Banka e Shqipërisë mbështet objektivin e saj për të përfaqësuar përballë autoriteteve të BE-së interesat e vendeve pritëse joanëtare të saj.

FJALIME E PREZANTIME TË ADMINISTRATORËVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIVITETE BRENDA E JASHTË VENDIT

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në simpoziumin e ekonomistëve Kinë-Evropë me temë
"Ekonomia Kinë-Evropë: Sfidat dhe mundësitë e së ardhmes"
12 janar 2013

I nderuar z. Kryetar,
Të nderuar Kolegë,
Zonja dhe Zotërinj,

Është kënaqësi e madhe për mua të marr pjesë në këtë simpozium. Panorama ekonomike që ka evoluar me shpejtësi përgjatë viteve të fundit paraqet sfida dhe shanse që kërkojnë shumë nga politikëbërësit. Jam i sigurt se shkëmbimi i sinqertë dhe produktiv i ideve do të mundësojë të kuptuarit qartë të problemeve me të cilat po përballemi si dhe hartimin e strategjive më të përshtatshme për kapërcimin e tyre.

HYRJE

Çështjet që shtrohen për diskutim sot përqendrohen në ecurinë dhe perspektivat e Kinës dhe të Evropës, dy rajone ekonomike që ndoshta janë në skajet e kundërta të spektrit të infektimit nga kriza globale. Ndërkohë që Kina ka mbetur kryesisht e paprekur, Evropa ka vuajtur në mënyrë domethënëse. Kriza ka nxjerrë në pah dobësi themelore strukturore dhe institucionale në Eurozonë dhe në BE.

Në fjalën time të shkurtër, do të përqendrohem në gjendjen aktuale ekonomike dhe financiare të Evropës. Do të ishte pothuajse nënvlerësim po t'i përkufizonim zhvillimet e shkuara, aktuale dhe të pritshme të Evropës si afatshkurtra dhe të vështira. I ashtuquajturi "Depresioni i Madh" vuri në provë si Eurozonën edhe të gjithë ekonominë evropiane. Procesi i konvergjencës në BE doli se ishte i paplotë, si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe nga pikëpamja institucionale. Nisur nga këndvështrimi afatgjatë, procesi i globalizimit dhe tendencat e pafavorshme demografike kanë sfiduar qëndrueshmërinë e sistemeve ekonomike dhe sociale të BE-së.

Pavarësisht nga këto probleme, jam plotësisht i bindur se Evropa do të vazhdojë të jetë një rajon dinamik dhe i begatshëm në të ardhmen. Përfitimet e synuara në periudhë afatgjatë do të tejkalojnë më së miri kostot afatshkurtra të reformave strukturore. Një Evropë më konkurruese dhe e integruar, e mbështetur nga institucione më të forta dhe e drejtuar nga politika ekonomike dhe financiare më të qëndrueshme, do të japë përfitime për gjithë ekonominë globale. Në vijim të fjalës sime do t'i trajtoj këto pika në mënyrë më të detajuar.

EVROPA PËRMES KRIZËS

Evropa ka qenë një prej rajoneve më të goditura nga kriza globale. Ndikimi fillestar i rrëzimit të tregut sub-prime në Shtetet e Bashkuara u ndje në të gjithë sektorin financiar evropian, me rënien e tregjeve të aksioneve dhe me humbjet e mëdha që pësuan bankat në bilancet e tyre. Rënia në çmimet e mjeteve dhe shterimi i kredisë bankare, pakësimi i aktivitetit tregtar në botë, si dhe rënia e besimit të bizneseve dhe konsumatorëve u pasqyruan menjëherë në një recesion të gjerë gjatë viteve 2008-2009, pasuar nga një periudhë pasigurie dhe rritjeje të ngadaltë. Papunësia u rrit me ritme të mëdha dhe balanca fiskale u përkeqësua me shpejtësi. Dobësimi i aktivitetit ekonomik rriti pasiguritë në sektorin financiar, duke krijuar si rezultat një bërryl negativ, i cili u bë i vështirë për t'u përballuar edhe për shkak të pranisë së deleverage në sektorin privat, mosmarrjes përsipër të rrezikut dhe shtrëngimeve në financat publike.

Shumë nga tiparet e mësipërme i kanë pasur edhe ekonomitë e tjera, si Shtetet e Bashkuara dhe Japonia. Rënia e bilanceve që ata përshkruajnë mbetet e lehtë për t'u kontrolluar, të paktën teorikisht, duke kombinuar stimulin ekonomik afatshkurtër, angazhimet afatgjata për stabilitet makroekonomik, reformat strukturore dhe durimin.

Megjithatë, kanë ekzistuar disa çështje ideosinkretike, të cilat e veçojnë përvojën evropiane nga ekonomitë e tjera. Ato u shfaqën në probleme të rënda për sektorin publik në disa vende të Eurozonës, në mungesë të përhapur të besimit ndaj institucioneve dhe autoriteteve, si dhe në forcimin e forcave centrifugale, të cilat rrezikuan euron.

Cilët faktorë e përkeqësuan krizës në Eurozonë? Ndërkohë që lista e plotë do të ishte e gjatë, do të doja të theksoja tre prej tyre.

- Së pari, ndërvarësia ndërmjet klasifikimit të kredisë sovrane, primeve të rrezikut në sektorin financiar dhe ekonomisë reale u përkeqësuan për shkak të integrimit të paplotë të tregut financiar. Ndërkohë që i gjithë rajoni vuante nga daljet e kapitalit, gjatë katër viteve të fundit integrimi financiar në BE eci në kahun mbrapsht. Riatdhesimi i flukseve financiare ndërkufitare krijoi probleme të mëtejshme në ekonomitë e Eurozonës dhe në rajonin fqinj. Në fakt, deleverage ndërkufitar që rezultoi nga kjo situatë dhe pakësimi i rrezikut (de-risking) kanë qenë ndër kanalet kryesore të përhapjes së krizës, e cila ka prekur vendet e Evropës Lindore, përfshirë edhe Shqipërinë.
- Së dyti, divergjenca në politikat ekonomike ndër-rajonale rezultoi në divergjencë të konkurrencës brenda BE-së dhe Eurozonës. Kjo divergjencë e vendosi theksin në çështjet e bilanceve të pagesave ekzistuese brenda-rajonale, duke nxjerrë në pah nevojën për reforma ekonomike dhe fiskale, të cilat duhet të ishin bërë prej kohësh.
- Së treti, mungesa e një bashkimi fiskal ka çuar në mungesën e reagimit të politikave ekonomike, veçanërisht në praninë e një politike monetare që merret me kufirin më të ulët (zero) të normave të interesit. Madje,

dyshimet për gjendjen fiskale afatgjatë të disa vendeve të Eurozonës, të tilla si Greqia, Irlanda, Italia, Portugalia dhe Spanja, rritën primet e rrezikut të tyre sovran dhe kostot e tyre të huamarrjes publike dhe private në nivele të papërballueshme.

CILI KA QENË REAGIMI I POLITIKAVE TË BE-SË?

Politika e BE-së për administrimin e krizave kishte për synim ta mbante nën kontroll dhe të kapërcente efektet e saj; megjithatë, në një shkallë të madhe, është kushtëzuar nga disa prej kufizimeve që përmenda më parë. Politika monetare mori rolin udhëheqës në sigurimin e nxitjeve kundërciklike për ekonominë, ku BQE-ja e uli me shpejtësi normën bazë dhe injektoi sasi të madhe të likuiditetit afatshkurtër dhe afatgjatë. Së fundi, njoftimi në shtator i transaksioneve të tipit OMT[1] nga ana e BQE-së ka shënuar një pikë kthese për fitimin e besimit në tregjet financiare.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh mungesën e hapësirës për politika nxitëse fiskale, sektori publik ka qenë më i interesuar për kontrollin e trajektoreve të borxhit publik afatgjatë, duke zbritur dhe jo duke shtuar, në stimulin ekonomik. Për këtë qëllim, politikat fiskale për mbikëqyrjen ekonomike kompakte dhe makroekonomike, për të cilat është rënë dakord, synojnë t'i vendosin financat publike të Eurozonës në një pozicion të shëndoshë e të besueshëm në afatin e gjatë. Nga ana fiskale, BE-ja ka rishikuar arkitekturën e vetë financiare duke ngritur mekanizmat EFSF[2] dhe ESM[3] dhe duke rënë dakord për ngritjen e një mbikëqyrësi të vetëm të sistemit bankar. Së fundi, janë ndërmarrë disa masa strukturore, me qëllim rigjallërimin e konkurrencës si për BE-në në tërësi edhe për secilin vend. Ndër të tjera, këto masa përfshijnë rritjen e fleksibilitetit të tregut të punës, reformimin e sistemit të pensioneve dhe liberalizimin e mëtejshëm në tregjet e të mirave dhe shërbimeve.

ÇFARË MBETET PËR T'U BËRË?

Ndonëse në mënyrë të debatueshme me vonesë, mendoj se reagimi me politika brenda BE-së ka ecur në drejtimin e duhur dhe ka qenë gjithëpërfshirës. Megjithatë, kërkohet punë e mëtejshme në të ardhmen. Do të doja të nënvizoja dy prej këtyre fushave.

- Së pari, axhenda e reformës e identifikuar nga katër presidentët (i Këshillit Evropian, i Komisionit Evropian, i Eurogrupit dhe i BQE-së) synon ta plotësojë bashkimin monetar me bashkim financiar, bashkim fiskal, bashkim ekonomik dhe me një shkallë disi më të lartë bashkimi politik. Ky është një qëllim ambicioz, po jam i bindur se do të arrihet brenda një kuadri kohor të arsyeshëm. Në këtë kontekst, kjo është më shumë një parakusht për rritje afatgjatë se sa një listë dëshirash dhe do t'i tregonte botës se Evropa i është përgjigjur dilemës për rolin e saj në ekonominë globale në shekullin e 21të.
- Së dyti, mendoj se përpjekjet për të rritur integrimin e BE-së duhet

> të zgjerohen e të përfshijnë një bashkëpunim më të thellë me vendet kandidate dhe ato kandidate potenciale në Evropën Lindore dhe Juglindore. Këto ekonomi, janë shumë të lidhura me BE-në, si nga këndvështrimi ekonomik edhe nga ai financiar. Ato kanë ndërmarrë reforma strukturore për të liberalizuar ekonomitë, për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të bashkërenduar politikat. Përpjekjet e BE-së duhet të përqendrohen për të ndihmuar dhe përshpejtuar procesin e konvergjencës në trajtat e tregjeve dhe kuadrin institucional, duke minimizuar, nga ana tjetër, kostot përkatëse afatshkurtra. Ky do të ishte përfitim i ndërsjellë si për BE-në edhe për rajonin.

Do të doja të shtoja se, për realizimin e kësaj axhende, hartuesit e politikave duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dimensionit kohë. Reformat që duhet të ndërmerren, duhet të bëhen në kohë si dhe duke pasur parasysh të gjithë projektin e BE-së. Vendet individuale kanë shumë punë për të bërë, po një zgjidhje që do të zgjasë në kohë do të duhet të jetë një reformë gjithëpërfshirëse që sheh përtej kufijve specifikë dhe synon rritjen e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së BE-së si një e tërë.

EVROPA NË TË ARDHMEN

Zonja dhe zotërinj, për ta mbyllur fjalën time, më lejoni të shpreh edhe njëherë bindjen time për të ardhmen e Evropës.

Një vështrim i shpejtë i disa të dhënave e ilustrojnë këtë pikë më së miri. BE-ja ka afërsisht 7% të popullsisë së botës, po jep rreth një të katërtën e PBB-së botërore. Ajo ka një model të pjekur social dhe ekonomik, i cili mbetet një paradigmë e arritshme e zhvillimit ekonomik pavarësisht nga sfidat afatgjata. Pozicioni i jashtëm si i BE-së edhe i Eurozonës është gjerësisht i balancuar, ku deficiti i llogarisë korrente përbën më pak se 1% të PBB-së. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së, prej 83%, krahasohet në mënyrë të favorshme me atë të ekonomive të tjera të avancuara dhe konkurrente, të tilla si SHBA-ja dhe Japonia, 103% dhe 230%, përkatësisht.

BE-ja është një prej zonave kyçe të inovacionit në shkallë botërore. Në termat e shpenzimeve për kërkimin dhe zhvillimin, nuk qëndron shumë pas SHBA-së, ndërsa në termat e numrit të kërkuesve dhe zbatimit të patentave ia kalon asaj.

Evropa dhe BE-ja ofrojnë një mjedis të pjekur ligjor, ku ka mbrojtje të duhur për investitorët dhe pronësinë intelektuale. Politikat makroekonomike mbeten të orientuara ndaj stabilitetit dhe sistemi i saj financiar është i pjekur dhe i shëndoshë. Pesë nga dhjetë vendet që renditen më lart në indeksin e fundit të konkurrueshmërisë globale janë vende anëtare të BE-së.

Më tej, do të doja të theksoja se, ndërkohë që në mënyrë të kuptueshme, përveç Eurozonës, ka vende të tjera në Evropën Lindore dhe Juglindore që ofrojnë një tablo cilësisht ndryshe. Deri në vitin 2008, ato përfshinin disa

prej ekonomive në zhvillim me rritjen më të shpejtë. Këto janë ekonomi me rritje të shpejtë, me prirje demografike më të mira dhe që ofrojnë potencial rritjeje të pashfrytëzuar, në lidhje me forcën e punës të kualifikuar, mjedisin miqësor ndaj biznesit dhe institucioneve të qëndrueshme. Procesi i integrimit evropian ka qenë ankorë kryesore dhe forcë madhore shtytëse për rritje dhe konvergjencë. Prandaj, do t'i inkurajoja fort vendet e rajonit të EJL-së të përkushtojnë përpjekje të qenësishme për integrim më të plotë rajonal në infrastrukturë, tregje dhe kuadrin arsimor e atë ligjor. Një integrim më i thellë rajonal rrit konkurrueshmërinë e rajonit në këndvështrimin evropian dhe atë global.

Kohët e fundit, janë bërë përpjekjet drejt një integrimi më të afërt rajonal, duke e bërë rajonin më tërheqës ndaj investitorëve të huaj potencialë. Me një integrim më të thellë rajonal, një ankorim më të mirë në procesin e konvergimit me BE-në dhe me më shumë financime, Evropa Lindore dhe Juglindore ka shumë për t'u ofruar si Evropës edhe ekonomisë botërore.

Periferia e Eurozonës apo anëtarët e rinj të ardhshëm ofrojnë shumë mundësi tërheqëse investimi për projekte zhvillimi në infrastrukturë, tregti, shfrytëzimin e burimeve natyrore, energji dhe kapacitete prodhuese. Më e rëndësishmja, zhvillimi i këtyre sektorëve strategjikë është hartuar brenda kuadrit të planeve të zhvillimit evropian dhe ekonomisë më të gjerë evropiane në të ardhmen. Prandaj, investimi në rajon do të thotë investim në të ardhmen e vetë ekonomisë evropiane.

Të nderuar pjesëmarrës,

Një ekonomi evropiane e integruar dhe një monedhë e vetme e besueshme japin një ankorë më të mirë për të ardhmen e konvergjencës tonë ekonomike, financiare dhe institucionale dhe rrjedhimisht, përfitime shtesë për vetë ekonominë evropiane. Ekonomia evropiane është një partner i rëndësishëm në shkallë botërore dhe zë një pjesë të qenësishme në kërkesën, financimin dhe përparimin teknologjik në shkallë globale. Forca e ekonomisë evropiane përbën interes të ndërsjellë për Evropën dhe partnerët e saj, përfshirë Kinën.

Duke marrë parasysh historinë në të shkuarën dhe gjendjen aktuale të çështjeve ekonomike, sociale, politike dhe intelektuale, mbetem plotësisht i bindur në aftësinë e Evropës për t'u bërë ballë sfidave të tanishme dhe të ardhshme dhe për t'u rishfaqur si vendi i mundësive dhe i begatisë.

Evropa do të jetë një partner i rëndësishëm për Kinën dhe ekonominë globale. Para se ta mbyll fjalën do të doja të sillja në vëmendjen tuaj një fjalë të urtë kineze "Dikush që arrin të ngrihet para se të agojë për 360 ditë të vitit, me siguri ka për ta bërë familjen e tij të pasur".

Faleminderit për vëmendjen!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
30 janar 2013

Sot, në datën 30 janar 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Deklaratën Gjashtëmujore të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të ulë normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje. Pas kësaj uljeje, norma e marrëveshjeve të riblerjes me afat njëjavor zbret në një minimum të ri historik, prej 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, lehtësimi i mëtejshëm i kushteve monetare do të ndihmojë në respektimin e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e monetare, si dhe të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Ekonomia shqiptare ka shënuar një përmirësim të lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012. Kjo ecuri është ndikuar nga reflektimi më i plotë i stimulit monetar dhe nga përmirësimi i ambientit të jashtëm ekonomik e financiar. Megjithatë, aktiviteti ekonomik mbetet nën nivelin potencial dhe burimet e rritjes nuk paraqiten të qëndrueshme. Rritja e prodhimit nuk është reflektuar në uljen e pasigurive të përgjithshme, të cilat frenojnë konsumin dhe investimet private, si dhe ndikojnë në reduktimin e kërkesës dhe të ofertës për kredi. Sistemi bankar është me bilance të shëndosha dhe likuide, por ai vazhdon të karakterizohet nga një kujdes i rritur në financimin e investimeve afatgjata. Këto tendenca do të kushtëzojnë zhvillimet ekonomike edhe gjatë periudhës së ardhshme.

Presionet inflacioniste kanë qenë të ulëta përgjatë tremujorëve të fundit. Duke reflektuar edhe politikën e kujdesshme monetare të Bankës së Shqipërisë, inflacioni ka qenë brenda objektivit të saj gjatë vitit 2012. Rritja vjetore e çmimeve të konsumit shënoi vlerën 2.4% në fund të vitit, ndërkohë që norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2%. Ecuria e inflacionit është karakterizuar nga rritja progresive e tij gjatë tre tremujorëve të parë dhe nga një rënie e lehtë në tremujorin e katërt.

Luhatjet e inflacionit janë përcaktuar kryesisht nga çmimet e ushqimeve, të cilat në vetvete kanë qenë subjekt i ndikimit të tregut ndërkombëtar dhe i ecurisë së prodhimit vendas. Ndikimi në inflacion i çmimeve të mallrave të tjerë të shportës ka qenë i vogël dhe pak i luhatshëm. Inflacioni i mallrave me çmime të rregulluara apo të administruara ka qenë i papërfillshëm, ndërkohë që rritja e çmimeve të produkteve të konsumit, të naftës dhe të lëndëve të

para në tregjet botërore, nuk ka shkaktuar rritje të inflacionit në ekonominë shqiptare.

Në këndvështrimin makroekonomik, të gjithë faktorët përcaktues të inflacionit kanë kontribuuar në ruajtjen e tij në nivele të ulëta. Shfrytëzimi jo i plotë i kapaciteteve prodhuese është shoqëruar me një kërkesë të ulët për punë nga bizneset, duke mos ushtruar presion për rritje të pagave dhe të kostove të punës. Gjithashtu, kërkesa e dobët për mallra e shërbime ka reduktuar aftësinë e bizneseve për diktimin e çmimeve të produkteve finale dhe ka ndikuar në ruajtjen në nivele të ulëta të marxheve të fitimit. Nga ana tjetër, rritja e ulët e çmimeve në tregjet botërore dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit kanë ndihmuar në kontrollin e çmimeve të mallrave të importit. Së fundi, pritjet për një inflacion të ulët në afatin e mesëm janë reflektuar në qëndrueshmëri të kostove, të çmimeve dhe të normave të interesit në kontratat afatmesme e afatgjata të lidhura në tregjet e punës, të produkteve të konsumit dhe të instrumenteve financiare.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 2.7% në tremujorin e tretë dhe pritjet tona janë për ritme të ngjashme rritjeje edhe në tremujorin e katërt të vitit 2012. Rritja ekonomike është mbështetur nga sektori i shërbimeve, nga sektori i industrisë dhe nga sektori i bujqësisë, ndërkohë që aktiviteti në sektorin e ndërtimit vijon të tkurret.

Vlerësimi i ecurisë së përbërësve të kërkesës agregate gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt konfirmon, në një masë të madhe, prirjet e vëna re në periudhat paraardhëse. Kërkesa e huaj ka qenë nxitësi kryesor i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend. Deficiti i eksporteve neto është ngushtuar në tremujorin e tretë të vitit, kryesisht si rezultat i rritjes së eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve. Të dhënat e tremujorit të katërt tregojnë për vijimësinë e këtij trendi. Në periudhën tetor-nëntor, eksportet u rritën me 14.3% ndërsa importet ishin rreth 5% më të ulëta se një vit më parë. Për pasojë, deficiti tregtar shënoi një reduktim vjetor prej 15.5%. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme mbetet e plogësht, si pasojë e mungesës së stimulit fiskal dhe e ecurisë së ngadaltë të konsumit dhe të investimeve private.

Të dhënat indirekte të disponuara tregojnë për një përmirësim të konsumit në tremujorin e tretë të vitit, por investimet private vijojnë të mbeten të ulëta si pasojë e shfrytëzimit jo të plotë të kapaciteteve të prodhimit, e pasigurisë për të ardhmen dhe e kushteve më të shtrënguara të financimit. Treguesit fiskalë kanë reflektuar ecurinë e përgjithshme të ekonomisë dhe politikën konsoliduese fiskale të ndjekur gjatë vitit 2012. Zhvillimet fiskale janë karakterizuar nga rritja e ngadaltë e të ardhurave dhe e shpenzimeve buxhetore, si dhe nga tkurrja e deficitit buxhetor. Të ardhurat fiskale për 11 muajt e parë të vitit janë rritur me 2.0% në terma vjetorë, duke reflektuar kontributin e ulët të komponentit tatimor të tyre. Shpenzimet publike kanë shënuar një rritje vjetore prej 0.9%, duke reflektuar në një masë të madhe ritmet negative të rritjes së shpenzimeve kapitale. Për rrjedhojë, deficiti buxhetor i kësaj periudhe paraqet një rënie vjetore prej rreth 8%.

Tremujori i katërt ka evidentuar një përcjellje më të mirë të stimulit monetar në tregjet financiare. Gjithashtu, ky tremujor është karakterizuar nga një ankorim më i mirë i normave të interesit të tregut ndërbankar dhe nga ulje e luhatshmërisë së tyre. Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese gjatë tre viteve të fundit. Stimuli monetar është rritur në mënyrë progresive gjatë kësaj periudhe, duke e sjellë normën bazë të interesit në nivelet minimale historike dhe duke qetësuar presionet e likuiditetit në tregun ndërbankar.

Megjithatë, përcjellja në ekonomi e efekteve të politikës monetare lehtësuese është frenuar nga rritja e primeve të perceptuara të rrezikut dhe nga ndryshimi i sjelljes së agjentëve të tregut financiar dhe të ekonomisë reale. Në gjysmën e parë të vitit, tregu primar vendas u përball me ndryshime strukturore, të rrjedhura nga zbatimi i masave shtrënguese të reja nga autoritetet mbikëqyrëse Evropiane. Ky zhvillim ndikoi në ruajtjen e normave relativisht të larta të yield-eve, pavarësisht kahut lehtësues të politikës monetare dhe rënies së normave afatshkurtra të interesit në tregun e parasë. Normalizimi i tregut primar në gjashtëmujorin e dytë u reflektua në rënie progresive të yield-eve gjatë kësaj periudhe. Kjo prirje duket të jetë përcjellë dhe në koston e kredisë në lekë për sektorin privat, ndonëse me një intensitet më të ulët si pasojë e primeve të rrezikut që reflektohen në çmimin e kredisë për agjentët privatë. Në përgjithësi, huamarrja e kontrolluar e sektorit publik në tregun e brendshëm të parasë, zgjerimi i bazës së investitorëve në letrat me vlerë të Qeverisë, si dhe stabilizimi i primeve të rrezikut në ekonomi, krijojnë premisa për funksionimin më të mirë të kanaleve të transmetimit në të ardhmen. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë beson se qëndrueshmëria afatgjatë e borxhit publik dhe kufizimi i huamarrjes publike në tregun e brendshëm të parasë ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikës monetare dhe në rritjen e hapësirave për kreditimin e sektorit privat të ekonomisë.

Treguesit monetarë janë karakterizuar nga ngadalësimi i ritmeve të rritjes në pjesën e dytë të vitit dhe sinjalizojnë për presione të ulëta inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës monetare rezultoi mesatarisht 5.9% në muajt tetor e nëntor, e mbështetur kryesisht nga zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë. Kërkesa për para e agjentëve të brendshëm ekonomikë ka qenë e ulët. Rritja e pjesëmarrjes së individëve në tituj të borxhit publik është reflektuar në një financim më të ulët të këtij sektori nga sistemi bankar. Kërkesa e bizneseve dhe individëve për financim është ngadalësuar ndjeshëm, duke reflektuar kërkesën e ulët për konsum e investime. Po kështu, bankat kanë vazhduar të ruajnë një përqasje më të kujdesshme në kredidhënie, duke zbatuar standarde të shtrënguara në përgjigje të pasigurive të perceptuara në nivel ekonomie dhe sektori. Në përgjigje të tyre, rritja vjetore e kredisë për ekonominë shënoi 4% në muajin nëntor. Kreditimi i ekonomisë është mbështetur në rritjen me 18% të kredisë në lekë, ndërkohë që kredia në valutë është reduktuar me 3.2%. Gjithashtu, rritja e kredisë vijon të udhëhiqet nga rritja e kredisë për bizneset, ndërkohë që kredia për konsum dhe për blerje banesash paraqitet mjaft e ulët.

Ecuria e deritanishme e aktivitetit ekonomik dhe projeksionet për vitin 2013, mbështesin vlerësimin për një rritje ekonomike pozitive, të përafërt

me atë të vitit paraardhës. Kërkesa e huaj parashikohet të ruajë kontributin pozitiv në rritjen e aktivitetit ekonomik në vend, por ky kontribut pritet të jetë më i ulët si rrjedhojë e zhvillimeve të pafavorshme në vendet partnere dhe e diversifikimit relativisht të ulët të eksporteve shqiptare. Kërkesa private pritet të jetë gjithashtu pozitive, duke përfituar nga rritja e stimulit monetar dhe nga shfrytëzimi i kursimeve të brendshme. Së fundi, një stimul pozitiv në rritjen ekonomike pritet të japë, gjithashtu, edhe sektori publik. Pavarësisht rritjes pozitive, aktiviteti ekonomik në vend pritet të mbetet poshtë potencialit të tij edhe gjatë vitit në vazhdim dhe presionet inflacioniste nga ana e kërkesës pritet të mbeten të ulëta gjatë këtij horizonti kohor. Banka e Shqipërisë vlerëson se, me një probabilitet prej 90%, inflacioni vjetor parashikohet të luhatet në intervalin 0.8 – 3.8% pas 4 tremujorëve. Nivelet e ulëta të inflacionit vjetor dhe parashikimi për vijimin e tyre përgjatë horizontit kohor të politikës monetare, diktojnë ruajtjen dhe forcimin e natyrës stimuluese të politikës monetare gjatë katër tremujorëve të ardhshëm.

***

Duke vënë në balancë informacionin e përmbledhur më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se presionet mbi çmimet e konsumit në vend mbeten të ulëta përgjatë horizontit kohor të politikës monetare dhe janë zhvendosur në kahun rënës gjatë muajve të fundit. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë normën bazë të interesit, me 0.25 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin 3.75%. Ky vendim synon të krijojë kushte të përshtatshme monetare për përmbushjen e objektivit të inflacionit në afat të mesëm. Lehtësimi i kushteve monetare ruan në nivele të ulëta normat afatshkurtra të interesit të tregjeve financiare, duke nxitur aktivitetin dhe duke ulur primet e tregtimit të likuiditetit në to. Nëpërmjet reduktimit të kostove të financimit, Banka e Shqipërisë synon rritjen e kredisë të konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Ky mekanizëm transmetimi nxit kërkesën agregate dhe, në rrethanat aktuale, krijon kushte më të përshtatshme për respektimin e objektivit afatmesëm të inflacionit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
27 shkurt 2013

Sot, në datën 27 shkurt 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor shënoi 2.7% në muajin janar. Pjesa më e madhe e inflacionit, ose rreth 75% e tij, vjen nga rritja e çmimeve të produkteve ushqimore. Në këtë kontekst, ndikimin më të madh e patën ushqimet e papërpunuara, të cilat regjistruan norma dyshifrore rritjeje. Çmimet e kategorive të tjera të shportës së konsumit shënuan luhatje të vogla, duke ruajtur një kontribut të ulët në inflacion.

Në aspektin makroekonomik, inflacioni është shkaktuar nga prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara të prodhimit, ndërkohë që goditjet e ofertës kanë munguar. Rritja e ngadaltë e kostove të prodhimit dhe marzhet e ulëta të fitimit të biznesit janë reflektuar në nivele të ulëta të inflacionit bazë dhe të atij total. Krahas tyre, qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, pritjet e ankoruara inflacioniste dhe shkalla e ulët e zgjerimit monetar kontribuan në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Ekonomia shqiptare vlerësohet të jetë rritur poshtë potencialit të saj gjatë vitit 2012. Informacioni i ri ekonomik e monetar konfirmon përgjithësisht vlerësimet tona të mëparshme për praninë e një hendeku negativ prodhimi. Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve neto, ndërkohë që kërkesa e brendshme vlerësohet të ketë dhënë një kontribut të vogël. Shkëmbimet tregtare në mallra gjatë tremujorit të katërt tregojnë një rritje vjetore të eksporteve me 12% dhe një rënie vjetore të importeve me 9.5%. Rrjedhimisht, deficiti tregtar nominal u ngushtua me 20.1% në terma vjetorë, duke siguruar një kontribut pozitiv në rritjen e kërkesës agregate në këtë tremujor. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme

mbetet e plogësht, si pasojë e hezitimit të konsumatorëve dhe bizneseve për të konsumuar dhe për të investuar.

Gjithashtu, kushtet e kreditimit paraqiten ende të shtrënguara si pasojë e kujdesit më të lartë të bankave në kredidhënie. Shpenzimet buxhetore kanë rënë me rreth 0.3% në terma vjetorë, të diktuara kryesisht nga tkurrja e shpenzimeve kapitale. Edhe të ardhurat e mbledhura gjatë vitit rezultojnë me rënie, duke çuar në reduktimin e deficitit buxhetor me rreth 1.2% në krahasim me vitin 2011. Megjithatë, politika fiskale ka marrë natyrë stimuluese në tremujorin e katërt, e materializuar në rritjen me 35% të deficitit buxhetor në këtë periudhë. Ndonëse në terma të ulët, shpenzimet publike pritet të kenë një kontribut pozitiv në aktivitetin ekonomik të vitit 2013.

Politika monetare forcoi natyrën e saj lehtësuese në muajin janar, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në nivelin më të ulët historik prej 3.75%. Ky lehtësim është përcjellë në normat e interesit të tregut ndërbankar gjatë muajit shkurt, ndërkohë që në vazhdim pritet të shohim një tejçim të saj edhe në segmentet e tjera të tregut financiar.

Kërkesa e ulët e qeverisë për financim ka ushtruar presione rënëse mbi yield-et e letrave me vlerë të qeverisë.

Në tërësi, zhvillimet monetare dhe financiare tregojnë për presione të ulëta të inflacionit dhe të rrezikut të likuiditetit. Treguesit monetarë kanë vijuar ngadalësimin edhe në muajin dhjetor. Rritja vjetore e ofertës së parasë zbriti në 5.0%. Burimi kryesor i rritjes së parasë ishin zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë, ndërkohë që kërkesa e sektorit të brendshëm për para ka qenë e ulët. Kërkesa relativisht e ulët e qeverisë për financim dhe rritja e interesit të individëve për të investuar në tituj të borxhit publik është reflektuar në rënien e financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar. Gjithashtu, kredia për ekonominë ka shënuar norma të ulëta të rritjes vjetore, si për bizneset, ashtu edhe për individët. Përdorimi i monedhës vendase përkundrejt asaj të huaj në tregun e kredisë është rritur, duke mundësuar një përcjellje më të mirë të sinjaleve të politikës monetare në ekonomi.

Informacioni i ri i marrë deri tani rikonfirmon projeksionet tona për zhvillimet e ardhshme ekonomike.

Rritja ekonomike në periudhën në vazhdim do të jetë e kushtëzuar nga ecuria e ekonomisë botërore dhe e partnerëve tanë tregtarë, nga natyra e politikës fiskale dhe nga rritja e produktivitetit. Aktiviteti ekonomik pritet të vijojë të jetë i dobët edhe gjatë vitit 2013. Ai do të vazhdojë të mbështetet nga rritja e eksporteve neto, por në një masë më të vogël se ajo e vitit që lamë pas. Ky parashikim mbështetet në vlerësimet jo-inkurajuese për aktivitetin ekonomik në vendet partnere, por ai reflekton gjithashtu edhe shkallën e ulët të diversifikimit të eksporteve tona. Kërkesa e brendshme pritet të mbetet në nivele të ulëta, duke reflektuar dobësinë e konsumit dhe të investimeve private dhe një kontribut pozitiv të sektorit publik. Duke faktorizuar të gjithë informacionin e disponuar, Banka e Shqipërisë vlerëson se, me një probabilitet

90%, inflacioni i çmimeve të konsumit parashikohet të luhatet në intervalin 0.8 – 3.8% pas 12 muajsh.

Ky vlerësim faktorizon projeksionet tona për vazhdimësinë e hendekut negativ të prodhimit, për presione të dobëta nga çmimet në tregjet botërore dhe për pritje të ankoruara të agjentëve ekonomikë.

Si konkluzion, Banka e Shqipërisë vlerëson se presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta gjatë horizontit afatmesëm.

***

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ndjekë një politikë monetare stimuluese, për sa kohë që presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta. Kushtet monetare stimuluese mbështesin rritjen e kërkesës agregate dhe shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese, duke krijuar premisat për respektimin e objektivit të inflacionit në afat të mesëm.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në forumin "Kreditimi i ekonomisë dhe shëndeti afatgjatë i sistemit bankar",
4 mars 2013

Të nderuar pjesëmarrës,

Duke ju uruar mirëseardhjen më lejoni të them dy fjalë në lidhje me rëndësinë e këtij takimi. Banka e Shqipërisë vlerëson se komunikimi i vazhdueshëm dhe i hapur me industrinë bankare dhe komunitetin e biznesit përbën një kusht të domosdoshëm për garantimin e një qëndrueshmërie më të madhe makroekonomike dhe financiare të vendit. Këto takime shërbejnë si platforma për të prezantuar nisma dhe vendime të natyrës strategjike, ndikimi i të cilave është i drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik dhe financiar të të dy komuniteteve që përfaqësohen në këtë takim. Për këtë arsye, ky është një forum i hapur ku analiza, përfundimet dhe vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë do të ballafaqohet me analizat dhe përfundimet e nxjerra nga dy grupimet e tjera.

Ajo çka besoj se do të arrihet në përfundim të takimit, do të jetë një mirëkuptim dhe një ndarje përgjegjësish për të dhënë një stimul të ri gjallërimit të aktivitetit ekonomik të vendit, nëpërmjet riaktivizimit të kanalit të kreditimit të ekonomisë. Në këtë mënyrë më lejoni të bëj publik dhe çështjen kryesore në të cilën do të ndalet forumi i sotëm: kreditimi i ekonomisë dhe stabiliteti afatgjatë i sistemit bankar. Ky takim, përveç diskutimit profesional mbi këtë çështje, do të shërbejë dhe për prezantimin e një nisme të re të Bankës së Shqipërisë, të cilën do ta quaja paketa e Bankës së Shqipërisë për gjallërimin e kredisë.

Më lejoni të ndalëm më në detaje rreth kësaj çështjeje , duke e ndarë fjalimin tim në tre pjesë kryesore:

- një fotografim i shpejtë i zhvillimeve më të fundit ekonomike dhe financiare në vend;
- një vështrim në retrospektivë i përballjes së ekonomisë sonë me krizën globale; dhe
- paketa e masave që propozojmë për gjallërimin e kredisë për ekonominë.

EKONOMIA SHQIPTARE GJATË VITIT 2012

Viti 2012 ishte një vit sfidues për zhvillimin ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare shënoi rritje pozitive dhe ekuilibrat ekonomikë e financiarë të saj vlerësohet të jenë të qëndrueshëm. Por, rritja ekonomike ka ndjekur një

trajektore të qartë ngadalësuese gjatë katër viteve të fundit dhe problemet të cilat kanë kushtëzuar këtë ecuri vazhdojnë të jenë të pranishme.

Sikurse e kemi bërë të ditur në vazhdimësi, aktiviteti ekonomik në vend vuan nga mungesa e kërkesës finale për mallra e shërbime. Në veçanti, konsumatori dhe biznesi shfaqen hezitues për të konsumuar dhe investuar, si pasojë e rritjes së pasigurisë dhe kushteve më të shtrënguara të financimit. Kjo mungesë kërkese reflektohet në mos-shfrytëzim të plotë të kapaciteteve prodhuese, duke u përcjellë më tej në rritje të ulët ekonomike, në dobësi të tregut të punës, në vështirësi financiare të bizneseve dhe në përkeqësim të treguesve të cilësisë së kredisë.

Ndonëse kredia me probleme u ngjit në 22.5% të totalit të kredisë në fund të vitit 2012, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm. Treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë qëndrojnë në nivele të mira. Rezultati financiar ishte dukshëm më i mirë se në vitin 2011.

Depozitat dhe kreditë u rritën në krahasim me vitin 2011, por ritmi i rritjes së tyre ka qenë më i ngadaltë. Veçanërisht i ndjeshëm ka qenë ngadalësimi i kreditimit, i cili gjatë vitit të kaluar u rrit me 2.1%. Kontribut në rritje ka dhënë vetëm kreditimi në lekë, ndërsa kreditimi në valutë është tkurrur në krahasim me një vit më parë. Bankat kanë rritur kujdesin në procesin e kreditimit, duke ndikuar në shtrëngimin relativ të ofertës së kredisë. Një ndikim të ndjeshëm në këtë drejtim ka dhënë shtrëngimi i normave mbikëqyrëse e rregullatore në nivel evropian, të cilat u përcollën në një frenim të aktivitetit kreditues në të gjitha vendet ku veprojnë bankat evropiane. Ky fenomen, i cili në terma teknikë njihet si ulje e ndërmjetësimit financiar apo ulje e "oreksit për rrezik", ka sjellë atë fenomen i cili sipas McKinsey-it njihet si "ballkanizim" i sistemit financiar evropian.

Ky fenomen, i hapur apo i fshehur, është mjaft i dëmshëm për perspektivat e zhvillimit të vendeve të rajonit dhe për procesin e integrimit evropian. Në këndvështrimin tonë, sistemi bankar duhet të jetë në pararojë të këtij procesi, duke ekspozuar avantazhet konkurruese të vendit pranë grupeve bankare mëma dhe duke tërhequr investitorë të huaj.

Në analizat e Bankës së Shqipërisë dobësia e kërkesës është identifikuar si problemi kryesor me të cilin përballet ekonomia shqiptare. Si institucion i mandatuar me ligj për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, kemi vlerësuar se rritja e dobët ekonomike mund të bëhet pengesë për përmbushjen e mandatit tonë në afat të mesëm. Për këtë arsye, kemi theksuar se politikat ekonomike të vendit duhet të kenë një kah stimulues.

Gjithashtu, vlerësojmë se politika fiskale përballet me mungesën e hapësirave për stimul fiskal dhe se ajo duhet të marrë një orientim në rritje drejt konsolidimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike. Në këto rrethana, kemi orientuar tërësisht politikat dhe instrumentet tona drejt nxitjes së konsumit dhe investimeve në vend. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka marrë një natyrë gjithnjë e më stimuluese. Banka e Shqipërisë

ka ndërmarrë gjashtë ulje të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit, duke e sjellë atë në nivelin minimal historik prej 3.75%. Njëkohësisht, kemi vijuar të furnizojmë sistemin bankar me të gjithë likuiditetin e kërkuar për të mbështetur aktivitetin e sektorit publik e privat. Paralelisht me këto masa, komunikimi ynë publik ka synuar të garantojë agjentët ekonomikë dhe tregjet financiare mbi ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare edhe në të ardhmen.

Në tërësi, politika monetare gjatë kësaj periudhe ka qenë e suksesshme në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë, por efekti i saj në stimulimin e ekonomisë ka qenë më i kufizuar. Tregu financiar dhe sistemi bankar nuk i kanë reflektuar plotësisht uljet e normës bazë të interesit në produktet e tyre kryesore; kredi; depozita e letra me vlerë të Qeverisë; ndërkohë që edhe biznesi e konsumatori shqiptar kanë qenë pak reagues ndaj stimujve monetarë dhe normave më të ulëta të interesit. Në opinionin tonë, kjo ecuri reflekton dy probleme themelore me të cilat po përballet ekonomia dhe politikat tona makroekonomike. Këto dy probleme janë, së pari, dobësitë strukturore të ekonomisë shqiptare dhe, së dyti, kufizimi që kanë instrumentet tradicionale të kontrollit ekonomik, politika monetare e fiskale, në nxitjen e kërkesës agregate dhe të rritjes ekonomike.

Trajtimi i diferencuar i tyre kërkon hartimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme strukturore që mbështesin sipërmarrjen, rrisin produktivitetin, përmirësojnë konkurrencën dhe mbështesin rritjen ekonomike. Gjithashtu, ai ilustron nevojën e marrjes së masave jotradicionale për nxitjen e kreditimit dhe mbështetjen e ekonomisë.

Me lejoni të ndalem shkurtimisht në shtjellimin e problemeve strukturore dhe të përqendrohem në vijim në nismën e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e sfidës së dytë.

EKONOMIA SHQIPTARE PËRBALLË KRIZËS BOTËRORE

Si të gjithë vendet në zhvillim, ekonomia shqiptare ka patur një rritje të shpejtë ekonomike në rrugën e saj të konvergjencës me ekonomitë e Bashkimit Evropian.

Në një masë të madhe kjo rritje është mbështetur nga rritja e shpejtë e konsumit në ekonomi dhe është financuar nga përdorimi i kursimeve të mëparshme apo nga burime të huaja financimi. Përfituesit kryesorë të kësaj kërkese kanë qenë sektorët e ndërtimit dhe të shërbimeve; dy sektorë, të cilët karakterizohen nga një përdorim intensiv të punës dhe sigurojnë rritje të pagave e të punësimit, por që janë pak të orientuar drejt eksporteve. Nga ana tjetër, sektorët e industrisë dhe të bujqësisë kanë patur një ecuri më të ngadaltë, duke vuajtur nga mungesa e vëmendjes së sistemit bankar, nga shkalla më e lartë e investimeve dhe e ekspertizës së kërkuar, si dhe nga koha më e gjatë e kthimit të investimit. Kjo tendencë e ka lënë Shqipërinë me një bazë të vogël të industrive të orientuara ndaj eksportit apo të atyre që konkurrojnë me produktet e importit.

Kriza botërore shërbeu si një test i rëndësishëm për këtë model zhvillimi. Ajo evidentoi kufijtë e tij për t'u përballur me goditje të huaja, si dhe kufizimet që ai ka në një mjedis botëror gjithnjë e më sfidues. Në terma më të thjeshtë, kriza botërore ilustroi rëndësinë që ka ruajtja e bilanceve të shëndosha, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Gjithashtu, ajo ilustroi se ekonomitë më konkurruese , të cilat arrijnë të konkurrojnë me sukses në tregjet botërore, janë ekonomitë që kanë norma më të larta e më të qëndrueshme zhvillimi. Me kënaqësi kam konstatuar se ky mësim është përvetësuar nga ekonomia shqiptare, si në nivel konsumatori ashtu edhe në nivel prodhuesi. Më konkretisht, familjet shqiptare kanë adoptuar një sjellje më të kujdesshme konsumatore dhe një prirje më të lartë drejt kursimit.

Në një horizont afatgjatë kjo është padyshim pozitive. Së pari, ajo garanton shëndetin e bilanceve individuale familjare dhe, së dyti, ajo mundëson një fond të mjaftueshëm kursimesh financiare për të mbështetur kredinë dhe investimet në vend.

Por, në horizontin afatshkurtër, ajo krijon mungesë kërkese dhe vështirësi në rritjen ekonomike të vendit. Nga ana tjetër, biznesi shqiptar mësoi se tregu i brendshëm ka aftësi të kufizuara për të gjeneruar rritje të qëndrueshme ekonomike. Për rrjedhojë, ai është duke i kushtuar një interes në rritje sektorëve të industrisë dhe të bujqësisë, si sektorë të cilët kanë një perspektivë më të mirë zhvillimi dhe treg më të madh.

E gjithë kjo situatë që përmenda ka implikime të rëndësishme për ritmin e zhvillimit të vendit dhe për politikat makroekonomike. Së pari, ajo nënkupton që potenciali i rritjes ekonomike të vendit është më i ulët në afatin e mesëm. Me fjalë të tjera, transferimi i burimeve financiare dhe njerëzore ndërmjet sektorëve, përvetësimi i teknologjive dhe praktikave më moderne të biznesit, si dhe eksplorimi e penetrimi i tregjeve të huaja, do të kërkojë kohë dhe do të kushtëzojë ritmin e rritjes ekonomike të vendit. Për më tepër, ky zhvillim përballet me ambientin e pafavorshëm të huaj, me koston relativisht të lartë të fondeve dhe me mungesën e kërkesës së brendshme. Rikuperimi i ritmeve të mëparshme të zhvillimit do të kërkojë kohë. Së dyti, prirja në rritje drejt kursimit dhe rritja e primeve të rrezikut kufizojnë aftësinë e politikës monetare që nëpërmjet uljeve të normës bazë të interesit, të gjenerojë kërkesë shtesë në ekonomi.

Njëkohësisht, zhvillimet në ekonominë globale janë optimiste. Eurozona dhe monedha evropiane duken më të konsoliduara, si rezultat i kontributit të Bankës Qendrore Evropiane dhe përpjekjeve për konsolidim fiskal në nivel kombëtar. Megjithatë, optimizmi është i brishtë. Bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara janë shprehur qartë se do të vazhdojnë lehtësimin sasior monetar (*quantitative easing*) për sa kohë inflacioni të mbetet nën objektiv dhe papunësia në nivele të larta.

Aktualisht, zgjidhjet e deritanishme kanë ardhur në forma të pa provuara më parë. Në fakt ato përfaqësojnë sfida të reja, për sa i përket zbatimit dhe efekteve anësore të rrezikut potencial, që ato projektojnë në periudhën afatgjatë.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë, pasi e vlerëson situatën si shumë komplekse dhe pas një pune intensive, ka arritur të dizenjojë një paketë të plotë masash. Ato synojnë rigjallërimin e kreditimit dhe përmirësimin e ekuilibrave mikro e makroekonomik të financimit të ekonomisë, me të cilën do t'ju njoh në vijim.

PAKETA PËR GJALLËRIMIN E KREDISË

Ideimi i paktës që po prezantojmë sot e ka fillesën e saj vitin e kaluar, kur bashkëristh, me ju dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë diskutuam në lidhje me modifikimet e duhura ligjore për nxitjen e ekzekutimit të kolateralit. Që nga ai takim, specialistët tanë kanë punuar intensivisht për ta pasuruar atë deri në formën që po e sjellim sot para jush.

Paketa konsiston në tre kolona: kolonën ligjore, kolonën e politikës monetare dhe kolonën prudenciale. Në vijim do të ndalem në trajtimin e së cilës prej tyre.

1 – Kolona ligjore

Rritja e shpejtë e kredive me probleme këto vitet e fundit, ndërmjet të tjerash, pasqyron dhe një sërë problemesh të njohura dhe të panjohura më parë në lidhje me ekzekutimin e kolateralit. Për këtë qëllim, së bashku me industrinë bankare, kemi identifikuar dhe bërë propozimet përkatëse për një efektivitetit më të lartë në procesin e ekzekutimit të kolateralit. Përmes konsultave me aktorë të tjerë të rëndësishëm në proces, u përgatiten ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Civil.

Këto ndryshime mundësojnë realizimin më të shpejtë të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, duke shmangur zgjatjet procedurale të shkaktuara nga debitorët e bankave.

Me konkretisht, ndryshimet e propozuara konsistojnë në:

- mosmarrjen e masave nga ana e gjykatave për sigurimin e padisë, në rastin e kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor;
- mosmarrjen e masës së sigurimit të padisë dhe mospezullimin e ekzekutimit të kolateralit nga ana e gjykatës, në rast se debitori kërkon pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, rrjedhur nga një kredi bankare;
- uljen e vlerës me 50% të çmimit fillestar të pasurisë së paluajtshme, duke vendosur një mesatare të pranueshme për debitorin dhe bankën, si dhe duke bërë më të qartë vlerën (çmimin) e sendit me të cilin do të fillohet në ankandin e dytë.

Nga komunikimet me Ministrinë e Drejtësisë, jemi në dijeni që ndryshimet e mësipërme janë në proces finalizimi dhe pritet që kjo paketë ligjore të përcillet për miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave, e më pas në Kuvendin e Shqipërisë. Shfrytëzoj këtë mundësi për të shprehur nevojën që këto

propozime ligjore të miratohen në Kuvendin e Shqipërisë, në një kohë sa më të shpejtë. Përmirësimet e kuadrit ligjor dhe të praktikës në ekzekutimin e kolateralit, mund t'i prezantonin autoriteteve publike, hapësira të reja për nxitjen e kreditimit në vend.

2 – Kolona e politikës monetare

E përmenda më sipër se politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë në krahun lehtësues kohët e fundit, duke ndërmarrë 6 ulje të një pas njëshme të përqindjes bazë të interesit.

Niveli i marrëveshjeve të riblerjes me maturim një javor, pas uljes së fundit të bërë në fund të muajit janar 2013, arriti vlerën më të ulët historike në nivelin 3,75%. Bëhet fjalë për një vlerë rekord, jo vetëm përsa i takon aspektit historik të saj, por edhe nëse e krahasojmë atë me të gjithë ekonomitë e tjera të rajonit, përfshirë dhe shumicën e anëtarëve të rinj të BE-së. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

Megjithatë, nga këndvështrimi i këtij takimi rëndësi paraqet e ardhmja e politikës monetare. Siç u përmend dhe në deklaratën e fundit të Këshillit Mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ndjekë një politikë monetare stimuluese, për sa kohë që presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta. Për më tepër, do të doja të siguroja sistemin bankar se kuadri operacional i ofruar prej nesh do të ruaj të njëjtin karakter stimulues. Ai do të synojë të shmangë çdo formë tensioni, qoftë dhe sporadike, nga ana e bankave, në lidhje me mjaftueshmërinë e likuiditetit në treg, si përsa i takon sasisë, ashtu dhe përsa i takon çmimit dhe maturitetit.

3 – Kolona prudenciale

Ndërkohë që dy shtyllat e para kanë një ndikim më të tërthortë dhe më të shtrirë në kohë, kolona e prudenciale do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në gjallërimin e kredisë. Bëhet fjalë për një sërë masash të cilat do të çlirojnë burime financiare tek bankat dhe do t'i nxisin ato t'i kanalizojnë këto burime drejt kreditimit. Në themel të këtyre masave qëndrojnë ndryshimet rregullative, që mundësojnë:

- uljen e kërkesave për aktive likuide të bankave; dhe
- ndryshimin e koeficienteve të rrezikut, të strukturës së investimeve për të mbështetur kredidhënien.

Ulja e kërkesës për aktive likuide të bankave, mund të realizohet pa cënuar stabilitetin e sistemit, pasi niveli i tyre është përgjithësisht më i lartë se ai i standardeve ndërkombëtare dhe i bankave në rajon. Për më tepër, në kushtet kur bankat që veprojnë në vend e kanë origjinën e tyre kryesisht nga Evropa, kjo ulje mund të bëhet në kushtet kur perceptimi i rrezikut në tregjet financiare evropiane ka rënë. Sidoqoftë, kjo ulje do të jetë e kontrolluar dhe e zbatuar

sipas profilit të rrezikut për çdo bankë. Kjo do të thotë që megjithëse ulja mund të jetë e përgjithshme, niveli i kërkuar i aktiveve likuide, sipas valutave dhe në tërësi, mund të jetë i ndryshëm në banka të ndryshme.

Ndryshimi i koeficienteve të rrezikut në strukturën e investimeve do të behet në mënyrë të tillë që kapitali i bankave të mbështesë më mirë zhvendosjen e burimeve të tyre drejt kreditimit. Më konkretisht, propozohet që koeficientet e rrezikut që përdoren për llogaritjen e kapitalit të bankave, të rriten ndjeshëm për flukset e reja të investimeve që bankat kryejnë me subjektet jorezidente.

Kjo rritje e koeficienteve të rrezikut mund të kryhet edhe për një pjesë të stokut të investimeve të bankave, me subjektet jorezidente, duke marre në konsiderate:

- kërkesat rregullative për aktive likuide;
- mbulimin e mjaftueshëm të detyrimeve që bankat kanë ndaj subjekteve jorezidente; si edhe
- kohën e nevojshme që kjo zhvendosje të mos shkaktojë mbingarkesë operacionale tek bankat.

Nga ana tjetër, koeficientet e rrezikut mund të ulen tek bankat për sasinë e kredisë së re që i shtohet stokut ekzistues, për një periudhë kohe të caktuar. Në këtë mënyrë, zhvendosja e synuar e fondeve drejt kreditimit në vend, mund të kryhet edhe nga ato banka që kanë një nivel më të ulët të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Këto masa nuk janë administrative. Vendimi për të realizuar zhvendosjen e fondeve drejt kreditimit të sektorit privat në vend, do të mbetet një vendimmarrje e vetë bankës. Si për çdo rast tjetër, banka duhet të vërë në balancë të gjithë faktorët që përcaktojnë rreziqet, kostot dhe përfitimet nga kjo zhvendosje.

Zbatimi i masave të mësipërme, kërkon një ndryshim të kuadrit rregullativ ekzistues, i cili do të rrijë në fuqi për një afat kohor të përkohshëm. Më pas, gradualisht, bankat duhet t'i kthehen zbatimit të kërkesave të kuadrit rregullativ ekzistues, për sa i takon mënyrës së llogaritjes së kërkesave për kapital. Në këtë mënyrë, në ruajmë në çdo kohë tek bankat stimulin e nevojshëm për të kredituar në mënyrë të kujdesshme.

Duke u ndalur me hollësisht tek nevoja për trajtimin e kredive me probleme, vlerësojmë se ajo përfaqëson një shqetësim për industrinë bankare dhe për Bankën e Shqipërisë. jo aq për qëndrueshmërinë e sistemit, por më tepër për kostot që ky fenomen sjell për veprimtarinë bankare dhe për konsumatorët e shërbimin ndaj tyre.

Gjithashtu, autoritetet publike mund të ndërmarrin masa në këtë drejtim. Gjej rastin të mbështes edhe një herë nevojën për shlyerjen e detyrimeve të sektorit publik ndaj firmave private. Kjo do të kontribuonte pozitivisht në shlyerjen e një pjese të detyrimeve që këto firma, ose të tjera të lidhura me to, kanë ndaj sektorit bankar, e duke sjelle kështu zbutjen e nivelit të kredive me probleme.

Paralelisht, ky proces duhet trajtuar në themel, për të ndërtuar një mekanizëm transparent dhe të qëndrueshëm që trajton faktorët që ndikojnë rritjen e detyrimeve të sektorit publik ndaj subjekteve private dhe shmang rritjen e tyre serish në të ardhmen.

Më tej, Banka e Shqipërisë do të ndryshojë kuadrin rregullativ, për të nxitur bankat që të mbështesin kërkesat për ristrukturim të kredisë nga kredimarrësit, që në momentin që kredia konsiderohet e mirë. Nëse bankat e realizojnë një gjë të tillë në mënyrë efektive, atëherë ato do të kenë një kosto më të ulët në drejtim të kërkesave për krijimin e fondeve rezervë për rrezikun e kredisë.

Ky element do të mundësojë që bankat të trajtojnë në mënyrë më të kujdesshme dhe proaktive klientët më të mirë, të cilët mund të jenë duke shfaqur problemet e tyre të para në shlyerjen e kredisë për shkak të faktorëve që janë jashtë kontrollit të tyre.

Si një element kontrolli për këtë veprim, kuadri rregullativ do të parashikojë qëndrimin e përkohshëm të kredisë së ristrukturuar në këtë kategori (apo në kategorinë standarde) dhe kalimin e saj të menjëhershëm në kategorinë e një cilësie më të ulët, nëse cilësia e kredisë bie pas ristrukturimit. Theksoj se Banka e Shqipërisë, pas një konsultimi të gjerë me bankat, ka përgatitur udhëzimet përkatëse që duhet t'i orientojnë ato në procesin e ristrukturimit të borxhit.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë konstaton që një pjesë e kredive me probleme, kryesisht atyre të humbura, qëndrojnë në bilancin e bankave për shkak të interpretimit të ndryshëm që industria bankare dhe autoritetet e tatim-taksave kanë për nisjen dhe përfundimin e procesit ligjor ndaj subjektit debitor kredimarrës.

Eliminimi i këtyre kredive nga bilanci i bankave në mungesë të bashkërendimit të këtij interpretimi, sjell pasoja për ngarkesën tatimore të bankave dhe rrjedhimisht pengon fshirjen e kredive të humbura nga bilanci, duke e fryrë nivelin e kredive me probleme dhe duke angazhuar kapacitetet e bankave në mënyrë joeficiente.

Për këtë arsye, gjej rastin për të theksuar nevojën që industria bankare dhe autoritetet fiskale, të identifikojnë faktorët që çojnë në interpretime të ndryshme të këtij problemi, si edhe të formulojnë zgjidhjet e të ndërmarrin përmirësimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore për zgjidhjen e tij në mënyrë përfundimtare. Banka e Shqipërisë është e interesuar dhe e gatshme të japë të gjithë ndihmën e nevojshme në këtë drejtim.

ROLI I BIZNESIT

Marrëdhënia mes biznesit dhe bankave, qëndron në themel të suksesit të veprimtarisë ekonomike. Gjithnjë, kjo marrëdhënie është e kushtëzuar nga zhvillimet në mjedisin ekonomik rrethues. Aktualisht, jo të gjithë sektorët e

ekonomisë janë të ndikuar nga ngadalësimi saj në mënyrë të njëjtë dhe jo të gjitha bizneset përballen me të njëjtat probleme.

Sidoqoftë, në përgjithësi bizneset ndeshen sot me një rënie të vëllimit të aktivitetit dhe të të ardhurave. Disa prej tyre përballen me nevojën për të ristrukturuar veprimtarinë, jo vetëm nëpërmjet uljes së kostove dhe përmirësimit të eficiencës, por edhe në drejtim të hyrjes në tregje dhe produkte të reja.

Për të realizuar këtë proces, nuk mjafton vetëm instinkti dhe vullneti i pronarëve, por kërkohet ekspertizë profesionale, projekte të mirëstudiuara dhe financime shtesë ose ristrukturim i borxhit ekzistues. Mendoj se në këtë proces, partneriteti mes biznesit dhe bankës është i domosdoshëm. Në fakt, gjithnjë e më shumë bankat po zhvillojnë kapacitetet e tyre të konsultimit financiar dhe njëherazi po zhvillojnë edhe produktet e nevojshme bankare për të qenë me pranë biznesit. Gjithashtu, bankat janë aktivizuar gjithnjë e më shumë në procesin e ristrukturimit të kredisë së dhënë sektorit të biznesit.

Megjithatë, palët kanë edhe ankesa për njëri-tjetrin. Kështu, biznesi ankohet se bankat janë dorështrënguara dhe shpesh financimi nuk përputhet si duhet me ciklin e veprimtarisë së tyre.

Nga ana tjetër bankat, evidentojnë mungesën e projekteve të besueshme në kërkesat për financim që vijnë nga biznesi dhe mangësitë ne informacionin financiar që kërkohet për vendimmarrje.

Banka e Shqipërisë beson që marrëdhënia mes biznesit dhe bankave do të zhvillohej në dobi të vetë palëve nëse ato:

- arrijnë në një kuptim më të mirë të profilit të veprimtarisë, kushteve të tregut dhe kërkesave rregullative që përcaktojnë veprimtarinë e secilit;
- hyjnë në një marrëveshje bashkëpunimi, mbi bazën e një informacioni që është transparent, i plotë dhe profesional;
- veprojnë në mënyrë proaktive për të identifikuar situatat kur kjo marrëveshje duhet rishikuar, për të përmirësuar mundësitë për shlyerjen e detyrimeve ndaj njëri-tjetrit.

Masat që propozon sot Banka e Shqipërisë, e mbështesin nevojën për një marrëdhënie më të ngushtë midis bankave dhe biznesit, në situatën ekonomike që kalon vendi. Ato zgjerojnë hapësirën e bankave për një fleksibilitet më të madh në procesin e ristrukturimit të kredisë. Megjithatë, theksoj se bankat nuk do të financojnë bizneset që janë të dështuara apo që veprojnë në mënyrë jotransparente e me informacion të cunguar. Kjo marrëdhënie më e ngushtë, nënkupton gjithashtu nevojën paraprake që bankat të shfrytëzojnë në mënyrë më efektive për analizën e tyre, të gjithë informacionin që ekziston ndaj kredimarrësve ekzistues dhe të rinj, prej burimeve të tilla si Regjistri i Kredive.

Bankat duhet të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme afatgjata me biznesin për të rritur konsulencën dhe financimin, veçanërisht përsa i takon biznesit të vogël dhe atij të mesëm.

PËRFUNDIME

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se situata ekonomike dhe financiare që po kalon ekonomia e vendit, kërkon të ruhet ritmi i ndërmjetësimit financiar dhe të trajtohet me përparësi çështja e kredive me probleme. Bashkëveprimi i deritanishëm me autoritetet e tjera publike ka qenë i mirë dhe ne presim zhvillime konkrete në drejtim të fillimit të procesit të shlyerjes së detyrimeve të sektorit publik ndaj firmave private, si edhe miratim të ndryshimeve të propozuara në legjislacion për përmirësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit. Banka e Shqipërisë propozoi sot disa masa të tjera, të cilat synojnë të stimulojnë bankat në procesin e kreditimit. Këto masa, të cilat do të reflektohen së afërmi në kuadrin rregullativ, kanë një natyrë kundërciklike dhe janë përgjithësisht të përkohshme.

Ky element, si dhe mekanizmat e nevojshëm kontrollues që i shoqërojnë këto masa, do të nxisin bankat të ruajnë detyrimin për të kredituar në mënyre të kujdesshme dhe të shëndetshme. Duke qenë se aktualisht veprimtaria e kreditimit ka rreziqe të shtuara, strukturat drejtuese të bankave dhe aksionaret duhet të sigurojnë që këto rreziqe afatshkurtra dhe afatmesme, mbulohen me sasinë e nevojshme të kapitalit. Efekti i këtyre masave do të përmirësohej nëse biznesi do t'i kuptonte dhe shfrytëzonte ato në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim, marrëdhënia mes biznesit dhe bankave duhet të ndërtohet vetëm mbi bazën e bashkëpunimit transparent dhe profesional. Kjo duhet të evidentohet mirë në media dhe në publik.

Banka e Shqipërisë do të vlerësojë efektin e këtyre masave dhe do të monitorojë zbatueshmërine e tyre në vazhdimësi. Në vijim të këtij procesi, në jemi të gatshëm t'i përshtatim ato me zhvillimet ekonomike dhe financiare ose t'i mbështesim me masa të tjera. Në themel të çdo veprimi të Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, do të qëndrojë stabiliteti i sistemit financiar.

Së fundi, dëshiroj t'u kujtoj të gjithë përfaqësuesve të sektorit privat prodhues e financiar, se nën efektet dhe ndikimin e krizës autoritetet publike, ligjvënëse, fiskale dhe monetare, kanë bërë ndryshime të rëndësishme në filozofi, objektiva dhe në vendimmarrje, larg konsideratave tradicionale. Këto ndryshime të përkohshme, kanë si qëllim kryesor absorbimin e efekteve të krizës, stabilizimin e ekonomisë, konsumit dhe investimeve private.

Paketa që prezantova sot është një shembull i mirë për të ilustruar këtë ndryshim. Është e nevojshme që edhe sektori privat të bëjë një përshtatje dhe korrektim të tille të përkohshëm.

Duke përsëritur thirrjen e zj. Lagarde, Drejtore e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në kushtet aktuale, objektivi i sektorit privat nuk duhet të jetë vetëm fitimi, por edhe krijimi i vendeve të punës, krijimi i vlerës së shtuar, krijimi i ideve të reja dhe përmes tyre stabilizimi i ekonomisë. Rritja e punësimit dhe e të ardhurave nga puna do të thotë më shumë konsum e investime, më shumë kërkesë konsumatore për mallra shërbime e mjete financimi. Ekonomia ka nevojë për një sektor privat dhe financiar të përgjegjshëm përkundrejt

ekonomisë reale, për një sektor privat që mbështet punëmarrësit dhe konsumatorin, për një sektor financiar që krijon vlera dhe jo që i shkatërron ato.

Në mbyllje të fjalës sime, dëshiroj të ndaj me ju një mesazh të rëndësishëm: kriza erdhi si një krizë globale dhe zgjidhja e plotë e saj do të jetë si e tillë. Megjithatë, çdo vend duhet të bëjë detyrat e shtëpisë dhe të ndërmarrë reformat e duhura strukturore për kalimin e saj.

Njerëzit e pranojnë ndryshimin vetëm në nevojë dhe e kuptojnë nevojën vetëm gjatë një krize- tha Zhan Mone, ideatori i Bashkimit Evropian.

Ju faleminderit dhe suksese në punën tuaj!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
27 mars 2013

Sot, në datën 27 mars 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e aktivitetit ekonomik.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

***

Inflacioni vjetor në muajin shkurt rezultoi 2.5%, duke rënë me 0.2 pikë përqindje në krahasim me vlerën e shënuar një muaj më parë. Ndikimin kryesor në rënien e inflacionit e ka patur reduktimi i çmimit të naftës, si pasojë e efektit bazë të rritjes së taksave të mjedisit gjatë vitit të shkuar dhe uljes së çmimeve në tregun ndërkombëtar. Në tërësi, ecuria e inflacionit vijon të përcaktohet nga rritja e çmimeve të mallrave ushqimorë; inflacioni i tyre ka përbërë rreth 90% të vlerës totale të inflacionit në muajin shkurt. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tjera të shportës kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme, duke dhënë një kontribut të ulët në inflacionin total.

Në aspektin makroekonomik, kushtet e përgjithshme ekonomike e monetare kanë favorizuar ruajtjen e inflacionit në nivele të ulëta.

Në veçanti, kërkesa agregate shfaqet e dobët dhe nuk arrin të gjenerojë një shfrytëzim të plotë të kapaciteteve prodhuese, duke mos ushtruar presione për rritje të kostove të prodhimit, të marzhave të fitimit dhe për rrjedhojë, të çmimeve finale të mallrave dhe të shërbimeve. Sikurse e kemi thënë në vazhdimësi, rritja ekonomike nën potencial është dhe do të vijojë të mbetet faktori me ndikim kryesor në nivelin e ulët të inflacionit. Paralelisht me të, ecuria e çmimeve në tregjet botërore, gjendja e likuiditetit në ekonomi dhe në tregjet financiare shqiptare, si dhe pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin, nuk kanë dhe nuk pritet të gjenerojnë presione të forta inflacioniste në afat të mesëm.

Të dhënat indirekte mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik për tremujorin e katërt të vitit të kaluar sugjerojnë për një rritje të ngadaltë ekonomike. Kërkesa

agregate është mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve, ndërkohë që kërkesa e brendshme private vlerësohet të ketë dhënë një kontribut pozitiv, por të ulët. Nga ana tjetër, shpenzimet e sektorit publik janë tkurrur, duke dhënë një kontribut negativ në rritjen e kërkesës agregate.

Informacioni për zhvillimet ekonomike në tremujorin e parë të këtij viti është i pakët. Megjithatë, analiza e treguesve indirektë të disponuar sugjeron për vazhdimin e një kërkesë të dobët agregate dhe rritje ekonomike nën potencial. Aktiviteti ekonomik është mbështetur më së shumti nga kërkesa e huaj dhe një stimul më i lartë fiskal, ndërkohë që kontributi i konsumit dhe i investimeve private mbetet i ulët. Konsumi dhe investimet private vazhdojnë të vuajnë nga pasiguria e përgjithshme për të ardhmen, nga ngadalësimi i rritjes së të ardhurave të disponuara, nga prania e kapaciteteve të pashfrytëzuara të prodhimit, si edhe nga kushtet relativisht të shtrënguara të financimit. Këta faktorë janë reflektuar në orientimin në rritje të familjeve shqiptare drejt kursimit dhe në hezitimin e bizneseve për të kryer investime.

Kërkesa e huaj dhe kushtet e favorshme klimaterike kanë sjellë rritjen e eksporteve shqiptare me rreth 34.6% në muajin janar. Në prani edhe të ecurisë së dobët të konsumit e investimeve në vend, e cila është reflektuar në rënien me 8.1% të importeve në këtë periudhë, kjo tendencë ka ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të pozicionit të jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Kështu, deficiti tregtar i vendit është ulur me 32.5% në këtë muaj. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë janë reflektuar në raporte të përmirësuara të kërkesës dhe të ofertës për valutë, çka ka përcaktuar më tej një sjellje të qëndrueshme të kursit të këmbimit.

Politika fiskale ka shfaqur natyrë lehtësuese në dy muajt e parë të vitit, të shprehur në rritjen e shpenzimeve publike dhe në zgjerimin e deficitit buxhetor. Shpenzimet buxhetore shënuan një rritje vjetore prej 1.3% në këta dy muaj, rritje kjo e reflektuar si në zërin e shpenzimeve korrente ashtu edhe në atë të shpenzimeve kapitale. Të ardhurat buxhetore vijojnë të tkurren, nën ndikimin e ecurisë së plogësht të ekonomisë, duke shënuar një rënie vjetore prej 0.8% në këta dy muaj. Kjo ecuri e shpenzimeve dhe të ardhurave publike është materializuar në rritjen e deficitit fiskal me rreth 5.1% për këta dy muaj.

Duke reflektuar mbi zhvillimet e pritura ekonomike e financiare, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka marrë një natyrë gjithnjë e më stimuluese.

Nëpërmjet uljeve të vazhdueshme të normës bazë të interesit si dhe injektimit të likuiditetit në tregun bankar, Banka e Shqipërisë ka synuar të krijojë kushte monetare më të përshtatshme për respektimin e objektivit të saj të inflacionit në afat të mesëm. Ecuria e tregut financiar tregon për presione të ulëta të likuiditetit dhe të inflacionit, të cilat kanë mundësuar përcjelljen e lehtësimit monetar në tregun e parasë dhe në atë primar. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë reflektuar shpejt uljen e fundit të normës bazë dhe yield-et e letrave me vlerë të borxhit publik kanë vijuar të bien. Rënia e normave të interesit është reflektuar më shumë në tregun e depozitave se në

atë të kredive, duke sinjalizuar për një sjellje më konservatore të bankave në kreditim dhe për një sektor real më shumë të orientuar drejt kursimit.

Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet e ekonomisë reale dhe presionet inflacioniste me natyrë monetare mbeten të ulëta. Oferta monetare në ekonomi është ngadalësuar më tej në muajin janar, duke shënuar një rritje vjetore prej 4.9%.

Ngadalësimi i masës monetare ka reflektuar kërkesën e ulët të bizneseve dhe individëve për financim, si edhe reduktimin e financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar. Rritja vjetore e kredisë për ekonominë vijon të ngadalësohet, duke regjistruar nivele të ulëta historike, prej 2.1% në muajin janar. Ecuria e plogësht e kredisë vihet re për të gjitha kategoritë dhe monedhat e financimit, si tek individët ashtu edhe tek bizneset.

***

Informacioni i ri i disponuar këtë muaj nuk ndryshon projeksionin tonë bazë për ecurinë e ekonomisë në vitin në vazhdim, por ai evidenton zhvendosje të balancës së rreziqeve në kahun e poshtëm. Aktiviteti ekonomik pritet të rritet me norma të ulëta e nën potencial, duke reflektuar ngadalësimin e kërkesës së huaj, ecurinë e dobët të konsumit e investimeve private dhe një stimul pozitiv fiskal bazuar në buxhetin e planifikuar për këtë vit.

Presionet inflacioniste parashikohen të mbeten të ulëta, në prani të hendekut negativ të prodhimit dhe në mungesë të presioneve nga tregjet botërore dhe kushtet e likuiditetit në ekonominë shqiptare.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Tabloja e zhvillimeve ekonomike e financiare brenda dhe jashtë vendit përcakton vazhdimin e ciklit lehtësues të kushteve monetare përgjatë horizontit kohor të politikës monetare. Një politikë e tillë, krijon kushtet e nevojshme për respektimin e objektivit të inflacionit në afat të mesëm, duke mbështetur njëkohësisht rritjen e kërkesës agregate dhe shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese në ekonomi.

Këshilli Mbikëqyrës, në mbledhjen e sotme, vendosi për ndryshimin e disa rregulloreve të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e sistemit bankar.

Në tërësinë e tyre, këto ndryshime fuqizojnë mekanizmin e transmetimit të politikës monetare dhe krijojnë kushte më të mira për rritjen e kredisë. Në këtë aspekt, këto ndryshime harmonizohen mirë me kahun lehtësues të politikës monetare dhe i shërbejnë stimulimit të aktivitetit ekonomik në vend. Më konkretisht, ndryshimet e miratuara rritin shkallën e lejuar të përdorimit të likuiditetit nga sistemi bankar, si dhe krijojnë hapësira më të mëdha për përdorimin e levës financiare nga sistemi bankar. Të dy këto nisma mbështesin direkt një rritje më të shpejtë kredie në ekonomi.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat
për Prezantimin e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012,
09.04.2013

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Dëshiroj ta filloj këtë takim duke ju shprehur vlerësimin maksimal për mundësinë e dhënë që, në emër të Bankës së Shqipërisë, t'ju bëj një pasqyrë të punës dhe rezultateve të bankës qendrore gjatë vitit të shkuar. Gjithashtu, ky takim shërben për të ndarë me ju opinionet tona mbi zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare, si dhe për të parashtruar disa nga sfidat të cilat sipas Bankës së Shqipërisë meritojnë vëmendje në të ardhmen.

Që në fillim, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka arritur të përmbushë detyrat e saj ligjore, gjatë vitit 2012. Çmimet e konsumit kanë qenë të qëndrueshme, sikurse shprehet nga një nivel mesatar inflacioni prej 2% gjatë vitit. Po kështu, shëndeti i sistemit financiar, në nivel makro e mikroekonomik, është përmirësuar.

Këto dy objektiva madhorë të Bankës së Shqipërisë janë arritur pavarësisht ambientit të pafavorshëm të brendshëm e të jashtëm, si dhe goditjeve që ka pësuar ekonomia shqiptare gjatë kësaj periudhe. Përmbushja e tyre ka reflektuar në një masë të madhe politikën e kujdesshme monetare të Bankës së Shqipërisë, si dhe masat rregullatore dhe politikën tonë mbikëqyrëse të sistemit bankar. Ato janë favorizuar nga përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së pagesave financiare, nga operacionet e kujdesshme dhe eficiente të administrimit të likuiditetit dhe nga komunikimi transparent me publikun. E gjithë puna jonë është mbështetur nga përmirësime cilësore në fushën e edukimit financiar të publikut, nga studimi analitik i një morie fenomenesh dhe çështjesh me interes për zhvillimin e vendit, si dhe nga prodhimi i statistikave financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare. Së fundi, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë një aktor serioz dhe i rëndësishëm në projektin e integrimit të vendit, nëpërmjet plotësimit dhe përditësimit të të gjitha detyrave të saj ligjore dhe angazhimeve institucionale.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në vijim të fjalës time do të bëj një trajtim më të detajuar të çështjeve kryesore të Raportit Vjetor, duke u fokusuar në drejtimet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të shkuar. Fjalimin po e filloj me punën dhe rezultatet tona në përmbushjen e objektivit kryesor: arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

1. ZHVILLIMET EKONOMIKE, STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2012

Sikurse e thashë në hyrje të fjalës , viti 2012 ishte një tjetër vit i vështirë për ekonominë shqiptare. Dobësitë e partnerëve tanë tregtarë e financiarë janë manifestuar në një kërkesë të ulët për eksportet shqiptare, në kushte të shtrënguara financimi për kapitalin e huaj dhe në pasiguri të shtuara tek agjentët ekonomikë. Po ashtu, ekonomia shqiptare vijon të përballet me një kërkesë të dobët të brendshme, si në sektorin publik dhe në atë privat.

Përtej këtyre faktorëve, aktiviteti ekonomik në vend u përball edhe me dy goditje specifike gjatë vitit të shkuar. Kështu, moti i keq i tremujorit të parë u reflektua në një aktivitet të ngadaltë të sektorit të ndërtimit dhe të eksportit në këtë periudhë. Ndërkohë, goditja tjetër, e cila pati më tepër rëndësi dhe ndikim, ka qenë reagimi i sistemit bankar ndaj masave të reja dhe më të shtrënguara rregullatore të EBA-s (Autoritetit Evropian të Mbikëqyrjes). Efekti direkt i kësaj goditjeje në tregjet financiare dhe veçanërisht në atë të letrave me vlerë të qeverisë, përafrohet rreth nivelit 2% të PBB-së. Megjithatë, ndikimi indirekt i tyre ishte edhe më i madh. Ashtu si dhe në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore, bankat që origjinojnë nga vendet e Eurozonës adoptuan sjelljeje më konservatore, e cila u manifestua në ngadalësim të mëtejshëm të kreditimit përgjatë vitit.

Në reflektim të tyre, ekonomia shqiptare u ngadalësua më tej gjatë vitit të shkuar, duke lënë kapacitete të pashfrytëzuara në tregjet e punës e të kapitalit.

Ky zhvillim u shoqërua me rritje të ulët të pagave e të kostove të prodhimit dhe u reflektua më tej në rritje të ulët të çmimeve të konsumit. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit të kaluar, goditjet e ofertës kanë qenë të pakta dhe me intensitet të ulët, pritjet inflacioniste kanë mbetur të ankoruara dhe situata e likuiditetit ka qenë e favorshme për kontrollin e inflacionit. Kjo balancë faktorësh është materializuar në norma të ulëta të inflacionit vjetor dhe rritja vjetore e çmimeve të konsumit shënoi vlerën 2.4% në fund të vitit 2012.

Presionet e ulëta inflacioniste dhe mungesa e stimulit fiskal krijuan hapësira për lehtësimin e mëtejshëm të politikës monetare gjatë vitit 2012. Banka e Shqipërisë kreu tre ulje të normës bazë të interesit, duke e zbritur atë nga niveli 4.75% në nivelin 4.0%. Lehtësimi i kushteve monetare ka synuar stimulimin e kërkesës së brendshme dhe krijimin e kushteve më të mira për respektimin e objektivit të inflacionit në afat të mesëm.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë rriti në mënyrë të ndjeshme injektimet e likuiditetit në sistemin bankar, për të qetësuar agjentët financiarë, për të kontrolluar tendencat rritëse të normave të interesit dhe për të garantuar zhvillimin normal të aktivitetit në tregje. Në përgjithësi, përpjekjet tona rezultuan efektive në administrimin e problemeve të likuiditetit, por ekonomia shqiptare u përball me kushte më të shtrënguara financimi, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Kjo tendencë reflekton në një masë të madhe dëshirën e ulët për rrezik në tregjet dhe agjentët financiarë. Trajtimi i saj ka qenë dhe do të mbetet sfida jonë kryesore gjatë vitit të ardhshëm.

Duke iu rikthyer zhvillimit të ekonomisë, të dhënat zyrtare tregojnë se rritja ekonomike në vitin 2012 mbeti në nivele pozitive, por ajo u ngadalësua në krahasim me ritmet e shënuara një vit më parë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 1.6% gjatë vitit 2012, i mbështetur nga rritja e aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe në atë të bujqësisë.

Ndërkohë, aktiviteti i sektorit të industrisë ishte stanjant gjatë kësaj periudhe ndërsa sektori i ndërtimit shënoi tkurrje, duke reflektuar dobësinë e kërkesës së brendshme dhe probleme specifike të tyre. Ndonëse në një masë më të ulët, edhe gjatë vitit 2012, rritja e aktivitetit ekonomik u mbështet kryesisht nga kërkesa e huaj dhe rritja e eksporteve. Nga ana tjetër edhe pse në prani të një politike monetare stimuluese, kërkesa e brendshme është shfaqur e dobët. Kjo dobësi reflekton uljen e gatishmërisë së konsumatorit dhe biznesit për konsum e investime, si dhe hapësirat e pakta për rritjen e shpenzimeve publike. Në vija të përgjithshme, Banka e Shqipërisë gjykon se këta faktorë përcaktues të rritjes ekonomike do të vijojnë të jenë të pranishëm edhe gjatë tremujorëve të ardhshëm. Ecuria e tregut të punës është ndikuar nga shkalla e ulët e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese. Rritja e punësimit në ekonomi ka ardhur duke u ngadalësuar, ndonëse norma e papunësisë ka mbetur në nivelin 13.3% prej më shumë se një viti.

Tendenca rritëse e eksporteve dhe ngadalësimi i importeve kanë sjellë një reduktim me 13.8% të deficitit të llogarisë korente.

Ndonëse flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare kanë shënuar një rënie vjetore prej 11.3%, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv dhe rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë shënoi rritje gjatë vitit të shkuar. Në nivelet e saj aktuale, kjo rezervë është në përputhje me kriteret tona operacionale të mjaftueshmërisë dhe ajo është e aftë të përballojë 4.5 muaj importe mallrash e shërbimesh. Përmirësimi i deficitit strukturor të llogarisë korente duhet të jetë një nga objektivat e politikave tona afatgjata; ai ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të vendit dhe në rritjen e rezistencës ndaj goditjeve të huaja.

Politika fiskale ka shfaqur një natyrë përgjithësisht konsoliduese gjatë vitit 2012. Deficiti buxhetor shënoi një rënie vjetore prej 1.2%, duke u vlerësuar në 3.4% të PBB-së ose 0.3 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Ngushtimi i deficitit buxhetor u arrit kryesisht nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve publike, të cilat ishin rreth 0.3% më të ulëta se një vit më parë. Paralelisht me to, edhe të ardhurat publike shënuan një rënie vjetore prej rreth 0.2%, duke reflektuar gjendjen ciklike të ekonomisë.

Nga ana tjetër, borxhi publik kaloi nivelin 60% të PBB-së, në reflektim të një rritje më të lartë se parashikimi të deficitit buxhetor si dhe të rritjes së garancive publike. Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë për këtë problem ka qenë gjithnjë transparent: ruajtja e borxhit publik në nivele të përballueshme dhe të padëmshme për ekonominë shqiptare, si dhe ruajta e besimit të tregjeve financiare ndaj borxhit publik shqiptar, duhet të mbetet objektivi parësor i politikës fiskale.

Treguesit monetarë kanë ecur në linjë me ato të ekonomisë reale, duke shfaqur ngadalësim gjatë vitit 2012. Kërkesa e ulët e bizneseve dhe individëve për kredi bankare, si dhe kushtet ende të shtrënguara të kreditimit, janë pasqyruar në një ecuri të dobët të kredisë për ekonominë. Rritja vjetore e saj zbriti në 2.4% në fund të vitit. Ecuria e dobët e kredisë ka qenë e pranishme në të gjitha segmentet e saj sipas qëllimit të përdorimit. Ndërkohë, përbërja valutore e kredisë vazhdon të evidentojë zhvendosjen e saj, nga monedhat e huaja në atë vendase. Një zhvillim i spikatur financiar i vitit të shkuar është zhvendosja e kursimeve të familjeve, nga depozita bankare në tituj të borxhit publik.

Kjo tendencë solli një rritje të financimit të deficitit buxhetor nga individët dhe ulje të këtij financimi nga sistemi bankar.

Situata e likuiditetit në tregun financiar dhe ecuria e primeve të rrezikut kushtëzuan përcjelljen e politikës monetare lehtësuese në tregjet financiare. Uljet e normës bazë u reflektuan menjëherë në tregun ndërbankar dhe në atë të depozitave në lekë, por përcjellja e tyre në tregjet e letrave me vlerë të qeverisë dhe të kredisë në lekë ka qenë më e pakët, kryesisht si pasojë e zhvillimeve që përmenda më sipër. Megjithatë, kostoja e ndërmjetësimit në monedhë vendase shënoi rënie gjatë vitit 2012 dhe rritja e ndërmjetësimit në lekë krijoi premisat për një transmetim më të mirë të sinjaleve të politikës monetare në ekonomi gjatë vitit në vazhdim. Së fundi, tregu valutor dhe kursi i këmbimit kanë qenë përgjithësisht të qetë, si pasojë e një kërkese dhe oferte të balancuar për valutë.

Në aspektin operacional, Banka e Shqipërisë përmirësoi infrastrukturën e rolit të saj si huadhënës i radhës së fundit për bankat tregtare.

Fryt i kësaj pune ishte rishikimi dhe miratimi i rregullores "Për kredinë për mbështetje me likuiditet", e cila ofron një kuadër më të përshtatshëm për mbështetjen e bankave në kushtet e vështirësive të përkohshme të likuiditetit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë rishikoi rregulloren e saj për rezervat e detyruara të bankave, duke rritur fleksibilitetin e tyre në mënyrën e mbajtjes së saj dhe duke krijuar më shumë mundësi për rritjen e ekspozimit të sektorit bankar ndaj ekonomisë shqiptare.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i detyrave të bankës qendrore është edhe mbikëqyrja e rregullimi i sistemit bankar, çka përbën edhe një kontribut të qenësishëm në forcimin e stabilitetit financiar. Në vijim, do të ndalem në disa tregues kryesorë të performancës dhe rreziqeve të sistemit bankar dhe në zhvillimet më të rëndësishme në fushën e mbikëqyrjes, licencimit dhe në kuadrin ligjor e rregullator.

2. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Aktivet e sistemit bankar shënuan 87.9% të PBB-së në fund të vitit 2012, me një rritje prej 3.1% kundrejt një viti më parë. Rezultati financiar është

përmirësuar dhe është reflektuar në përmirësimin e treguesve të kthimit ndaj aktiveve mesatare (RoAA) dhe të kthimit ndaj kapitalit mesatar (RoEA). Në fund të vitit 2012, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar qëndron në nivelin 16.2%, duke shënuar rritje kundrejt një vitit më parë. Si në nivel sistemi, ashtu edhe për të gjitha bankat individuale, ky tregues mbetet mbi normën minimale të kërkuar prej 12%.

Aktiviteti mbikëqyrës ka synuar të vlerësojë e të kontrollojë rreziqet me të cilat përballet sistemi në aktivitetin e tij. Kujdes i veçantë i është kushtuar mbikëqyrjes së cilësisë së portofolit të kredisë dhe rreziqeve të sistemit nga aktiviteti i kredisë, si dhe efekteve të tyre aktuale apo potenciale në shkallën e kapitalizmit të sistemit. Ekspozimi i sistemit bankar ndaj rrezikut të kredisë është rritur gjatë vitit 2012.

Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë rezultoi 22.5% në fund të këtij viti, nga 18.8% që qëndronte në fund të një viti më parë. Megjithatë, pjesa e kredive me probleme të mbuluara me kolateral është më e madhe se vitin e kaluar, duke përbërë rreth 81% të portofolit të kredive me probleme. Gjithashtu, sistemi bankar ka rritur me 31% fondet rezervë për përballimin e humbjeve të mundshme nga rreziku i kredisë.

Treguesit e likuiditetit janë përmirësuar në vitin 2012. Raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra rezultoi 36.7%, duke qenë mbi nivelin minimal si për lekun ashtu edhe për monedhat e huaja. Depozitat përbëjnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar dhe linjat e kredisë nga bankat mëma kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me fundin e një viti më parë. Ulja e varësisë së financimit të bankave në Shqipëri nga bankat mëma përbën një zhvillim pozitiv në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar vendas nga goditjet e huaja.

Sistemi bankar paraqitet i mbrojtur nga rreziqet e tregut. Kështu, vlerësimet tona tregojnë se sistemi bankar është pak i ekspozuar ndaj rrezikut të luhatjeve të normave të interesit. Po ashtu, ky sistem është pak i ekspozuar ndaj efekteve direkte të luhatjeve të kursit të këmbimit dhe pozicioni i tij i hapur valutor është dukshëm poshtë kufijve tonë. Por, sistemi bankar vijon të jetë i ekspozuar ndaj rrezikut indirekt të kursit të këmbimit si rrjedhojë e kredive në valutë dhënë kredimarrësve që nuk kanë të ardhura në monedhë të huaj.

Kontrolli i rrezikut operacional është përmirësuar gjatë vitit 2012, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit të procedurave. Sistemi bankar zotëron infrastrukturën teknologjike të nevojshme për përmbushjen e kërkesave rregullative, duke siguruar zhvillimin e aktiviteteve edhe në kushte ekstreme. Transparenca dhe publikimi i informacionit vijojnë të mbeten në qendër të vëmendjes së Bankës së Shqipërisë, si shtylla të rëndësishme në funksion të mbrojtjes së klientit dhe forcimit të disiplinës e konkurrencës së tregut.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe konkurrencës midis bankave në treg, Banka e Shqipërisë në korrik të vitit 2012, filloi publikimin në faqen e saj zyrtare të internetit të normave të interesit dhe komisioneve të produkteve të

ofruara nga bankat. Pavarësisht përmirësimeve, mbetemi të ndërgjegjshëm se ka ende hapësira për përmirësim, në drejtim të normës referencë të interesit të përdorur në kontratat e kredisë dhe në drejtim të informacionit të publikuar në faqet e internetit të bankave.

Pjesë e rëndësishme e proceseve rregullative e mbikëqyrëse gjatë vitit 2012 ka qenë edhe adresimi i parandalimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Përveç përmirësimit të bazës rregullative në kuadër të përshtatjes me ligjin e ri dhe me standardet e BE-së, është forcuar bashkëpunimi me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parasë dhe procesi mbikëqyrës i institucioneve financiare. Nga analizat dhe inspektimet në vend, ka rezultuar se subjektet kanë marrë masa të përshtatshme parandaluese dhe kanë krijuar infrastrukturën e përshtatshme për identifikimin dhe raportimin e rasteve të dyshimta.

Viti 2012 ka shënuar zhvillime të rëndësishme në fushën e licencimit të aktivitetit financiar. Kështu, dy degë të bankave të huaja u shndërruan në filiale të tyre, duke ulur rrezikun e ekspozimit të tyre ndaj rreziqeve të bankave mëma dhe duke rritur pavarësinë e tyre dhe nivelin e kontrollit të ushtruar mbi to nga Banka e Shqipërisë. Një ndryshim i rëndësishëm gjatë këtij viti ishte edhe transferimi në masën 100% i aksioneve të Bankës Emporiki nga Emporiki Bank of Greece tek IUB Holding Francë, duke ndihmuar në zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të industrisë bankare. Së fundi, gjatë vitit 2012 është rritur numri i institucioneve jo-banka, si dhe gama e produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara në treg nga i gjithë sistemi financiar.

Gjatë vitit 2012, u ndërmorën ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor e rregullator të sistemit bankar. Banka e Shqipërisë dhe ASD, duke marrë shkas nga ndryshimet rregullative që ka ndërmarrë Bashkimi Evropian, përgatitën ndryshimet përkatëse në ligjin "Për sigurimin e depozitave".

Në përputhje me direktivat e BE-së, u zgjerua baza e kontribuuesve në skemën e sigurimit, duke përfshirë dhe shoqëritë e kursim-kreditit si dhe u qartësuan dhe thjeshtuan formulat për llogaritjen e kompensimit. Ndryshimet u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në 26 korrik të vitit 2012. Miratimi i rregullores së re "Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë", përmirësoi ndjeshëm kuadrin rregullativ në drejtim të administrimit të bankave në rast falimentimi. Ndryshime dhe përmirësime të tjera rregullative të rëndësishme janë ndërmarrë në drejtim të bankave, të administrimit të rrezikut dhe strukturave përkatëse, të vendimmarrjes në procesin mbikëqyrës, si dhe të ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit dhe të ri-sigurimit.

Krahas drejtimeve kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë të përshkruara më lart, në vijim do të doja të ndalesha edhe në disa aktivitete të tjera të punës sonë. Këto aktivitete, përveçse përmbushin detyrimet tona ligjore, i shërbejnë njëkohësisht zhvillimit të sistemit financiar dhe të ekonomisë së tregut në Shqipëri.

3. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Emisioni i monedhës

Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të emetimit dhe të qarkullimit të monedhës kombëtare, si dhe mbikëqyr dhe siguron cilësinë e monedhës dhe të kartëmonedhës. Një nga investimet më të mëdha të Bankës së Shqipërisë për garantimin e integritetit të monedhës sonë është ndërtimi i ndërtesës së re të Emisionit të Parasë, e cila u vu në përdorim në vitin 2012. Në këtë ndërtesë realizohet cikli i mbyllur dhe i automatizuar i kontrollit, i përpunimit, i ambalazhimit dhe i asgjësimit të kartëmonedhave dhe së shpejti do të mundësohet ekspertimi profesional i kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara, duke përmbushur një nga detyrimet e shtetit shqiptar në kuadër të MSA-së.

Administrimi i rezervës valutore

Funksion tjetër kushtetues i Bankës së Shqipërisë, është ruajtja dhe administrimi i rezervës valutore të vendit në shërbim të ruajtjes së qëndrueshmërisë financiare të ekonomisë.

Rezerva valutore bruto është rritur me rreth 65 milionë euro gjatë vitit 2012, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 1,972 milionë euro.

Nxitja e sistemit të pagesave

Në përmbushje të përgjegjësisë së saj ligjore, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave me qëllim mbështetjen e zbatimit të politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Gjatë vitit 2012, transaksionet ndërbankare në lekë janë kleruar dhe shlyer në kohë, me efikasitet dhe siguri, sipas rregullave dhe procedurave të dy sistemeve (AECH dhe AIPS). Gjithashtu, janë rishikuar dhe janë hartuar një sërë rregulloresh dhe manualesh të cilat konsistojnë në fuqizimin e mbikëqyrjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit shqiptar të pagesave.

Përmirësimi i statistikave

Viti 2012 ka shënuar përmirësimin e sistemit të statistikave pasi publikimi i informacionit statistikor lidhur me bilancin e pagesave është përgjegjësi ligjore e Bankës së Shqipërisë.

Gjatë këtij viti, u hartua një model për përmirësimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare, i cili synon përafrimin e sistemit statistikor kombëtar me standardet e BQE-së dhe SEBQ-së. Gjithashtu, u realizuan me sukses objektivat e projektit IPA-2009, "Programi rajonal i bashkëpunimit statistikor për vendet e Ballkanit" nga koordinatorët e të cilit Banka e Shqipërisë mori komente mjaft pozitive.

Të tjera (puna kërkimore, burimet njerëzore, komunikimi e transparenca, proceset integruese)

Përveç realizimit të detyrave të sanksionuara me ligj, Banka e Shqipërisë është e angazhuar në realizimin e objektivave të tjera që ndihmojnë përmbushjen e rolit që ka një bankë qendrore moderne në ekonominë e vendit. Gjatë vitit 2012, puna kërkimore dhe aktivitetet akademike të Bankës së Shqipërisë në arenën ndërkombëtare u intensifikuan më tej. Vlen të përmenden mbajtja e Konferencës së 10-të Ndërkombëtare "Politika monetare në Shqipëri: nga e shkuara tek e ardhmja", e cila ishte një ndër aktivitetet e organizuara nga Banka në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit.

Gjithashtu, nëpërmjet Institutit të Studimeve Ekonomike dhe Bankare të Bankës së Shqipërisë, kemi nxitur interesin e gjerë të kërkuesve shqiptarë dhe të huaj, si dhe kemi organizuar dy workshop-e rajonale.

Banka e Shqipërisë prej vitesh ka vënë në qendër të strategjisë së zhvillimit institucional përmirësimin e urave të komunikimit me publikun dhe rritjen e transparencës. Gjatë vitit 2012 ka vijuar plotësimi i informacionit të publikuar dhe diversifikimi i tij sipas segmenteve të dëgjuesve. Ky vit është karakterizuar nga thellimi i kontakteve me mediat dhe rritja e përpjekjeve në fushën e edukimit financiar, me qëllim rritjen e kulturës financiare dhe përçimin sa më të qartë të mesazheve të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka qenë pjesëmarrëse aktive në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA, nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, e të tjera angazhime kombëtare. Vlerësimet e autoriteteve ndërkombëtare lidhur me progresin e Bankës së Shqipërisë kanë qenë pozitive. Për çështjet që lidhen me veprimtarinë e institucionit kanë dhënë vlerësime maksimale: Komisioni Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë,

Në mbyllje të fjalës sime, më lejoni të evidentoj edhe disa probleme të cilat kanë kushtëzuar dhe do të vazhdojnë të kushtëzojnë funksionimin e ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare. Ne gjykojmë se këto probleme kërkojnë vëmendje parësore dhe rrugëzgjidhje të kujdesshme.

- Së pari, integrimi i ekonomisë shqiptare me tregjet dhe sistemet financiare evropiane nënkupton që goditjet dhe luhatjet e partnerëve tanë tregtarë e financiarë përcillen shpejt në ekonominë shqiptare. Ecuria afatmesme dhe afatgjatë e ekonomisë shqiptare është e lidhur me atë të partnerëve tanë tregtarë. Baticat dhe zbaticat në tregjet botërore ngrenë dhe ulin aktivitetin ekonomik në vend. Në tërësinë e tij, integrimi mbetet një proces dobiprurës për ekonominë shqiptare, por ai paraqet edhe sfida. Për këtë arsye, dua të theksoj se ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar duhet të bëhen më të kujdesshëm ndaj zhvillimeve në tregjet

botërore. Reformat tona strukturore duhet të synojnë rritjen e rezistencës sonë ndaj luhatjeve të tyre, ndërsa politikat tona ekonomike duhet të orientohen me kujdes ndaj trendeve afatgjata botërore.

- Së dyti, çështja e stabilitetit financiar të vendit duhet kuptuar si detyrë e të gjithëve dhe jo si çështje e një apo disa institucioneve. Stabiliteti financiar i vendit është një e mirë publike, e cila i shërben zhvillimit afatgjatë të vendit. Zhvillimet e fundit botërore kanë provuar se sistemi financiar është një mozaik tejet i integruar; stabiliteti i tij ka shumë dimensione dhe ai përcaktohet nga bashkëveprimi i shumë segmenteve e aktorëve. Në këtë drejtim, e gjej me vend të përsëris thirrjen time të vazhdueshme për gjetjen e një konsensusi politik, i cili do të mundësojë vendosjen e një rregulli fiskal, në interes të ruajtjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike dhe të besimit të investitorëve në ekonominë shqiptare.
- Së treti, një aspekt tjetër, i cili mbetet problematik në kontekstin e qëndrueshmërisë afatgjatë të vendit është edhe reforma e sistemit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Deficitet e krijuara prej tyre janë në rritje dhe ato mund të cënojnë shumë parametra fiskalë e financiarë në të ardhmen. Kjo reformë duhet t'i hapë rrugë zhvillimit të segmenteve relativisht të prapambetura të sistemit financiar, atyre të fondeve private të pensioneve dhe të sigurimeve. Ky do të ishte një kontribut real në zgjerimin dhe thellimin e tregut financiar të vendit.
- Së katërti, duke qëndruar ende në çështjen e stabilitetit financiar do të doja të sillja në vëmendjen tuaj ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile që lidhen me lehtësimin e ekzekutimit të kolateraleve. Në vijim të paketës së prezantuar para pak kohësh nga Banka e Shqipërisë dhe të letrës që i kam nisur para disa ditësh partive kryesore të Kuvendit, do të apeloja edhe njëherë për miratimin e shpejtë të tyre.
  Bëhet fjalë për një grup propozimesh, të cilat si nga ana jonë ashtu edhe nga ana e ekspertëve ndërkombëtare vlerësohen të domosdoshme për stabilitetin e sistemit bankar, për garantimin e depozitave të popullatës si dhe për gjallërimin e kreditimit të ekonomisë.
- Së fundi, çështja e zhvillimit afatgjatë të vendit dhe e politikave e strategjive të mbështetjes së tij, meriton një vëmendje më të madhe. Banka e Shqipërisë mbetet e bindur në perspektivat afatgjata të zhvillimit të vendit. Këto perspektiva favorizohen nga burimet natyrore dhe nga kostoja e ulët e fuqisë punëtore, por, mbi të gjitha, ato duhet të mbështeten në mundësitë dhe aftësitë tona për t'u integruar në zinxhirin e vlerës së shtuar të ekonomive evropiane. Rruga që kemi përpara do të jetë e gjatë dhe e mundimshme. Në afat të shkurtër e të mesëm, ajo do të kërkojë vullnet dhe zgjuarsi në kryerjen e reformave si dhe në rritjen e vëmendjes ndaj çështjeve të shëndetit makroekonomik e financiar të vendit.

Në afat të gjatë, struktura e ekonomisë shqiptare duhet të përafrohet më shumë me ato të vendeve evropiane; rritja ekonomike duhet të mbështetet më shumë në produktivitetin e faktorëve të prodhimit dhe bizneset shqiptare duhet të tregohen më të vëmendshëm në gjetjen dhe eksplorimin e tregjeve të reja.

Duke qenë e vëmendshme dhe e ndërgjegjshme për sfidat që kemi përpara, Banka e Shqipërisë ka filluar të analizojë mjete dhe teknika të reja në përmbushjen e misionit të saj. Duke evidentuar ngadalësimin ekonomik si rrezikun kryesor me të cilin përballen ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar, si dhe duke vlerësuar rolin që ka kredia bankare në aktivitetin ekonomik, Banka e Shqipërisë miratoi në muajin mars, 2013 një paketë masash makroprudenciale të orientuara drejt nxitjes së kredisë dhe uljes së rrezikut në sistemin bankar. Shkurtimisht, këto masa konsistojnë në lehtësimin e kërkesave për kapital për rritjen e kredisë, në lehtësimin e kërkesave për likuiditet, në uljen e provigjionimit për kredinë e ristrukturuar, si dhe në rritjen e kërkesave për kapital për aktivet jashtë vendit mbi normat e kërkuara nga Banka e Shqipërisë.

Këto masa të përkohshme janë një tjetër shenjë e vullnetit tonë për respektimin e misionit dhe të detyrave tona ligjore.

Në mbyllje të fjalës , dëshiroj të theksoj se Raporti Vjetor dhe Pasqyrat Financiare të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012 janë paraqitur pranë jush. Mbetem i hapur për pyetje dhe sqarime.

Ju faleminderit për vëmendjen.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
30 prill 2013

Sot, në datën 30 prill 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme.

Në nivelin e tyre aktual, normat e interesit dhe situata e likuiditetit në ekonomi ofrojnë njëkohësisht stimulin e nevojshëm monetar për nxitjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

Sipas të dhënave të INSTAT-it, aktiviteti ekonomik në vend u rrit me 1.6% gjatë vitit 2012. Ekonomia shqiptare shfaqi shenja dobësie gjatë vitit të kaluar, duke reflektuar pasigurinë e përgjithshme në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm. Megjithatë, pavarësisht kontekstit të zhvillimeve të pafavorshme, treguesit kryesorë të balancave të brendshme e të jashtme të vendit kanë qëndruar brenda parametrave të shëndetshëm. Gjatë kësaj periudhe, inflacioni rezultoi brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe treguesit e shëndetit të sistemit bankar u përmirësuan.

Ruajtja e këtyre ekuilibrave krijon premisat e duhura makroekonomike për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Duke u rikthyer te ecuria e inflacionit, të dhënat e INSTAT-it tregojnë se çmimet e konsumit u rritën mesatarisht me 2.5%, në tremujorin e parë të vitit 2013. Ecuria e inflacionit vijon të përcaktohet nga çmimet e ushqimeve: kontributi i tyre përbën rreth 90% të inflacionit total. Nga ana tjetër, inflacioni i artikujve ushqimorë është balancuar nga reduktimi i inflacionit të mallrave të konsumit jo-ushqimor. Inflacioni i kësaj kategorie ka reflektuar rënien e çmimit të naftës, si pasojë e reduktimit të çmimit të saj në tregjet botërore. Efekt rënës në inflacion ka dhënë edhe reduktimi i çmimeve të mallrave të konsumit afatgjatë, ndërkohë që çmimet e kategorive të tjera të mallrave të konsumit nuk kanë shfaqur ndryshime të rëndësishme.

Nga këndvështrimi makroekonomik, ecuria e inflacionit vijon të reflektojë

presionet e ulëta nga kahu i kërkesës agregate dhe mungesën e goditjeve të kahut të ofertës.

Rritja nën potencial e kërkesës agregate, sjell mos-shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese dhe gjeneron presione të ulëta për rritjen e pagave, të kostove të prodhimit dhe të marxheve të fitimit të biznesit. Në këto rrethana, presionet e brendshme mbi çmimet e konsumit paraqiten të dobëta, sikurse reflektohen edhe nga niveli i ulët i inflacionit bazë. Nga ana tjetër, inflacioni i importuar ka rezultuar i përmbajtur, në prani të inflacionit të ulët në vendet partnere dhe të qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit.

Të dhënat më të fundit mbi ekonominë reale i përkasin tremujorit të katërt të vitit 2012. Sipas tyre, ekonomia shqiptare u rrit me 1.7%, e mbështetur nga zgjerimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve, të industrisë dhe të bujqësisë, ndërkohë që aktiviteti në sektorin e ndërtimit vijoi të tkurret. Të dhënat mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik, në tremujorin e parë të këtij viti, mbeten të pakta.

Analizat tona, të bazuara mbi tregues indirektë, vlerësojnë se rritja ekonomike ka qenë e ulët - ajo është mbështetur kryesisht në kërkesën e huaj, ndërkohë që komponentët e kërkesës së brendshme vijojnë të shfaqin një ecuri të plogësht. Konsumi dhe investimet private mbeten të dobët , në prani të pasigurive për të ardhmen, të ngadalësimit të të ardhurave të disponueshme, të kushteve më të shtrënguara të financimit dhe të kapaciteteve të lira të prodhimit.

Ecuria e treguesve buxhetorë në tremujorin e parë të vitit, tregon për rritjen e stimulit fiskal. Deficiti buxhetor u rrit me 41.5% gjatë këtij tremujori, duke reflektuar rënien me 3.6% të të ardhurave fiskale dhe rritjen me 1.4% të shpenzimeve publike. Banka e Shqipërisë tërheq edhe njëherë vëmendjen për rëndësinë e ruajtjes së ekuilibrave fiskalë dhe për kontrollin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik në nivele të përballueshme e të padëmshme për ekonominë shqiptare. Në opinionin tonë, prioriteti afatmesëm i politikës fiskale duhet të mbetet ruajtja e disiplinës buxhetore.

Në afat të gjatë, borxhi publik shqiptar duhet të reduktohet dhe të ankorohet në një rregull fiskal të besueshëm, efektiv dhe transparent.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë për vazhdimësi të kontributit pozitiv të eksporteve neto në rritjen e kërkesës agregate. Të dhënat e tregtisë së jashtme për muajt janar dhe shkurt, tregojnë për ngushtimin vjetor me 27.1% të deficitit tregtar, duke reflektuar njëkohësisht rritjen e mëtejshme të eksporteve dhe ecurinë e dobët të importeve. Për këtë periudhë, importet janë tkurrur me 9.5% në terma vjetorë, ndërkohë që eksportet kanë ruajtur ritme të larta të rritjes vjetore, prej 18.6%.

Zhvillimet monetare kanë qenë në linjë me ecurinë e ekonomisë reale, gjatë tremujorit të parë. Në dy muajt e parë të vitit, kredia për ekonominë ka shfaqur një ecuri të dobët në të gjithë segmentet e saj.

Në fund të muajit shkurt, portofoli i kredisë së sektorit bankar ishte vetëm 1.7% më i lartë se një vit më parë. Sikurse e kemi theksuar, problemi kryesor i kreditimit mbetet kërkesa e ulët për kredi nga biznesi dhe konsumatori shqiptar. Megjithatë, edhe politikat krediduese të bankave paraqiten më konservatore, çka reflektohet edhe në kushte relativisht të shtrënguara kreditimi.

Vlerësimet për ecuri të përmbajtur të çmimeve të konsumit dhe për rritje të dobët të ekonomisë në periudhën e ardhshme, motivuan lehtësimin e mëtejshëm të politikës monetare në fillim të këtij viti. Në muajin janar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 3.75%. Nëpërmjet ankorimit të pritjeve inflacioniste, qetësimit të presioneve të likuiditetit dhe uljes së normave afatshkurtra të interesit, politika monetare ka synuar të ulë koston e financimit afatgjatë të ekonomisë dhe të mbështesë rritjen e kredisë, të konsumit dhe të investimeve në vend.

Politika lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka gjetur pasqyrim të diferencuar në segmentet e tregut financiar. Reduktimi i radhës i normës bazë u reflektua shpejt dhe i plotë në tregun ndërbankar dhe në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë. Nga ana tjetër, tejçimi i saj në tregun e depozitave ka qenë i pjesshëm, ndërsa ai në tregun e kredisë, edhe më i zbehtë. Këto zhvillime ilustrojnë faktin se, në prani të primeve të shtuara të rrezikut dhe ndryshimeve strukturore të sjelljes në tregun financiar dhe në ekonominë reale, efektiviteti i veprimit të politikës monetare është më i ulët. Për këto arsye, Banka e Shqipërisë vendosi të mbështesë politikën e saj stimuluese monetare me ndërmarrjen e disa ndryshimeve në kahun lehtësues të kuadrit rregullator mbikëqyrës e makroprudencial. Këto masa, të cilat i kemi detajuar gjatë muajit të shkuar, synojnë të ulin më tej primet e likuiditetit dhe kostot e ndërmjetësimit në tregjet financiare, me qëllim nxitjen e kreditimit dhe rritjen e aktivitetit ekonomik.

Projeksionet tona për vitin 2013, mbështesin vlerësimin për një rritje ekonomike në nivele pranë atyre të vërejtura në vitin e kaluar. Kërkesa e huaj do të jetë nxitësi kryesor i rritjes së aktivitetit ekonomik, ndërkohë që në të njëjtin kah por me intensitet më të ulët, pritet të kontribuojë edhe politika fiskale gjatë vitit në vazhdim. Nga ana tjetër, ecuria e konsumit dhe investimeve private mbetet e dobët dhe e paqëndrueshme. Vazhdimësia e rritjes ekonomike nën potencial do të përcaktojë presione të ulëta inflacioniste edhe gjatë periudhës së ardhshme. Në mungesë të goditjeve të paparashikuara nga kahu i ofertës, çmimet e konsumit do të vazhdojnë rritjen me norma të ulëta. Me një probabilitet ndodhjeje 90%, inflacioni vjetor pritet të luhatet në intervalin 0.6% – 3.6%, pas 4 tremujorëve. Nivelet e ulëta të inflacionit vjetor dhe parashikimi për vazhdimësi të tyre përgjatë horizontit kohor të veprimit të politikës monetare, kushtëzojnë ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare edhe gjatë tremujorëve të ardhshëm.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Ai përfundoi se kushtet monetare stimuluese krijojnë premisat për respektimin e objektivit të

inflacionit në afat të mesëm, si dhe mbështesin rritjen e kërkesës agregate dhe shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese. Presionet e dobëta inflacioniste kërkojnë vazhdimin e një politike monetare stimuluese nga ana e Bankës së Shqipërisë. Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës rithekson nevojën e vazhdimit dhe thellimit të reformave strukturore, të cilat rritin produktivitetin dhe forcojnë konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare. Këto reforma i hapin rrugë zgjerimit të potencialit ekonomik dhe duhen parë si instrumenti kryesor që mbështet rritjen e qëndrueshme e afatgjatë të vendit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
29 maj 2013

Sot, në datën 29 maj 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme, duke ofruar njëkohësisht edhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

Të dhënat e fundit ekonomike e monetare tregojnë se presionet inflacioniste vazhdojnë të jenë të dobëta. Inflacioni vjetor në muajin prill rezultoi 2.3%, duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me muajin paraardhës. Kjo prirje u ndikua më së shumti nga rënia e çmimit të naftës dhe e çmimeve të qirave. Në një mjedis me inflacion të ulët, profili i inflacionit vijon të përcaktohet nga ecuria e çmimeve të mallrave ushqimorë, kontributi i të cilave formoi rreth 95% të shifrës vjetore të inflacionit në muajin prill.

Çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të tjera të shportës së konsumit nuk kanë pësuar luhatje të mëdha, duke qëndruar rreth niveleve të vërejtura gjatë muajve të kaluar.

Në këndvështrimin makroekonomik, presionet e brendshme dhe të huaja inflacioniste paraqiten të dobëta ose në rënie, ndërkohë që pritjet inflacioniste janë të ankoruara në objektivin e Bankës së Shqipërisë. Ekonomia shqiptare vijon të karakterizohet nga kapacitete të lira në faktorët e prodhimit. Kjo tablo është shoqëruar me reduktimin e ndjeshëm të inflacionit bazë gjatë katër muajve të parë të vitit, duke pasqyruar presionet e ulëta për rritjen e kostove të prodhimit, të marxheve të fitimit dhe të çmimeve finale të produkteve. Nga ana tjetër, çmimet në tregjet botërore kanë ngadalësuar rritjen e tyre, ndërsa kursi i qëndrueshëm i këmbimit nuk ka mbështetur rritjen e çmimeve të mallrave të konsumit të importuara.

Informacioni më i fundit sugjeron se dobësia e aktivitetit ekonomik është mbartur edhe në muajt e parë të vitit 2013. Në balancë, të dhënat e disponuara tregojnë për ecuri të ngadaltë të konsumit dhe të investimeve private. Familjet shqiptare vazhdojnë të shfaqin një tendencë të ulët për shpenzim, të

ndikuara nga pasiguria për qëndrueshmërinë e burimeve të financimit dhe nga ngadalësimi i ritmeve të rritjes së të ardhurave të disponueshme. Në një efekt zinxhir, dobësia e kërkesës agregate, pasiguria e vetë bizneseve për të ardhmen, por dhe kushtet e shtrënguara te kreditimit, nuk kanë inkurajuar ndërmarrjen e investimeve të reja private. Nga ana tjetër, rritja ekonomike në muajt e parë të këtij viti vlerësohet të ketë gjetur mbështetje kryesisht në kërkesën e huaj dhe në kërkesën e sektorit publik.

Politika fiskale ka patur një natyrë stimuluese në katër muajt e parë të vitit, e reflektuar kjo në rritje vjetore të deficitit buxhetor dhe të shpenzimeve publike gjatë kësaj periudhe. Shpenzimet fiskale shënuan një rritje vjetore prej 9.8%, kryesisht si pasojë e rritjes së shpejtë të shpenzimeve kapitale, ndërkohë që shpenzimet korente ruajnë norma të ulëta të rritjes vjetore. Nga ana tjetër, të ardhurat fiskale kanë shënuar një rritje minimale prej 0.3%, në reflektim të ecurisë së ngadaltë të aktivitetit ekonomik. Kjo ecuri e shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore është materializuar në një deficit buxhetor rreth 2 herë më të lartë se në katër muajt e parë të vitit të kaluar. Banka e Shqipërisë vëren se politika afatmesme dhe afatgjatë fiskale duhet të orientohet më shumë drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë së borxhit publik. Përmbushja e këtij objektivi ndihmon në uljen e pasigurisë dhe të primeve të rrezikut. Borxhi i ulët dhe i kontrolluar publik krijon një ambient më të mirë për iniciativën private, nëpërmjet ruajtjes së normave të ulëta të interesit dhe rritjes së fondeve të disponueshme, duke ndihmuar kështu rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Shkëmbimet me partnerët tanë tregtarë kanë dhënë një stimul pozitiv në rritjen e aktivitetit ekonomik edhe gjatë tremujorit të parë të vitit. Deficiti tregtar u tkurr me 28.6% në terma vjetorë gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar ecurinë e mirë të eksporteve dhe rënien e importeve. Eksportet shënuan një rritje vjetore prej 17.2% në tre muajt e parë të vitit, të dominuar nga eksportet në sektorin e energjisë. Nga ana tjetër, importet vazhdojnë të thellojnë rënien e tyre vjetore, rënie e cila për këtë periudhë shënoi vlerën 11.1%.

Analiza më e detajuar e eksporteve evidenton përqendrimin e lartë të tyre në segmentin e burimeve natyrore. Banka e Shqipërisë gjykon se rritja e konkurrueshmërisë së produkteve e shërbimeve tona, si dhe zgjerimi i bazës së eksporteve, mbetet instrumenti më i mirë për të siguruar korrektimin e shëndetshëm të llogarisë korrente. Ky objektiv kërkon vazhdimin e thellimin e reformës strukturore, si në tregjet e produkteve ashtu dhe në atë të faktorëve të prodhimit.

Ecuria e treguesve monetarë dëshmon për presione të ulëta inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi. Rritja vjetore e ofertës së parasë ka vijuar të ngadalësohet më tej, duke zbritur në 4.6% në fund të muajit mars. Kërkesa e ulët për para e agjentëve ekonomikë është reflektuar në një ecuri të dobët të kreditimit. Rritja vjetore e kredisë në muajin mars shënoi 1.2%. Krahas faktorëve të kërkesës, ecuria e ngadaltë e kredisë reflekton edhe politikën e kujdesshme të bankave në kreditim dhe shkallën e ulët të gatishmërisë së tyre për të marrë përsipër rrezik. Kjo sjellje konservatore e bankave kushtëzohet nga

zhvillimet në hapësirën evropiane dhe politikat më të shtrënguara mbikëqyrëse e rregullatore të vendeve të origjinës. Duke u nisur nga rrethanat aktuale në të cilat ndodhet sistemi bankar evropian, Banka e Shqipërisë vlerëson se ajo mund të vijojë të shoqërojë ekonominë shqiptare në një afat të mesëm.

Tregu financiar është karakterizuar nga presione të ulëta të likuiditetit dhe të inflacionit, duke mundësuar një përcjellje më të mirë të stimulit monetar në ekonomi. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë ndjekur uljen e normës bazë të interesit dhe vazhdojnë të qëndrojnë të ankoruara rreth saj.

Ndërkohë, në muajin prill e maj, vijon rënia e yield-eve në tregun primar në linjë me ciklin lehtësues të politikës monetare. Normat e interesit në tregun e depozitave dhe atë të kredive kanë reaguar më ngadalë, në përputhje me kohëvonesat në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare. Gjithashtu, transmetimi i politikës lehtësuese monetare në normat e interesit të kredive është ndikuar edhe nga primet e larta të rrezikut që shoqërojnë aktivitetin kreditues.

Duke iu rikthyer zhvillimeve ekonomike, projeksionet për ecurinë e ekonomisë në të ardhmen mbeten të njëjta, si edhe në muajin e mëparshëm. Aktiviteti ekonomik në vend pritet të rritet me norma të ulëta pozitive, pranë niveleve të vitit të kaluar. Kërkesa e huaj dhe politika fiskale priten të japin stimul pozitiv në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, konsumi dhe investimet private do të kenë një ecuri të dobët edhe gjatë këtij viti. Rritja nën potencial e ekonomisë do të vijojë të kushtëzojë presione të dobëta mbi çmimet e konsumit. Në mungesë të goditjeve të paparashikuara të ofertës, inflacioni vjetor pritet të qëndrojë rreth niveleve aktuale edhe gjatë vitit në vazhdim.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kushtet aktuale monetare janë të përshtatshme për respektimin e objektivit të inflacionit në afat të mesëm. Uljet e mëparshme të normës bazë të interesit po përkthehen gradualisht në norma më të ulëta financimi të sektorit publik e privat, duke krijuar premisa për një rritje më të shpejtë të kërkesës agregate.

Gjithashtu, lehtësimi i disa kërkesave mbikëqyrëse e rregullatore në muajin mars stimulon rritjen e aktivitetit kreditues të sistemit bankar.

Zhvillimet e pritura ekonomike e financiare do të kërkojnë ruajtjen e natyrës lehtësuese të kushteve monetare përgjatë horizontit kohor të politikës monetare. Banka e Shqipërisë mbetet gjithnjë e gatshme të reagojë, në kohën dhe në masën e duhur, për të krijuar kushtet e duhura monetare për respektimin e objektivit të saj të inflacionit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën me temë "Ndërlidhjet me Eurozonën dhe dinamikat e konvergjencës afatgjatë", organizuar nga Banka Qendrore Evropiane, Frankfurt, Gjermani, 17 qershor 2013

I nderuar z. Kryetar!
Të nderuar zonja dhe zotërinj!
Të nderuar kolegë!

Tema e kësaj konference është mjaft e rëndësishme për perspektivën ekonomike dhe financiare të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këto vende janë tërësisht të integruara me ekonominë dhe sistemin financiar të Bashkimit Evropian (BE). BE-ja përfaqëson partnerin e tyre kryesor tregtar dhe bankat me origjinë nga BE dominojnë sistemin financiar të rajonit tonë. Siç dëshmohet qartë nga përvoja jonë, përpara dhe gjatë krizës së fundit, zhvillimet në BE kanë ndikim të menjëhershëm si në ekonominë reale, ashtu dhe në sistemin financiar të rajonit. BE dhe Ballkani Perëndimor mund të konsiderohen partnerë dhe, si të tillë, ata kanë interes logjik në politikat dhe veprimet e njëri-tjetrit. Besoj se kjo konferencë do të përpiqet të shqyrtojë mekanizmat më të mirë për konsultime dhe koordinim të përbashkët.

Vendet e rajonit të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJ) kanë zgjedhur integrimin me BE-në si instrumentin kryesor për të siguruar një perspektivë ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë për qytetarët e tyre. Do të doja të theksoja se vendet tona, në mënyrë të ndërgjegjshme, kanë zgjedhur rrugën e integrimit me BE-në: ne kemi ndërmarrë reforma strukturore të vështira; kemi ndërmarrë reforma ligjore dhe rregullative lidhur me këtë proces; si dhe kemi hapur tregjet tona drejt mallrave, shërbimeve dhe kapitalit nga BE. Mendoj se është e kuptueshme për ne që të presim angazhim afatgjatë dhe solidaritet nga partnerët tanë.

Ky proces integrimi dhe konvergjence sigurisht që ka dhënë frytet e veta gjatë dy dekadave të fundit. Rritja e PBB-së e ka tejkaluar atë të BE-së dhe ndërmjetësimi financiar është përmirësuar në mënyrë të shpejtë. Gjykimi i përgjithshëm ekonomik i bazuar në tregues të tillë, si për shembull PBB për frymë, ndërmjetësimi financiar relativ, kostoja relative e punës dhe teknologjia dëshmojnë se ky proces do të vijojë dhe në të ardhmen. Vendet e EQLJ-së ende ofrojnë mundësi tërheqëse investimi. Ato përgjithësisht karakterizohen nga dinamika më të mira demografike dhe janë gjeografikisht më afër Evropës sesa ekonomitë e tjera me treg në zhvillim. Ky integrim politik dhe ekonomik ka çuar natyrshëm në integrim financiar.

Megjithatë, do të doja të trajtoja tre çështje lidhur me rrugën e integrimit ekonomik dhe financiar që po ndjekim.

Së pari, fokusi kryesor i autoriteteve kombëtare të Evropës Juglindore duhet të jetë lehtësimi i shpërndarjes së kapitalit në sektorë më produktivë, duke siguruar stimujt e duhur, reformat strukturore, mjedisin ligjor, politikat tatimore dhe stabilitetin ekonomik. Kjo kërkon dhe mirëkuptimin e bankave që veprojnë në rajon. Bankat janë dhe do të mbeten subjekte që kanë si objektiv maksimizimin e fitimit. Megjithatë, ato duhet të jenë më të vëmendshme ndaj tendencave afatgjata, pasi ato luajnë rol në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Së dyti, ne kemi zhvilluar një sistem financiar dhe kemi zbatuar një strategji të integrimit financiar të bazuar mbi bankat, të cilat përfaqësojnë më shumë se 90% të sistemit financiar në mbarë rajonin. Për këtë arsye, sugjerimet e fundit lidhur me zhvillimin e tregjeve të brendshme të kapitalit si një alternativë ndaj një sistemi financiar të bazuar në banka janë të nevojshme, por ndoshta të parealizueshme në periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme.

Së treti, Evropa Juglindore është dhe do të mbetet një rajon i etur për kapital, i cili pjesërisht duhet ndërmjetësuar përmes bankave ndërkombëtare. Ky fakt duhet pranuar si nga rregullatorët, ashtu dhe nga bankat mëma të BE-së. Një model i ri biznesi i mbështetur tërësisht në depozita të brendshme është përgjigjja e gabuar për ekstremet e mëparshme të flukseve të mëdha të kapitalit.

Aktualisht, sfidat kryesore për stabilitetin financiar në rajonin e Evropës Juglindore përfshijnë kreditë me probleme, rritjen e ngadaltë të kredisë për ekonominë, problemin e financave fiskale dhe qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Natyra dhe madhësia e tyre janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me problemin e rritjes ekonomike, si dhe me përqasjen e sektorit privat ndaj konsumit, kursimeve dhe pritshmërive. Këto probleme u krijuan ose u ekspozuan nga kriza dhe janë përkeqësuar më tej për shkak të çështjeve të lidhura me stabilitetin financiar të partnerëve tanë dhe përqasjes së tyre ndaj zgjidhjes së këtyre sfidave. Në mënyrë më të drejtpërdrejtë, sektori bankar ka ulur ndërmjetësimin financiar për shkak të masave të kërkuara të stabilitetit financiar nga ana e autoriteteve bankare evropiane. A ndikon kjo mbi kreditimin dhe rritjen ekonomike? Është e qartë që përgjigjja është "po". Si në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë dhe pavarësisht origjinës së tyre, problemet aktuale të stabilitetit financiar janë të lidhura me rritjen e ngadaltë ekonomike, e cila, në vetvete, është rezultat i uljes së ndërmjetësimit financiar. Këto zhvillime janë kombinuar në një rreth vicioz, i cili po e çon ekonominë në një spirale të një rritjeje të ngadaltë dhe në rënie.

Kriza na ka dhënë disa mësime të rëndësishme. Mbi të gjitha, ekziston një ndryshim thelbësor në perceptimin e hartimit të politikave dhe zbatimit të tyre nga ana e autoriteteve, me dy tendenca të përcaktuara. Së pari, po shikojmë një paradigmë të re – rishqyrtimi i hartimit dhe zbatimit të politikave nga ana e bankës qendrore. Modeli i ri konsiston së pari në idenë se shënjestrimi i inflacionit i bazuar në indeksin e çmimeve të konsumit mund të mos jetë i mjaftueshëm për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe atë financiar; dhe së dyti, në përdorimin e rregullimit makroprudencial në kombinim me masat

tradicionale të politikës monetare. Për të qenë eficiente, këto masa kërkojnë koordinim të madh me ato të politikës monetare tradicionale, rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare. Nëse nuk janë të koordinuara, ato mund të kenë më tepër ndikim negativ sesa pozitiv. Për më tepër, nisur nga lidhjet e forta financiare me jashtë midis BE-së dhe EQLJ-së, ato kanë ndikime të jashtëzakonshme edhe përtej kufijve. Në këtë drejtim, koordinimi shndërrohet në një përpjekje shumëdimensionale.

Për shkak të këtyre lidhjeve të forta financiare dhe ekonomike të EQLJ-së me Eurozonën, politikat dhe rregulloret evropiane, si dhe ndërhyrja makroekonomike dhe makroprudenciale kanë ndikim të mirëfilltë dhe në kohë reale mbi ekonomitë tona, duke u hapur rrugën kështu sfidave të reja. Koordinimi i masave makroekonomike dhe makroprudenciale brenda Eurozonës do të vijojë të ushtrojë presione të stabilitetit makro mbi rajonin e EQLJ-së. Për këtë arsye, është e rëndësishme për ekonomitë e këtyre vendeve që të njohin që më parë dhe të kuptojnë zhvillimet ligjore, institucionale dhe rregullative në sistemin financiar të BE-së dhe, mundësisht, të mund të parashikojnë ndikimin e mundshëm dhe pasojat e paplanifikuara që këto zhvillime mund të kenë mbi ekonomitë e tyre.

Do të dëshiroja t'i ftoja autoritetet monetare dhe mbikëqyrëse të BE-së që të përqendrohen në tablonë e përgjithshme dhe të mendojnë për zgjidhje afatgjata dhe jo për rregullime afatshkurtra, të cilat në vend që të zgjidhin problemet, riciklojnë ato më të vjetra dhe i shndërrojnë në sfida të reja, duke transformuar kështu natyrën dhe subjektin e problemit, por pa trajtuar çështjen e stabilitetit të përgjithshëm.

Në pikëpamjen tonë, Bashkimi Bankar i BE-së është një hap shumë i rëndësishëm drejt integrimit dhe koordinimit të mëtejshëm midis autoriteteve vendase dhe ato pritëse. Ne e vlerësojmë faktin që krijimi i një autoriteti mbikëqyrës të centralizuar do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse, duke krijuar kështu një komunikim më eficient midis rregullatorëve vendas dhe pritës, si dhe duke ulur ndërlikimet që krijon komunikimi me organet e shumta mbikëqyrëse dhe rregullative kombëtare. Banka e Shqipërisë, si anëtare e Komitetit Drejtues të Nismës së Vjenës, e përkrah nevojën e autoriteteve të BE-së për të vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjet që lidhen me ndërlidhjen midis BE-së/Eurozonës dhe vendeve joanëtare të BE-së/Eurozonës, me qëllim hartimin e politikave të ekuilibruara dhe të qëndrueshme. Masat makroprudenciale në Eurozonë duhet të konsiderojnë, në veçanti, gjendjen dhe ndikimin e mundshëm mbi vendet pritëse joanëtare të BE-së. Ne presim që Banka Qendrore Evropiane (BQE), si një autoritet drejtues brenda Mekanizmit të Vetëm Mbikëqyrës, të luajë një rol të rëndësishëm dhe konstruktiv, ndërkohë që autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve joanëtare të BE-së duhet t'u jepet mundësia që të shprehin pikëpamjet e tyre mbi vendimet e BE-së lidhur me politikat financiare, me ndikim mbi stabilitetin financiar vendas, përpara marrjes së vendimeve aktuale. Funksionimi eficient i kolegjeve mbikëqyrëse konsiderohet gjithashtu si një çështje mjaft e rëndësishme, ku vendet me filiale sistemike të BE-së mund të adresojnë shqetësimet e tyre lidhur me mbikëqyrjen.

Nga ana tjetër, do të ndihmonte nëse vendet e vogla të rajonit jashtë Bashkimit Bankar do të kishin një pikëpamje dhe përqasje të unifikuar ndaj autoriteteve të BE-së dhe t'i shprehnin shqetësimet e tyre në një zë të vetëm. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë, duke marrë rolin e koordinatorit, i ka ftuar vendet e tjera joanëtare të BE-së që të kontribuojnë në hartimin e një përqasjeje të përbashkët rajonale drejt Bashkimit Bankar dhe ndikimeve të tij mbi këto vende.

Ne gjithashtu argumentojmë se është në përfitim të BQE-së, si dhe të autoriteteve të tjera monetare dhe mbikëqyrëse dhe atyre të BE-së, që t'i sjellin vendet e EQLJ-së në tryezën e diskutimit, ashtu sikurse një doktor i përgjegjshëm, i cili teksa i jep pacientit të tij një ilaç të fortë për shërim, përpiqet të minimizojë efektet e mundshme anësore. BQE-ja duhet të konsiderojë efektet e mundshme anësore të politikave të saj në rajonin tonë. Kjo konsideratë lidhet me pesë çështje të rëndësishme:

Së pari, BQE-ja gëzon një ekspertizë të madhe teorike dhe empirike mbi analizën e stabilitetit financiar, si dhe atë monetare dhe ekonomike. Megjithatë, vendet e EQLJ-së mund të kenë një këndvështrim më të saktë dhe më të drejtpërdrejtë mbi efektet e mundshme anësore mbi ekonomitë e tyre.

Së dyti, diskutimi midis BQE-së dhe vendeve të EQLJ-së duhet të fillojë herët, mundësisht që në procesin e hartimit dhe jo pas zbatimit të legjislacionit dhe rregulloreve. Kjo do t'u mundësojë autoriteteve të vendeve të EQLJ-së kohë të mjaftueshme për të bërë amendimet përkatëse ligjore dhe rregullative për të harmonizuar legjislacionin me atë të BE-së, si dhe për të përshtatur strukturat institucionale në kohën e duhur.

Mekanizmat reformues të BE-së lidhur me sigurimin e depozitave dhe zgjidhjen e bankave me probleme, për shembull, do të kenë implikime ligjore dhe rregullative për ekonomitë e EQLJ-së, për shkak të dominimit të grupeve bankare evropiane në sektorët tanë financiarë. Megjithatë, deri sa BQE dhe BE të vendosin mbi një zgjidhje dhe legjislacioni të miratohet, ne nuk mund të dimë se cilat do të jenë implikimet e mundshme (si për shembull mundësitë e arbitrazhit rregullativ), ndryshimet e kërkuara ligjore dhe kostot financiare për sistemet tona bankare dhe ekonomitënë përgjithësi. Informacioni është natyrshëm në interes të vendeve të EQLJ-së, pasi do të eliminonte pasigurinë dhe rrezikun midis autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve pritëse (joanëtare të BE-së/Eurozonës) lidhur me zgjidhjen eficiente (duke përfshirë ndarjen e barrës) të bankave evropiane shumëkombëshe me probleme;

Së treti, krijimi i "Kolegjeve për Zgjidhjen e Bankave me Probleme", të ngjashëm me "Kolegjet e Mbikëqyrësve" mund të jetë një mënyrë inteligjente dhe eficiente për t'u përgatitur për situata ekstreme. Këto kolegje do t'i lejonin autoritetet mbikëqyrëse vendase dhe pritëse që të diskutojnë që më parë lidhur me zgjidhjen e mundshme të bankave evropiane shumëkombëshe me probleme, me qëllim minimizimin e ndryshimeve gjatë këtij procesi dhe ndarjen e barrës për sa të jetë e mundur. Në parim, mund të krijohet një formë mbikëqyrjeje që i mundëson BQE-së ndarjen e përgjegjësisë së mbikëqyrjes

së bankave evropiane shumëkombëshe me autoritetet mbikëqyrëse pritëse (veçanërisht në rastin kur këto janë banka me rëndësi sistemike në vendet pritëse).

Së katërti, mund të krijohen linja *swap* të likuiditetit në euro midis BQE-së dhe bankave qendrore të vendeve pritëse (ose autoriteteve mbikëqyrëse) – vendeve joanëtare në BE, me qëllim administrimin dhe përballimin e rrezikut të papritur të likuiditetit dhe problemeve të tjera të mundshme të hasura nga ana e bankave evropiane shumëkombëshe, të cilat mund të lindin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si pasoja të paplanifikuara në përgjigje të vendimeve të marra nga autoritetet mbikëqyrëse dhe ato të stabilitetit financiar në Eurozonë. Një gjë e tillë mund të krijohej vetëm për ato vende pritëse (joanëtare të Eurozonës ose të BE-së) ku bankat evropiane kanë rëndësi sistemike. Nga ana e tyre, autoritetet mbikëqyrëse të vendeve pritëse do t'i sigurojnë BQE-së informacion mbi gjendjen financiare të filialeve sistemike dhe mbi politikat e tyre mbikëqyrëse përkatëse;

Së pesti, bëhet fjalë për rolin e organizatave financiare ndërkombëtare. FMN, Banka Botërore dhe Komiteti i Bazelit kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në modelimin e sistemit financiar dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë së ekonomive tona ndaj goditjeve. Projekti i Asistencës për Sipërmarrjet dhe Sektorin Financiar është një shembull i shkëlqyer për ta ilustruar këtë pikë, duke qenë se ato gëzojnë mjaft ekspertizë në trajtimin e këtyre çështjeve në vendet e zhvilluara dhe ato me treg në zhvillim. Për këtë arsye, unë besoj se përfshirja e këtyre institucioneve në procesin e diskutimit do të jetë me përfitim si për BE-në, ashtu dhe për ekonomitë e vendeve të EQLJ-së.

Në fund të fundit, Eurozona dhe ekonomitë e vendeve të EQLJ-së do të jenë pjesë e të njëjtit bashkim politik, ekonomik dhe monetar. Pavarësisht vështirësive aktuale, axhenda e integrimit politik dhe ekonomik e BE-së mbetet e përkushtuar ndaj këtij objektivi. Dikush mund të thotë se pavarësisht pengesave të mundshme politike dhe sociale të shkaktuara nga kriza, kjo e fundit e ka shtyrë axhendën e integrimit më shpejt dhe më fort se më parë. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të lidhim procesin e integrimit politik dhe atij ekonomik së bashku për të vijuar me zhvillimin e këtyre dy proceseve me të njëjtën shpejtësi. Në rrethanat aktuale, bashkëpunimi dhe komunikimi rajonal shndërrohen në një objektiv të nevojshëm të procesit të integrimit të vendeve të rajonit të EQLJ-së, të paktën për reformën bankare dhe atë të tregut financiar. Do të ishte shumë më e lehtë për autoritetet e BE-së që t'i shqyrtojnë dhe adresojnë shqetësimet e rajonit të EQLJ-së si një grup i vetëm dhe jo në mënyrë individuale.

Në përfundim, është shumë e rëndësishme që të vendoset një nivel i konsiderueshëm komunikimi dhe koordinimi midis bankave qendrore dhe institucioneve të BE-së, si dhe me kuadrin e tyre ligjor dhe rregullativ. Së fundi, do të rekomandoja plotësimin e tij me një nivel të ngjashëm koordinimi midis institucioneve të tjera që luajnë një rol të rëndësishëm në stabilitetin makroekonomik dhe atë financiar në ekonomitë tona. Në veçanti, nevojitet

më shumë komunikim dhe koordinim midis ministrive të financave të rajonit, për shkak se politika fiskale është thelbësore për stabilitetin makrofinanciar të ekonomisë dhe ajo luan një rol mjaft të rëndësishëm në zbatimin e suksesshëm të instrumenteve makroprudenciale. Koordinimi nuk është një detyrë e lehtë, veçanërisht kur përfitimet e një vendi janë me kosto për vendet e tjera partnere, megjithatë, nëse aspirojmë për rezultate gjithëpërfshirëse, kjo është mënyra e duhur dhe momenti i përshtatshëm për të vepruar.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në Samitin e Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve të Rajonit me temë "E ardhmja financiare e rajonit",
Becic, Mali i Zi, 14 qershor 2013

Të nderuar Ministra të Financave,
Të nderuar Guvernatorë,

Kriza që po kalojmë, duke qenë kaq e thellë dhe e tejzgjatur, do të lërë gjurmë në ekonominë në përgjithësi dhe bankingun qendror në veçanti. Deri te Recesioni i Madh, politika monetare jetonte në një botë që mund të quhet "epoka e shënjestrimit të inflacionit". Për këdo që i ka ndjekur diskutimet rreth politikës optimale të bankës qendrore që në fillimet e krizës, është e qartë se tashmë vlefshmëria e qasjes së mëparshme është vënë në pikëpyetje. Në shumë mënyra, shënjestrimi i inflacionit e thjeshtonte punën e bankës qendrore, për aq kohë sa banka qendrore e zbatonte politikën e saj në mënyrë korrekte. Banka qendrore, e parë nga publiku si institucion i pavarur, duhej të angazhohej në mënyrë të besueshme për objektivin e shpallur të inflacionit, me qëllim ankorimin e pritjeve afatmesme për inflacionin. Vetëpërmbushja e pritshmërive të agjentëve ekonomikë dhe të çmim-vënësve do të ndihmonte në transmetimin e objektivave të politikës monetare.

Për fat të keq, siç është treguar kohët e fundit, kjo qasje rigoroze e politikës monetare ka disa mangësi. Për shkak të përqendrimit në çmimet e konsumit, kësaj qasjeje i mungonte pikërisht lëvizja e çmimeve të mjeteve në përgjithësi. Përshkallëzimi i çmimeve të mjeteve dhe shpërthimi i papritur i tyre ndikoi ndjeshëm në sjelljen dhe bilancet e agjentëve ekonomikë dhe sfidoi stabilitetin e sistemit financiar. Në këtë aspekt, koncepti i stabilitetit financiar u konsiderua si produkt plotësues i stabilitetit monetar.

Ekonomistët besonin se stabilizimi i çmimeve të konsumit do të çotne drejt një sjelljeje të qëndrueshme dhe të parashikueshme të mjeteve financiare. Kriza na kujton dhimbshëm se kjo nuk është domosdoshmërish e vërtetë. Sjellja në tregjet financiare nuk është gjithmonë racionale dhe mungesa e besimit në këto tregje mund të përkeqësohet vazhdimisht, duke tronditur të gjithë ekonominë.

Fatmirësisht, Banka e Shqipërisë miratoi një politikë më konservatore, duke i trajtuar njëkohësisht çështjet e politikës monetare dhe të stabilitetit financiar, e duke i kushtëzuar proceset vendimmarrëse të njërit nga tjetri. Për rrjedhojë, kriza dha ndikim të drejtpërdrejtë, por të pakonsiderueshëm në sistemin financiar.

Pavarësisht kësaj qasjeje, sistemi bankar u përball menjëherë me vështirësi të formës së tërheqjes së depozitave, nën ndikimin indirekt të frikës dhe

pritshmërive irracionale. Probleme likuiditeti ranë mbi tregun e kredive dhe më pas mbi ekonominë reale dhe sektorin e jashtëm.

Banka e Shqipërisë reagoi me shpejtësi ndaj kësaj klimë ekonomike në ndryshim. U injektua likuiditet i bollshëm në sistemin tonë bankar dhe u zbatuan rregulla rigoroze për transferimin e fondeve. Megjithatë, ndryshe nga shumë vende të tjera ku politika monetare u përdor fillimisht për të rritur kërkesën agregate, në Shqipëri, politika monetare qëndroi në të njëjtin kah, duke lënë vend për një politikë fiskale ekspansioniste.

Për shkak të një periudhe relativisht të gjatë konsolidimi, politika fiskale gjatë shpërthimit të krizës kishte hapësira të bollshme për manovrim dhe për ndikim të drejtpërdrejtë në ekonomi. Reagimi i politikë sonë u kushtëzua nga çështjet e stabilitetit financiar, me gjykimin se ulja e normës së interesit do të përshpejtonte tërheqjen e depozitave nga sistemi bankar.

Banka e Shqipërisë ndërmori hapa të guximshme dhe të vendosura, për të kontrolluar këto probleme dhe për të rikthyer besimin te sistemi bankar. Ndërkohë që efektet e stimulit fiskal filluan të veniten dhe u rikthye besimi ndaj sistemit bankar, ne ulëm normën bazë të politikës monetare në vlerën më të ulët historike, me qëllim që t'i siguronim ekonomisë stimul të mëtejshëm fiskal. Ajo që është edhe më e rëndësishme, ne forcuam mbikëqyrjen e sistemit bankar, duke krijuar një departament krejt të ri, atë të Stabilitetit Financiar dhe duke i sjellë çështjet e stabilitetit financiar në procesin vendimmarrës të politikës monetare.

Si rezultat, është zgjeruar tërësia e mjeteve që Banka e Shqipërisë ka në dispozicion, me qëllim përfshirjen e disa masave makroprudenciale, të cilat synojnë të trajtojnë njëkohësisht rritjen ekonomike dhe problemet e stabilitetit financiar.

Besoj se hapa të ngjashme janë ndërmarrë nga shumë banka qendrore në botë. Me dashje apo pa dashje, objektivi i stabilitetit financiar tashmë konsiderohet si detyrë themelore e institucioneve tona. Nuk ka rëndësi nëse është ndryshuar apo jo mandati ligjor i bankës qendrore për përfshirjen e këtij objektivi. Çfarë ka vërtet rëndësi është fakti që stabiliteti financiar është një kusht paraprak për stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik dhe atë monetar. Sfida me të cilën po përballemi ka të bëjë me mënyrën se si ta përfshijmë këtë objektiv të ri në politikën tonë, a mund të ndërthuret shënjestrimi i inflacionit me stabilitetin financiar, apo nevojitet një regjim tërësisht i ri.

Deri tani janë përmendur qasje të ndryshme, të reja e radikale. Megjithatë, besoj se nuk duhet të heqim dorë nga të gjitha mësimet e nxjerra dhe sukseset e arritura në të kaluarën. Stabilizimi i inflacionit duhet të jetë diçka që i bën bankierët qendrorë të krenohen, diçka që duhet ta ushqejmë dhe për të cilën duhet të vazhdojmë të përpiqemi.

Inkorporomi i objektivave të stabilitetit financiar me regjimin e shënjestrimit të inflacionit duhet të shihet si mundësi për të kuptuar zhvillimet ekonomike

dhe rreziqet potenciale makro-financiare, me qëllim arritjen e të dyja këtyre objektivave dhe ruajtjen e stabilitetin ekonomik afatgjatë. Besoj se drejtimi i politikës monetare do të vazhdojë të diskutohet gjerësisht në të ardhmen, duke përfshirë kuptimin tonë të përmirësuar mbi rolin e çmimeve të mjeteve dhe konfliktet financiare (financiar frictions).

Në këto rrethana, bankat qendrore më të mëdha të vendeve të zhvilluara i kanë shtrirë teorinë dhe praktikat e bankingut qendror përtej aktiviteteve tradicionale. Bilancet e tyre janë rritur përtej imagjinatës dhe në disa raste, përfshijnë edhe pasuritë private;ato kanë pranuar një rol më të zgjeruar dhe kanë marrë përsipër më shumë përgjegjësi.

Ky lloj i ri dhe i paprovuar i bankingut qendror do të ndikojë fuqishëm, jo vetëm në natyrën e politikës monetare dhe ndërveprimin e saj me objektivat e tjera të bankës qendrore, por edhe në pavarësinë dhe besueshmërinë e vetë bankës qendrore. Natyra e ardhshme e politikës monetare do të varet shumë nga suksesi i bankave qendrore kryesore për daljen nga kjo situatë në mënyrë të kontrolluar dhe në kohën e duhur, pa rritur inflacionin dhe pa dëmtuar besueshmërinë e bankave qendrore, gjë që është fituar me aq vështirësi.

Këto zhvillime do të ndikojnë në politikën monetare të vendeve me ekonomi tregu në zhvillim, nëpërmjet kurseve të këmbimit dhe normave të interesit, por çka është edhe më e rëndësishme, edhe në mënyrën se si bankat qendrore e drejtojnë politikën monetare.

Të ndikuara nga praktikat aktuale të bankave kryesore qendrore, disa banka të tjera qendrore i kanë riorientuar objektivat e tyre dhe janë angazhuar në aktivitete tradicionale për bankat e zhvillimit dhe qeveritë. Ne kemi qenë të kujdesshëm për të qëndruar larg miratimit dhe synimit të këtyre objektivave, jo vetëm në politikën monetare, por edhe në politikën tonë makroprudenciale.

Banka e Shqipërisë, tradicionalisht e ka bazuar politikën e saj mbi dy shtylla të rëndësishme. Fokusi ynë i parë ka qenë arritja e objektivit të inflacionit dhe menaxhimi i pritjeve të inflacionin, me qëllim ruajtjen e fuqisë blerëse të monedhës sonë kombëtare. Kjo politikë ka siguruar njëkohësisht nxitjen e nevojshëm për aktivitetin ekonomik. Fokusi ynë i dytë ka qenë mbikëqyrja bankare dhe stabiliteti financiar, gjë që ka rritur besimin në sistemin tonë financiar, e për rrjedhojë, ka rritur eficiencën dhe besueshmërinë e politikës monetare.

Siç jam shprehur edhe në prill të vitit 2008, në konferencën vjetore me sistemin bankar në Shqipëri, "Çdo investim që bëjmë sot për të garantuar stabilitetin financiar na kthehet në eficiencë të shtuar të politikës monetare".

Kohët e fundit, Banka e Shqipërisë e ka paraqitur rritjen e kulturës financiare si shtyllën e tretë të politikës dhe pavarësisë tonë. Ky objektiv bazohet në besimin tim se dy shtyllat e para fitojnë qëndrueshmëri, vetëm nëse publiku e kupton rolin e bankës qendrore, pavarësinë dhe politikën e saj.

E fundit por jo më pak e rëndësishmja, do të doja të theksoja nevojën për bashkëpunim dhe bashkërendim me politikën fiskale. Politika fiskale dhe ndikimi i saj janë fakte të jetës që nuk mund të lihen mënjanë. Ndaj, politikat monetare dhe makroprudenciale duhet të hartohen dhe zbatohen duke pasur parasysh ekzistencën e saj.

Banka qendrore nuk jeton në një ishull të izoluar; suksesi i saj varet, ndër të tjera, edhe nga aftësia e saj për të vepruar në bashkëpunim dhe bashkërendim me politikën fiskale, pa humbur pavarësinë e saj.

Përfshirja e këtij kuptimi në teorinë dhe praktikën e bankës qendrore kërkon përshtatje dhe fleksibilitet, por njëkohësisht, kërkon që bankat qendrore të ruajnë fokusin dhe pavarësinë, si dhe të pranojnë kufizimet e tyre.

Në tërësi, këto ndryshime do ta bëjnë bankën qendrore dhe regjimin e shënjestrimit të inflacionit një mjet të dobishëm në duart e autoriteteve monetare, me qëllim ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar pas krizës financiare globale.

Faleminderit për vëmendjen.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

mbi vendimmarrjen e politikës monetare
të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,
26 qershor 2013

Sot, në datën 26 qershor 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike e monetare në vend, si dhe në vijim të diskutimeve mbi ecurinë e pritur të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Në gjykimin e Këshillit Mbikëqyrës, kushtet monetare janë të përshtatshme për të siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit në një periudhë afatmesme. Njëkohësisht, këto kushte ofrojnë edhe stimulin e nevojshëm monetar për mbështetjen e kërkesës së brendshme.

(Më lejoni në vijim të bëj një pasqyrë të zhvillimeve ekonomike e të çështjeve kryesore të diskutuara në mbledhjen e sotme.)

Inflacioni vjetor vijoi prirjen rënëse edhe në muajin maj, duke shënuar nivelin 2.1%. Reduktimi i çmimeve të produkteve bujqësore, si pasojë e shtimit të ofertës së tyre në tregun vendas, e zhvendosi për poshtë inflacionin e këtij muaji. Nga ana tjetër, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të tjera të shportës së konsumit janë luhatur rreth niveleve të muajve të kaluar.

Nga këndvështrimi makroekonomik, ecuria e çmimeve të konsumit vijon të reflektojë presione të dobëta inflacioniste, si nga kahu i kërkesës ashtu edhe nga ai i ofertës. Dobësia ciklike e ekonomisë është shoqëruar me reduktimin e fortë të inflacionit bazë gjatë kësaj periudhe. Hapësirat e pashfrytëzuara në tregun e punës dhe të kapitalit mbajnë në nivele të ulëta rritjen e kostove të prodhimit dhe të marxheve të fitimit, duke u përcjellë më tej në rritje të ulëta të çmimeve finale të mallrave të konsumit të prodhuara në vend. Gjithashtu, stabilizimi i çmimeve në tregjet botërore si dhe pritjet e ankoruara të agjentëve ekonomikë për inflacionin, janë reflektuar në rritje të ulëta të çmimeve në tregun e brendshëm. Inflacioni i çmimeve të konsumit shfaqet në nivele të ulëta dhe parashikohet të jetë i tillë edhe në periudhën e ardhshme.

Përditësimi i analizës makroekonomike me informacionin më të fundit të disponuar tregon për rritje të ulët të kërkesës agregate gjatë pesë muajve të parë të vitit. Rritja ekonomike është mbështetur nga kërkesa e huaj dhe nga rritja e shpenzimeve publike gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që ecuria e konsumit dhe e investimeve private është e dobët. Gjatë tremujorëve të fundit, konsumi dhe investimet private vlerësohet të kenë vuajtur nga pasiguria për të ardhmen dhe nga kushtet më të shtrënguara të financimit. Ecuria e mëtejshme e tyre do të kushtëzohet në një masë të madhe nga përmirësimi i këtyre dy faktorëve frenues.

Në pesë muajt e parë të vitit, politika fiskale ka shfaqur një karakter stimulues për ekonominë, të shfaqur në zgjerimin me ritme të shpejta të deficitit fiskal dhe të shpenzimeve publike. Gjithashtu, lehtësimi fiskal është mbështetur edhe në politikën tatimore të uljes së drejtpërdrejtë apo indirekte të disa lloj taksash. Shpenzimet buxhetore u rritën me rreth 13.3%, të diktuara kryesisht nga rritja e investimeve publike gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, të ardhurat fiskale janë ulur me 0.2%, kryesisht në reflektim të tkurrjes së komponentit tatimor të tyre. Deficiti buxhetor për 5 muajt e parë të vitit rezultoi rreth 38.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 1.1 herë më lartë se një vit më parë dhe duke ndikuar në rritjen në nivelin 62.4% të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Banka e Shqipërisë vazhdon të tërheqë vëmendjen mbi nevojën e marrjes së masave fiskale të cilat garantojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit publik, rritin besimin e tregjeve financiare në financat tona publike dhe ulin koston afatgjatë të shërbimit të borxhit. Ky objektiv duhet të jetë prioriteti kryesor afatmesëm i financave publike.

Të dhënat mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë për një kontribut pozitiv të kërkesës së huaj neto në rritjen ekonomike të tremujorit të parë. Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua në terma vjetorë dhe vlerësohet të qëndrojë në 9.8% të PBB-së në këtë periudhë. Të dhënat e tregtisë së jashtme për muajin prill tregojnë për ngushtim të mëtejshëm vjetor të deficitit tregtar, me rreth 5.3% në terma vjetore. Ky ngushtim erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve ndërkohë që, për herë të parë që prej muajit shtator 2012, importet totale shënuan rritje me rreth 3.6% në këtë muaj. Sikurse e kemi theksuar dhe më herët, deficiti i llogarisë korente përbën një dobësi strukturore të ekonomisë shqiptare. Korrektimi i saj zbut një nga burimet e mundshme të rrezikut të ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare, si dhe rrit hapësirat për ndjekjen e politikave makroekonomike stimuluese në të ardhmen.

Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet në ekonominë reale dhe analizat tona tregojnë se presionet monetare mbi inflacion janë të ulëta. Rritja vjetore e ofertës së parasë u përshpejtua në muajin prill, duke ndaluar prirjen ngadalësuese të vënë re që nga muaji korrik i vitit të kaluar. Agregati i parasë së gjerë, M3, regjistroi një rritje prej 5.2% nga 4.6% në muajin mars, kryesisht në reflektim të rritjes së kërkesës për financim nga sektori publik. Nga ana tjetër, kërkesa e ulët e sektorit privat është pasqyruar në ecurinë e plogësht të kredisë. Kredia për ekonominë u ngadalësua më tej në muajin prill, duke shënuar një normë vjetore rritjeje prej vetëm 0.9%. Krahas kërkesës së ulët, dobësimi i kreditimit pasqyron edhe rritjen e kujdesit të bankave në kredidhënie, të materializuar në kushte krahasimisht të shtrënguara kreditimit. Ky fenomen ka një përhapje rajonale dhe diktohet në një masë të madhe nga zhvillimet në tregjet financiare të Eurozonës.

Tipari kryesor i zhvillimeve në tregjet financiare ka qenë ecuria rënëse e normave të interesit gjatë muajve të fundit. Tejçimi i sinjaleve lehtësuese të politikës monetare ka qenë i përgjithshëm ndonëse në masë të ndryshme për segmente të ndryshme të tregut. Normat e interesit në tregun ndërbankar ndoqën uljen e fundit të normës bazë që në muajin mars dhe vazhdojnë të

qëndrojnë të ankoruara rreth saj. Ndërkohë, në muajin maj e qershor, vijon rënia e yield-eve në tregun primar në linjë me ciklin lehtësues të politikës monetare. Normat e interesit në tregun e depozitave dhe atë të kredive po reagojnë më ngadalë, në përputhje me kohëvonesat në mekanizmin e transmisionit të politikës monetare, por dhe në prezencë të pasigurisë së agjentëve ekonomikë për të ardhmen dhe primeve të rrezikut që shoqërojnë aktivitetin kreditues.

Zhvillimet e faktuara deri më tani nuk kanë ndryshuar projeksionet tona bazë për zhvillimet ekonomike në të ardhmen. Për vitin 2013, rritja ekonomike projektohet pranë niveleve të vitit të kaluar, ndonëse balanca e rreziqeve është zhvendosur në kahun rënës. Kërkesa e huaj pritet të japë një kontribut më të ulët gjatë këtij viti, e ndikuar nga ngadalësimi ekonomik në vendet partnere. Ndërkohë, intensifikimi i shpenzimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit pritet të shfaqet si kontribut pozitiv i sektorit publik në rritjen e kërkesës agregate në këtë periudhë. Por, aftësia e saj për të induktuar një rritje të qëndrueshme të sektorit privat duket e kufizuar në kohë dhe e kufizuar nga respektimi i treguesve të deficitit buxhetor. Në këto kushte, ecuria e kërkesës së brendshme private mbetet përcaktuese për rritjen e kërkesës agregate në të ardhmen. Akumulimi i kursimeve financiare dhe stimuli lehtësues i politikës monetare pritet të materializohet në një ecuri më të mirë të konsumit dhe shpenzimeve private në të ardhmen. Rritja e kërkesës nën potencialin e ekonomisë edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit do të vijojë të ushtrojë presione të dobëta inflacioniste nga kahu i kërkesës.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 3.75%. Tabloja e zhvillimeve ekonomike e financiare brenda dhe jashtë vendit përcakton ruajtjen e natyrës lehtësuese të kushteve monetare përgjatë horizontit kohor të politikës monetare. Një politikë e tillë krijon kushtet e nevojshme për respektimin e objektivit të inflacionit në afat të mesëm, duke mbështetur njëkohësisht rritjen e kërkesës agregate dhe shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese në ekonomi.

Zhvillimet e pritura ekonomike e financiare kërkojnë ruajtjen e natyrës lehtësuese të kushteve monetare përgjatë horizontit kohor të politikës monetare. Banka e Shqipërisë është e gatshme të reagojë, në kohën dhe në masën e duhur, për të krijuar kushtet e duhura monetare për respektimin e objektivit të saj të inflacionit.

ANALIZA PERIODIKE*

** Pikëpamjet e shprehura në këto materiale janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR TREMUJORI I, 2013

ERJONA SULJOTI, SOFIKA NOTE, OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, PRILL 2013

1. BANKAT DHE AKTIVITETI NDËRMJETËSUES

Sistemi financiar shqiptar përbëhet nga 16 banka tregtare dhe institucione të tjera financiare si shoqëritë e kursim-kreditit, fondet private të investimit dhe korporata të tjera financiare. Megjithatë struktura e sistemit financiar vijon të mbizotërohetnga sektori bankar, i cili aktualisht përbën mbi 90% të totalit të aktiveve të sistemit. Kështu, pjesa më e madhe e ndërmjetësimit financiar në ekonomi mbulohet nga sektori bankar ndaj dhe termat "ndërmjetësim financiar" dhe "ndërmjetësim bankar" përdoren në mënyrë të përkëmbyer. Ecuria e ndërmjetësimit financiar diktohet kryesisht nga aktiviteti depozitues dhe kreditues. Sistemi bankar luan rolin kryesor në ndërmjetësimin e fondeve nga agjentët ekonomikë në rolin e kursimtarëve – kryesisht individët – tek përdoruesit e këtyre fondeve si bizneset private dhe individë të tjerë.

Grafik 1. Kredia për ekonominë dhe depozitat në raport me PBB-në, (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e ndërmjetësimit financiar gjatë tremujorit të parë të vitit 2013[1] kanë regjistruar një tendencë të lehtë rënëse. Raporti i depozitave ndaj PBB-së shënon 68.7% në muajin shkurt kundrejt 68.9% në fund të tremujorit të kaluar. Ndërsa raporti i kredisë për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto shënon një normë prej 40.6% në muajin shkurt, ose rreth 0.5 pikë përqindje më poshtë se në fund të vitit. Pakësimi i financimit me kredi të ekonomisë nga

[1] *Të dhënat më të fundit monetare në analizë i përkasin periudhës janar-shkurt '13.*

sektori bankar vijon të diktohet si nga faktorë të kërkesës dhe të ofertës. Në kuadrin e zhvillimeve të përgjithshme makroekonomike, ku ecuria e aktivitetit ekonomik mbetet e plogësht, dhe si pasojë e faktorëve psikologjikë lidhur me pasiguritë e perceptuara për zhvillimet ekonomike në të ardhmen, kërkesa për mjete monetare e agjentëve ekonomikë vlerësohet e ulët. Ndërkohë, nga ana e ofertës, megjithëse të mirëkapitalizuara dhe likuide, bankat vijojnë të mbajnë të shtrënguara kushtet e kreditimit dhe të jenë mjaft përzgjedhëse ndaj projekteve që mbulojnë me financim. Shfrytëzimi i ulët i këtij likuiditeti për ndërmjetësimin e fondeve në kanalin e kredisë ka vijuar të nxisë mbajtjen e fondeve në formën e mjeteve valutore neto.

Ndërmjetësimi financiar – i matur si raport i kredisë ndaj depozitave të sistemit bankar – ka rezultuar i ulët dhe thuajse në të njëjtat nivele të tremujorit të kaluar, por me një tendencë të lehtë rënëse. Por megjithëmonetizimin në rritje, në fund të muajit shkurt sistemi bankar rezulton të ketë ndërmjetësuar rreth 59.1% të fondeve nga depozitat, në kredi për ekonominë ose 0.5 pikë përqindje më pak se në fund të vitit. Kjo rënie në normën e ndërmjetësimit ka ardhur kryesisht si pasojë e kursimeve më të larta të agjentëve ekonomikë në depozita – raporti i depozitave ndaj parasë së gjerë qëndron në rreth 83.4% në muajin shkurt –kundrejt kërkesës së ulët për financim me kredi nga sistemi bankar. Kështu, në muajin shkurt, rritja vjetore e depozitave totale ishte 6.1%, duke qëndruar pranë nivelit të fundvitit 2012. Kjo ecuri është pranë mesatares afatgjatë të zgjerimit vjetor të depozitave në total të sistemit bankar në 10 vitet e fundit (duke përjashtuar periudhën 2008-2009). Nga ana tjetër, ritmet e rritjes vjetore të portofolit të kredisë kanë vazhduar të reduktohen. Në muajin shkurt ky portofol ishte vetëm 1.7% më i lartë se një vit më parë. Ky nivel përbën edhe normën më të ulët historike të rritjes së portofolit të kredisë në 10 vitet e fundit.

Grafik 2. Tregues të ndërmjetësimit për sistemin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. ECURIA E NDËRMJETËSIMIT

Aktiviteti ndërmjetësues në dy muajt e parë të vitit 2013 është karakterizuar nga ecuri e mirë e depozitave, por mobilizim i ulët i tyre nëkredidhënie. Kredia për ekonominëështë shfaqur e plogësht, në reflektim të kërkesës së ulët të agjentëve ekonomikë dhe sjelljes konservatore të bankave, të shprehur në kushte të shtrënguara të kreditimit. Marzhet e ndërmjetësimit kanëpaturluhatshmëri të lartë mujore dhe janë ndikuar nga kredia e pakët dhe norma të luhatshme të interesit të kredisë, por në terma mesatarë ata qëndrojnë në nivele më të ulëta se një vit më parë. Pjesa më e madhe e elementëve jokosto të kushteve të kreditimit vijon të veprojë në kahun shtrëngues, veçanërisht për kreditë për biznese.

2.1 NDËRMJETËSIMI NË LEKË

Ndërmjetësimi në monedhën vendase është ngadalësuar në tremujorin e parë të vitit 2013. Në fund të muajit shkurt, raporti kredi/depozita në lekë shënoi 44.0%, duke rënë me 1.1 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar. Rënia e raportit të ndërmjetësimit në lekë në dy muajt e fundit ka ardhur si pasojë e ngadalësimit të kredisë në lekë.

Grafik 3. Tregues të ndërmjetësimit në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat në lekë në tremujorin e parë të vitit 2013, kanë shfaqur një performancë lehtësisht më të mirë se në tremujorin e fundit të vitit 2012, me një rritje vjetore prej 5.3%. Ecuria e mirë e kreditimit në lekë si dhe rritja e kërkesës për financim të qeverisë në dy muajt e parë të vitit kanë ndihmuar në qarkullimin/ krijimin e parasë në lekë në ekonomi. Sipas afateve të maturimit, performanca e mirë e depozitave në lekë është mbështetur nga depozitat pa afat në lekë, të cilat kanë mbajtur norma rritjeje vjetore të larta në 8.9% në muajin shkurt. Kjo ecuri e depozitave në lekë është ndikuar kryesisht nga

depozitat e bizneseve pa afat, të cilat shfaqin luhatshmëri të lartë gjatë vitit. Kurse depozitat në lekë meafat janë rritur 4.5% vit mbi vit, të përkrahura nga një rritje e moderuar por e qëndrueshme e depozitave të individëve me afat në lekë.

Grafik 4. Depozitat në lekë sipas afateve të maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në lekë ka qenë nxitësi kryesor i kredisë gjatë vitit të kaluar, e orientuar kryesisht në segmentin e kreditimit të bizneseve. Megjithatë, në dy muajt e parë të këtij viti ajo është ngadalësuar ndjeshëm. Gjatë kësaj periudhe, stoku i saj ka rënë me 3.6 miliardë lekë, pjesa më e madhe e së cilës ishte kredi për investime. Rritja vjetore e saj në fund të muajit shkurt rezultoi 12.6%, duke rënë me 1.3 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar dhe me 5.0 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 5. Ecuria e aktivitetit kreditues në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në lekë, është shfaqur e luhatshme në dy muajt e parë të vitit. Kështu, pasi u ul në5.35 pikë përqindje nëmuajin janar, ajo u rrit ndjeshëm në 7.29 pikë përqindje në muajin shkurt. Në prani të tendencës rënëse të normës së interesit të depozitave, luhatshmëria e saj është shkaktuar kryesisht nga luhatjet në normat e interesit të kredisë. Në kushtet e nivelit të ulët të kredisë së re, norma mesatare e interesit është ndikuar ndjeshëm nga kredi me karakteristika tëveçanta të rrezikut dhe kthimit. Në terma mesatarë vjetorë, në krahasim me një vit më parë, norma e interesit për kredinë në lekë ka shënuar rënie më të madhe se ajo e depozitave, duke rezultuar në rënie të kostos së ndërmjetësimit në lekë gjatë kësaj periudhe.

Luhatshmëria e normave të interesit të kredisë në lekë në dy muajt e parë të vitit është pasqyruar edhe në diferencën e tyre me Yield-et e bonove të thesarit 12-mujore. Pas rënies të shënuar pas tremujorit të parë të vitit të kaluar, spread-i mesatar në këta dy muaj rezultoi 4.3 pikë përqindje, duke qëndruar në nivelet e një viti më parë.

Grafik 6. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në lekë*.



*Marzhi llogaritet si diferencë mes normave të interesit të kredisë dhe atyre të depozitave. Spread-i llogaritet si diferencë mes normës së interesit të kredisë/depozitave dhe asaj referencë (bono thesari 12-mujore për lekun dhe Euribor 12-mujor për euron).
Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 NDËRMJETËSIMI NË VALUTË

Aktiviteti ndërmjetësues në monedhë të huaj, pasi shënoi rënie në tremujorin e katërt të vitit 2012, mbeti thuajse i pandryshuar në tremujorin e parë të vitit 2013. Raporti kredi/depozita në fund të muajit shkurt rezultoi 75.1%, duke rezultuar 8.7 pikë përqindje më i ulët në krahasim me një vit më parë. Rënia e ndërmjetësimit në valutë gjatë vitit të kaluar ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së kredisë në valutë. Ndërkohë, ruajtja e niveleve të ulëta të ndërmjetësimit në muajt e fundit është shkaktuar edhe nga ngadalësimi i rritjes sëdepozitave në monedhë të huaj.

Ritmet e rritjes vjetore të depozitave në valutë janë ngadalësuar më tej në tremujorin e parë të vitit 2013, duke shënuar 6.9%. Ky ngadalësim ka

Grafik 7. Tregues të ndërmjetësimit në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

reflektuar krahas flukseve më të ulëta valutore nga jashtë, edhe krijimin më të pakët në monedhë të huaj, si pasojë e ecurisë së dobët të kredisë në valutë. Gjithashtu, në 3 muajt e fundit kjo ecuri është ndikuar edhe nga zhvendosja e investimeve të kursimeve në valutë të individëve në institucioneve të tjera financiare jobanka. Kontributin kryesor në zgjerimin e depozitave në valutë e japin depozitat me afat të individëve, edhe pse ky kontribut ka ardhur duke u reduktuar që prej korrikut të vitit të kaluar. Ndërkohë, në dy muajt e parë të vitit 2013, përmirësimi i normës vjetore të depozitave pa afat në valutë, në 6.7%, është mbështetur në rritjen e depozitave pa afat të individëve.

Grafik 8. Depozitat në valutë sipas afateve të maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në valutë ka vijuar të shfaqë një ecuri të dobët në dy muajt e parë të vitit. Teprica e saj është tkurrur me 0.6 miliardë lekë në këtë periudhë. Ndonëse është regjistruar një rritje e kredisë për investime në valutë në këta dy muaj, ajo nuk ka arritur të balancojë tkurrjen e llojeve të tjera të kredisë

në valutë. Reduktimi i vazhdueshëm i portofolit të kredisë në valutë është reflektuar në thellimin e tkurrjes vjetore të saj. Në fund të muajit shkurt, ajo është 4.2% më e ulët se një vit më parë.

Grafik 9. Ecuria aktivitetit kreditues në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e dobët e kreditimit në valutëështëepranishme si tek bizneset, ashtu edhe tek individët. Përveç kërkesës së ulët dhe kushteve të shtrënguara që kanë karakterizuar ecurinë e përgjithshme të kreditimit, ecuria e dobët e kredisë në valutë ka reflektuar edhe një zhvendosje të preferencave të klientëve nga monedhat e huaja tek monedha vendase. Ky fenomen ka qenë më i dukshëm në kreditë hipotekare për individë dhe kreditë për qëllime likuiditeti të bizneseve.

Grafik 10. Ecuria e kostos së ndërmjetësimit në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit në euro[2] në muajt janar dhe shkurt është shfaqur gjithashtu e luhatshme, duke u ndikuar nga lëvizjet në normat e interesit të kredisënë mënyrë të ngjashme si edhe kostoja e ndërmjetësimit në lekë. Kështu, në muajin janar, ajo rezultoi 3.88 pikë përqindje, duke rënë me mbi 1 pikë përqindje nga mesatarja e vërejtur në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Rënia e ndjeshme e saj është ndikuar nga norma veçanërisht e ulët e një kredie preferenciale. Në muajin shkurt, norma mesatare e interesit të kredisë u rrit sërish, duke iu afruar niveleve të muajve të mëparshëm. Nga ana tjetër, norma mesatare e interesit të depozitave ka vijuar të bjerë në muajt janar dhe shkurt, duke reflektuar edhe situatën e mirë të likuiditetit në monedhë të huaj.

Normat e interesit për monedhën euro në vend mbeten ndjeshëm më të larta nga ato në tregjet ndërkombëtare, në reflektim të tipareve strukturore të tregut vendas. Megjithatë, ulja e normave të interesit për depozitat në euro në vend, e vërejtur në tremujorin e fundit të vitit të kaluar dhe në muajt e parë të këtij viti, është reflektuar në ngushtimin e kësaj diference. Një ecuri e tillë krijon premisat edhe për rënie të normës së interesit të kredisë në këtë monedhë në të ardhmen.

3. ECURIA E ELEMENTEVE JOKOSTO NË NDËRMJETËSIM

Vrojtimi i aktivitetit kreditues i kryer në tremujorin e parë të këtij viti tregon njështrëngim të mëtejshëm të kushteve të kreditimit për bizneset, për të gjitha llojet e kredive. Ndërkohë, kushtet e kreditimit për individë kanë shënuar një lehtësim të vogël për kreditë hipotekare, por janë shtrënguar për ato

Grafik 11. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas)*.



*Balanca neto e përgjigjeve në këtë vrojtim.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[2] *Veprimtaria e bankave në valutë mbizotërohet nga aktiviteti i tyre në euro, i cili zë më shumë se 80% të aktivitetit në valutë.*

konsumatore. Një pjesë e mirë e elementëve jokostonë kushtet e kreditimit vijon të veprojë në kahun shtrëngues, veçanërisht për bizneset.

Standardet e kreditimit për bizneset kanë vijuar të shtrëngohen në tremujorin e parë të këtij viti, por në një masë më të ulët se në tremujorët e mëparshëm. Të gjithë elementët jokosto të këtyre kushteve kanë vepruar në kahun shtrëngues. Ndër to, kërkesat për kolateraldhe maturiteti maksimal i kredisëmbeten dy kriteret me efektin më të madh shtrëngues në kushtet e kreditimit për biznese.

Kushtet e financimit për individët, pasi mbetën të pandryshuara për tre tremujorët e fundit të vitit 2012, shënuan një lehtësim marzhinal në tremujorin e parë të këtij viti. Lehtësimi i kushteve të financimit, krahas elementëve kosto (normë interesi, komisione), është realizuar nëpërmjet maturitetit maksimal të kredisëdhe raportit të kështit me të ardhurat. Dy elementët e tjerë jokosto të kushteve të kreditimit, madhësia e kredisëdhe kërkesat për kolateral mbeten në kahun shtrëngues, por në një masë më të ulët se në tremujorin e mëparshëm.

INFORMACION MBI TREGUES EKONOMIKË E MONETARË TË DISA VENDEVE PARTNERE TREGTARE, TI-2013

JONIDA BOLLANO, MEDVIN SHEHU
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, PRILL 2013

EUROZONË

Ekonomia e Eurozonës në tremujorin e fundit të vitit 2012 vijoi të tkurret. Buletini i fundit i Eurostat-it tregoi se ajo ishte tkurrur me 0.6% nga tremujori paraardhës dhe 0.9% nga viti i kaluar. Ekonomia e zonës euro vazhdon të ndikohet nga ecuria negative e konsumit dhe e investimeve, ndërkohë që në këtë periudhë këtyre faktorëve i është shtuar edhe ngadalësimi i eksporteve neto. Treguesit paraprakë dhe të tërthortë deri në muajin shkurt (prodhimi industrial, shitjet me pakicë dhe treguesi i ndërtimit), konfirmojnë vijimin e ngadalësimit edhe në pjesën e parë të këtij viti. Gjithsesi, në horizontin afatmesëm, rimëkëmbja e ekonomisë së Eurozonës pritet të ndikohet pozitivisht nga ripërtëritja e eksporteve në kushtet kur ekonomia botërore ka shfaqur shenja gjallërimi.

Tregjet financiare dhe politika monetare në përgjithësi kanë luajtur një rol zbutës dhe ndihmues në këtë periudhë. Norma bazë e interesit qëndron në nivel të ulët historik (0.75%), ndërkohë që operacionet jokonvencionale të ndërmarra nga BQE kanë vijuar të sigurojnë likuiditet të bollshëm. Në tregjet e kapitaleve është reflektuar veprimi i BQE-së, i cili ka arritur të zbusë tensionet dhe ka sjellë ulje të *yield*-eve tek të gjitha kategoritë e emetuesve. Tregjet financiare kanë arritur të përthithin efektet e krizës në Qipro dhe të tensioneve në Slloveni, duke shmangur kështu përsëritjen e situatave të para në kohën e krizës në Greqi. Gjithsesi, mekanizmi i transmetimit të politikës monetare nuk ka qenë homogjen duke shfaqur në shumë shtete ngurtësi në aplikimin e normave të ulura të interesit në kreditimin e ekonomisë. Nga një analizë më specifike, problemi kryesor vijon të mbetet performanca e dobët ekonomike e disa shteteve kryesore (Itali, Spanjë) të cilat janë të detyruara të ndjekin njëkohësisht edhe një politikë të rreptë konsolidimi balancash fiskale. Hapësirat e ngushtuara në këtë drejtim si dhe zgjatja në kohë e tkurrjes ekonomike rëndojnë jo pak në krijimin e kushteve për një rikthim sa më të shpejtë në rritje pozitive ekonomike. Ngadalësimi ekonomik i vënë re tek shtetet me ecuri deri tani pozitive (Gjermani, Francë etj..), gjykohet se ka ardhur edhe si pasojë e efekteve të lidhura me këto shtete të Eurozonës që po përjetojnë një ngërç të zgjatur ekonomik. Një faktor tjetër shqetësues është rritja e papunësisë, vlera e së cilës vijon të rritet muaj pas muaji (12% në muajin shkurt). Vijimi i rritjes së papunësisë nga njëra anë, si dhe rënia e treguesve të punësimit nga ana tjetër kanë qenë në fokusin e analizës së Këshillit Drejtues të BQE-së në raportet e fundit. Norma bazë ka mbetur e pandryshuar (0.75%), megjithëse pritjet e agjentëve financiarë ishin për një ulje të lehtë të saj. Inflacioni ka ndjekur një trajektore rënëse në muajt e fundit, duke konfirmuar parashikimet e ekspertëve të BQE-së për presione inflacioniste të përmbajtura.

Tabela 1. Parashikimi i PBB-së dhe IÇK-së.

	PBB		IÇK	
	2013	2014	2013	2014
Eurozonë	-0.4	0.9	1.7	1.6
Gjermani	0.7	1.7	1.7	2.0
Spanjë	-1.6	0.2	2.0	1.5
Itali	-1.4	0.5	1.9	1.7
Greqi	-4.9	-1.4	-0.1	1.3

Burimi: Consensus economics, prill 2013.

GJERMANI

Ekonomia e Gjermanisë në tremujorin e fundit të vitit 2012 njohu një ngadalësim, duke regjistruar -0.6% nga tremujori paraardhës, ndonëse në krahasim me vitin e kaluar rritja e PBB-së ka qenë pozitive (0.4%). Zëri kryesor që ndikoi negativisht ishte kontributi i eksporteve neto (veçanërisht ato drejt vendeve të BE-së), të cilat në muajt e fundit njohën rënie. Ky zhvillim i ekonomisë gjermane ka rikthyer në vëmendjen e analistëve rolin e mundshëm negativ që mund të luajnë situata e përgjithshme ekonomike botërore dhe ecuria negative e shteteve kryesore partnere tregtare të Gjermanisë. Të dhënat e fundit për muajt janar dhe shkurt (prodhimi industrial, tregtia, eksportet, ndërtimi dhe konsumi personal) mbështesin idenë që ngadalësimi i ekonomisë gjermane do të jetë i përkohshëm dhe për pjesën e parë të vitit ajo pritet të ketë rritje ekonomike pozitive. Në këtë drejtim flasin edhe treguesit e besimit të biznesit (Ifo) dhe ato të konsumatorëve. Norma e papunësisë prej 5.5% në muajin shkurt vijon të mbetet një nga më të ulëtat në shtetet e zhvilluara, ndërkohë që edhe treguesit e punësimit shfaqen pozitivë. Inflacioni ka shfaqur rënie muaj pas muaji dhe parashikimet (KE) janë që ai do të qëndrojë në nivele të ulëta gjatë vitit 2013.

SPANJË

PBB-ja e Spanjës në tremujorin e katërt të 2012-ës ka vazhduar të regjistrojë vlera negative si në terma tremujorë(-0.8%) ashtu edhe në ato vjetorë (-1.9%). Faktori kryesor vijon të mbetet tkurrja e kërkesës së brendshme, ndërkohë që eksportet neto kontribuan pozitivisht duke arritur të zbusin rënien e PBB-së në tremujorin e fundit 2012. Dobësimi i vazhdueshëm i ekonomisë spanjolle ka ngritur pikëpyetje tek agjentët financiarë mbi arritjen dhe realizimin e konsolidimit të balancave fiskale në një kohë kur tregjet ndërkombëtare të kapitaleve nuk shfaqen shumë miqësore me idenë e rifinancimit të një deficiti të mundshëm. Papunësia në përgjithësi dhe ajo tek të rinjtë në veçanti vazhdon të rritet, duke shtuar trysnitë sociale dhe dobësuar më tej konsumin dhe iniciativën e biznesit. Ashtu si edhe në shtetet e tjera të Eurozonës, inflacioni në muajt e fundit ka ndjekur një ecuri rënëse. Të njëjtën trajektore ka ndjekur edhe indeksi i çmimeve të prodhimit, i cili ka regjistruar ulje prej 5 muajsh. Të dhënat e fundit (prodhimi industrial, tregtia, porositë e reja në industri, kreditë për shtëpi) tregojnë se tkurrja ekonomike do të vazhdojë edhe në pjesën e parë të këtij viti.

ITALI

Aktivitetit ekonomik i Italisë ka shënuar një tjetër tkurrje në tremujorin e fundit të vitit 2012. Ashtu si edhe në tremujorët e mëparshëm, ekonomia e Italisë paraqet dobësimin e vazhdueshëm të konsumit, investimeve dhe prodhimit industrial. Eksportet neto kanë rezultuar pozitive duke arritur të zbusin sadopak efektin negativ të zërave të mësipërm. Të dhënat e fundit për disa tregues paraprakë dhe sinjalizues të ecurisë ekonomike flasin për një përkeqësim të saj në muajt në vijim. Kështu prodhimi industrial, indeksi i shitjeve, porositë e reja në industri kanë regjistruar ulje si në terma mujorë ashtu edhe në krahasim me vitin e kaluar. Nevoja për të konsoliduar balancat fiskale i ka ngushtuar hapësirat e manovrave të mundshme nga ana e qeverisë qendrore, ndërkohë që situata jo e favorshme e ekonomisë botërore ka frenuar ritmin e eksporteve. Problemeve ekzistuese u është shtuar ndërkohë edhe ngërçi politik, i cili ka shtuar pasigurinë e agjentëve ekonomikë. Zgjatja në kohë e arritjes së marrëveshjes për krijimin e një qeverie të mbështetur dhe të aftë për kryerjen e reformave të nevojshme i ka shtuar pikëpyetjet për rikuperimin e pritshëm të ekonomisë italiane. Indeksi i çmimeve të konsumit ka ndjekur ecuri rënëse prej katër muajsh e bashkë me të edhe ai i çmimeve të prodhimit. Presionet inflacioniste janë zbutur në pjesën e fundit të vitit dhe parashikimet e ekspertëve të Bankës Qendrore të Italisë anojnë nga ana rënëse edhe për vitin në vazhdim.

GREQI

Informacioni i fundit nga Instituti Kombëtar i Statistikave të Greqisë tregoi se ekonomia e Greqisë në tremujorin e fundit të 2012-ës vijoi tkurrjen duke regjistruar -5.7% (vit mbi vit). Rënia e vazhduar e shpenzimeve për konsum dhe e kërkesës së brendshme në përgjithësi, zvogëlimi i investimeve, si dhe kontributi modest që vjen nga eksportet neto kanë qenë faktorët kryesorë që kanë ndikuar këtë ecuri. Ekonomia greke po përjeton një fazë të vështirë, ku nevoja për korrektim të shumë balancave si në aspektin fiskal por edhe ato financiare të bankave e kanë vështirësuar rimëkëmbjen dhe rikthimin në rritje ekonomike në këtë periudhë. Treguesit e ndryshëm për muajt janar dhe shkurt si prodhimi industrial, indeksi i shitjeve dhe ai i ndërtimit kanë vijuar të ndjekin trajektore rënëse si në terma mujorë ashtu edhe në ata vjetorë. Kjo panoramë mbështet idenë se ekonomia greke do të tkurret edhe në tremujorët në vazhdim. Inflacioni ka ndjekur një trajektore rënëse gjatë kësaj periudhe dhe madje në muajin mars të vitit 2013, ai regjistroi vlera negative (-0.2%) duke u zhvendosur drejt deflacionit.

KINË

Ekonomia kineze ka vazhduar të shënojë norma të larta rritëse edhe për tremujorin e parë 2013 (7.7% vit mbi vit), ndonëse me ritme më të zbutura krahasuar me tremujorin e fundit të vitit 2012 (7.9% vit mbi vit). Zgjerimi i PBB-së u mbështet kryesisht në kërkesën e brendshme, e cila gjeneroi 4.3 pikë përqindje të rritjes totale. Ndërkohë, akumulimi i kapitalit neto dhe rritja vjetore e eksporteve me 17.8% kontribuan përkatësisht me 2.3 dhe 1.1 pikë përqindje. Investimet në tregun e banesave u rritën me 20.2% në terma

vjetorë, ndërkohë që të ardhurat nga shitjet shënuan një rritje 61.3%, duke shtuar shqetësimet për një mbiçmim në këtë treg. Pavarësisht kësaj, analistët mendojnë se zhvillimi i shpejtë i një klase konsumatore përbën një faktor pozitiv për të ardhmen afatgjatë të ekonomisë kineze duke krijuar kështu një bazë për një rritje ekonomike të qëndrueshme larg shpenzimeve në investime dhe eksporteve. Në muajin mars, inflacioni vjetor kërceu në 4.5% nga 3.2% që ishte në shkurt si rezultat i një baze të ulët krahasuese. Politika monetare vlerësohet lehtësuese dhe nuk parashikohen ndërhyrje të bankës qendrore në një perspektivë afatshkurtër.

TURQI

Ekonomia e Turqisë, në tremujorin e katërt të vitit 2012, shënoi një rritje vjetore prej 1.4%, duke vijuar ngadalësimin e normës së rritjes. Zgjerimi i PBB-së është ushqyer kryesisht nga rritja e eksporteve neto dhe shpenzimeve qeveritare. Nga ana tjetër, tkurrja e kërkesës private dhe rënia e investimeve me 9.2% patën kontribut negativ. Tregues të tërthortë tregojnë për një rritje të mëtejshme në tremujorin e parë të vitit 2013. Indeksi industrial dhe ai i besimit janë përmirësuar si në muajin janar ashtu edhe në shkurt duke i mëshuar vlerësimeve për një rimëkëmbje të kërkesës së brendshme. Gjatë këtij fillim viti, Turqia ka përjetuar norma të larta inflacioni. Rritja vjetore e tij shënoi 7.3% në muajin mars nga 7.0% të shënuar në muajin shkurt dhe 7.3% në janar. Presionet inflacioniste kanë ardhur kryesisht nga çmimet e larta të ushqimeve të cilat u zgjeruan me 8.1% në terma vjetorë. Në këto kushte, ruajtja e inflacionit në objektivin 5.0% për vitin 2013 konsiderohet e vështirë për Bankën Qendrore të Turqisë (BQT). Në përgjigje të rritjes së lartë të nivelit kreditues, në tremujorin e parë të vitit, BQT ka ndërhyrë në tregun bankar duke rritur dy herë radhazi normën e remunerimit të rezervës së detyrueshme për depozitat në lira turke (me maturim më të gjatë se 1 vit) dhe në valutë (me maturim më të gjatë se 3 vjet) përkatësisht në 11.0% e 11.4%. Përpos kësaj, BQT uli normën bazë në 5.0% nga 5.5% me qëllim balancimin e rreziqeve me prejardhje nga një rritje e shpejtë e kapitaleve hyrëse dhe shuarjen e presioneve mbiçmuese mbi lirën turke.

MAQEDONI

Në Maqedoni, rritja ekonomike rezultoi e zbehtë për tremujorin e katërt (0.2% në terma vjetorë). Mbështetësit kryesorë të kësaj dinamike ishin investimet dhe shpenzimet publike. Nga ana tjetër, konsumi privat shënoi rritje negative për të dytin tremujor radhazi (-2.0% dhe -2.4% në bazë vjetore përkatësisht në T4 dhe T3 2012) duke pasqyruar uljen e pagës neto me 5.5% në terma realë, si dhe rënien e theksuar të transfertave private. Pavarësisht rritjes së eksporteve me vendet partnere të Eurozonës, kontributi i eksporteve neto në rritjen e PBB-së mbeti negativ si rrjedhojë e rritjes së përshpejtuar të importeve[1]. Vlerësimet më të fundit flasin për përmirësim të ekonomisë maqedonase për vitin 2013, gjatë të cilit, rimëkëmbja e kërkesës së brendshme pritet të luajë rolin kryesor.

[1] *Importet rezultuan në rritje kryesisht, si rrjedhojë e investimeve të fuqishme që po ndërmerren në degën e pjesëve të këmbimit për automjete.*

Tregues paraprakë, si ai Industrial e ai i Ndërtimit tregojnë për një aktivitet ekonomik në rritje në muajt e parë të vitit. Ndërkohë, vlera e eksporteve për periudhën janar-shkurt 2013 rezultoi më e lartë e krahasuar me një vit më parë.

Në muajin mars, inflacioni vjetor zbriti në 3.1% nga 3.5% që regjistroi në muajin shkurt. Rënia e çmimit të energjisë ishte faktori përcaktues në rënien e çmimeve të konsumit.

SERBI

Serbia ishte i vetmi shtet në grupin e vendeve të Evropës Juglindore që e mbylli vitin 2012 në recesion të thellë. Pavarësisht përmirësimit të aktivitetit ekonomik në tremujorin e fundit si rrjedhojë e performancës në rritje të sektorit industrial dhe atij të shërbimeve[2], PBB-ja vjetore u ngushtua mesatarisht me 1.7%. Shtrëngimi i kushteve të kreditimit kushtëzoi tkurrjen e aktivitetit në sektorin e ndërtimit për tremujorin e katërt me 24.7% në bazë vjetore. Nga ana tjetër, për shkak të thatësirës, prodhimi bujqësor ra ndjeshëm me 16.9% duke ndjekur një ecuri të ngjashme me periudhën janar-shtator të vitit 2012, gjatë të cilit aktiviteti sektorial u ngushtua me 17.2%.

Viti aktual parashikohet të shënojë një rritje pozitive të aktivitetit ekonomik. Normalizimi në sektorin bujqësor dhe konkurrenca e produkteve serbe si rrjedhojë e nënçmimit të dinarit serb në terma realë në këto katër vitet e fundit vlerësohen si faktorët parësorë në mbështetje të zgjerimit të PBB-së për vitin 2013.

Grafik 1. Diferenca e *yield*-eve të obligacioneve qeveritare të vendeve të rajonit me ato gjermane.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[2] *Pas një rritjeje negative gjatë nëntë muajve të parë të vitit, sektori industrial u zgjerua me 2.1% (v.m.v) në T4 2012 duke u mbështetur në rritjen e aktivitetit prodhues të kompanive FIAT dhe rafinerisë Pancevo. Nga ana tjetër, sektori i shërbimeve vazhdon të luajë rolin e lokomotivës në ekonominë vendase duke gjeneruar 54% të PBB-së.*

Inflacioni në Serbi vazhdon të kapë nivele dyshifrore. Në mars, çmimet e konsumit u rritën me 11.2% duke u ngushtuar me 0.8 pikë përqindje në krahasim me një muaj më parë. Me qëllim kontrollin e presioneve inflacioniste, Banka Qendrore e Serbisë ka rritur tetë herë normën bazë që nga qershori 2012 duke e çuar atë në 11.75%. Politika shtrënguese monetare pritet të ndryshojë kah vetëm në gjysmën e dytë të 2013-ës, atëherë dhe kur vlerësohet se vendi do të regjistrojë norma inflacioni më të përmbajtura duke reflektuar një nënshtrim të kërkesës së brendshme, shuarjen e efektit të rritjes së TVSH-së në tetor 2012 dhe një bazë krahasuese më të favorshme.

ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË, TREMUJORI IV-2012

OLTI MITRE, MERITA BOKA
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE, PRILL 2013

1. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE[1]

Marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me vendet e tjera vijuan të jenë subjekt i presioneve dhe zhvillimeve makroekonomike botërore në përgjithësi dhe i atyre në vendet fqinje si Italia dhe Greqia në veçanti. Vijimësia e situatës së vështirë në Greqi dhe rëndimi i situatës ekonomike dhe politike në Itali kanë vijuar të ndikojnë ecurinë e treguesve të sektorit të jashtëm të ekonomisë të vendit tonë. Ngadalësimi i rritjes ekonomike në këto vende dhe dobësimi i kërkesës së huaj çoi në moderimin e ritmit të rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2012. Rënia e importeve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2012 sugjeron praninë e një kërkese të brendshme të dobët. Për pasojë, deficiti i eksporteve neto nominale u ngushtua me rreth 14.4% në terma vjetorë udhëhequr nga rënia e importeve. Flukset financiare neto në llogarinë kapitale dhe financiare u tkurrën me rreth 11.3% gjatë vitit 2012 dhe financuan rreth 84.9% të deficit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave.

	T4 '11	T1 '12	T2 '12	T3 '12	T4 '12	2011	2012
Llogaria korrente (në mil euro)	-366.4	-290.4	-251.8	-242.8	-236.3	-1185.4	-1021.3
Ndryshim vjetor	2.8%	26.7%	-23.9%	-6.2%	-35.5%		-13.8%
/ PBB-së	-15.8%	-13.5%	-9.8%	-9.4%	-9.8%		10.5%
Bilanci tregtar	-658.6	-465.3	-475.5	-540.5	-517.8	-2,241.6	-1,999.2
Eksporte, f.o.b.	360.0	325.8	394.2	402.5	403.1	1,405.5	1,525.6
Importe, f.o.b.	-1,018.6	-791.2	-869.7	-943.0	-920.9	-3,647.1	-3,524.8
Bilanci i shërbimeve	41.3	8.5	26.2	132.6	27.9	134.9	195.1
Kredi	428.5	293.8	381.1	578.1	402.1	1,747.4	1,655.1
Debi	-387.2	-285.4	-354.9	-445.4	-374.2	-1,612.4	-1,459.9
Shërbime udhëtimi - eksport	285.1	185.1	246.4	445.3	268.4	1169.4	1145.2
Shërbime udhëtimi - import	-256.8	-180.8	-240.1	-325.6	-256.1	-1121.5	-1002.7
Shërbime udhëtimi - neto	28.4	4.3	6.2	119.7	12.3	47.9	142.6
Bilanci i të ardhurave	10.3	-40.4	-27.7	-20.6	-0.2	22.7	-89.0
Kredi	53.2	48.2	43.0	57.8	55.3	220.1	204.4
Debi	-43.0	-88.6	-70.7	-78.5	-55.5	-197.3	-293.3
Të ardhura nga IHD-neto	-7.0	-54.8	-29.8	-42.0	-26.2	-53.2	-152.8
Transferta korrente	240.7	206.8	225.3	185.8	253.9	898.5	871.7
Kredi	266.6	243.5	265.2	224.1	285.8	1,003.8	1,018.6
Debi	-25.9	-36.7	-39.9	-38.4	-31.9	-105.3	-146.9
Dërgesa nga emigrantët -neto	182.5	166.5	171.6	140.8	196.3	664.5	675.3
Kapitale dhe financiare (mil euro)	284.9	258.3	185.5	174.4	249.1	978.1	867.3

[1] *Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të katërt të vitit 2012. Me publikimin e të dhënave të tremujorit të fundit të vitit 2012, janë riparë edhe të dhënat për tre tremujorët e parë të të njëjtit vit. Gjithashtu, janë rishikuar të dhënat e bilancit të pagesave për vitin 2011, të dhënat e borxhit të jashtëm dhe ato për investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik dhe shpërndarjes gjeografike.*

Ndryshim vjetor	-30.7%	15.1%	-21.3%	-25.2%	-12.5%		-11.3%
/ PBB-së	12.3%	12.0%	7.2%	6.8%	10.3%		8.9%
Llogaria kapitale	27.8	12.9	43.0	9.8	15.6	84.9	81.4
Llogaria financiare	257.0	245.3	142.5	164.6	233.5	893.2	785.9
A. Detyrime	398.0	307.5	277.7	378.4	224.4	1302.5	1188.0
IHD	288.2	205.5	191.1	164.5	183.7	745.4	744.9
Investime portofoli	21.3	14.5	19.6	7.8	21.0	75.7	62.9
Investime të tjera	88.6	87.5	67.0	206.0	19.7	481.3	380.2
Huamarrje	39.3	41.6	30.4	28.5	10.5	221.6	111.0
Monedha dhe depozita	53.1	69.1	34.8	164.8	3.7	261.4	272.5
B. Mjete	-141.0	-62.2	-135.2	-213.8	9.2	-409.2	-402.1
IHD	-19.5	-2.7	-0.3	-7.7	-7.0	-29.9	-17.7
Investime portofoli	14.4	-61.0	9.9	-26.4	-10.0	-88.8	-87.5
Investime të tjera	-135.8	1.5	-144.8	-179.7	26.2	-290.5	-296.9
Monedha dhe depozita	-94.3	-11.0	-133.2	-178.2	67.0	-174.2	-255.4
Hua (për financim tregtie)	-56.9	9.7	0.6	-1.8	-52.8	-119.5	-44.3
Gabime dhe harresa	75.3	35.4	73.8	158.0	-36.0	178.6	231.2
Mjetet e rezervës	6.2	-3.2	-7.5	-89.7	23.1	28.7	-77.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.1 LLOGARIA KORRENTE

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 236.3 milionë eurosh në tremujorin e katërt të vitit 2012. Në terma vjetorë, deficiti korrent u ngushtua me rreth 35.5% duke përforcuar kështu tendencën e nisur që prej tremujorit të dytë të vitit 2012. Deficiti korrent u vlerësua në 9.8% ndaj PBB-së nominale[2] ose rreth 6.0 pikë përqindje më i ulët krahasuar me nivelin e tij në tremujorin e katërt të vitit 2011. Duke përjashtuar të ardhurat nga transfertat zyrtare, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 10.2% të PBB-së nominale për tremujorin e katërt të vitit 2012. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë ky raport ishte rreth 16.2%.

Grafik 1. Kontributi sipas zërave në deficitin korrent (në pikë përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika e llogarisë korrente gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012, ashtu si dhe në tre tremujorët e mëparshëm të të njëjtit vit, u ndikua gjerësisht nga ecuria e bilancit të eksporteve neto. Në terma vjetorë, deficiti tregtar u ngushtua me rreth 21.4% dhe suficiti i llogarisë së shërbimeve u ngushtua me rreth 32.5%. Pozicioni i kombinuar i këtyre dy llogarive çoi në ngushtimin e deficitit të eksporteve neto për tremujorin e fundit të vitit 2012 me rreth 20.6% në terma vjetorë. Si pasojë e rritjes së fluksit dalës të të ardhurave, bilanci neto i llogarisë të të ardhurave rezultoi në deficit duke kontribuar negativisht në ecurinë e llogarisë korrente. Suficiti i llogarisë së transfertave korrente u zgjerua me rreth 5.5% në terma vjetorë. Nënzëri kryesor i kësaj

[2] *PBB–ja nominale e përdorur për periudhën 2003 – 2010 është ajo e publikuar nga INSTAT-i. Shpërndarja nëpër tremujorë është bërë në bazë të peshave të PBB-së reale tremujore. Për vitet 2011 dhe 2012 janë përdorur projeksione të Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.*

llogarie, transfertat prej emigrantëve (hyrëse), shënuan rritje me rreth 7.4% në terma vjetorë në tremujorin e katërt të vitit 2012.

Grafik 2. Kontributi i eksporteve neto në PBB-në reale (në pikë përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i shkallës së hapjes ekonomike të vendit tonë për tremujorin e katërt të vitit 2012 shënoi vlerën 87.0%, rreth 7.8 pikë përqindje më i ulët krahasuar me nivelin e këtij raporti në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ecuria e treguesve të sektorit të jashtëm të ekonomisë tregon një kontribut pozitiv të këtij përbërësi në kërkesën agregate për vitin 2012. Pas zgjerimit me rreth 21.2% në terma vjetorë vitin e mëparshëm, gjatë vitit 2012 u regjistrua një ngushtim në terma vjetorë i deficitit të eksporteve neto reale[3] me rreth 7.4%. Ngushtimi i deficitit të eksporteve neto u përcaktua nga rënia e importit të mallrave e shërbimeve në terma realë me rreth 1.7% dhe e rritjes së eksporteve të tyre me rreth 2.4% në terma vjetorë. Zhvillimet në balancën e importit dhe eksportit të mallrave e shërbimeve në terma realë, janë materializuar në një kontribut pozitiv të këtij komponenti në rritjen e kërkesës agregate përgjatë kësaj periudhe.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012, flukset financiare neto nga pozicioni i kombinuar i llogarisë së të ardhurave, transfertave korrente dhe shërbimeve shënuan rënie me rreth 3.7% në terma vjetorë. Si rezultat, flukset neto të këtyre tre llogarive së bashku financuan rreth 54.4% të deficitit tregtar të regjistruar gjatë kësaj periudhe, raport ky rreth 10.0 pikë përqindje më i lartë krahasuar me atë të një viti më parë.

Bilanci neto i llogarisë së shërbimeve vlerësohet të ketë pasur një ecuri pozitive gjatë vitit 2012, veçanërisht në tremujorin e tretë të tij. Pas ngushtimit të theksuar të suficitit të kësaj llogarie gjatë vitit 2011, si pasojë e heqjes së regjimit të vizave ndaj Shqipërisë me vendet e *Schengen*-it (e cila solli një rritje të flukseve valutore dalëse për shërbime udhëtimi), viti 2012 shënoi një bilanc pozitiv prej 195.1 milionë eurosh, në rritje me rreth 44.6% në terma vjetorë.

Në analizën tremujore të llogarisë së shërbimeve, rritja e flukseve valutore ishte më e ndjeshme gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, periudhë kjo që përkon dhe me sezonin turistik veror. Tremujori i katërt i vitit 2012, rezultoi me një suficit prej 27.9 milionë eurosh, në rënie me rreth 32.5% krahasur me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rënies së flukseve valutore hyrëse nga shërbimet e udhëtimit. Bilanci neto i nënzërit "shërbime udhëtimi (personale dhe biznesi)" u tkurr me rreth 56.6% në terma vjetorë, kryesisht si pasojë e rënies

[3] *Për kalimin nga terma nominalë në terma realë të importeve dhe eksporteve të mallrave është përdorur Indeksi i Vlerës Njësi llogaritur dhe publikuar nga INSTAT-i. Ndërsa, për importet dhe eksportet e shërbimeve është përdorur indeksi i çmimeve të konsumit të kategorisë së shërbimeve, llogaritur nga Banka e Shqipërisë.*

Grafik 3. Bilanci i shërbimeve (flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Bilanci i të ardhurave (flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Përbërja e të ardhurave nga investimet (flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

së prurjeve valutore për shërbime udhëtimi për qëllime turizmi e biznesi të jorezidentëve në vendin tonë. Daljet valutore në trajtën e shpenzimeve të kryera nga rezidentët për shërbimet personale të udhëtimit jashtë shënuan rënie me rreth 0.2% gjatë periudhës në analizë. Nënzëri "shërbime të tjera" (ku përfshihen shërbimet e komunikacionit, konstruksionit, qeveritare, financiare, kompjuterit dhe informacioni etj.) regjistroi një bilanc pozitiv prej 48.1 milionë eurosh, në rritje me rreth 3.3% në terma vjetorë. Nga ana tjetër, bilanci negativ (deficiti) i shënuar në nënzërat "shërbime të transportit" dhe "shërbime të sigurimit" vijojnë të kontribuojnë negativisht në bilancin total të shërbimeve për tremujorin e katërt të vitit 2012.

Pas një përmirësimi të lehtë gjatë vitit 2011, bilanci i të ardhurave neto, shënoi një deficit prej rreth 89.0 milionë eurosh në vitin 2012. Rritja e përshpejtuar e riatdhesimit të të ardhurave nga investimet si dhe rënia në terma vjetorë e të ardhurave nga kompensimi i punonjësve përcaktuan kahun e zhvillimeve në këtë llogari gjatë periudhës së konsideruar.

Në shpërndarjen sipas tremujorëve, niveli më i lartë i deficitit në llogarinë e të ardhurave u regjistrua gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Gjatë tremujorit të katërt të të njëjtit vit, llogaria e të ardhurave neto rezultoi në deficit me rreth 0.2 milionë euro, nivel ky ndjeshëm më i ulët krahasuar me pjesën tjetër të vitit. Rënia me rreth 25.2% e të ardhurave neto nga kompensimi i punonjësve, si dhe riatdhesimi i fitimeve nga investimet përcaktuan kahun e zhvillimeve në totalin e të ardhurave neto për tremujorin e katërt të vitit 2012.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave nga investimet e huaja direkte rezultoi në deficit me rreth 26.2 milionë euro nga 7.0 milionë euro që ishte një vit më parë. Rritja e deficitit të të ardhurave nga IHD-të erdhi si pasojë e rritjes së fluksit dalës të tyre. Edhe pse në rënie, deficiti i të ardhurave nga investimet e portofolit ndikoi negativisht në llogarinë e të ardhurave për tremujorin e fundit të vitit 2012. Bilanci i të ardhurave nga investimet e tjera neto shënoi vlera pozitive për të dytin tremujor radhazi kryesisht si pasojë e rënies së pagesave neto të interesit të borxhit privat dhe publik. Në tremujorin

e katërt të vitit 2012, suficiti i këtij nënzëri të llogarisë të të ardhurave rezultoi rreth 2.8 milionë euro, kundrejt deficitit prej 10.9 milionë eurosh që ishte një vit më parë. Pagesat neto të interesit të borxhit privat dhe publik kanë ulur detyrimet e vendit me rreth 12.6 milionë euro gjatë periudhës së konsideruar.

Bilanci neto i llogarisë së transfertave korrente gjatë vitit 2012 ka vijuar rënien progresive të suficitit të nisur që prej vitit 2009. Në terma vjetorë, gjatë kësaj periudhe, suficiti i transfertave korrente u ngushtua me rreth 3.0% si pasojë e rritjes së fluksit dalës të tyre.

Tremujori i katërt i vitit 2012, u karakterizua nga një zgjerim me rreth 5.5% i suficitit të transfertave korrente neto. Transfertat e sektorit shtetëror dhe ato të sektorëve të tjerë shënuan rritje me përkatësisht 39.6% dhe 4.5% në terma vjetorë. Nënzëri kryesor i llogarisë të transfertave korrente, remitancat, shënoi rritje me rreth 7.4% në terma vjetorë. Raporti i tyre kundrejt deficitit tregtar vlerësohet në nivelin 38.0%, raport ky rreth 10.2 pikë përqindje më i lartë se raporti i financimit i regjistruar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

1.2 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan një bilanc pozitiv prej 249.1 milionë eurosh gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012, duke financuar plotësisht deficitin korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, flukset kapitale dhe financiare shënuan rënie me rreth 12.5% dhe u vlerësuan në rreth 10.3% në raport ndaj PBB-së nominale. Rënia në terma vjetorë e flukseve valutore në këtë llogari u përcaktua kryesisht nga rënia me rreth 9.1% në terma vjetorë e flukseve financiare. Në raport ndaj PBB-së nominale, llogaria financiare u vlerësua rreth 9.7%, raport ky rreth 1.4 pikë përqindje më i ulët krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011. Flukset neto në llogarinë kapitale shënuan një suficit prej 15.6 milionë eurosh në tremujorin e katërt të vitit 2012. Detyrimet financiare të rezidentëve ndaj jorezidentëve pësuan një rënie të theksuar prej 43.6% në terma vjetorë, si pasojë e rënies së fluksit hyrës të investimeve të huaja direkte dhe fluksit hyrës të investimeve të tjera.

Grafik 6. Llogaria kapitale dhe financiare
(flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kahun e mjeteve vendase të investuara në ekonomitë jorezidente evidentohet një rënie e tyre me rreth me 9.2 milionë euro nga rritja me 141.1 milionë euro të investuara në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përcaktuesi kryesor i zhvillimeve në mjetet tona të investuara jashtë ishte rënia e theksuar e mjeteve në formën e investimeve të tjera.

Investimet e huaja direkte neto (flukse hyrëse – dalëse) shënuan një rënie të theksuar me rreth

34.2% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2011. Ky ndryshim vjen, në masën më të madhe, nga rënia me rreth 36.2% e detyrimeve në formën i IHD-ve (flukseve hyrëse të IHD-ve). Sipas instrumentit të përdorur për investime, IHD-të hyrëse në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë (aksione) dhe riinvestim të fitimeve u vlerësuan në rënie me rreth 31.3% në terma vjetorë. Në të njëjtin drejtim ndikoi dhe rënia në 1.7 milionë euro nga 23.1 milionë euro rritje në tremujorin e katërt të vitit 2011 e flukseve hyrëse në trajtën e kapitaleve të tjera. Të ardhurat nga privatizimet vijojnë të luajnë një rol modest në totalin e investimeve të huaja direkte. Duke përjashtuar nga flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte ato në trajtën e privatizimeve, IHD-të shënuan rënie me rreth 36.8% në terma vjetorë gjatë periudhës në analizë.

Në terma kumulativë vjetorë, viti 2012 shënon një rritje të lehtë të investimeve të huaja direkte me rreth 1.6%, pas rënies së tyre me rreth 9.3% gjatë vitit të mëparshëm.

1.3 SHPËRNDARJA SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK DHE SHTETEVE, E STOKUT TË IHD-VE[4]

Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tre viteve të fundit (2009, 2010 dhe 2011), stoku i investimeve të huaja direkte në vend njohu një rritje progresive edhe pse nën presionin e krizës së përgjithshme ekonomiko – financiare që përfshiu tregjet ndërkombëtare. Në fund të vitit 2011, stoku i investimeve të huaja direkte u vlerësua në rreth 3,036.6 milionë euro, rreth 13.9% më i lartë krahasuar me nivelin e regjistruar në vitin 2010. Ecuria pozitive në stokun e IHD-ve në vend pasqyron preferencën e investitorëve të huaj për vendin tonë në kushtet e kostove të prodhimit më të ulëta dhe marzheve të fitimit potencialisht më të larta[5]. Në dy vitet e fundit, privatizimet kanë luajtur një rol modest në rritjen e IHD-ve duke qenë tregues i një interesi të investitorëve të huaj për vendin tonë.

Në ndarjen e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik, vihet re një përqendrim i lartë i investimeve në sektorin e shërbimeve. Ky fakt vlerësohet të jetë i lidhur dhe me privatizimet që kanë karakterizuar këtë sektor përgjatë viteve. Të dhënat më të fundit për vitin 2011 tregojnë se sektorët më tërheqës dhe që kanë thithur pjesën më të madhe të IHD-ve

[4] *Të dhënat më të fundit mbi stokun e investimeve të huaja direkte sipas shteteve dhe sipas aktivitetit ekonomik i përkasin vitit 2011.*

[5] *Përafërsuar me fluksin dalës të të ardhurave nga investimet e huaja direkte. Duke filluar që prej vitit 2008, të ardhurat nga investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje të ndjeshme vit pas viti. Gjatë periudhës 2008 – 2011, të ardhurat nga investimet e huaja direkte (flukset dalëse) rezultojnë rreth 1,052 milionë euro.*

Grafik 8. Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik
(stoku i fundvitit, në përqindje ndaj stokut total).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

janë "Ndërmjetësimi monetar dhe financiar"[6] dhe "Industria nxjerrëse" me përkatësisht 23.1% dhe 20.8% ndaj totalit të stokut. Gjatë vitit 2011 vihet re një rishpërndarje e IHD-ve sipas sektorëve të ekonomisë, një diversifikim më i madh i portofolit të IHD-ve dhe orientim multidimensional i tyre. Ndër vite, "Ndërmjetësimi monetar dhe financiar" ka përfaqësuar sektorin me peshën më të madhe në stokun e IHD-ve deri në vitin 2011. Megjithatë, ndër vite vihet re një rënie progresive e peshës së këtij sektori në favor të sektorëve të tjerë të ekonomisë, nga 32.1% në vitin 2007 në rreth 23.1% në vitin 2011. Ndryshimi më i qenësishëm vihet re në rritjen e peshës së sektorit të "Industrisë nxjerrëse" nga 12.2% në vitin 2010 në 20.8% në vitin 2011. Peshën kryesore në këtë sektor e luajti industria nxjerrëse e mineraleve energjetike (88.6%) dhe atyre joenergjetike (11.4%). Orientimi i investimeve të huaja direkte drejt burimeve natyrore mbështeti zgjerimin e eksporteve të vendit tonë për këto produkte duke kontribuar pozitivisht në përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë. Industria përpunuese vlerësohet të mos ketë thithur investime të huaja për vitin 2011. Pesha e saj në stokun e IHD-ve mbeti pothuajse e pandryshuar krahasuar me një vit më parë (15.6%). "Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit të ngrohtë" dhe "Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete profesionale" gjithashtu kanë rritur peshën e tyre në stokun total të IHD-ve gjatë vitit 2011. Ndërkohë, duket se potencialet turistike të vendit tonë ende nuk janë eksploruar nga investitorët e huaj. "Hoteleri dhe turizëm" përveçse zë një peshë të ulët në stokun e investimeve, ka ndjekur dhe një trajektore rënëse në tre vitet e fundit.

Struktura e stokut të IHD-ve sipas vendeve të origjinës gjatë periudhës 2007 – 2011 paraqet ndryshime të ndjeshme nga viti në vit. Gjatë këtyre viteve, partnerët kryesorë në investime kanë qenë Greqia dhe Italia. Në vitin 2007, investimet e huaja direkte me origjinë greke përfaqësonin rreth

[6] *Në këtë sektor, peshën më të madhe në IHD e zë zëri "Ndërmjetësim monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguruese dhe fondeve të pensioneve".*

28.5% të stokut total të IHD-ve në vend. Vendin e dytë për nga pesha e zënë investimet me origjinë italiane, me rreth 12.0% në të njëjtën periudhë. Me fillimin e krizës ekonomike dhe financiare dhe intensifikimin e krizës së borxhit në Greqi, vihet re një rënie progresive e peshës së këtij vendi në stokun total të investimeve të huaja. Nga viti 2007 deri në vitin 2011, pesha e IHD-ve nga Greqia shënoi rënie me rreth 11.2 pikë përqindje, duke përfaqësuar në vitin 2011 rreth 17.3% ndaj stokut total të IHD-ve. Në anën tjetër, investimet me origjinë italiane, pas një rritjeje të peshës së tyre me rreth 3.6 pikë përqindje gjatë vitit 2008, kanë ruajtur pothuajse të njëjtën peshë në vitin 2009 (mesatarisht 15.5% në periudhën 2008 -2009). Gjatë viteve 2010 dhe 2011 vihet re një rënie e stokut të investimeve me origjinë italiane në nivelet e parakrizës ekonomiko – financiare. Për vitin 2011, investimet me origjinë italiane përfaqësuan vetëm 12.3% të stokut total të IHD-ve.

Grafik 9. Investimet e huaja direkte sipas shteteve
(stoku i fundvitit, në përqindje ndaj stokut total).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vitin 2010, tre investuesit me peshën më të madhe në stokun e IHD-ve[7] përfaqësuan rreth 53.1% të stokut total. Në vitin 2011, vihet re një ulje e përqendrimit në stokun e IHD-ve të këtyre tre shteteve në favor të shteteve të tjera. Kështu, pavarësisht rënies së peshës së IHD-ve nga Greqia dhe Italia, në vendin tonë ka vijuar të regjistrohet një rritje në stokun total të investimeve të huaja direkte. Kjo rritje mund të pasqyrojë riorientimin e investuesve të huaj drejt tregut vendas, kryesisht të atyre austriakë dhe kanadezë[8]. Për pasojë, tërheqja e investuesve potencialë prej vendeve të tjera mund të minimizojë efektet e krizës së borxhit publik në Greqi dhe ato të vështirësive në Italì në flukset hyrëse të kapitalit në vend.

Investimet e portofolit neto për tremujorin e katërt të vitit 2012 kontribuan në rritjen e detyrimeve vendase ndaj jorezidentëve me rreth 11.0 milionë

[7] *Greqi, Italì dhe Austri.*

[8] *Në vitin 2011, IHD-të me origjinë kanadeze përfaqësuan rreth 18.6% të stokut total të IHD-ve në vend duke u bërë partneri me peshën më të madhe të investimeve në vend. IHD-të me origjinë austriake përfaqësuan rreth 15.6% të stokut.*

euro. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ato rezultuan rreth 69.2% më të ulëta. Në periudhën e konsideruar, rezidentët kanë investuar rreth 10.0 milionë euro në tituj borxhi. Flukset hyrëse të investimeve të portofolit rezultuan pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me një vit më parë.

Në terma kumulativë vjetorë, investimet e portofolit neto kontribuan në rritjen e mjeteve tona të investuara jashtë me rreth 24.6 milionë euro, vlerë kjo pothuajse e dyfishuar krahasuar me një vit më parë.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012, llogaria e investimeve të tjera neto u mbyll me një bilanc pozitiv duke kontribuar me rreth 45.9 milionë euro në rritjen e detyrimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, vihet re një ndryshim pozicioni nga kreditor neto në debitor neto. Gjatë këtij tremujori, evidentohet rënia e theksuar në terma vjetorë e fluksit hyrës të detyrimeve dhe rënia e mjeteve tona të investuara jashtë. Në llogarinë e investimeve të tjera, detyrimet tona kundrejt jorezidentëve shënuan rënie në 19.7 milionë euro nga 88.6 milionë euro që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë, kryesisht si pasojë e rënies së huamarrjes dhe rënies së fluksit të monedhave dhe depozitave. Huamarrja private dhe shtetërore rezultoi rreth 10.5 milionë euro gjatë tremujorit në analizë nga 39.3 milionë euro që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2011. Rënia në totalin e huamarrjes u përcaktua nga shlyerja e kryegjësë nga sektori privat. Në total, pagesat e borxhit (privat dhe publik) ulën detyrimet e vendit tonë me rreth 69.3 milionë euro në tremujorin në analizë. Në kahun e mjeteve vendase të investuara në ekonomitë e huaja në trajtën e investimeve të tjera, tremujori i katërt i vitit 2012 shënoi rënie të tyre me rreth 26.2 milionë euro nga rritja me rreth 135.8 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënia e nivelit të mjeteve tona të investuara jashtë u përcaktua kryesisht nga rënia e theksuar e mjeteve të investuara në formën e monedhave dhe depozitave të sistemit tonë bankar jashtë vendit. Kështu, depozitat e sistemit bankar vendas shënuan rënie me rreth 67.0 milionë euro, nga rritja me rreth 94.3 milionë euro e shënuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

1.4 BORXHI I JASHTËM BRUTO

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012, stoku i borxhit të jashtëm bruto i Shqipërisë shënoi vlerën totale prej 5,294.4 milionë eurosh. Në vlerë, stoku i borxhit u rrit me rreth 51.8 milionë euro krahasuar me tremujorin e mëparshëm dhe me rreth 498.7 milionë euro krahasuar me stokun e tij në fundin e tremujorit të katërt të vitit 2011. Në pjesën më të madhe, rritja e stokut të borxhit në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012 u shkaktua nga rritja e huamarrjes së sistemit bankar dhe qeverisë qendrore. Në ndarjen sipas sektorëve institucionalë, në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012, sektori i qeverisë së përgjithshme zotëroi

Grafik 10. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve institucionalë (stok në fund të vitit, në përqindje ndaj totalit.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

rreth 42.0% të stokut total të borxhit. Pjesa tjetër është shpërndarë midis: sektorëve të tjerë 19.3%, bankave 20.8%, investimeve të huaja direkte – hua ndërkompani 16.1% dhe autoritetit monetar 1.7%.

Sektori me peshën më të madhe në totalin e stokut të borxhit mbetet qeveria qendrore. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012, stoku i borxhit të sektorit të qeverisë qendrore rezultoi në rreth 2.2 miliardë euro. Gjatë katër tremujorëve të vitit 2012, pesha e borxhit të qeverisë qendrore është luhatur në intervalin 42% - 43.2%, me peshën më të ulët në tremujorin e katërt. Krahasuar me fundin e vitit 2011, vërehet një rënie e peshës së borxhit të qeverisë qendrore nga 43.1% në 42.0% në fundin e tremujorit të katërt të vitit 2012.

Stoku i borxhit të jashtëm bruto të sistemit bankar në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012 rezultoi në rreth 1.1 miliardë euro, në rritje me rreth 232.6 milionë euro krahasuar me fundin e vitit 2011. Stoku i borxhit të jashtëm të sektorëve të tjerë rezultoi në rreth 1 miliard euro, duke shënuar rritje nga viti 2011 me rreth 69.2 milionë euro. Pesha e tij në totalin e stokut të borxhit të jashtëm për periudhën e konsideruar ishte rreth 19.3%, në rënie me rreth 0.6 pikë përqindje krahasuar me fundvitin 2011. Stoku i investimeve të huaja gjatë periudhës së konsideruar u vlerësua në rreth 853.4 milionë euro, në rritje me rreth 51.6 milionë euro ose rreth 6.4% krahasuar me fundin e vitit 2011.

Grafik 11. Struktura e borxhit të jashtëm sipas maturitetit (stok në fund të vitit, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012, rreth 62.4% e stokut të borxhit (duke përjashtuar investimet direkte – hua ndër kompani), vlerësohet të jetë borxh afatgjatë kryesisht në formën e huave. Borxhi afatshkurtër për periudhën e konsideruar vlerësohet në rreth 21.4% ndaj totalit të stokut të borxhit të marrë kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave nga sektori bankar. IHD-të përfaqësojnë rreth 16.1% ndaj stokut total të borxhit publik. Sektorët e qeverisë së përgjithshme dhe autoritetit monetar zotërojnë vetëm borxh afatgjatë, ndërsa sektori bankar dhe sektorët e tjerë zotërojnë një portofol të përbërë prej borxhit afatgjatë dhe afatshkurtër. Në ndarjen sipas instrumenteve dhe maturitetit, huatë përfaqësojnë instrumentin kryesor afatgjatë të investimit, me rreth 84.8% ndaj totalit të borxhit afatgjatë (përjashtuar IHD-të). Rreth 13.5% e borxhit afatgjatë mbahet në trajtën e dëftesave dhe obligacioneve. Borxhi afatshkurtër përfaqësohet kryesisht nga instrumenti i monedhave dhe depozitave, rreth 84.9% në fund të tremujorit të katërt të vitit 2012. Kreditë tregtare gjatë periudhës së konsideruar përfaqësuan rreth 10.2% të stokut të borxhit afatshkurtër.

Mjetet e rezervës valutore shënuan rënie me rreth 23.1 milionë euro në tremujorin e katërt të vitit 2012. Në fund të muajit dhjetor 2012, stoku i

rezervës valutore rezultoi rreth 1.972,5 milionë euro, nivel ky i mjaftueshëm për mbulimin e 4.5 muaj importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

Grafik 12. Borxhi i jashtëm afatshkurtër dhe afatgjatë
(stok në fund të vitit, në milionë euro.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

STUDIME E ARTIKUJ*

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

"PROJEKSIONET AFATMESME DHE FUNKSIONIMI I MODELIT GAP NË VENDIMMARRJE"

EVELINA ÇELIKU
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

ABSTRAKT

Parashikimet afatmesme përbëjnë një instrument të rëndësishëm të vendimmarrjes së politikës monetare. Për të përsosur këtë proces vjen në ndihmë një model i formës Gap, i cili projekton trajektoren e normës bazë të interesit për të mbajtur inflacionin rreth një objektivi të caktuar në terma afatmesëm dhe rritjen ekonomike pranë një norme potenciale rritjeje e cila vlerësohet në kohë. Ky model, furnizohet nga parashikimet afatshkurtra për inflacionin dhe për PBB-në. Ai mundëson hartimin dhe analizën sipas skenarëve të rrezikut në formë konsistente. Për të realizuar funksionimin e tij dhe prezantimin e rezultateve në raportet tremujore të politikës monetare, ky material evidenton hapa të rëndësishëm në zhvillimin e modelit dhe zbatimin e tij për projeksione.

Fjalë kyçe: Modelet strukturore, projeksioni afatmesëm, politika monetare
Jel- classification: C53, E17, E52

I. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI MODELET E PLOTA DHE GJYSMËSTRUKTURORE[1]

Modelet dhe mënyrat se si ato janë përdorur për analizat e zbatimit të politikave të ndryshme kanë evoluar në mënyrë të dukshme. Modelet strukturore dhe gjysmë-strukturore, për shkak se mbështeten mbi specifikime të gjera të mjedisit ekonomik, brenda të cilit agjentët e modeleve veprojnë, duhet të adresojnë të paktën në parim, kritikën e Lucas (1976).

Trajtimi modern i modeleve konsiston në përdorimin e tyre për të analizuar politika të ndjekura. Sot, me anë të modeleve mund t'u jepet përgjigje, pyetjeve të tilla se: "Si zbatimi i politikave sistematike do të ndikonte sjelljen e agjentëve ekonomikë? Cilat janë projeksionet mbi variablat e qëllimit (objektivë) nën politika optimale? Si ndryshimet strukturore në ekonomi prekin

[1] *Modelet strukturore janë pjesë e një fushe relativisht të re të modelimit ekonometrik, tentativat e para të zhvillimit të të cilëve shfaqen në fund të viteve '60. Në modelet ekonometrike strukturore, teoria ekonomike përdoret për të vënë në relacion matematikor një grup variablash të vrojtuar "endogjenë apo të shpjeguar", Yi, me një grup tjetër "variablash të vrojtuar "ekzogjenë apo shpjegues", Xi. Por teoria ekonomike kërkon të shpjegojë edhe lidhje ndërmjet variablave Yi dhe një grupi variablash të pavrojtuar, ξ. Në këto raste, disa funksione janë të njohur dhe disa të tjerë të panjohur nga pikëpamja e vetive të tyre të shpërndarjes probabilitare. Për këto të fundit, teoria ekonomike si e vetme nuk ka informacion për t'i vlerësuar ekonometrikisht.Në modelet strukturore dhe gjysmë-strukturore, informacioni ekonomik i shprehur në ekuacione dhe identitete të njohura sjelljesh kombinohet me supozimet statistikore mbi informacionin e vrojtuar dhe të pavrojtuar. Kështu, shtohen struktura statistikore (supozime mbi shpërndarjet dhe parametrat e tyre) duke racionalizuar pjesën e panjohur dhe të pashpjeguar nga teoria ekonomike dhe nga të dhënat në dispozicion. Këto modele janë sisteme blloqesh ekuacionesh dhe identitesh që marrin në konsideratë vlerësime për ekuilibra dhe prirje afatgjata.*

parametrat e modelit? Si këto ndryshime ndikojnë në hartimin e politikave optimale?" Aftësia për të trajtuar këto pyetje reflekton evolucionin e bërë përgjatë tridhjetë viteve të fundit në lëmin e politikës monetare, e cila nga njëra anë përdor si variabël ekzogjen "intervalin korridor" të instrumenteve të saj. Nga ana tjetër, vetë ajo - politika monetare - luan rol endogjen, duke iu përgjigjur relativisht kushteve ekonomike.

Modelet strukturore dhe gjysmë-strukturore mund të trajtojnë çështje shumë interesante që modelet e tjera nuk mund t'i trajtojnë. Ata u japin përgjigje pyetjeve se: Cilat mund të jenë efektet e goditjeve të forta që nuk janë ndeshur më parë në të dhënat historike të përdorura në vlerësimin e modelit? Nëse politika është endogjene, si mund të arrihet në një përfundim se çfarë do të bënin politikëbërësit në situata të paparashikuara? Por ashtu, siç thekson (Canova dhe Sala 2009), shumë nga parametrat strukturorë të këtyre modeleve mund të identifikohen në mënyrë shumë të dobët. Gjeneratat moderne të modeleve ekonomike, strukturore dhe dinamike, kanë pikat e tyre të dobëta. Disa nga parametrat kyçe të strukturës nuk janë realisht "strukturorë". Kjo do të thotë se modeli nuk ka gjasa të mbetet i pandryshueshëm kundrejt ndryshimeve të rëndësishme në ekonomi. Kështu lind gjithmonë nevoja për vlerësimin dhe zbatimin e modeleve të reja në shërbim të analizave të vendimmarrjes së politikës monetare.

Të kuptuarit e klasës moderne të modeleve është si të ndërtohet një drejtëz paralele me të kuptuarin e artit modern: ashtu si jo të gjithë njerëzit kuptojnë artin modern, ashtu edhe jo të gjithë ekonomistët mund t'i kuptojnë modelet. Por, në thelb, rezultatet dhe interpretimet mbi to duhet të jenë të kuptueshme e të qarta si për politikëbërësit përdoruesit dhe publikun. Kjo do të thotë se agjentët ndërtojnë përqasje mbi vendimmarrjen afatmesme në varësi të shenjës dhe madhësisë së diferencave të projeksioneve nga ekuilibrat afatgjatë apo nga objektivat.

Për shkak se modelet apo edhe blloqe të veçanta kanë kufizimet e tyre, "nuk mund t'u thonë" gjithçka vendimmarrësve. Në ditët e sotme, e reja në punën me modelet konsiston në faktin se si mund të përmirësohet dobishmëria e tyre në shërbim të politikëbërjes në përgjithësi dhe të asaj monetare, në veçanti. Me shtimin e pasigurive ekonomike, portofoli i modelimit është diversifikuar ndjeshëm ndërmjet modeleve ekonometrikë statistikorë[2], atyre strukturorë, gjykimit të specializuar të ekonomistëve dhe pritshmërive të agjentëve të tregut apo edhe të publikut.

Kjo do të kërkonte, para së gjithash, njohjen e kufizimeve, por mbi të gjitha, të përparësive që modelet kanë në shërbim të projeksionit, të vendimmarrjes dhe të analizës së kësaj të fundit. Për ta mbyllur pjesën hyrëse të këtij materiali teknik, do të citonim George Box (1987) me shprehjen e tij të mirënjohur në literaturën e modelimit në ekonomi "All models are wrong but some are useful".[3]

---

[2] *Modelet klasike që zhvillohen kryesisht mbi historinë e kaluar të serive kohore dhe mbi supozime të njohura për shpërndarjen e variablave të modeleve, mbajnë në konsideratë teorinë ekonomike në specifikimin e modeleve, por jo në aspektin e lidhjeve afatgjata. Për këtë arsye, ato aplikohen kryesisht për parashikime afatshkurtra.*

[3] *Përkthimi i shprehjes është: "Të gjitha modelet janë të gabuara, por disa prej tyre janë të dobishme".*

II. MODELI GAP DHE PARAMETRAT E TIJ

Parashikimet afatmesme janë një element i rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes në kushtet e vendosjes së një objektivi sasior për inflacionin. Qëllimi kryesor i këtyre parashikimeve është që të projektojnë trajektoren e normës së interesit, që do të siguronte luhatje të inflacionit pranë objektivit afatmesëm, përgjatë horizontit parashikues. Modeli makroekonomik Keynesian(i ri), që përpiqet të kryejë misionin e mësipërm, ka një strukturë shumë të ngjashme me modele të përdorura në një numër të konsiderueshëm bankash qendrore, të cilat kanë zbatuar regjimin e inflacionit të shënjestruar. Ndërkohë, modeli përmban edhe karakteristika specifike që lidhen me ekonominë shqiptare. Ai synon të realizojë projeksionet afatmesme për inflacionin, mbi bazën e një mekanizmi çmim-formues në ekonominë shqiptare, duke përshkruar kanalet e transmetimit të politikës monetare.

a. Modeli dhe përdorimet e tij

Ashtu si pjesa më e madhe e modeleve të këtij lloji, edhe ky model nënkupton katër blloqe ekuacionesh të sjelljes ekonomike të variablave makroekonomikë. Ai përmban: ekuacionin e kërkesës agregate, të shprehur në formën e një ekuacioni të hendekut të prodhimit (kurbën IS); ekuacionin e inflacionit bazë (kurbën e Phillipsit); ekuacionin e kursit të këmbimit (pariteti i pambuluar i normës së interesit - UIP); dhe ekuacionin e funksionit të reagimit të politikës monetare. Përveç kësaj, modeli përmban një numër ekuacionesh shtesë që përshkruajnë lëvizjen e parametrave të tjerë të rëndësishëm ekonomikë si edhe identitete.

Gjatë periudhës 2011-2012, modeli i kësaj forme (Dushku dhe Kota, 2011)[4], ka qenë subjekt i rregullimeve dhe i përmirësimeve të nevojshme, proces që ka vijuar të kryhet nga ekipi përkatës në Bankën e Shqipërisë në bashkëpunim me ekspertët e asistencës teknike të FMN-së.[5]

Modeli i përket klasës së gjerë të modeleve mbi teorinë e re keynesiane. Parimi bazë i modeleve të tilla konsiston në rolin e politikës monetare në ankorimin e inflacionit pranë objektivit dhe të pritjeve inflacioniste.Vetëm politika monetare përcakton normën e inflacionit në afat të gjatë, duke ndryshuar normën e interesit "repo" në përgjigje të goditjeve të ndryshme në ekonomi. Për shkak të natyrës pak fleksibël, kryesisht në lëvizjen e pagave, ndryshimet në normën e interesit në terma nominalë rezultojnë në ndryshimet e normës reale të interesit, duke u paraprirë devijimeve të variablave realë (si aktiviteti ekonomik dhe kursi real i këmbimit) nga prirjet e tyre dhe për rrjedhojë nga ndikimi i tyre në inflacion. Politika monetare ka një ndikim afatgjatë në variablat nominalë dhe një ndikim të përkohshëm në ata realë. Në ndryshim nga një ekonomi e pastër keynesiane, në këto modele pritjet racionale luajnë një rol të rëndësishëm (pritjet që pjesërisht varen nga parashikimet e modelit),

[4] *Në lidhjen në vijim mund të gjeni detaje të modelit dhe të vlerësimit të parametrave të tij: http://www.bankofalbania.org/web/Nje_vleresim_Bayesian_i_nje_modeli_strukturor_per_ekonomine_shqiptare_6226_1.php?kc=0,27,0,0,0*

[5] *Ekspertë të grupit të asistencës teknike të FMN-së, David Vavra dhe Zoltan Jakab (2009-2012).*

që do të thotë se agjentët ekonomikë presin që të ndodhin veprimet e politikës monetare, qoftë edhe pjesërisht, duke ulur mundësinë e përballjes me efekte "surprizë".

Megjithëse modeli ka katër blloqe me bashkësinë e ekuacioneve dhe të identiteteve përkatëse, ai i përket klasës së thjeshtë të modeleve. Përparësia e modeleve të thjeshta është aftësia e tyre për të përshkruar ndërlidhjen e variablave kryesorë që ndikojnë inflacionin. Ky i fundit, së bashku me variablat e tjerë makroekonomikë, krijojn mekanizmin e transmetimit të politikës monetare në mënyrë më të qartë dhe sipas një skeme të thjeshtë, duke ruajtur koherencën teorike. Në të njëjtën kohë, qartësia dhe thjeshtësia e modelit lejon politikëbërjen monetare të ketë një kuptueshmëri të mirë të tij, duke siguruar diskutimin e projeksioneve brenda bankës qendrore, ndërmjet njësisë së parashikimit të Departamentit të Politikës Monetare (DPM) dhe specialistëve të tjerë të tij; brenda Komitetit Këshillimor të Politikës Monetare (KKPM). Kështu, pjesë e tij janë jo vetëm hartuesit e modelit, por mbi të gjitha stafi që në mënyrë aktive krijon skenare për parashikimet e ardhshme. Ky proces interaktiv bën që modeli të mos përbëjë një "kuti të zezë".

Variablat realë në model, të tilla si PBB-ja, kursi real i këmbimit, norma reale e interesit etj.., janë shprehur si devijime nga prirjet të tyre, pra në trajtën e hendekut (Gap), dhe kjo është arsyeja pse këtij lloj modeli i referohemi si Modeli – Gap(MG). Politika monetare me masat e vendimet e saj mund të ndikojë në terma afatshkurtër vetëm Gap-et dhe jo tendencat. Por, ndërsa Gap-et dhe tendencat janë komponentë që nuk maten drejtpërdrejtë (të pavrojtueshëm), një fazë e rëndësishme në bazë të parashikimeve afatmesme është vlerësimi i historisë së serive kohore. Për të realizuar këtë, është zbatuar metoda e filtrimit Kalman.

Ky model është gjysmë-strukturor, që do të thotë se edhe pse modeli ka një interpretim të qartë ekonomik dhe teorik, në zhvillimin e tij është kërkuar që të reflektojë prirjet e ekonomisë shqiptare në mënyrën më të mirë të mundshme. Koeficientët e modelit nuk janë të vlerësuar, por më së shumti të kalibruar në mënyrë që të ndiqet intuita dhe teoria ekonomike, duke marrë parasysh karakteristikat themelore të ekonomisë tonë dhe zhvillimet e saj në të kaluarën e afërt. Vlerësimi ekonometrik është përdorur sa herë që është shfaqur mundësia. Detaje rreth arsyeve pse modeli është më shumë i kalibruar se sa i vlerësuar jepen në shpjegimin e parametrave të tij.

Procesi i projeksionit afatmesëm është shumë më tepër se një përdorim apo ekzekutim i modelit. Në praktikë modelet nuk prodhojnë parashikime pasi janë ekonomistët që i bëjnë ato (Berget. al., 2006). Hartimi i supozimeve të parashikimeve dhe i analizave të përgjithshme ekonomike është përcaktues për rezultatet e projeksioneve. Në këtë kuptim, modeli do të shërbente kryesisht për të sistemuar supozimet dhe gjykimet për të ardhmen në mënyrë të unifikuar dhe konsistente, proces që është konfirmuar edhe nga përvoja e bankave të tjera qendrore që aplikojnë MG (Djukić, et. al., 2010, 2011).

Skemë 1. Transmetimi i politikës monetare sipas MG.



Burimi: Përshtatur nga autorja për MG në rastin e Shqipërisë.

Modeli ka si synim kryesor projeksionin e trajektores së normës bazë të interesit, e cila duhet të jetë në përputhje me arritjen e nivelit objektiv të inflacionit në afat të mesëm. MG gjen pasqyrim në skemën 1, e cila në mënyrë të thjeshtuar paraqet kanalet në transmetimin e politikës monetare.

MG ka edhe disa aplikime të tjera, ku mund të përdoret për analizimin e rreziqeve për të arritur projeksionet dhe reagimin e politikës monetare, në rast se disa nga këto rreziqe do të materializoheshin në masa të caktuara. Për më tepër, MG ka një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin me ambientin jashtë bankës qendrore, kur projeksionet tremujore të inflacionit do të publikohen në raportet përkatëse të politikës monetare.

b. Parametrat e modelit: vlerësimi kundrejt kalibrimit

Karakteristikat e modelit janë të përcaktuara jo vetëm nga struktura, por edhe nga vlerat e parametrave. Vlerat e parametrave përcaktojnë dinamikën e marrëdhënieve ndërmjet variablave të modelit, të tilla si: efektet e disa faktorëve në inflacion; shpejtësinë dhe intensitetin e ndikimit të normës bazë të interesit në inflacion; formimin e kursit të këmbimit etj..

Në përgjithësi, modelet mund të vlerësohen duke u bazuar në historinë e serive kohore të disponueshme ose thjeshtë ata mund të përftohen duke kalibruar parametrat. Portofoli i modeleve aktuale në përdorim mbi inflacionin, parashikimin e rritjes reale të PBB-së tremujore, si edhe një seri modelesh ndihmëse satelite (për kursin e këmbimit, për çmimet e huaja, të naftës në vend, të yield-it të bonove të thesarit etj.), janë modele të vlerësuara mbi parimet bazë të ekonometrisë klasike dhe mbi vlerësime statistikore. Parametrat vlerësohen ekonometrikisht, duke përdorur kritere të mirënjohura si ai i madhësisë së koeficientit të korrektuar të përpuethshmërisë, i kritereve SWC dhe AC apo edhe teste të tjera. Në fund të fundit, këto modele duke shpjeguar historinë e serive kohore nën supozimin e qëndrueshmërisë relative të modeleve në kohë, në

mënyrën më të mirë të mundur, arrijnë të vlerësojnë parametrat pranë variablave shpjegues. Për shkak të supozimit të mësipërm, ky grup modelesh është shumë i vlefshëm për horizonte parashikimi afatshkurtër: brenda 4 tremujorëve dhe aktualisht për inflacionin jo më të largët se 6 tremujorë (Çeliku dhe Hashorva 2011). Nga ana tjetër, pa këto parashikime nuk mund të realizohen projeksionet në terma afatmesëm. MG, i shfrytëzon si lëndë të parë parashikimet afatshkurtra.

Ndërkohë që në modelet afatmesme, si në rastin e MG, nuk është gjithmonë e mundur të vlerësohen parametrat me mënyrat dhe metodat klasike ekonometrike.Jo pse metodat ekonometrike nuk mund të zbatohen, por sepse vlerat e parametrave të përftuar prej tyre nuk sigurojnë besueshmëri dhe qëndrueshmëri të mjaftueshme në kohë të pacaktuar. Për këtë qëllim, operohet me parametra të kalibruar, që përcaktohen në bazë të kritereve të veçanta.

Ka disa arsye të njohura pse vlerësimi i pastër ekonometrik i modeleve të projeksionit afatmesëm nuk mund të jetë plotësisht "i besueshëm". Së pari, ndodh shpesh që në vlerësimet ekonometrike është e vështirë të bëhet analiza shkak-pasojë apo të dallohet qartë variabli shkak nga ai pasojë. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për rregullin e politikës monetare dhe të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Supozojmë se vendimmarrja e politikës monetare i paraprin goditjeve të pritura (anticipated) inflacioniste, duke bërë ndryshime të shpeshta të normës bazë të interesit për të mbajtur inflacionin pranë objektivit gjatë gjithë kohës. Në këtë rast, nëse vlerësohet ekuacioni i normës së interesit (repo) si në vijim[6] – në formë ekonometrike, ai nuk do të mund të shpjegojë ndryshimet e saj me anë të rregullit të politikës monetare, sepse inflacioni do të mbahet gjithmonë në objektiv.

$$rs_t=\lambda_1 rs_{t-1}+(1-\lambda_1)rr^*-\pi 4_{t+4})+\lambda_2(\pi 4_{t+4}-\pi_t^{ss})+\lambda_3 ygap_t+\varepsilon_t^{rs}.$$

Për pasojë, nuk do të dilte nevoja për reagim të politikës monetare për efekt të kthimit të inflacionit në vlerën e shënjestruar, sepse shprehja $\lambda_2(\pi 4_{t+4}-\pi_t^{ss})$ do të ishte shumë pranë ose e barabartë me vlerën zero.

Në rastin e Shqipërisë dhe të ekonomive të ngjashme me të, vlerësimet ekonometrike për projeksione afatmesme janë veçanërisht të vështira për t'u realizuar, për shkak të mungesës së serive të gjata dhe të qëndrueshme kohore. Në shumë prej rasteve, seritë ekonomike janë të shkurtra dhe kanë shkëputje strukturore. Shpesh ato pasqyrojnë dinamizmin e lartë të ndryshimeve strukturore në ekonomi, duke shkaktuar goditje në marrëdhëniet ndërmjet variablave ekonomikë. Këto fenomene, sjellin vlerësime të paqëndrueshme ekonometrike, duke i bërë të papërshtatshme për projeksione ekonometrike në terma afatmesëm. Për të gjitha këto arsye, modeli i projeksioneve afatmesme dhe konkretisht - MG - është i kalibruar në pjesën më të madhe të parametrave

[6] *Ku janë koeficientët shoqërues përkatësisht sipas termave:për normën bazë të interesit të tremujorit paraardhës (rst-1); për hendekun ndërmjet inflacionit të pritur vjetor pas 4 tremujorëve dhe inflacionit objektiv); dhe për hendekun e prodhimit (ygapt).Termi i fundit është ai i mbetjeve. Për më shumë detaje shpjeguese , shihni: http://www.bankofalbania.org/web/Nje_vleresim_Bayesian_i_nje_modeli_strukturor_per_ekonomine_shqiptare_6226_1.php?kc=0,27,0,0,0*

të tij, ndërkohë që vlerësimet ekonometrike janë aplikuar në rastet kur është gjykuar e mundur. Parametrat në model janë kalibruar në mënyrë të tillë që vetitë e modelit (marrëdhëniet midis variablave) të jenë në përputhje me teorinë ekonomike dhe të reflektojnë disa nga karakteristikat e ekonomisë shqiptare. Në të njëjtën kohë, është e përshtatshme për modelin të shpjegohen sa më shumë të jetë e mundur, lëvizjet makroekonomike në të shkuarën e afërt.

Procesi i kalibrimit ka krijuar hapësira edhe kur historia e variablave ekonomikë në Shqipëri nuk ka mundësuar furnizimin me ndonjë vlerë të përcaktuar, qoftë edhe të përafërt për parametra të modelit. Në këto raste, ashtu si Berg et. al., (2006) sugjerojnë, mund të konsiderohen vlera të parametrave respektivë, të rezultuar nga modele të këtij tipi në vende me ekonomi të ngjashme si e jona. Intervalet në të cilat ato janë luhatur kanë qenë orientuese për përzgjedhjen e vlerës së parametrave të munguar në rastin tonë. Në këtë kontekst, përvoja e vendeve të tjera, veçanërisht e vendeve në tranzicion, ka qenë e dobishme për procesin e kalibrimit.

Fuqia shpjeguese e të dhënave nga modeli i kalibruar, zakonisht kontrollohet nga të ashtuquajturat simulime të historisë, sepse nuk ka një tregues sasior të drejtpërdrejtë (R2k etj.), si në rastin e vlerësimeve ekonometrike klasike. Simulimi i historisë bëhet për të evidentuar faktin se sa mirë modeli projekton lëvizjen e variablave (inflacion, kurs këmbimit, hendek prodhimi etj..) përgjatë historisë (in sample simulation – simulim brenda periudhës), pra për të vlerësuar se sa shumë projeksionet devijojnë nga vlerat aktuale. Duhet që këto devijime të jenë sa më të vogla, veçanërisht në të kaluarën e afërt apo në tremujorët e fundit të të dhënave historike. Ky proces kryhet me qëllim që të investigohet nëse ka sinjale të mjaftueshme që intensiteti i marrëdhënieve ndërmjet variablave, praparametrat e modelit, kanë vend të ndryshohen apo jo. Nëse verifikohet ndryshimi nëpërmjet simulimeve të serive në fund të periudhës historike të tyre, do të thotë se shpjegimi i të dhënave të historisë nga ana e modelit (me parametrat e fiksuar më parë) nuk mund të jetë aq i saktë për të gjithë periudhën. Për sa kohë pranohet që modeli do të përdoret për projeksione afatmesme është më mirë të rikonsiderohet një set parametrash që shpjegon më mirë zhvillimet e fundit të serive kohore.

Gjatë procesit të kalibrimit përdoren disa metoda, përzgjedhja e së cilave bëhet në varësi të masës me të cilën parametrat përafrojnë projeksionin me të dhënat historike të periudhave të fundit. Në një gjykim më të thjeshtë, kalibrimi është një proces mjaft'më tolerant' krahasuar me vlerësimin klasik ekonometrik, ku mospërmbushja e kritereve bazë, përjashton parametra në ekuacione apo sisteme ekuacionesh. Kalibrimi është proces investigues dhe përzgjedhës, duke përfshirë gjithë informacionin që disponohet për të konsideruar vlerat e parametrave. Në rastin konkret, në kalibrim janë shfrytëzuar rezultate nga vrojtimet dhe lidhje të treguesve të tyre me inflacionin, ndonëse seritë e vrojtimeve nuk përfshihen drejtpërdrejtë në model. Kjo është aplikuar veçanërishit në lidhjen ndërmjet parashikimeve dhe pritjeve inflacioniste të konsumatorëve dhe të bizneseve, sa kohë që nuk disponohet një seri mjaftueshmërisht e gjatë e pritjeve. Kur vlerat e parametrave kanë dalë nga disa vlerësime të pavarura, në procesin e kalibrimit është marrë një mesatare e tyre.

Konkretisht në MG, janë përdorur vlerësimi ekonometrik dhe vetitë e modelit për të kalibruar ekuacionet e inflacionit bazë dhe atë të hendekut të prodhimit. Ekuacioni i UIP është plotësisht teorik, ndërkohë që ai i rregullit të politikës monetare është i kalibruar vetëm në bazë të vetive të modelit për të plotësuar karakteristikat specifike të politikës monetare.

d) Vetitë e modelit

Metoda kryesore që përdoret për të testuar vetitë e modelit është aplikimi i funksionit "impuls-reagimi". Ky funksion jep një përgjigje për pyetjen se si variabla të sistemit do të reagonin ndaj një goditjeje të njërit prej tyre. Ky reagim nuk mund të gjehet vetëm duke u nisur nga madhësia e parametrave të modelit për sa kohë që nuk kemi të bëjmë me një ekuacion, por me blloqe ekuacionesh. Këto marrëdhënie analizohen duke goditur një variabël me 1% dhe më pas analizohet reagimi i të gjithë variablave të tjerë në model.

Grafik 1. Reagimi ndaj një goditjeje nga kërkesa agregate.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Asistenca Teknike e FMN-së (2011).

Grafik 2. Reagimi ndaj një goditjeje nga oferta.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Asistenca Teknike e FMN-së (2011).

Grafik 3. Reagimi ndaj goditjes nga politika monetare.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Asistenca Teknike e FMN-së (2011).

Analiza të tilla, ofrojnë në mënyrë të thjeshtë mundësinë për të kontrolluar nëse modeli sillet në përputhje me teorinë ekonomike dhe sa mirë pasqyron zhvillimet e njohura në ekonominë e vendit.

III. PROCESI I PROJEKSIONEVE AFATMESME DHE ROLI I TIJ PËR POLITIKËN MONETARE

MG, duhet të përbëjë një nga instrumentet e rëndësishme në procesin e zhvillimit të projeksioneve afatmesme. Rezultati kryesor i këtij procesi është të projektohet trajektorja e normës bazë të interesit që duhet të ndiqet nga Banka e Shqipërisë për të mbajtur inflacionin pranë objektivit të synuar në afat të mesëm.Trajektorja e projektuar e normës bazë të interesit (repo), e cila përdoret nga hartuesit e politikës monetare, përbën një pikënisje në vendimmarrje në lidhje me nivelin e saj.

Krahas rezultateve tremujore të MG, rezultatet më frekuente të modeleve të tjera informojnë politikë-bërësit në lidhje me zhvillimet në terma më afat-shkurtër dhe për më tepër, të përditësuar mbi tregues të tillë si: inflacioni; rritja reale e PBB-së; kursi i këmbimit etj..Nga ana tjetër, rezultatet e tyre ushqejnë MG në terma tremujorë. Por, MG dhe projeksioni i realizuar nëpërmjet tij përbën një proces kompleks. Ai përfshin një numër aktivitetesh të tjera që e mundësojnë procesin ku ndër më të rëndësishmit janë: projeksionet afatshkurtra të inflacionit, të PBB-së dhe të kursit të këmbimit; hartimi i supozimeve të projeksionit lidhur me variablat ekzogjenë; supozimet mbi tendencat e variablave realë, duke përfshirë këtu ndikimin e faktorëve jashtë modelit; propozimet në lidhje me goditjet përgjatë horizontit parashikues etj..

Mbështetur në përvojat e bankave të tjera qendrore që prodhojnë projeksione afatmesme me anë të modeleve të ngjashme me MG[7], procesi

[7] *Banka Kombëtare e Serbisë, Maqedonisë, Rumanisë, Republikës Çeke, Armenisë etj..*

i projeksioneve afatmesme fillon me analizën e inflacionit dhe të faktorëve nga krahu i kërkesës dhe i ofertës, të cilat kanë kontribuar në formimin e tij gjatë muajve (tremujorit) të kaluar apo tremujorit të cilit i referohet analiza. Parë në një vështrim specifik për MG, kjo analizë ndihmon në një masë të rëndësishme në përcaktimin e kushteve fillestare (Initial Conditions (IC)) dhe në hartimin e supozimeve të projeksionit.

Siç është përmendur në seksionin 2, komponentet e pavrojtuara apo të pamatshme drejtpërdrejtë (tendencat dhe Gap-et e variablave realë), janë vlerësuar në bazë të historisë së serive kohore bazuar kryesisht në metodën e filtrimit të Kalman. Vlerat e fundit të tyre, të vlerësuara mbi historinë e serive kohore, do të jenë vlerat fillestare për projeksionin afatmesëm. Vlerësimi i komponentëve të pavrojtuar përfshin jo vetëm thjeshtë aplikimin e filtrit Kalman, por edhe gjykimet ekonomike për kushtet fillestare të ekonomisë. Për shembull, testimi i parë duke kryer projeksione me MG në muajin shkurt të vitit 2011, përfshinte inercinë për çmimet e larta të ushqimeve dhe të lëndëve të para në tregjet botërore; supozimet për ndryshim strukturor të trendit afatgjatë të rritjes ekonomike (drejt rishikimit për poshtë të rritjes potenciale të PBB-së); inflacion të lartë të importuar; dhe të primeve më të larta të rrezikut.

Modelet parashikuese afatmesme nuk informojnë rreth formimit të tendencave të variablave realë. Prandaj, në këtë fazë është e domosdoshme të aprovohen supozimet në lidhje me lëvizjet/ecurinë e tyre të ardhshme. Përgjithësisht, prirjet për të ardhmen janë projektuar duke u bazuar në supozimin se gjendja e tyre në afat të mesëm (më shpejt apo më ngadalë) është duke shkuar drejt ekuilibrit, pavarësisht luhatjeve të tyre.

Supozimet dhe parashikimet në lidhje me ecurinë e disa variablave ekzogjene merren nga burime të jashtme, sepse parashikimet e institucioneve ndërkombëtare konsiderohen të besueshme. Ndër këta variabla përmenden: parashikimet për inflacionin dhe rritjen e PBB-së në EU dhe normën e interesit Euribor (OECD, Komisioni Evropian, FMN).

Veçanërisht të rëndësishme janë supozimet në lidhje me luhatjen e inflacionit jobazë. Këto luhatje varen nga ecuria e ardhshme e çmimeve të mallrave të akcizës, të atyre të rregulluara, të çmimeve të produkteve me sezonalitet të lartë - frutave dhe perimeve, të çmimeve të naftës. Pesha e mallrave që krijojnë inflacionin jobazë në shportën e IÇK-së në rastin e Shqipërisë vlerësohet rreth 23%, duke ndikuar drejtpërdrejtë në projeksionet e inflacionit total. Nëse njihen planet e qeverisë për çmimet e rregulluara dhe ato të akcizës; nëse supozohen saktë luhatjet e çmimeve bujqësore (bazuar në nivelin e tyre aktual dhe të pritjeve për të korrat dhe çmimet e produkteve në tregjet botërore, kryesisht ai i drithërave), projeksionet për inflacionin jobazë do të shërbenin në mënyrë të dobishme në parashikimet afatmesme për inflacionin total.

Për një tremujor në avancë, në vend të një modeli projeksioni për inflacionin, përfshihen në mënyrë të drejpërdrejtë parashikimet afatshkurta për të. Këto të fundit kanë në konsideratë jo vetëm supozimet e bëra për variablat ekzogjenë të tyre, por edhe gjykimet e ekonomistëve, të cilat janë shumë më të sigurta

e të besueshme pasi ato përfshijnë informacione specifike që nuk mund t'i përmbledhin modelet. Këto projeksione përfshijnë vendimet dhe njoftimet korrente mbi çmimet e rregulluara dhe ato të akcizës, si edhe vlerësimet afatshkurtra të ndikimit të faktorëve të tjerë që shkaktojnë luhatje në çmimet e konsumit. Projeksionet afatshkurtra në çdo tremujor për inflacionin janë shumë të rëndësishme, sepse së pari, ato ndikojnë drejtpërdrejtë inflacionin e parashikuar në terma vjetorë në horizontin e një viti dhe së dyti, ndikojnë inflacionin në terma tremujorë në sajë të termit të inercisë dhe të pritjeve inflacioniste.

Modeli nuk përfshin të gjithë variablat e rëndësishëm në projeksion. Për këtë arsye, është e nevojshme që të përfshihen në model në mënyrë implicite faktorë që janë jashtë tij. Kjo arrihet duke përfshirë në termat e goditjeve (që janë të pranishëm në çdo ekuacion), në mënyrë intuitive një goditje nga faktori që nuk është si variabël i shprehur në model. Për shembull, nëse dihet se politika fiskale do të jetë dukshëm ekspansioniste (rritje të shpenzimeve buxhetore), kjo do të ndikonte në një rritje të kërkesës. Ky zhvillim do të përfshihej në projeksione si një goditje me kah rritës/shtesë nëpërmjet termit të goditjeve në ekuacionin e hendekut të prodhimit (ekuacioni IS).

Bazuar në supozimet dhe parashikimet afatshkurtra mund të gjenerohen skenare për parashikime afatmesme. Skenari kryesor apo bazë është ai që ndërtohet mbi supozime të cilat pritet të verifikohen apo të ndodhin me një probabilitet të lartë, pra konsiderohet si skenari më i mundshëm. Krahas projeksionit bazë, mund të ndërtohen edhe alternativa të tjera parashikimesh duke ndryshuar supozimet në përputhje me vlerësimet mbi rreziqe me të cilat mund të përballet ekonomia përgjatë horizontit parashikues të 8 tremujorëve. Këta skenarë rreth atij bazë kanë një rol të veçantë, sepse tregojnë dekursin e veprimit të politikës monetare nëse ngjarjet në ekonomi nuk shkojnë në linjë me pritjet më të mundshme apo me parashikimet sipas skenarit bazë. Ky proces merr një rëndësi të dorës së parë, kur dihet që parashikimet afatmesme do të kryhen dhe do të publikohen për publikun çdo tremujor dhe se ndërkohë, mospërputhjet me supozimet e skenarit bazë janë të mundshme të ndodhin brenda muajve të tremujorit. Për shembull, skenarët mund të bazohen në supozime të ndryshme lidhur me çmimet e rregulluara, me çmimet e naftës në botë apo me ecurinë e kursit të këmbimit.

Tërësia e procesit të projeksioneve afatmesme përfshin një komunikim intensiv ndërmjet anëtarëve të KKPM dhe ekpertëve të fushës së analizës ekonomike e të projeksioneve. Për më tepër, siç është theksuar edhe më parë në këtë analizë teknike, anëtarët e KKPM me propozimet e tyre konkrete mbi skenarët mbështetur me diskutime të argumentuara mbi to, luajnë një rol proaktiv në krijimin e tyre për të rekomanduar formulimin më optimal të vendimmarrjes së politikës monetare. Mbi bazën e skenarëve të diskutuar, ndërtohen probabilitetet e rreziqeve për projeksionet. Ato skematizohen në paraqitje të ndryshme tabelare dhe grafike, ku më e përhapura është figura e Fan Chart e projeksioneve të inflacionit. Zakonisht ai prezantohet në raportet tremujore të inflacionit në banka të ndryshme qendrore, kryesisht të atyre që kanë zgjedhur si regjim të politikës monetare atë të "shënjestrimit

të inflacionit". Ai konsiston në projeksionin qendror (bazë) dhe intervalin e projeksioneve alternative që nënkupton rreziqet lart dhe poshtë projeksionit bazë të inflacionit. Si pikënisje për vendimin mbi normën e interesit është kryesisht trajektorja e normës bazë të interesit e rezultuar sipas skenarit bazë të projeksioneve afatmesme, por edhe vlerësimet mbi rreziqet në lidhje me skenarin bazë.

Ndërmjet dy projeksioneve afatmesme kryhet procesi i përditësimit të projeksioneve në terma afatshkurtër. Në secilin muaj analizohen devijimet nga projeksioni i fundit. Devijimet nga parashikimet mund të rezultojnë nga fakti se parashikimet janë të bazuara në supozime, të cilat mund të mos përmbushen. Në bazë të kësaj analize, përditësohen para së gjithash parashikimet afatshkurtra. Ndërkohë që rikonsiderohet fakti nëse norma bazë e interesit duhet të devijojë dhe sa duhet të jetë ky devijim nga trajektorja e projektuar sipas parashikimeve të fundit afatmesme. Po kështu, analizat e vazhdueshme kanë për synim të investigojnë nëse tendencat makroekonomike janë apo jo në linjë me skenarët alternativë. Sa kohë që ka vendimmarrje mujore të politikës monetare, procesi i përditësimit të projeksioneve afatshkurtra dhe reflektimi mbi devijimet afatmesme është një element mjaft ndihmues për politikëbërjen monetare.

IV. NË VEND TË MBYLLJES

Secili model është një pamje e thjeshtëzuar e realitetit ekonomik. Kjo do të thotë që asnjëherë modelet nuk mund të jenë plotësisht të sakta në përshkrimin dhe parashikimin e prirjeve makroekonomike. Sidoqoftë, modelet mund të sjellin informacion të dobishëm për politikëbërësit rreth masave që duhet të merren për të arritur objektivat bazë të politikave të caktuara monetare.

MG i parashikimit afatmesëm është së pari një alernativë e mirë për të përmbledhur faktet e njohura mbi ekonominë e vendit në një mënyrë të saktë dhe konsistente me teorinë ekonomike. Jo vetëm gjatë zhvillimit të modelit, por edhe gjatë punës përgatitore për prodhimin e projeksioneve afatmesme, ky model lejon përfshirjen e informacionit që gjykohet se është domethënës nga pikëpamja e ekonomistëve të DPM dhe më gjerë. Modeli shërben për të sistemuar gjithçka, çdo gjykim dhe informacion ekonomik në një kuadër të unifikuar makroekonomik.

Siç theksohet në analizat e modeleve të tilla (Berg et. al., 2006), zhvillimi i MG ka në bazë përmbushjen e dy kërkesave kontradiktore: nga njëra anë, kërkohet një përfshirje sa më e plotë informacioni dhe nga ana tjetër, kërkohet të ruhet një model sa më i thjeshtë të jetë e mundur. Kjo e fundit do të thotë se megjithëse disa nga variablat mund të jenë të rëndësishëm, ata përsëri nuk figurojnë në model. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ato nuk merren parasysh: nëse vlerësohet se ndikimi i tyre në projeksion është i rëndësishëm, ata përfshihen përmes termave të goditjeve që figurojnë si terma të veçantë në secilin prej ekuacioneve kryesore të blloqeve të MG.

Projeksioni i trajektores së normës bazë të interesit duhet të jetë në përputhje me kthimin në objektiv të inflacionit në terma afatmesëm. Kjo e bën MG me një rol të rëndësishëm dhe mbështetës në sjelljen e ardhshme të politikës monetare. Megjithatë, devijimet nga trajektorja e projektuar e normës bazë të interesit janë të mundshme, në varësi të vlerësimit të rrezikut, si edhe kur në muajt ndërmjet dy parashikimeve tremujore ndodhin shmangie të konsiderueshme nga parashikimi i fundit afatmesëm.

Në të ardhmen do të monitorohet me kujdes realizimi i procesit të projeksioneve afatmesme. Krahas procesit, do të ndiqet performanca e tyre në kënvështrimin e ruajtjes së prirjeve dhe të saktësisë së parashikimeve. MG do të jetë në proces zhvillimi dhe testimi për të identifikuar mangësitë dhe për t'i riparuar ato. Në këtë kuptim, modelet parashikuese në përgjithësi dhe ai formës Gap në veçanti, të paraqitura deri më sot nuk janë përfundimtarë. Nëse gjykohet se është e nevojshme, ata përmirësohen rregullisht, si në drejtim të parametrave ose të strukturës së tyre.

Në përfundim, funksionimi i një modeli të tillë, sipas një skeduli kohor të përcaktuar, do të kërkonte përmirësime të ndjeshme në drejtim të respektimit të publikimit të të dhënave të statistikave të sektorit real;, përshpejtimit të datave të publikimit të tyre dhe rritjes së cilësisë së këtyre statistikave. Ky kuadër do të ndihmonte funksionimin eficient të modelit për parashikime afatamesme, do të rriste peshën racionale të pritjeve inflacioniste si edhe transparencën e politkëbërjes, duke afruar më shumë punën parashikuese në Bankën e Shqipërisë me standardet e përparuara evropiane në këtë fushë.

REFERENCA

Berg, A., Karam, P.D., & Laxton, D. (2006). A Practical Model-Based Monetary Policy Analysis – A How-To Guide. IMF Working Paper, No. 06/81.

Box, G.E.P., & Draper, N.R. (1987). Empirical Model-Building and Response Surfaces. John Wiley & Sons.

Canova, F., Sala, L. (2006). Back to Square One: Identification Issues in DSGE Models. Journal of Monetary Economics. http://www.crei.cat/people/canova/bk%20to%20sq%201.pdf.

Çeliku, E., Hashorva, G.(2012). Performance Evaluation: Uncertainties in Forecasting Inflation. Bank of Albania. Working PaperNr. 01 (32) 2012, Bank of Albania.

Djukić, M., Momčilović, J., & Trajčev, Lj. (2010). Medium-term projection model of the National bank of Serbia. NBS Working Paper 17.

Djukić, M., Momčilović, J., & Trajčev, Lj. (2011). Structure and Use of the Mediumterm Projection Model in the National Bank of Serbia. Economic Annals, Volume LVI, No. 188 / January – March 2011. Scientific Papers DOI:10.2298/EKA1188032D.

Lucas, R. E.(1976). Econometric policy Evaluation: A Critique. Carnegie – Rochester, Series on Public Policy, Vol.1, 9-46.

Dushku, E., Kota, V. (2011). Një vlerësim bayesian i një modeli strukturor për ekonominë shqiptare. Material Diskutimi, Nr. 04 (27) 2011, Banka e Shqipërisë.

KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT: ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË VEND DHE RAJON

ERJONA SULJOTI DHE SOFIKA NOTE
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

ABSTRAKT

Ashtu si në shumë vende të botës edhe në Shqipëri , kriza financiare globale dha një ndikim të rëndësishëm në rolin e sistemit bankar si ndërmjetës financiar. Mbas vitit 2008, dhe në veçanti gjatë dy viteve të fundit, roli ndërmjetësues i bankave për kanalizimin e fondeve në ekonomi është zbehur. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti kreditues është ngadalësuar ndjeshëm dhe përdorimi i levës financiare në ekonomi është ulur. Kjo analizë shqyrton faktorët pas ecurisë së dobët të kredisë, duke plotësuar përfundimet edhe në një plan krahasimi rajonal. Për sa i takon të ardhmes, Shqipëria, me një prospekt të mirë të rritjes ekonomike, përdorim të pakët të levës financiare dhe varësi të ulët nga financimi i huaj, renditet ndër vendet me potencial të lartë për zhvillimin e aktivitetit kreditues.

HYRJE

Kredia për ekonominë është një element i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit, duke shërbyer si levë financiare dhe duke nxitur rritjen e aktivitetit ekonomik. Përveç kësaj, ajo përbën edhe një nga kanalet më të rëndësishme të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare në ekonominë reale. Ky artikull synon të analizojë faktorët pas ecurisë së dobët të kredisë në Shqipëri duke i parë këto zhvillime edhe në një prizëm krahasues me vendet e rajonit. Analiza e plotë e aktivitetit kreditues ka për qëllim që t'i vijë në ndihmë jo vetëm vendimmarrjes së politikës monetare në Bankën e Shqipërisë, por edhe publikut të gjerë të interesuar.

Zhvillimet në kreditimin në Shqipëri duket se reflektojnë faktorë të ofertës dhe të kërkesës së bashku, me një rritje të ndikimit të këtyre të fundit mbas vitit 2011. Ato janë në një linjë me zhvillimet në vendet e rajonit, duke ndjekur nga afër ecurinë ciklike të ekonomisë. Për sa i takon të ardhmes, Shqipëria, me një prospekt të mirë të rritjes ekonomike, përdorim të pakët të levës financiare dhe varësi të ulët nga financimi i huaj, renditet ndër vendet me potencial të lartë për zhvillimin e aktivitetit kreditues.

Materiali në vazhdim është i strukturuar në katër seksione kryesore. Seksioni i parë paraqet një tablo të zhvillimeve të aktivitetit kreditues në Shqipëri mbas periudhës së krizës financiare globale të vitit 2008. Më pas, në seksionin e dytë, është pasqyruar një analizë e faktorëve të kërkesës dhe ofertës që kanë ndikuar në këtë ecuri, duke ju referuar si të dhënave të bilancit të bankave ashtu edhe opinionit të tyre nga vrojtimi i aktivitetit kreditues. Analiza vazhdon me një pasqyrim të ecurisë së aktivitetit kreditues dhe ndërmjetësimit financiar në vendet e rajonit, duke sjellë të përbashkëtat dhe të veçantat mes zhvillimeve

në Shqipëri dhe në rajon. Së fundi, artikulli përmbyllet me gjetjet kryesore të kësaj analize duke dhënë edhe një gjykim për hapësirat e zhvillimet në të ardhmen.

1. ZHVILLIMET NË PORTOFOLIN E KREDISË NË VEND

Portofoli i kredisë së sistemit bankar në fund të tremujorit të parë të vitit 2013 përfaqësonte 39.1% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB-së)[1], duke qenë 1.7 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Reduktimi i përdorimit të levës financiare në ekonomi duket të ketë filluar që në pjesën e dytë të vitit 2012 dhe është konfirmuar në vazhdim edhe për muajt e parë të vitit 2013. Gjatë periudhës 2011-2013, rritja kumulative e portofolit të kredisë prej 12% është ndjeshëm më e ulët se rritja prej 55% për periudhën 2008-2010. Ky ngadalësim vihet re në të gjitha segmentet e kredidhënies. Kështu, kredia për individë duket të ketë ndërprerë rritjen që në fillim të vitit 2010, dhe ka mbetur rreth të njëjtit nivel për më shumë se dy vjet. Këto zhvillime janë përcaktuar nga tkurrja e kredisë hipotekore. Ndërkohë, norma e rritjes së kredisë për biznese po ndjek një trajektore rënëse që nga muaji shtator 2012, duke reflektuar në mënyrë të barabartë si ngadalësimin e rritjes së kredisë për investime ashtu edhe të asaj për likuiditete.

Grafik 1. Zhvillimet në aktivitetin kreditues.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Paralelisht me këto zhvillime, kredia në valutë është tkurrur me ritme të larta, ndërkohë që ajo në lekë ka ruajtur nivele të kënaqshme rritjeje. Kontraktimi prej më shumë se 6 muajsh i kredisë në valutë, e cila në fund të tremujorit të parë është -4.6% më e ulët se një vit më parë, ka reflektuar jo vetëm tkurrjen e iniciativës për investime nga agjentët ekonomikë, por edhe konsideratat për

[1] *Ky raport përafron edhe përdorimin e levës financiare në ekonomi. Në kuptimin e ngushtë, leva financiare mat shkallën e financimit të një biznesi nëpërmjet borxhit. Në kuptimin makroekonomik, leva financiare përafrohet me raportin Kredi/PBB, duke matur kështu peshën që zë huamarrja në financimin e aktivitetit ekonomik të vendit.*

rrezikun e kursit të këmbimit. Ndërkohë, ecuria e kredisë në lekë duket të jetë favorizuar jo vetëm nga lehtësimi i kushteve të financimit në lekë, por edhe nga orientimi i bankave drejt financimit në monedhën vendase. Rritja vjetore e kredisë në lekë prej 11% në fund të tremujorit të parë 2013 pasqyron këto zhvillime pozitive.

Me gjithë vijueshmërinë e prirjes ngadalësuese të portofolit të kredisë, zhvillimet në pjesën e parë të vitit 2013 dallojnë nga ecuria e kredisë në pjesën e dytë të vitit 2012. Zhvillimet e portofolit të kredisë së bankave gjatë vitit 2012 janë ndikuar në mënyrë të veçantë nga dy fenomene kryesore. I pari është pastrimi i bilanceve të bankave nga kreditë me probleme pa shpresa arkëtimi. Nivelet e larta të kredive të fshira nga bilancet e bankave ndikuan negativisht tepricën e portofolit. Fenomeni i dytë i vërejtur është rritja e portofolit të kredisë për ndërmarrjet publike, e cila u zgjerua në pjesën e parë të vitit 2012 dhe më pas u tkurr dukshëm në pjesën e dytë të tij. Të dy këto zhvillime duket që nuk janë të pranishme në pjesën e parë të vitit 2013. Ndërkohë, ngadalësimi i kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur si rezultat i nivelit më të ulët të kredisë së re.

2. FAKTORËT QË KANË NDIKUAR ECURINË E KREDITIMIT

Për të kuptuar arsyet e ngadalësimit të rritjes së portofolit të kredisë, në këtë artikull analizojmë si faktorët e kërkesës, ashtu edhe ato të ofertës. Për arritjen e përfundimeve më të bazuara, krahas të dhënave nga vrojtimi i aktivitetit kreditues, kemi marrë në shqyrtim edhe të dhëna të sektorit real të ekonomisë.

3. FAKTORËT NGA ANA E KËRKESËS

Zhvillimet në ecurinë e kredisë kanë reflektuar zhvillimet e tjera makroekonomike në vend. Ngadalësimi i kërkesës agregate është shoqëruar

Grafik 2. Kërkesa për kredi nga bizneset dhe faktorët që e kanë ndikuar atë .



* Në kllapa janë peshat e kredisë për cdo sektor në kredinë për biznese.

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

me rënien e kërkesës për kredi, si nga bizneset ashtu edhe nga individët. Sipas vrojtimit të kredisë me bankat e nivelit të dytë vlerësohet se rënia e kërkesës është faktori kryesor në ecurinë e dobët të kredisë për ekonominë pas gjysmës së parë të vitit 2012.

Ecuria e kredisë për biznese ka ndjekur zhvillimet në ekonominë reale. Në përgjithësi, në 3 vitet e fundit, sektorët më të kredituar të ekonomisë kanë qenë shërbimet dhe industria, të cilët kanë dhënë edhe vlerën më të madhe të shtuar në ekonomi. Kështu, sektori i shërbimeve, i cili ka dhënë një kontribut mesatar prej 2.4 pikë përqindjeje në rritjen e aktivitetit ekonomik në tre vitet e fundit[2], ka marrë 56% të kredisë për biznese të dhënë gjatë kësaj periudhe. Kontributi i sektorit të industrisë në rritjen ekonomike ka qenë mesatarisht 0.5 pikë përqindje në këto vite dhe ky sektor ka thithur rreth 35% të kredisë për biznese. Nga ana tjetër, kredia për sektorin e ndërtimit është rritur pak në vitet 2010-2011 dhe është tkurrur në vitin 2012 e në fillimin e vitit 2013, duke reflektuar edhe ecurinë e dobët ekonomike të këtij sektori (kontribut negativ prej 1.5 pikë përqindje në periudhën 2010-2012). Ndërkohë, sektori i bujqësisë, ndonëse me një kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike (prej mesatarisht 1.1 pikë përqindjeje), mbetet i nënkredituar si pasojë e rrezikut të lartë të kredisë që mbart procesi i kreditimit në këtë sektor.

Kërkesa e bizneseve për financim është orientuar kryesisht drejt financimit të nevojave për kapital qarkullues, veçanërisht në dy vitet e fundit. Nga ana tjetër, kërkesa për financimin e investimeve ka qenë në rënie të vazhdueshme që nga fundi i vitit 2008. Kërkesa e ulët për kredi për investime ka ndikuar edhe në ngadalësimin e shpejtë e më pas tkurrjen e kredisë në valutë, e cila tradicionalisht ka qenë e lidhur me financimin e investimeve. Sipas raportimeve të bankave, arsyet kryesore pas rënies së kërkesës për kredi janë ngadalësimi i përgjithshëm i ekonomisë dhe veçanërisht rënia e nivelit të investimeve të reja.

Ndryshe nga bizneset, kërkesa e individëve për kredi ka rënë në të dyja segmentet e kredisë për individë, si atë për konsum, ashtu edhe atë hipotekore, pavarësisht se bankat kanë shtrënguar më pak kushtet e kreditimit për individë. Ajo është rritur lehtë në vitin 2011 dhe ka rënë sërisht në vitin 2012. Faktorët kryesorë të identifikuar nga bankat për rënien e kërkesës për kredi të individëve janë situata në tregun e pasurive të paluajtshme dhe prania e burimeve të tjera (joformale) të financimit. Ndërkohë, ndikim pozitiv në kërkesën për kredi kanë dhënë politikat e ndjekura nga Banka e Shqipërisë, veçanërisht ato të uljes së normës bazë të interesit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së çmimeve, si ankorë stabiliteti në ekonomi. Sjellja e individëve duket të ndikohet nga pasiguritë për të ardhmen e financave të tyre, në kushtet e ngadalësimit të të ardhurave reale të disponueshme. Familjarët vijojnë të reflektojnë këtë pasiguri në ruajtjen e tendencës së tyre për të kursyer, e cila është reflektuar në rritjen e qëndrueshme të depozitave dhe mjeteve të tjera të investimit të kursimeve, si letrat me vlerë të qeverisë.

[2] *Rritja mesatare e PBB-së në vitet 2010-2012 ka qenë 2.5%.*

Grafik 3. Kërkesa për kredi nga individët dhe faktorët që e kanë ndikuar atë.



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

4. FAKTORËT E OFERTËS

Nga ana e ofertës, analiza e rezultateve të vrojtimit të bankave tregon për një ofertë të shtrënguar edhe pse bankat kanë likuiditet dhe kapital të mjaftueshëm për të kryer funksionin e ndërmjetësimit në ekonomi. Në këtë pjesë, do të analizojmë jo vetëm opinionin e bankave mbi kushtet e kreditimit, por edhe njëkohësisht se cilët janë elementët kryesorë që bankat kanë përdorur për të reflektuar shtrëngimin e kushteve të ofertës. Gjithashtu, analiza e kostove të kreditimit si dhe ajo e strukturës së tregut të kredidhënies, plotësojnë analizën për kushtet e kreditimit dhe faktorët e ofertës që kanë ndikuar në ecurinë aktuale të portofolit të kredisë.

5. STANDARDET E KREDITIMIT

Analiza e ecurisë së kushteve të kreditimit sipas vrojtimit të kredisë,tregon se kushtet e kreditimit të bankave kanë qenë në kahun shtrëngues që prej fundit të vitit 2008. Në fund të vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011 u vu re një tendencë lehtësuese e kushteve të kreditimit për biznese, si për qëllime likuiditeti ashtu edhe për atë për investime. Kjo ecuri ishte në linjë me përmirësimin e kushteve makroekonomike si dhe besimin për përmirësim të mëtejshëm të tyre. Ndërkohë,nga gjysma e dytë e vitit 2011 e më pas, thellimi i krizës së Eurozonës dhe në veçanti rikthimi i një recesioni të dytë në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, duket se riktheu tendencën për shtrëngimin e kushteve. Kushtet për bizneset u shtrënguan ndjeshëm, dhe në veçanti për kredinë për investime. Në vrojtimin e kredisë, bankat identifikojnë probleme specifike të sektorëve të ekonomisë, situatën makro dhe ecurinë e kredive me probleme si faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rikthimin e politikave shtrënguese për kreditim. Faktorët që kanë vepruar në kahun lehtësues vlerësohen të jenë konkurrenca dhe gjendja e mirë e likuiditetit në

sistem bankar. Ndërkohë, kërkesat për kapital janë evidentuar të veprojnë në kahun shtrëngues, veçanërisht mbas fundit të vitit 2011, duke reflektuar kështu aplikimin e kërkesave të reja rregullative të autoritetit bankar evropian.

Grafik 4. Kushtet e kreditimit për bizneset.



Burimi: VAK, Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, në segmentin e kredidhënies për individë, zhvillimet në standardet e kreditimit shfaqen ndryshe nga ato për biznese. Kushtet e kreditimit për individë janë shtrënguar ndjeshëm deri në fund të vitit 2009 dhe më pas kanë ndjekur një tendencë lehtësuese, në veçanti për kredinë për banesa, deri në mes të vitit 2011. Më pas, pati një kthim të lehtë të kësaj trajektore në dy tremujorët e fundit të vitit 2011 dhe standardet vazhdojnë të qëndrojnë në këto nivele deri më sot. Në tregun e kredidhënies për individë, bankat kanë ndjekur politika më lehtësuese krahasuar me bizneset. Kjo ka qenë në përputhje me strategjitë e bankave, veçanërisht atyre të mëdha, për t'u rritur në këtë treg gjatë kësaj periudhe. Si faktorë kryesorë që kanë

Grafik 5. Kushtet e kreditimit për individë.



Burimi: VAK, Banka e Shqipërisë.

përcaktuar ecurinë e kushteve të individëve, bankat përmendin ecurinë e tregut të banesave, gjendjen financiare të individëve dhe ecurinë e raportit të kredive me probleme ndaj totalit (NPL-të). Në kahun e kundërt, likuiditeti, konkurrenca midis bankave dhe vendimet e Bankës së Shqipërisë kanë ndikuar në lehtësimin e standardeve të kreditimit për individë.

Në tërësi, nga analiza e mësipërme vëmë re se kushtet e shtrënguara të kreditimit, krahas shqetësimeve të bankave për ecurinë makroekonomike në vend, reflektojnë edhe përkeqësimin e portofolit të kredive me probleme. Grafiku i mëposhtëm tregon ecurinë e këtij portofoli në 3 vitet e fundit për sektorët e ekonomisë dhe për kredinë për individë. Përkeqësimi i cilësisë së portofolit të bankave e ndikon në dy drejtime të rëndësishme rolin ndërmjetësues që ato kryejnë. Nga njëra anë ato rrisin nevojën për kapital për përmbushjen e kërkesave rregullative të autoritetit mbikëqyrës dhe nga ana tjetër ato sinjalizojnë drejtpërsëdrejti mbi rrezikun e ndryshëm që kanë sektorë të caktuar të ekonomisë. Në lidhje me këtë të fundit, vihet re që portofoli i individëve karakterizohet nga një raport më i ulët i kredisë me probleme ndaj totalit, prej 17.8%, krahasuar me 27.4% që e kanë bizneset. Brenda sektorëve të ekonomisë, vihet re se kreditë me probleme janë rritur nga viti në vit pothuajse për të gjithë sektorët, ndërkohë që ato mbeten problematike për sektorin e ndërtimit dhe atë të tregtisë.

Grafik 6. Ecuria e raportit të kredive te këqija ndaj totalit sipas agjentëve ekonomik.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6. KUSHTET E KREDITIMIT

Një nga kostot kryesore që shoqëron financimin me kredi është norma e interesit. Statistikat e sektorit bankar tregojnë se norma e interesit ndryshon ndjeshëm në varësi të monedhës që merret kredia si dhe të maturitetit të saj. Përgjithësisht, normat e interesit të kredisë janë të indeksuara me norma referencë dhe ecin kryesisht në linjë me ecurinë e normës referencë. Për shkak të sjelljes së ndryshme të normës së interesit të kredisë, analiza e saj do të

fokusohet në dy monedhat kryesore; në atë në lekë dhe në atë në euro. Kreditë në euro zënë peshën kryesore të kreditimit në valutë në vend. Ky portofol zë rreth 90% të totalit të portofolit të kredisë në valutë.

Ecuria e normës së interesit të kredisë së re në lekë tregon se, pasi qëndroi në nivele të larta për dy vitet e para mbas krizës, ajo pësoi një rënie të shpejtë gjatë fundit të vitit 2010. Më pas, ajo u rrit lehtë dhe që prej këtij momenti ka qëndruar në një trend rënës. Megjithë këtë rënie, marzhi që bankat aplikojnë ndaj normës referencë vijon të qëndrojë i lartë dhe ka mbetur pothuajse konstant për gjatë gjithë periudhës mbas krizës 2008-2013. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2013 vihet re një rritje e lehtë e këtij marzhi.

Grafik 7. Ecuria e normës së interesit të kredisë, sipas monedhës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë norma e interesit të kredisë në euro, është shfaqur më e qëndrueshme. Diferenca e saj ndaj normës referencë, kryesisht asaj euribor, është rritur ndjeshëm gjatë periudhës së pas krizës. Kjo ecuri është në linjë me orientimin strategjik të bankave drejt monedhës vendase dhe uljes së diferencës së normave të interesit mes monedhës vendase dhe euros. Kjo e fundit vlerësohet nga shumë studime (FMN, Prill 2013) si faktori kryesor që ka nxitur marrjen e kredisë në euro/monedhë të huaj përkundrejt asaj në monedhë vendase në periudhën e rritjes së shpejtë të kredidhënies në vendet e EQJL. Rritja e diferencës mes normave të interesit në euro brenda dhe jashtë vendit në periudhën e pas krizës përngjason dhe me zhvillimet në rajon dhe në Eurozonë, duke përbërë nja nga shqetësimet kryesore të politikë-bërësve për funksionimin e kanaleve të politikës monetare. Gjithashtu, zgjerimi i diferencës reflekton ndër të tjera edhe kostot më të larta për bankat tona (krahasuar me periudhën para krizës) për gjenerimin e financimit në tregjet ndërkombëtare.

Krahas normës së interesit të kredisë, bankat kanë përcjellë shtrëngimin e standardeve të kreditimit edhe në elementët jo-kosto[3]. Rezultatet e vrojtimit

[3] *Elementët jo-kosto përfshijnë elementët që nuk janë normë interesi apo komisione.*

të kredisë tregojnë se mbas vitit 2008, për shtrëngimin e standardeve të bizneseve, bankat kanë rritur kërkesën për mbulimin e kredisë me kolateral krahasuar me periudhën e para-krizës. Gjithashtu, ato kanë ulur maturitetin e kredisë, duke ofruar kryesisht kredi me maturitet afatshkurtër. Ndërkohë, bankat kanë rritur marxhin e aplikuar si për kredinë normale dhe atë me rrezik, duke çuar në shtrëngimin e kushteve. Paralelisht me këto zhvillime janë rritur edhe komisionet që bankat aplikojnë për marrjen e kredisë nga bizneset. I vetmi element që është lehtësuar disi për bizneset në periudhën e pas krizës është madhësia e kredisë.

Grafik 8. Ecuria e elementëve jo kosto sipas agjentëve ekonomikë.



Burimi: VAK, Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, për kredinë për individë, kushtet që bankat kanë lehtësuar janë të lidhura me uljen e komisioneve, marxhin mesatar dhe me rritjen e maturitetit. Edhe për këtë segment, bankat kanë shtrënguar kërkesat për kolateral dhe kanë kërkuar një raport më të lartë të mbulimit të kështit me të ardhurat. Në ndryshim nga bizneset, madhësia e kredisë ka shërbyer si kriter shtrëngues për kredinë për individë.

7. POLITIKAT E GRUPIT

Oferta për kredi nga sistemi bankar dhe në veçanti zhvillimet në standardet e kreditimit, duket të jenë kushtëzuar edhe nga origjina e kapitalit të bankave. Sikurse tregon studimi më i fundit i FMN-së (Prill 2013), standardet e kreditimit dhe politikat e ndjekura nga bankat në vendet e EQJL janë të kushtëzuara nga politikat e grupit (bankave mëma), në veçanti për ato me prejardhje evropiane. Ngërçi në kredidhënie në këto banka ndikohet drejtpërsëdrejti nga modeli i centralizuar i bankingut të bankave evropiane, duke pasqyruar edhe impaktin shtrëngues që pati aplikimi i rregullave të reja të vendosura nga EBA[4]në këtë periudhë (FMN, 2013). Në Shqipëri, këto zhvillime janë

[4] *Autoriteti i Mbikëqyrjes Evropiane.*

pasqyruar në ndryshimin e strukturës së tregut të aktivitetit kreditues. Kështu, bankat greke mbas krizës financiare të vitit 2008 kanë ndjekur politika konsoliduese, duke ulur dukshëm portofolin e kredisë dhe peshën e tyre në treg sikurse vihet re edhe në vendet e tjera të rajonit (OENB, 2012). Tkurrja e aktivitetit kreditues të bankave greke, duket të jetë balancuar kryesisht nga banka të tjera të sistemit. Ndërkohë,bankat që janë pjesë e grupeve bankare evropiane,mbasi shfaqën rritje të kreditimit deri nëmesin e vitit 2011, kanë më shumë se një vit që mbajnë një nivel të pandryshuar të portofolit të kredisë.

8. KREDITIMI NË FOKUS RAJONAL

Ecuria e dobët e kredisë nuk është vetëm një fenomen i izoluar i ekonomisë sonë, por kjo është vënë re në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Që në gjysmën e dytë të vitit 2012, ritmet tashmë të dobëta të rritjes së kredisë u ngadalësuan edhe më tej dhe për shumicën e vendeve qëndrojnë pranë zeros ose në territor negativ. Në këtë krahasim rajonal, Shqipëria renditet ndër vendet me performancën më të mirë, si në rajonin e ngushtë, ashtu edhe më gjerë.

Grafik 9. Rritja vjetore e kredisë së deflatuar me inflacionin, %.



Burimi: Bankat qendrore dhe institutet statistikore të vendeve të rajonit, llogaritje të autoreve.

Sikurse u përmend më lart për rastin e Shqipërisë, faktorët që kanë kushtëzuar këtë ecuri i përkasin si kahut të kërkesës, ashtu edhe atij të ofertës. Megjithatë, vlen për t'u përmendur fakti se, nëse në vitet 2009-2011 kanë qenë faktorët e ofertës ata që kanë kontribuar më shumë në kahun shtrëngues (kryesisht probleme të likuiditetit të bankave), gjatë vitit 2012 e më pas është kërkesa e agjentëve ekonomikë për financim ajo që qëndron pas dobësimit të mëtejshëm të kreditimit në këto vende (Institute ofInternational Finance, 2013). Në shumë vende (si Hungari, Bullgari, Kroaci), kërkesa më e ulët lidhet edhe me shkallën e lartë të përdorimit të kredisë në periudhën përpara krizës. Diçka e tillë nuk vërehet në vende si Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit,

në të cilat agjentët ekonomikë kanëqenë pak të ngarkuar me borxhe dhe nuk e kanë patur të nevojshme të korrektojnë në masë bilancet e tyre.

Ndikimin e kahut të kërkesës e shohim në lidhjen që ka mes rritjes së PBB-së dhe rritjes së kredisë për sektorin privat në këto vende (grafiku 10 më poshtë). Lidhja është parë në dy periudha, atë 2005-2008 dhe atë 2009-2012. Të dhënat tregojnë për një lidhje të ngushtë mes ecurisë së këtyre dy treguesve; vendet me rritje më të lartë të PBB-së reale kanë edhe rritje më të lartë të kredisë për sektorin privat dhe anasjelltas. Një përfundim i tillë shpjegon edhe performancën krahasimisht më të mirë të Shqipërisë pas vitit 2008. Gjithashtu, krahasimi mes dy periudhave nxjerrë në pah edhe faktin se lidhja mes kredisë dhe PBB-së është forcuar pas krizës financiare globale të vitit 2008. Ky përfundim është në linjë edhe me përfundimet e tjera të arritura nga puna kërkimore e viteve të fundit, ku lidhja mes aktivitetit ekonomik dhe kredisë është më e fortë në periudha të vështira ekonomike (RaiffeisenResearch, 2013).

Grafik 10. Lidhja mes rritjes së PBB-së dhe rritjes së kredisë për sektorin privat.



Burimi: Bankat qendrore dhe institutet statistikore të vendeve të rajonit, llogaritje të autoreve.

Faktorët e ofertës vijojnë të kontribuojnë në kahun shtrëngues gjatë vitit 2012, ndonëse më pak se në vitet e mëparshme. Zhvillimet që kanë ravijëzuar ofertën për kredi në vendet e EQJL vitet e fundit kanë qenë të lidhur kryesisht me burimet e financimit të aktivitetit ndërmjetësues dhe rritjen e rrezikut të kredisë. Në të gjitha këto vende, sistemet bankare karakterizohen nga prania e lartë e bankave të huaja, kryesisht evropiane. Në vitet 2005-2008, kjo prani ishte katalizatori i nxitjes së kreditimit në vendet e EQJL, të financuar nga fonde të huaja me origjinë vendet e zhvilluara evropiane. Në ato vite, detyrimet e huaja të bankave në këto vende rriteshin mesatarisht me 44% në vit, dhe në vende si Bullgaria, Hungaria dhe Rumania, këto detyrime zinin një peshë prej 30%-40% të detyrimeve totale të sistemit bankar. Ky model financimi u vendos përballë një testi të fortë në krizën financiare të fund-vitit 2008, ku bankat në EQJL u përballën me tërheqjen masive dhe të shpejtë të

financimit të huaj[5]. Ky ishte edhe faktori kryesor që diktoi fillimisht shtrëngimin e kushteve të kreditimit dhe ngadalësimin e kredidhënies në këto vende. Më pas, me zëvendësimin gradual të fondeve të huaja me burime të brendshme të financimit - depozitat -, situata e likuiditetit u përmirësua në pjesën më të madhe të vendeve, duke mos përbërë më një faktor të rëndësishëm kufizimi në kreditim. Në fund të vitit 2008, sistemi bankar shqiptar ishte ndër sistemet me shkallën më të ulët të varësisë ndaj financimit të huaj (10% e totalit të detyrimeve). Kjo shkallë u përgjysmua në harkun kohor të dy viteve dhe vijon të qëndrojë e ulët. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se tërheqja e financimit të huaj nga bankat në Shqipëri është më shumë e balancuar nga rritja e bazës së depozitave, çka deri në vitin 2012 mundësoi një rritje më të mirë të kredisë për sektorin privat në ekonominë tonë.

Grafik 11. Financimi i huaj i bankave dhe raporti i kredive me probleme.



Burimi: Bankat qendrore dhe institutet statistikore të vendeve të rajonit, llogaritje të autoreve.

Faktori i dytë që kushtëzon një ofertë të shtrënguar të kredisë në rajon është rritja e rrezikut të kredisë. Raporti i kredive me probleme[6] është rritur ndjeshëm në shumicën e këtyre vendeve dhe reflekton së pari ecurinë e dobët të ekonomisë reale. Në periudhën 2009-2012, ky raport është rritur me 9 pikë përqindje mesatarisht për të gjithë rajonin. Sistemi bankar shqiptar është përballur me një rritje të shpejtë të këtij raporti, çka përbën një nga faktorët kryesorë për shtrëngimin e kushteve të kreditimit, veçanërisht në sektorë të caktuar. Në kontekstin makroekonomik, niveli i lartë i kredive me probleme çon në kapitale të pashfrytëzuara (kolateralet) dhe mban peng financimin e projekteve të reja, duke penguar rimëkëmbjen ekonomike. Trajtimi i shpejtë i këtij problemi dhe pastrimi i bilanceve të bankave në vendet e EQJL është një

[5] *Kjo erdhi edhe si pasojë e politikave të grupeve mëma lidhur me financimin e filialeve të tyre në vendet e EQJL, ku aktiviteti kreditues duhej të financohej vetëm me burime të brendshme të financimit.*

[6] *Ky raport nuk është i krahasueshëm ndërmjet vendeve pasi për llogaritjen e tij përdoren metodologji të ndryshme nga vende të ndryshme. Metodologjia e përdorur në rastin e Shqipërisë është ndër më konservatoret, çka shpjegon në një masë të madhe edhe nivelin më të lartë nga vendet e tjera.*

parakusht i rëndësishëm për rritjen e pranimit të rrezikut nga bankat në këto vende dhe rimëkëmbjen e financimit bankar në ekonomitë e tyre.

Grafik 12. Tregues të ndërmjetësimit në rajon.



Burimi: Bankat qendrore dhe institutet statistikore të vendeve të rajonit, llogaritje të autoreve.

Së fundi, në krahasimin rajonal është me vlerë të përmenden edhe diferencat që lindin mes vendeve si rrjedhojë e niveleve të ndryshme të ndërmjetësimit. Shqipëria renditet si vendi me përdorimin më të ulët të levës financiare në ekonomi, sikurse tregohet nga raporti Kredi/PBB. Kjo tregon se, nga ana e kërkesës ka akoma hapësira për vazhdimësi të rritjes së kredisë dhe rritje të mbështetjes së saj në aktivitetin ekonomik. Nga ana tjetër, edhe sistemi bankar në Shqipëri ka hapësira për rritje të financimit të sektorit privat; përdorimi i depozitave në aktivitetin kreditues, i matur me raportin kredi/depozita, qëndron gjithashtu në nivele të ulëta. Niveli i ulët i këtyre dy treguesve, të cilët përcaktojnë edhe shtegun që do të ndjekin zhvillimet në kreditim në afat të mesëm e të gjatë, dëshmon se ngërçi i krijuar në kreditim është afatshkurtër dhe i ndikuar kryesisht nga faktorë kalimtarë dhe jo thelbësorë.

9. PËRFUNDIME

Kriza financiare globale ashtu sikurse në shumë vende të botës, edhe në Shqipëri dha një ndikim të rëndësishëm në rolin e sistemit bankar si ndërmjetës financiar. Mbas vitit 2008, dhe në veçanti gjatë dy viteve të fundit, roli ndërmjetësues i bankave për kanalizimin e fondeve në ekonomi është reduktuar. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti kreditues është ngadalësuar dhe përdorimi i levës financiare në ekonomi është ulur. Ky fenomen është ndikuar si nga faktorë të kërkesës ashtu edhe ata të ofertës, të cilët kanë vepruar me intensitet të ndryshëm ndër vite. Fillimisht ishin faktorët e ofertës ata që përcaktuan shtrëngimin e kushteve të kreditimit dhe dekurajuan kërkesën për kredi. Ndërkohë, në vitin e fundit, kërkesa për kredi është ulur ndjeshëm, duke dhënë edhe kontributin kryesor në ecurinë e dobët të kredisë në gjysmën e dytë të vitit 2012 dhe gjysmën e parë të vitit 2013.

Zhvillimet në kreditimin në Shqipëri duket se janë në një linjë me zhvillimet në vendet e rajonit. Kërkesa e ulët për kredi është reflektim i ecurisë së dobët ekonomike në këto vende. Ndërkohë, oferta për kredi vijon të jetë e shtrënguar prej dy faktorëve kryesorë: nevoja për të financuar aktivitetin ndërmjetësues nga burime të brendshme të financimit (depozita) dhe rritja e rrezikut të kredisë (niveli i lartë i huave me probleme). Analiza krahasuese e vendos Shqipërinë në një pozicion më të mirë ndër vendet e rajonit, duke qenë se financimi i huaj zë një peshë të ulët në bilancet e bankave shqiptare. Nga ana tjetër, kreditë me probleme mbeten në nivele të larta, sikurse në të gjithë rajonin. Adresimi dhe menaxhimi i shpejtë i tyre përbënnjë ndër sfidat e radhës për politikë-bërësit dhe bankat në rajon. Pastrimi i bilanceve të bankave prej tyre do të rriste aftësinë e bankave për të kredituar dhe do të ndihmonte në rimëkëmbjen e ekonomisë në të ardhmen.

Për sa i takon së ardhmes, në afatin e shkurtër, ecuria e kreditimit duket se do të vijojë të kushtëzohet nga kërkesa e ulët për kredi, pasiguritë e agjentëve ekonomikë dhe të bankave për ecurinë e ardhshme dhe menaxhimin e kredive me probleme. Nga ana tjetër, Shqipëria konsiderohet një vend me potencial të lartë të rritjes ekonomike, ndërkohë që ajo ka një përdorim të ulët të levës financiare përkundrejt aksesit të një bazë të gjerë depozitash nga bankat. Këta faktorë bazë përcaktojnë një prospekt pozitiv për ecurinë e kreditimit në Shqipëri në afat të mesëm e të gjatë.

LITERATURA

FMN, Prill 2013, RegionalEconomicIssues: "Central EastandSoutheasternEurope". http://www.imf.org/external/pubs/ft/reo/2013/eur/eng/ereo0413.htm
Institute ofInternational Finance, 2013 "EmergingMarketsBankLendingConditionsSurvey, 2013Q1".
RaiffeisenResearch, Maj 2013 "CEE BankingSectorReport".
Banka e Shqipërisë, Prill 2013 " Vrojtimi iaktivitetit kreditues për tremujorin e parë të 2013".
E. Suljoti, S. Note dhe O. Manjani, Prill, Janar 2013 " Analiza e ndërmjetësimit financiar".
Backé P dhe Gardó S. 2012:"Spillovers of the GreekCrisis to SoutheasternEurope: Manageable or a CauseforConcern?"- FocusonEuropeanEconomicIntegration Q1/12-OENB

PERFORMANCA DHE RËNDËSIA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE PËR AKTIVITETIN EKONOMIK VENDAS

IRIS METANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Ndryshimet strukturore të përjetuara në një ekonomi, përgjithësisht, reflektohen në strukturën e peshave të sektorëve në produktin e brendshëm bruto dhe punësim. Në ekonominë vendase, gjatë dy dekadave të fundit rëndësia e sektorit të shërbimeve është rritur në kohë. Kjo tendencë e shënuar në ekonomi, së bashku me rolin e sektorit të shërbimeve [1] edhe për aktivitetet e tjera ekonomike, kërkon një analizë të kujdesshme të zhvillimeve sektoriale. Artikulli do të trajtojë më gjerësisht profilin dinamik të sektorit të shërbimeve, në një analizë të detajuar të vlerës së shtuar, të punësimit dhe të produktivitetit të punës.

Teoria ekonomike dhe studimet empirike kanë identifikuar një sërë faktorësh përgjegjës për rolin më të madh të sektorit të shërbimeve. Rëndësia e shtuar e këtij sektori shpjegohet nëpërmjet konceptit të shtruar nga Clark (1951, i cituar në materialin e ECB, 2006), i cili argumentoi se produktet e shërbimeve plotësojnë kërkesa të një niveli më të lartë krahasuar me mallrat[2]. Sipas këtij argumenti, rritja e të ardhurave shoqërohet me alokimin e një pjese më të madhe të tyre drejt shpenzimeve për produktet e shërbimeve. Baumol (1967, 2001, sipas materialit të ECB) e kundërshtoi këtë argument, duke cilësuar se kur treguesit shprehen në çmime konstante, kërkesa relative për shërbime nuk varet nga të ardhurat. Sipas tij, pesha më e lartë e punësimit në sektorin e shërbimeve është pasojë e ndryshimeve në produktivitet. Jacobs, Shipp dhe Brown (1989), si edhe Cancedda (2001, referuar në materialin e ECB) rendisin si një faktor tjetër shpjegues pjesëmarrjen më të lartë të femrave[3] në tregun e punës dhe veçanërisht në degët e sektorit të shërbimeve, të pasqyruar në rritjen e peshës së sektorit në totalin e vlerës së shtuar dhe të punësimit. Gjithashtu, Nicoletti (2001, argumentuar në materialin e ECB) thekson rolin e procesit të liberalizimit dhe efektet e globalizimit për rëndësinë relative të sektorit të shërbimeve, kryesisht në degët e transportit ajror, postës e komunikacionit dhe turizmit.

Sektori i shërbimeve në Shqipëri gjeneroi rreth 60.3% të vlerës së shtuar totale me çmime korrente gjatë vitit 2011[4], duke punësuar pjesën më të madhe

[1] *Në sektorin e shërbimeve përfshihen degët: "Tregti, hotele dhe restorante", "Transporti", "Posta dhe telekomunikacioni", "Shërbime të tjera".*

[2] *Sipas teorisë standarde të mikroekonomisë nënkuptohet se shërbimet gjenerojnë produkte më superiore, të shprehura në vlerën e elasticitetit të kërkesës ndaj të ardhurave më të madhe se 1.*

[3] *Në kushtet e papunësisë, angazhimi i femrave në aktivitetet shtëpiake nuk përfshihet në vlerësimin e prodhimit të brendshëm bruto dhe në statistikat e tregut të punës.*

[4] *Bazuar në të dhënat vjetore paraprake të prodhimit të brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik, të publikuara nga INSTAT për periudhën e kohës 1996 – 2011.*

të forcës punëtore rreth 69.8%[5]. Pesha e sektorit të shërbimeve në vlerën e shtuar dhe në punësimin në total duhet analizuar në dy këndvështrime. Së pari, që prej vitit 1996 pesha e këtij sektori është rritur, kryesisht në terma të vlerës së shtuar, me rreth 10.7 pikë përqindje. Së dyti, ndryshimet e peshës së sektorit të shërbimeve sipas vlerës së shtuar dhe punësimit mund të sinjalizojnë dinamikë të ndryshme të produktivitetit të punës midis sektorëve, e cila trajtohet më gjerësisht në vazhdim. Për më tepër, duke ju referuar treguesve përafrues të strukturës së tregut[6], për periudhën 2006 – 2011, numri i ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e shërbimeve, me një peshë mesatare tek totali rreth 83%, regjistroi rritje me 39.6%. Ndërkohë, treguesit e tregut të punës dëshmojnë për rritje të peshës së numrit të femrave të punësuara në këtë sektor ndaj totalit të punësimit nga 14.6% në 16.0%.

Grafik 1. Pesha e sektorit të shërbimeve në vitin 2011 në vlerën e shtuar reale dhe punësimin në ekonomi.



Burimi: INSTAT.

Krahasimi me disa prej vendeve të rajonit e më gjerë[7] dëshmon se ndryshimi strukturor, i lidhur me zhvendosjen e aktiviteteve drejt sektorit të shërbimeve, është përjetuar edhe nga këto ekonomi. Sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në vlerën e shtuar e punësimin në ekonomi, dhe rëndësia e tij në kohë ka ardhur në rritje, ndërkohë që shpejtësia e procesit të ristrukturimit është e ndryshme.

[5] *Kjo peshë është llogaritur duke mos marrë parasysh të vetëpunësuarit në sektorin e bujqësisë, të cilët kanë peshën më të madhe në punësimin total në ekonominë vendase. Punësimi në sektorin bujqësor vlerësohet me anën e vrojtimeve me frekuencë vjetore, të cilat kanë shkallë të ulët saktësie dhe janë subjekt i vazhdueshëm rishikimesh. Pesha e të punësuarve në sektorin bujqësor zë rreth 54.6% të punësimit total, ndërsa në sektorin e shërbimeve rreth 31.7%. Të dhënat mbështeten në publikimin e INSTAT "Të punësuar sipas aktivitetit ekonomik", të referuara për periudhën e kohës 2000 – 2011.*

[6] *INSTAT publikon këto të dhëna në "Anketën strukturore pranë ndërmarrjeve", vrojtim i realizuar me frekuencë vjetore dhe i disponueshëm në bazën e të dhënave statistikore të INSTAT për periudhën e kohës 2006 – 2011.*

[7] *Ekonomitë e përfshira në krahasimin me Shqipërinë (AL) janë: Bosnje dhe Hercegovina (BiH), Bullgaria (BG), Greqia (EL), Hungaria (HU), Italia (IT), Kroacia (HR), Mali i Zi (ME), Serbia (RS), Sllovenia (SI) dhe Turqia (TR).*

Grafik 2. Pesha e sektorit të shërbimeve në totalin e vlerës së shtuar reale dhe në punësimin në Shqipëri, në disa prej vendeve të rajonit e më gjerë.



Burimi: INSTAT, Eurostat, bankat qendrore dhe institutet e statistikave të disa prej vendeve të rajonit.

Analiza e mëtejshme e sektorit të shërbimeve mbështetet në vlerën e shtuar me çmime bazë[8], e cila disponohet me frekuencë tremujore dhe është e disagreguar sipas Nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike[9](NACE Rev 1.1). Duke marrë parasysh edhe efektin e inflacionit, pesha e sektorit të shërbimeve, rreth 56.9%, është më e ulët e llogaritur për vlerën e shtuar me çmime bazë e krahasuar me peshën e llogaritur tek vlera e shtuar me çmime korrente. Ndërkohë, e analizuar sipas aktiviteteve të përfshira në këtë sektor evidentohen ndryshime të peshave të degëve në terma të vlerës së shtuar dhe të punësimit. Ndryshimet rezultojnë më të mëdha për degët e tregtisë, transportit, postës e telekomunikacionit, arsimit dhe shëndetësisë. Kjo sugjeron për nivele të ndryshme të produktivitetit të punës midis degëve të aktiviteteve të shërbimeve, gjë që mbështetet nga dinamika e ndryshme e llogaritur e produktivitetit të punës të pasqyruar më tej në material.

Disagregimi i vlerës së shtuar sipas NACE Rev 1.1 nuk evidenton aktivitetet e përfshira në shërbimet e tregut dhe ato të përfshira në shërbimet jo të tregut. Megjithatë, në publikimin më të fundit të INSTAT,"Rezultate kryesore

[8] *Seritë e vlerës së shtuar sipas aktiviteteve ekonomike, mbi të cilën është ndërtuar analiza mbulojnë periudhën e kohës 2005 T1 – 2012 T4.*

[9] *Vlerën e shtuar të sektorit të shërbimeve, INSTAT e raporton për degët: "Tregti" (G), "Hotele dhe restorante" (H), "Transporti" dhe "Posta dhe telekomunikacioni" (I), "Ndërmjetësimi financiar" (J), "Pasuritë e paluajtshme, dhënia me qira dhe shërbimet kundrejt bizneseve" (K), "Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar" (L), "Arsimi" (M), "Shëndetësia" (N), "Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual" (O). INSTAT megjithëse e ndan punësimin sipas aktiviteteve në bazë të NACE Rev 1.1 e raporton të disagreguar sipas degëve G, H, I, M, N dhe "Shërbime të tjera" (ku përfshihen aktivitetet e grupeve J, K, L, O, "Shërbimi shtëpiak" (P) dhe "Aktivitete të organizmave ndërkombëtare" (Q)).*

nga Anketa e Forcave të Punës 2012"[10], punësimi grupohet në dy kategoritë e mësipërme[11]. Sipas anketës, sektori i shërbimeve të tregut ka peshë më të madhe se sektori i shërbimeve jo të tregut. Duke aplikuar përkufizimet e anketës, lidhur me grupimet edhe për vlerën e shtuar sipas aktiviteteve ekonomike, rezulton se sektori i shërbimeve të tregut ka peshën më të madhe në vlerën e shtuar të gjeneruar nga sektori i shërbimeve.

Grafik 3. Peshat e degëve të sektorit të shërbimeve në vitin 2011 në vlerën e shtuar reale dhe punësimin.



Burimi: INSTAT.

Ndryshimet e rezultuara midis peshave të aktiviteteve të shërbimeve sipas vlerës së shtuar dhe punësimit, shtrojnë domosdoshmërinë e vlerësimit të performancës së sektorit në terma të produktivitetit të punës. Ecuria e treguesit të produktivitetit të punës[12]në sektorin e shërbimeve ka rezultuar negative gjatë viteve 2006 – 2008. Në të kundërt, tendenca u përmirësua lehtësisht për periudhën 2009 – 2011, për të shënuar sërish rënie gjatë vitit 2012. Gjithashtu, degët e shërbimeve kanë shfaqur ecuri të ndryshme të produktivitetit të punës, duke sugjeruar për një shkallë të caktuar heterogjeniteti midis tyre. Kështu, produktiviteti i punës në degët e postës e telekomunikacionit, si edhe hoteleve e restoranteve ka shënuar ecuri pozitive, ndonëse me ritme të ulëta. Kjo mund të reflektojë në një masë të caktuar rritje të eficiencës dhe të kërkesës, si edhe ulje të çmimeve dhe adoptim të teknologjive më të avancuara, veçanërisht në degën e telekomunikacionit.

[10] *Ky publikim pasqyron strukturën sektoriale të punësimit për vitin 2012, si pesha ndaj punësimit në total. Megjithatë, pamjaftueshmëria e të dhënave në terma të njësisë së referuar, të shtrirjes në kohë dhe të disagregimit sipas aktiviteteve ekonomike e kufizon përdorimin e këtij publikimi si një burim parësor analize. Në të njëjtën kohë, peshat e raportuara në të ndryshojnë nga ato të rezultuara në publikimin "Të punësuar sipas aktivitetit ekonomik", duke evidentuar ndër të tjera problematikën e statistikave në tregun e punës veçanërisht në sektorin e bujqësisë, i cili vlerësohet mbi bazën e anketave, për një analizë konsistente të këtij tregu.*

[11] *Sipas Anketës së Forcave të Punës 2012, në sektorin e shërbimeve të tregut përfshihen seksionet G, H, I, J, K. Në sektorin e shërbimeve jo të tregut përfshihen seksionet L, M, N, O, P, Q.*

[12] *Treguesi është llogaritur mbi bazën e përqasjes së ndjekur nga Çeliku dhe Metani (2011), ku produktiviteti i punës vlerësohet si raport i vlerës së shtuar (në formë indeksi me vit bazë 2005) me indeksin e të punësuarve për sektorin dhe degët përkatëse të tij.*

Në të kundërt, produktiviteti i punës në degët e tregtisë dhe të transportit rezulton të ketë pasur kryesisht profil negativ. Duhet mbajtur parasysh se kjo dinamikë mund të burojë edhe nga përmirësimet e vazhdueshme metodologjike të treguesve të vlerës së shtuar, indeksit të të punësuarve dhe supozimeve të aplikuara për llogaritjen e treguesit të produktivitetit të punës sipas aktiviteteve ekonomike.

Grafik 4. Produktiviteti i punës në sektorin e shërbimeve (majtas) dhe në disa prej degëve të tij (djathtas).



Burimi: Llogaritje të autores.

Ndërkohë, në krahasimin e normave të ndryshimit vjetor të produktivitetit të punës në sektorin e industrisë me atë të shërbimeve rezulton një hendek[13] pozitiv midis tyre. Megjithatë, duhet theksuar se ky hendek është ngushtuar për periudhën 2007 – 2012. Natyra e ndryshme e produkteve të shërbimeve, të cilët në krahasim me mallrat nuk mund të magazinohen apo ruhen, shpjegon në një masë hendekun pozitiv. Si rezultat, kufizohet përfitimi që buron nga koncepti i ekonomive të shkallës në procesin e prodhimit, pavarësisht inovacioneve teknologjike të përdorura në sektorin e shërbimeve.

Grafik 5. Hendeku midis produktivitetit të punës në sektorin e industrisë dhe në sektorin e shërbimeve.



Burimi: Llogaritje të autores.

Rëndësia relative e sektorit të shërbimeve sugjerohet edhe nga lëvizjet ciklike të sektorëve në ekonomi. Kështu, lëvizjet ciklike kanë qenë me luhatshmëri më të lartë në sektorin e industrisë, ndërkohë që ecuria e sektorit të shërbimeve ka qenë më e qëndrueshme. Rritja e vlerës së shtuar nga shërbimet pasqyron volatilitet më të ulët krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë[14]. Natyra relativisht

[13] *Hendeku llogaritet si diferenca e normave të ndryshimit vjetor të produktivitetit të punës në sektorin e industrisë me atë të shërbimeve.*

[14] *E shprehur në terma të devijimit standard të pasqyruar në tabelën 1.*

Grafik 6. Ecuria e vlerës së shtuar sipas sektorëve dhe prodhimi i brendshëm bruto*.



*Indeksi është ndërtuar mbi seritë e PBB-së me çmime bazë në total dhe vlerës së shtuar sipas sektorëve, si shumë rrëshqitëse vjetore, me bazë tremujorin e parë të vitit 2011. Përzgjedhja e periudhës bazë është realizuar duke u mbështetur tek ecuria e treguesit të përbërë paraprirës, i cili në tremujorin e parë të vitit 2011 ka marrë vlerën më të ulët që prej tremujorit të dytë të vitit 2006.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

më pak e luhatshme e sektorit të shërbimeve e krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë ilustrohet edhe në grafikun e mëposhtëm, duke evidentuar një tjetër karakteristikë specifike të vlerës së shtuar së sektorit[15].

Pavarësisht peshës më të madhe të sektorit të shërbimeve në vlerën e shtuar në ekonomi, të dhënat dhe treguesit e disponuar për të monitoruar zhvillimet afatshkurtra në prodhimin e shërbimeve janë ende në fazat e para të zhvillimit, përtej përmirësimit të shënuar në terma të sigurimit dhe të volitshmërisë në publikimin e tyre.

Tabelë 1. Vlera e shtuar sipas sektorëve, me frekuencë tremujore dhe e rregulluar për sezonalitet.

Zhvillimet sektoriale në terma të vlerës së shtuar me çmime bazë (mesatare e periudhës 2005 T2 – 2012 T4)				
	Ndryshimet tremujore (në %)	Devijimi standard i ndryshimeve tremujore	Kontributet në ecurinë tremujore (në pikë përqindje)	Kontributet në ecurinë tremujore në vlerë absolute (në pikë përqindje)
Shërbimet	1.3	1.5	0.9	1.2
- Tregtia, hotele restorante	1.1	2.5	0.2	0.4
- Transporti	1.2	6.0	0.1	0.2
- Postë-telekomunikacioni	2.8	6.5	0.1	0.2
- Shërbime të tjera	1.3	1.0	0.3	0.3
Industria	1.5	7.2	0.1	0.6
Ndërtimi	0.5	9.1	0.0	1.0
Bujqësia	1.1	1.2	0.2	0.3
Totali	1.1	2.0	1.1	

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të autores.

Në përgjithësi, shtimi i të dhënave të disponuara i shërben përmirësimit dhe plotësimit të analizës së sektorit të shërbimeve, për të rritur shkallën e kuptueshmërisë së zhvillimeve të faktuara në kohë. Përmirësimi i mëtejshëm i të dhënave lidhet me shkallën e disagregimit të detajuar të të dhënave, frekuencën me të cilën mblidhen të dhënat, volitshmërinë në publikimin e të tyre, intervalin kohor që mbulojnë si edhe cilësinë e treguesve të disponueshëm. Ndër të tjera, përmirësimi i databazës statistikore do t'i shërbente edhe krahasimit më konsistent me ekonomitë e rajonit e më gjerë.

Në përfundim, vlerësimi i performancës ekonomike të sektorit të shërbimeve evidenton rëndësinë e këtij sektori për ekonominë vendase, si të reflektuar në

[15] *Pavarësisht volatilitetit më të ulët që shfaq, meqenëse përfaqëson sektorin me peshën më të madhe, aktivitetet e shërbimeve kanë kontribuar mesatarisht më shumë në volatilitetin e rritjes së vlerës së shtuar në total krahasuar me sektorët e tjerë më volatilë si ndërtimi, bujqësia dhe industria. Ky tipar thekson ndër të tjera edhe rëndësinë e zhvillimeve afatshkurtra në këtë sektor, për një proces të saktë analizimi dhe parashikimi të mbështetur në tregues konsistentë dhe të gjeneruar në kohë.*

rritjen e peshës së tij në kohë ashtu edhe në peshën më të lartë krahasuar me sektorët e tjerë. Analiza evidenton një shkallë të caktuar heterogjeniteti midis aktiviteteve në sektorin e shërbimeve, si edhe volatilitetin relativ më të ulët të sektorit. Kështu, ritmet e rritjes së vlerës së shtuar reale të gjeneruar nga sektori i shërbimeve karakterizohen nga luhatshmëri e ulët si përsa i takon luhatjeve përgjatë ciklit të biznesit, ashtu edhe luhatjeve afatshkurtra të shprehura në ecurinë e normave tremujore. Ndërkohë, treguesi i produktivitetit të punës sugjeron për domosdoshmërinë e përmirësimit të mëtejshëm të sektorit të shërbimeve. Shtimi i konkurrencës në sektorin e shërbimeve mund të ndikojë në rritjen e eficiencës dhe fleksibilitetit ekonomik të sektorit. Gjithashtu, kjo do të mbështesë rritjen e produktivitetit të punës dhe do të nxisë dinamizmin e sektorit, duke rritur si rrjedhojë reagimin ndaj goditjeve ekonomike dhe duke lehtësuar procesin e përshtatjes së ekonomisë ndaj ndryshimeve strukturore.

REFERENCA

Çeliku, Evelina dhe Iris Metani. 2011. "Pozicioni konkurrues i ekonomisë shqiptare në terma të produktivitetit të kostos së punës".Material Diskutimi. Banka e Shqipërisë.
European Central Bank. 2006. "Competition, productivity and prices in the Euro Area services sector". Task Force of the Monetary Policy Committee of the European System of Central Banks. Occassional Paper Series. No. 44. April.
European Central Bank. 2007. "Competition in and economic performance of the Euro Area services sector". Monthly Bulletin. Article, pg. 73. May.
INSTAT. Llogaritë kombëtare vjetore. "Prodhimi i brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik, 1996 – 2011, me çmimet e vitit të mëparshëm". http://www.instat.gov.al/al/themes/llogaritë-kombetare.aspx
INSTAT. Tregu i punës. "Të punësuar gjithsej sipas aktivitetit ekonomik". http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-punës.aspx
INSTAT. Tregu i punës. "Rezultate të anketës së forcave të punës 2012".http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-punës/publications/books/2012/rezultate-të-anketës-së-forcave-të-punës-2012.aspx
INSTAT. Databaza statistikore. Informacioni ekonomik për ndërmarrjet. "Të dhënat bazë për prodhuesit e të mirave e shërbimeve për treg 2006 – 2011".http://www.instat.gov.al/al/figures/statistical-databases.aspx?expand=EE
INSTAT. Informacioni ekonomik për ndërmarrjet. "Anketa Tremujore pranë ndërmarrjeve – Indekset e punësimit".http://www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet.aspx

"STATUS QUO-JA" E SME-VE NË SHQIPËRI

ELONA DUSHKU DHE ALBAN PLLAHA
DEPARTAMENI I KËRKIMEVE

ABSTRAKT

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ose ndryshe SME-të (small medium enterprises) padyshim luajnë një rol kyç në rritjen ekonomike të vendit, duke u cilësuar edhe si gjeneratorët kryesorë në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave në ekonomi. Për këtë arsye, analizimi dhe studimi i tyre është i rëndësishëm për të kuptuar zhvillimet e ardhshme ekonomike të një vendi. Ky artikull ka për qëllim analizimin e zhvillimeve të SME-ve në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2011. Identifikimi i tendencave kryesore është mbështetur kryesisht në analizimin e gjashtë treguesve kryesorë që janë: numri i ndërmarrjeve, numri i të punësuarve, vlera e shtuar, produktiviteti i punës, norma e fitimit dhe prirja e tyre për të investuar. Rezultatet tregojnë që SME-të në Shqipëri kanë ndikuar në rritjen e numrit të të punësuarve dhe të vlerës së shtuar në ekonomi, gjatë periudhës 2006-2011, duke siguruar gjithashtu vlera pozitive fitimi në kohë. Prandaj, mbështetja dhe hartimi i politikave të përshtatshme mbetet si sfidë e ardhshme, për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

1. HYRJE

Elementë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi janë padiskutim njohuritë që zotëron kapitali human dhe niveli teknollogjik, të cilët cilësohen si nxitësit kryesorë të rritjes afatgjatë të ekonomisë së një vendi. Ky fakt është materializuar së shumti në konceptin e "knowledge based economy" dhe të rolit që kanë vetë SME-të në zhvillimin e mëtejshëm të vendit. "Small Business Act for Europe" në 2008, i shikon SME-të si promotorë të punësimit, të të ardhurave dhe të rritjes së mëtejshme ekonomike të vendit bazuar në kontributin e tyre në numrin e të punësuarve dhe të vlerës së shtuar. SME-të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të vendit, duke ndikuar në eficiencën e tregjeve, si dhe rritjen e të ardhurave, rezultate këto të konfirmuara edhe nga Komisioni Europian[1], në një studim të kryer për vendet e BE-së. SME-të në këto vende (BE-27), përbëjnë mesatarisht 99.8 % të të gjithë ndërmarrjeve duke punësuar mesatarisht dy të tretat e forcave të punës (KE, 2011). Rrjedhimisht, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) vlerësohen si lojtarë potencialë në mirëqënien e vendit dhe rritjes së punësimit, duke bërë që ato (SME-të) të shikohen si një pjesë e rëndësishme e strategjisë të Evropës 2020.

Duke patur parasysh rolin që kanë SME-të për ekonominë e vendit, përqasjet kryesore për analizimin e tyre janë përqasja multidimensionale (Schmiemann, 2009) dhe përqasja njëdimensionale. Meqenëse ndërmarrjet janë shumë heterogjene, jemi fokusuar kryesisht në përqasjen njëdimensionale

[1] *KE, 2011*

për analizimin e SME-ve në Shqipëri, duke u bazuar në ndarjen e tyre sipas madhësisë, ndarje kjo e përdorur edhe nga autorë të tjerë[2]. Kështu, sipas madhësisë ndërmarrjet janë ndarë në: ndërmarrjet mikro që punësojnë nga 1 deri në 4 persona, ndërmarrje e vogla që punësojnë nga 5 deri në 19 persona, ndërmarrje të mesme me nga 20 deri 79 persona, ndërsa ndërmarrjet e mëdha përfshijnë mbi 80 persona të punësuar.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është dhënia e tendencave kryesore të sektorit privat në Shqipëri, fokusuar në ndarjen e tyre sipas madhësisë gjatë periudhës 2006-2011, për të dhënë një këndvështrim të përgjithshëm mbi rolin e SME-ve në krijimin e vendeve të reja të punës, uljes së papunësisë dhe rritjes së vlerës së shtuar.

Bazuar në informacionin e vlefshëm nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, kemi klasifikuar si ndërmarrje SME në Shqipëri, të gjitha ato ndërmarrje që kanë një numër të punësuarish të barabartë ose më të vogël se 79, ndërsa ndërmarrje të mëdha janë ato që kanë një numër të punësuarish të barabartë ose më të madh se 80. Gjithashtu, si pjesë e analizës janë edhe ndryshimet ndërsektoriale bazuar pikërisht në ndarjen e ndërmarrjeve sipas madhësisë.

Artikulli është strukturuar në këtë mënyrë: Seksioni i dytë paraqet një përmbledhje të treguesve kryesorë që kemi analizuar, seksioni i tretë paraqet një përmbledhje të shkurtër të tendencave kryesore, rezultateve dhe të analizës së detajuar mbi ecurinë e ndërmarrjeve të ndara sipas madhësisë së tyre, së fundi janë dhënë disa përfundime.

2. TË DHËNAT

Baza kryesore e të dhënave për analizimin e SME-ve përfshin informacionin e marrë nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve në Shqipëri, publikuar nga INSTAT. Ky anketim analizon ecurinë e ndërmarrjeve kryesore në Shqipëri, të lokalizuara në disa nga qytetet kryesore, duke mos përfshirë informacionin mbi institucionet financiare bankare dhe jo-bankare, nga institucionet arsimore dhe ato shëndetësore. Ndërmarrjet i kemi analizuar të agreguara, por gjithashtu edhe në nivel sektori, kryesisht: sektori i industrisë, sektori i ndërtimit, sektori i transport-komunikacionit, sektori i tregtisë dhe sektori i shërbimeve.

Ashtu siç e përmendëm edhe në fillim, ky artikull mbështetet në analizën e gjashtë treguesve kryesorë që janë: numri i ndërmarrjeve, numri i personave të punësuar, vlera e shtuar bruto, produktiviteti i punës, norma e fitimit, si dhe prirja për të investuar. Më poshtë do të gjeni një përshkrim më të detajuar të secilit tregues dhe informacionin apo tendencën që synojmë të vlerësojmë nëpërmjet tyre.

Numri i ndërmarrjeve është një tregues që përdoret gjërësisht për të kapur

[2] *Për më tepër, referojuni materialit "Key figures on European business with a special feature on SMEs", KE, 2011.*

të ashtëquajturin nivelin e "shpirtit" sipërmarrës të një vendi. Megjithatë, ky tregues ka kufizimet e tij, pasi paraqet nga ana sasiore numrin e ndërmarrjeve në një vend, por nuk paraqet efektivitetin dhe eficiencën e tyre. Numri i personave të punësuar paraqet aftësinë që ka secili sektor ose ndërmarrje për të krijuar vende të reja pune, por gjithashtu shërben për të analizuar edhe strukturën e gjithë punësimit në ekonomi, si dhe shpërndarjen e tyre sipas sektorëve, matur kryesisht në terma të ndërmarrjeve të vogla përkundrejt ndërmarrjeve të mëdha. Vlera e shtuar bruto është një tregues, që ndryshe nga dy treguesit e parë, është edhe më i plotë, pasi mund të përdoret si një matës i produktivitetit që paraqet diferencën midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm, për çdo njësi të prodhuar, mbas heqjes të gjithave taksave dhe kostove. Produktiviteti i punës është llogaritur si raport i vlerës së shtuar bruto me numrin e të punësuarve. Ky tregues në fakt është një tregues i përgjithshëm i produktivitetit, i cili mat fizikisht se çfarë ndodh me nivelin e prodhimit, për numër të punësuarish. Shkalla e rentabilititetit përfaqëson performancën e ndërmarrjeve, e llogaritur si raport i fitimit neto ndaj të ardhurave totale. Ky tregues përdoret për të matur aftësinë e ndërmarrjeve për të mbijetuar, duke matur në këtë mënyrë eficiencën e ndërmarrjeve. Prirja për të investuar është llogaritur si raport i investimeve bruto ndaj vlerës së shtuar bruto për të analizuar në këtë mënyrë zhvillimet e ardhshme të sektorit, bazuar në prirjen e ndërmarrjeve për të investuar.

Seksioni i mëposhtëm paraqet një përmbledhje kryesore të tendencave të SME-ve përkundrejt ndërmarrjeve të mëdhave në Shqipëri, bazuar në treguesit e sipërpërmendur.

3. TENDENCAT KRYESORE TË NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI

Nga një vështrim i përgjithshëm i të dhënave (Tabela 1) vërejmë se SME-të në Shqipëri përbëjnë mesatarisht 99.6 % të totalit të ndërmarrjeve në vend, një shifër kjo pothuajse stabël gjatë gjithë periudhës 2006-2011. Ndërmarrjet mikro, të cilat punësojnë mesatarisht nga 1 deri në 4 punëtorë duket se janë ndërmarrjet tipike në Shqipëri duke përbërë mesatarisht 91 % të tregut të ndërmarrjeve në Shqipëri. Ndërsa, ndërmarrjet e mëdha, përbëjnë një pjesë shumë të vogël të totalit të ndërmarrjeve, duke zënë vetëm 0.38 % të totalit të tyre.

Në terma të punësimit, SME-t punësojnë mesatarisht 71.3 % të totalit të punësuarve në sektorin privat jofinanciar të ekonomisë, ndërsa ndërmarrjet e mëdha punësojnë vetëm 28.7 %. Kurse, në terma të vlerës së shtuar situata është pak më ndryshe, ku ndërmarrjet e mëdha kontribuojnë mesatarisht në 45.84 % të totalit të vlerës së shtuar, ndërsa SME-t në 54.16 % të totalit të vlerës së shtuar. Gjithashtu, kemi parë edhe shpërndarjen e SME-ve sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë gjatë periudhës 2006-2011 (Tabela 2[3]).

[3] *Duke qenë se ndryshimet midis periudhash janë marxhinale kemi paraqitur vetëm të dhënat për vitin 2011, ndërkohë që pjesa e plotë e të dhënave gjendet në fund të materialit, tabela 7-A, B shtjoca 1.*

Tabela 1. Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar në Shqipëri, 2006-2011.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
		Numri i ndërmarrjeve				
Mikro	51,045	57,239	63,388	67,471	68,616	71,371
Të vogla	3,500	4,201	4,303	4,746	5,080	5,374
Të mesme	910	976	1,094	1,209	1,348	1,362
SME	55,455	62,416	68,785	73,426	75,044	78,107
Të mëdha	195	241	260	276	317	322
Total	55,650	62,657	69,044	73,702	75,361	78,429
SME (% ndaj totalit)	99.65	99.62	99.62	99.63	99.58	99.59
Të mëdha (% ndaj totalit)	0.35	0.38	0.38	0.37	0.42	0.41
Total	100	100	100	100	100	100
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
		Numri i të punësuarve				
Mikro	79,547	87,906	93,057	97,525	105,194	103,512
Të vogla	30,788	35,204	37,975	40,500	44,703	46,342
Të mesme	34,334	36,771	39,271	42,886	48,340	49,636
SME	144,669	159,881	170,303	180,911	198,238	199,490
Të mëdha	57,522	66,735	70,088	71,314	75,790	81,647
Total	202,191	226,616	240,391	252,226	274,028	281,137
SME (% ndaj totalit)	71.55	70.55	70.84	71.73	72.34	70.96
Të mëdha (% ndaj totalit)	28.45	29.45	29.16	28.27	27.66	29.04
Total	100	100	100	100	100	100
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
		Vlera e shtuar (Mil lekë)				
Mikro	41,986	47,103	51,497	56,226	57,915	60,039
Të vogla	30,248	38,900	34,603	50,465	60,002	58,973
Të mesme	26,159	35,298	43,021	47,046	66,525	67,295
SME	98,393	121,301	129,120	153,737	184,443	186,307
Të mëdha	87,578	104,972	143,735	112,474	156,675	127,844
Total	185,971	226,273	272,855	266,211	341,118	314,151
SME (% ndaj totalit)	52.91	53.61	47.32	57.75	54.07	59.30
Të mëdha (% ndaj totalit)	47.09	46.39	52.68	42.25	45.93	40.70
Total	100	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Tabela 2. Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar për të gjithë sektorët, në bazë të përmasave të ndërmarrjeve, viti 2011[4].

Sektorët kryesorë	2011		
Industria	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali i Industrisë (%)
Numri i ndërmarrjeve	12.4	0.2	12.6
Numri i të punësuarve	14.8	16.2	31.1
Vlera e shtuar	11.0	21.7	32.7
Tregtia	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali i Tregtisë (%)
Numri i ndërmarrjeve	45.6	0.0	45.6
Numri i të punësuarve	24.4	1.6	26.0
Vlera e shtuar	22.9	1.7	24.6
Sherbimet	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali i Shërbimeve (%)

[4] *Shënim: Çdo tregues është shprehur në përqindje ndaj totalit të numrit të ndërmarrjeve, numrit të punësuarve dhe vlerës së shtuar për të gjithë sektorët.*

Numri i ndërmarrjeve	25.4	0.1	25.4
Numri i të punësuarve	16.1	4.2	20.3
Vlera e shtuar	8.8	2.4	11.2
Ndertimi	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali i Ndërtimit (%)
Numri i ndërmarrjeve	4.7	0.1	4.8
Numri i të punësuarve	10.1	2.2	12.3
Vlera e shtuar	12.1	3.5	15.7
Transp.Komunikacioni	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali i Transp.Komunikacionit (%)
Numri i ndërmarrjeve	11.6	0.0	11.6
Numri i të punësuarve	5.5	4.8	10.4
Vlera e shtuar	4.5	11.3	15.8
Totali i Sektorëve	SME (%)	Të mëdha (%)	Totali (%)
Numri i ndërmarrjeve	99.6	0.4	100.0
Numri i të punësuarve	71.0	29.0	100.0
Vlera e shtuar	59.3	40.7	100.0

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Sipas të dhënave të analizuara, vërehet se pjesa më e madhe e SME-ve gjatë vitit 2011 është përqëndruar kryesisht tek sektori i tregtisë dhe sektori i shërbimeve. SME-të e këtyre sektorëve përbëjnë përkatësisht 45.6 % dhe 25.4 % të totalit të ndërmarrjeve. Ndërkohë, që në sektorin e industrisë, telekomunikacionit dhe ndërtimit, SME-të përbëjnë përkatësisht 12.4 %, 11.6 % dhe 4.7 % të totalit të ndërmarrjeve të sektorit privat jo-financiar. Edhe sipas numrit të punësuarve evidentohet se SME-të në sektorin e tregtisë dhe në sektorin e shërbimeve, kontribuojnë më shumë në krahasim me sektorët e tjerë. Kurse në terma të vlerës së shtuar, sektori i industrisë rezulton me kontribut më të lartë, përkundrejt sektorëve të tjerë, si rezultat i veprimtarisë së ndërmarrjeve të mëdha përkundrejt SME-ve.

Një fakt interesant është që pavarësisht rritjes totale të numrit të punësuarve, vihet re një rënie e numrit të punësuarve për ndërmarrje (Tabela 3), si për SME-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Kështu nga 2.61 punëtor për ndërmarrje gjatë vitit 2006, vihet re një rënie graduale në 2.55 të punësuarve për punëtor tek SME-të në vitin 2011, ku rënien më të madhe SME-të e kanë patur gjatë vitit 2009. Megjithatë, duke patur parasysh peshën e të punësuarve të SME-ve ndaj totalit të punësuarve, ndryshimet marxhinale janë shumë të rëndësishme për totalin e të punësuarve dhe të ndërmarrjeve. Ndërkohë, për sa i përket ndërmarrjeve të mëdha, ato kanë punësuar 253.6 punëtor për ndërmarrje në 2011, nga 295 punëtor për ndërmarrje në 2006, ndërsa numrin më të ulët të të punësuarve, ndërmarrjet e mëdha e kanë reflektuar më së shumti gjatë vitit 2010.

Tabela 3. Madhësia e ndërmarrjeve, bazuar në numrin mesatar të punëtorëve për ndërmarrje.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	2.61	2.56	2.48	2.46	2.64	2.52
Të mëdha	294.98	276.91	269.94	258.33	238.79	253.56

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Një tjetër komponent i analizuar është struktura e të punësuarve për ndërmarrje, bazuar në kriteret e punësimit të tyre. Kështu, nëse për të gjithë sektorin privat janë punësuar mesatarisht 3.5 punëtor për ndërmarrje, 30 % e tyre janë të vetëpunësuar dhe 70 % të punësuar me pagesë. Ndërsa të ndarë sipas gjinive, vihet re një pjesmarrje më e ulët e të punësuarve femra, mesatarisht vetëm një punonjëse femër për ndërmarrje, strukturë kjo e mbetur e pandryshuar për të gjithë periudhën e marrë në shqyrtim.

Grafik 1. Struktura e të punësuarve në sektorin privat jofinanciar.



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Një tjetër evidencë lidhet edhe me nivelin e pagave dhe divergjencat që ekzistojnë midis ndarjeve sipas madhësisë dhe sektorëve. Kështu, vërehet që ndërmarrjet mikro pavarësisht se punësojnë pjesën më të madhe të individëve, mesatarja e pagës për të punësuar në këto ndërmarrje është pothuajse 8 herë më i ulët se mesatarja e pagës për të punësuar në ndërmarrjet e mëdha. Ndërsa, SME-të kanë mesatarisht një nivel page për të punësuar pothuajse 1.5 herë më të vogël se mesatarja e pagës për të punësuar për ndërmarrjet e mëdha, ku një faktor i rëndësishëm ka të bëjë edhe me intensitetin e përdorimit të kapitalit të secilit sektor. Bazuar në nivel sektorësh[5] gjatë vitit 2011, ndërmarrjet e mëdha, kryesisht të sektorit të transportit, paguhen 1.7 herë më shumë se totali i ndërmarrjeve, ndërsa SME-të e të gjithë sektorëve paguhen pothuajse 50 % më pak se te ndërmarrjet e mëdha.

Grafik 2. Paga mesatare mujore sipas përmasave të ndërmarrjeve.



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Duke marrë parasysh rëndësinë që kanë SME-të në të gjithë ekonominë, është e rëndësishme të shihet se si ato kanë performuar gjatë kësaj periudhe, si dhe impakti që ka patur kriza e fundit në performancën e tyre. Në vijim, do të paraqesim një analizë më të hollësishme për normat e rritjes së numrit të ndërmarrjeve, numrit të personave të punësuar, vlerës së shtuar bruto, produktivitetit të punës, si dhe normës së fitimit dhe prirjes për të investuar gjatë periudhës 2007-2011.

Tabela 4. Normat e rritjes së ndërmarrjeve, numrit të punësuarve dhe vlerës së shtuar.

	Mikro	Të vogla	Të mesme	SME	Të mëdha	Total
Ndërmarrjet (normat e rritjes %)						
2007	12.1	20.0	7.3	12.6	23.6	12.6
2008	10.7	2.4	12.1	10.2	7.7	10.2
2009	6.4	10.3	10.5	6.7	6.3	6.7

[5] *Referojuni figurës 4, në shtojcën 1.*

2010	1.7	7.0	11.5	2.2	15.0	2.3
2011	4.0	5.8	1.0	4.1	1.5	4.1
Të punësuarit (normat e rritjes %)						
2007	10.5	14.3	7.1	10.5	16.0	12.1
2008	5.9	7.9	6.8	6.5	5.0	6.1
2009	4.8	6.6	9.2	6.2	1.7	4.9
2010	7.9	10.4	12.7	9.6	6.3	8.6
2011	-1.6	3.7	2.7	0.6	7.7	2.6
Vlera e shtuar (normat e rritjes %)						
2007	12.2	28.6	34.9	23.3	19.9	21.7
2008	9.3	-11.0	21.9	6.4	36.9	20.6
2009	9.2	45.8	9.4	19.1	-21.7	-2.4
2010	3.0	18.9	41.4	20.0	39.3	28.1
2011	3.7	-1.7	1.2	1.0	-18.4	-7.9

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Bazuar në normat e rritjes së numrit të ndërmarrjeve, numrit të punësuarve dhe vlerës së shtuar vihet re se SME-të janë karakterizuar me norma pozitive rritjetje të këtyre treguesve, duke treguar qartë për kontributin e tyre në punësim, nivelin sipërmarrës së tyre dhe vlerës së shtuar, duke patur parasysh edhe peshën që zënë ato ndaj totalit të ndërmarrjeve. Viti 2011, duket se karakterizohet nga normat më të ulëta të rritjes së punësimit nga SME-të, rezultat i shkaktuar nga normat negative të rritjes në ndërmarrjet mikro, që punësojnë mesatarisht 40 % të totalit të të punësuarve të sektorit privat jo-financiar. Ndërsa në vlerat negative të rritjes së vlerës së shtuar, më së shumti ndikon kontributi negativ i ndërmarrjeve të mëdha, përkundrejt kontributit pozitiv të SME-ve.

Gjithashtu, kemi parë edhe produktivitetin e punës llogaritur si raport i vlerës së shtuar ndaj numrit të punësuarve. Vihet re se ndërmarrjet e mëdha karakterizohen nga një nivel më i lartë i produktivitet të punës për të gjithë periudhën 2006-2011. Ndërsa në nivel sektori, produktivitet më të lartë kanë ndërmarrjet e mëdha të sektorit të transportit përkundrejt sektorëve të tjerë, pothuasje gjatë gjithë periudhës së marrë në shqyrtim[6].

Grafik 3. Produktiviteti i punës sipas madhësisë dhe sektorëve.



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

[6] *Për të dhënat totale të produktivitetit në nivel sektori referojuni figurës 5 në shtojcën 1.*

Përveç treguesve të mësipërm, kemi analizuar edhe besimin e bizneseve në zhvillimet e ardhshme ekonomike, duke parë nivelin e investimeve të ndërmarrjeve, më konkretisht prirjen e tyre për investim sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sektorit ku bëjnë pjesë. Rezultatet e marra tregojnë që mesatarisht ndërmarrjet mikro kanë një nivel më të ulët të prirjes së investimit përkundrejt ndërmarrjeve të tjera. Kurse ndërmarrjet mesatare dhe ndërmarrjet e mëdha kanë pothuajse të njëjtën nivel të prirjes për investim. Ndikimi i krizës financiare dhe ekonomike duket që është shfaqur me një prirje më të ulët për invetimeve, që nga viti 2008, pothuajse për të gjithë tipet e ndërmarrjeve (Tabela 5). Ndërsa në nivel sektori[7], të dhënat e vitit 2011 tregojnë që sektori i industrisë dhe ndërtimit kanë nivel më të lartë të prirjes për investim duke shënuar një investim përkatësisht prej 64.5 % dhe 36.9 % të vlerës së shtuar të tyre. Kurse sektori i tregtisë ka prirjen më të ulët për investim, me vetëm 17.5 % të vlerës së shtuar të tyre.

Tabela 5. Prija për investim sipas madhësisë së ndërmarrjeve (në përqindje).

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Mikro	8.8%	11.2%	13.4%	23.1%	9.6%	9.0%
Të vogla	29.4%	55.4%	33.4%	36.6%	31.6%	43.5%
Të mesme	52.0%	44.3%	58.2%	28.1%	26.4%	29.1%
SME	26.6%	35.0%	33.7%	29.1%	22.8%	27.2%
Të mëdha	61.4%	34.8%	31.9%	43.5%	27.9%	59.1%
Total	43.0%	34.9%	32.7%	35.2%	25.1%	40.2%

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Padyshim që prirja për investim e çdo ndërmarrjeje varet nga niveli i fitimit i secilës ndërmarrje, ku fitimet konsiderohen si një burim i rëndësishëm i investimeve të ardhshme. Normën e fitimit e kemi llogaritur në raport me të ardhurat totale. Rezultatet tregojnë për vlera pozitive dhe në rritje të fitimit gjatë gjithë periudhës 2006-2011. Ndërmarrjet mikro duket që kanë një normë më të lartë të fitimit ndaj totalit të të ardhurave përkundrejt gjithë ndërmarrjeve të tjera. Gjatë vitit 2011, rezulton që SME-të kanë normë fitimi më të lartë se ndërmarrjet e mëdha, pra tregon se ato kanë përformuar më mirë përkundrejt ndërmarrjeve të mëdha, dhe se kanë tendencë për të investuar më shumë gjatë vitit 2012.

Përsa i përket të dhënave në nivel sektori[8], norma e fitimit, si raport ndaj të ardhurave sugjeron se gjatë gjithë periudhës 2006–2011, SME-të e sektorit të shërbimeve, tregtisë dhe të sektorit të industrisë kanë shfaqur norma pozitive të fitimit mesatarisht më të larta se ndërmarrjet e mëdha në këta sektorë. Kurse ndërmarrjet e mëdha kanë performuar mesatarisht më mirë se SME-të në terma të normës së fitimit, kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe atë të transport telekomunikacionit. Një fotografim i vitit 2011, tregon që të gjitha SME-të e të gjithë sektorëve kanë patur norma fitimi më të larta se ndërmarrjet e mëdha, duke treguar për një rritje të besimit të tyre në ekonomi dhe një prirje më të madhe për të investuar në të ardhmen.

[7] *Për të dhënat në nivel sektori, referojuni tabelës 8 në shtojcën 1.*
[8] *Tabela 9 në shtojcën 1.*

Tabela 6. Norma e fitimit sipas madhësisë së ndërmarrjeve (në përqindje).

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Mikro	15.0	16.0	16.6	16.3	16.2	18.0
Të vogla	7.1	6.9	6.7	8.3	9.6	8.0
Të mesme	6.0	7.0	8.4	7.8	9.0	8.6
SME	9.5	9.7	10.0	10.2	11.0	10.3
Të mëdha	15.3	16.2	15.0	9.4	14.4	6.5
Total	11.1	11.7	11.7	10.0	12.1	9.0

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

4. PËRFUNDIME

Nxitja dhe zhvillimi i SME-ve, veçanërisht mbas krizës, është bërë pjesë e strategjive të vendeve jo vetëm në zhvillim, por edhe vendeve anëtare në BE për të stimuluar rritjen e të punësuarve dhe të vlerës së shtuar. Bazuar në analizën e mësipërme, konstatojmë se përgjithësisht ndërmarrjet SME në Shqipëri, përbëjnë absolutisht pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, duke zënë 99.8 % të tregut. Ato kanë shfaqur tendencë rritjeje në numrin e ndërmarrjeve në ekonomi, duke ndikuar pozitivisht edhe në rritjen e numrit të të punësuarve. SME-të punësojnë mesatarisht 71.3 % të totalit të punësuarve të sektorit privat jo-financiar, si dhe sigurojnë mesatarisht 54.2 % të totalit të vlerës së shtuar. Në nivel sektorësh evidentojmë se SME-të janë përqëndruar kryesisht në sektorin e tregtisë dhe atë të shërbimeve. Një fakt interesant është që pavarësisht kontributit të tyre në punësim, të punësuarit në ndërmarrjet SME paguhen mesatarisht 1.5 herë më pak se ndërmarrjet e mëdha, ndërsa në ndërmarrjet mikro 8 herë më pak.

Përgjithësisht, përgjatë periudhës 2006–2011, SME-të janë karakterizuar nga efikasiteti si në vlerën e shtuar ashtu edhe në norma fitimi, megjithëse konstatohet një nivel më i ulët produktiviteti se ndërmarrjet e mëdha. Ndërsa, në nivel sektori, duket që produktiviteti i sektorit të transportit dhe komunikacionit ka udhëhequr produktivitetin e të gjithë sektorëve të tjerë për të gjithë periudhën 2006-2011. Edhe pse periudha e analizës së ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare përkon me periudhën e krizës ekonomike globale, kjo nuk ka penguar të paktën deri në periudhën që ne marrim në shqyrtim, aktivitetin privat si dhe prirjen e tyre për të investuar në bizneset e tyre, e cila tregon për një nivel besimi të ndërmarrjeve në zhvillimet e ardhshme ekonomike. Gjithashtu, vihet re se pavarësisht rritjes totale të të punësuarve, ka rënë numri i të punësuarve për ndërmarrje, si për SME-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Pavarësisht se ndryshimet e të punësuarve për ndërmarrjet e SME-ve janë marxhinale, ndikimi i tyre në punësim është i konsiderueshëm duke patur parasysh peshën e tyre në totalin e të punësuarve.

Të gjitha karakteristikat e sipërpërmendura, ofrojnë evidenca të qëndrueshme se SME-të kanë luajtur rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit në Shqipëri. Prandaj, në kushtet e pasigurive të shtuara edhe në arenën ndërkombëtare, kërkohet që pjesë e politikave të brendshme zhvëllimore të vendit të jetë hartimi i strategjive efiksase kombëtare për promovimin dhe stimulimin e SME-ve në Shqipëri.

REFERENCA

"The SME financing Gap", OECD publications, 2012
"Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve Ekonomike'', INSTAT (2007 – 2011)
"Key figures on European business with a special feature on SMEs", European Commission, 2011

"Small Bussines Fact Sheet Albania 2010/2011", European Commission and Entreprise and Industry.
"Enhancing SMEs Development in Albania; A study on Macro-Financial Soundness", Cooperazione Italiana allo Sviluppo, Ministero Affari Esteri and Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

F. Saliola and M. Seker (2011) "Total Factor Productivity Across the Developing World", International Finance Corporation, The World Bank Group.

Schmiemann, 2009, "Eurostat-statistics in focus, SME-s were the main drivers of economic growth, between 2004 and 2006".

SHTOJCA 1

Tabela 7-A: Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar për sektor në raport ndaj totalit të numrit të ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar, sipas përmasave të ndërmarrjeve.

		2006			2007			2008	
Industria	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	11.0	0.2	11.2	11.7	0.2	11.9	11.9	0.2	12.1
Numri i të punësuarve	15.4	19.4	34.7	15.4	18.7	34.1	14.9	17.6	32.5
Vlera e shtuar	8.9	21.3	30.2	9.5	17.6	27.1	8.5	24.4	32.9
		2006			2007			2008	
Tregtia	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	50.0	0.0	50.0	49.7	0.0	49.7	49.3	0.0	49.4
Numri i të punësuarve	24.0	0.7	24.7	24.7	1.2	25.9	25.3	1.5	26.8
Vlera e shtuar	18.7	2.2	20.9	21.0	2.0	23.0	16.7	1.6	18.3
		2006			2007		2008	2008	
Sherbimet	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	23.5	0.0	23.6	23.4	0.1	23.5	24.1	0.0	24.1
Numri i të punësuarve	14.9	2.2	17.1	14.4	2.5	16.8	14.5	2.1	16.6
Vlera e shtuar	8.0	2.0	10.0	7.9	1.8	9.7	7.6	1.5	9.0
		2006			2007			2008	
Ndërtimi	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	5.3	0.0	5.4	4.8	0.0	4.9	4.1	0.1	4.1
Numri i të punësuarve	12.6	1.8	14.4	11.3	2.8	14.1	11.2	3.6	14.8
Vlera e shtuar	12.9	2.2	15.0	11.2	6.5	17.7	9.7	8.6	18.3
		2006			2007			2008	
Tranp. Komunikacioni	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	9.8	0.0	9.9	10.0	0.0	10.0	10.2	0.0	10.3
Numri i të punësuarve	4.6	4.5	9.1	4.7	4.3	9.0	5.0	4.3	9.3
Vlera e shtuar	4.5	19.4	23.9	4.0	18.5	22.5	4.9	16.6	21.4
		2006			2007			2008	
Totali i sektorëve	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	99.7	0.3	100.0	99.6	0.4	100.0	99.6	0.4	100.0
Numri i të punësuarve	71.6	28.4	100.0	70.6	29.4	100.0	70.8	29.2	100.0
Vlera e shtuar	52.9	47.1	100.0	53.6	46.4	100.0	47.3	52.7	100.0

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve

Tabela 7-B: Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar për sektor në raport ndaj totalit të numrit të ndërmarrjeve, të punësuarve dhe vlerës së shtuar, sipas përmasave të ndërmarrjeve.

		2009			2010			2011	
Industria	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	11.3	0.2	11.5	12.0	0.2	12.2	12.4	0.2	12.6
Numri i të punësuarve	14.6	16.3	30.9	15.3	15.7	31.0	14.8	16.2	31.1
Vlera e shtuar	9.4	13.0	22.5	9.8	26.2	36.1	11.0	21.7	32.7
		2009			2010			2011	
Tregtia	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	48.3	0.0	48.4	46.7	0.0	46.7	45.6	0.0	45.6
Numri i të punësuarve	25.2	1.5	26.7	24.4	1.5	25.9	24.4	1.6	26.0
Vlera e shtuar	23.0	1.5	24.5	17.7	1.7	19.4	22.9	1.7	24.6
		2009			2010			2011	
Sherbimet	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	24.6	0.1	24.7	25.5	0.1	25.6	25.4	0.1	25.4
Numri i të punësuarve	15.3	3.1	18.3	15.4	3.9	19.4	16.1	4.2	20.3
Vlera e shtuar	9.0	1.8	10.8	8.6	1.9	10.4	8.8	2.4	11.2
		2009			2010			2011	
Ndertimi	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	4.4	0.1	4.5	4.0	0.1	4.1	4.7	0.1	4.8
Numri i të punësuarve	11.4	3.2	14.5	10.2	2.5	12.7	10.1	2.2	12.3
Vlera e shtuar	12.2	8.4	20.6	13.4	5.2	18.7	12.1	3.5	15.7
		2009			2010			2011	
Tranp. Komunikacioni	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	11.0	0.0	11.0	11.4	0.0	11.4	11.6	0.0	11.6
Numri i të punësuarve	5.3	4.2	9.5	7.0	4.1	11.0	5.5	4.8	10.4
Vlera e shtuar	4.1	17.5	21.6	4.5	10.9	15.4	4.5	11.3	15.8
		2009			2010			2011	
Totali i Sektorëve	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total	SME	Të mëdha	Total
Numri i ndërmarrjeve	99.6	0.4	100.0	99.6	0.4	100.0	99.6	0.4	100.0
Numri i të punësuarve	71.7	28.3	100.0	72.3	27.7	100.0	71.0	29.0	100.0
Vlera e shtuar	57.7	42.3	100.0	54.1	45.9	100.0	59.3	40.7	100.0

Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve

Grafik 4. Paga mujore për punëtor, nivel sektori në 2011.



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Grafik 5. Produktiviteti i punës sipas përmasave të ndërmarrjeve në nivel sektori.



Burimi: INSTAT, llogaritje të autorëve.

Tabela 8. Prirja për investim sipas sektorëve, (viti 2011).

	Industria	Tregtia	Shërbimet	Ndërtimi	Transporti
Mikro	14.0	6.6	6.1	62.1	4.5
Të vogla	73.4	22.0	117.5	28.0	18.3
Të mesme	33.8	22.5	18.4	36.2	11.4
SME	41.6	15.5	38.2	34.4	10.2
Të mëdha	76.1	43.5	25.4	45.3	40.5
Total	64.5	17.5	35.5	36.9	31.8

Tabela 9. Norma e fitimit ndaj të ardhurave sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

			Industria			
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	9.1%	8.9%	10.3%	13.6%	12.9%	10.5%
Të mëdha	9.7%	11.3%	6.4%	-1.7%	18.4%	5.9%
Totali	9.4%	10.2%	7.8%	4.3%	16.4%	7.6%
			Ndërtimi			
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	14.4%	13.7%	14.0%	14.4%	20.0%	18.5%
Të mëdha	14.9%	22.9%	24.1%	15.2%	19.3%	13.1%
Totali	14.5%	16.3%	17.6%	14.6%	19.8%	17.2%
			Transporti e Komunikacioni			
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	13.4%	13.4%	16.9%	16.4%	18.4%	17.3%
Të mëdha	32.4%	33.4%	41.2%	30.5%	16.7%	8.5%
Totali	27.3%	27.2%	32.2%	26.8%	17.2%	11.4%
			Tregtia			
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	6.6%	7.3%	7.5%	7.0%	6.7%	7.7%
Të mëdha	2.5%	3.5%	2.9%	1.5%	2.6%	4.3%
Totali	6.3%	6.8%	6.9%	6.4%	6.1%	7.2%
			Shërbimet			
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
SME	12.2%	11.4%	12.4%	14.1%	16.7%	14.7%
Të mëdha	10.4%	14.5%	11.5%	4.0%	18.6%	7.2%
Totali	11.5%	12.7%	11.9%	9.3%	17.6%	11.0%

"DEPOZITAT NË VALUTË DHE TENDENCAT MË TË FUNDIT TË EUROIZIMIT"

OLTA MANJANI
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

HYRJE

Sistemi bankar shqiptar është karakterizuar vazhdimisht nga norma të larta të euroizimit, si të mjeteve ashtu edhe të detyrimeve financiare të sistemit bankar. Një nga mënyrat klasike të matjes së euroizimit/ dollarizimit të sistemit bankar është raporti i depozitave në valutë ndaj parasë së gjerë. Në rastet kur ky raport qëndron mbi 30%, sistemi bankar përkatës konsiderohet si një sistem me euroizim të lartë (Balino et al, 1999). Në këtë këndvështrim, sistemi bankar shqiptar në mënyrë të vazhdueshme në këto 5-6 vitet e fundit ka patur një raport më të lartë se ky *benchmark*, duke e klasifikuar kështu sistemin bankar shqiptar në vendet me euroizim të lartë. Raporti i depozitave në valutë ndaj stokut të depozitave në total ka shënuar vazhdimisht norma të larta dhe në rritje dhe aktualisht depozitat në valutë përbëjnë thuajse gjysmën e shumës së stokut total.

Me shfaqjen e krizës financiare globale dhe përhapjen e efekteve të saj në vend, tremujori i fundit i vitit 2008 dhe gjysma e parë e vitit 2009 njohën rrjedhje të një pjese të depozitave nga sistemi bankar. Fenomeni i tërheqjes së depozitave preku në një masë më të madhe stokun e depozitave në valutë. Rrjedhimisht, këto zhvillime ndikuan edhe në strukturën e parasë së gjerë, ku u vu re një rënie e raportit të depozitave në valutë ndaj M3 në muajin korrik'09 në 31.0%, norma më e ulët e shënuar gjatë këtyre 5 viteve. Megjithatë, me rikthimin e depozitave në sistemin bankar dhe rimëkëmbjen e plotë të stokut

Grafik 1. Ecuria e euroizimit sipas treguesve kryesorë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

total, ky raport ka ndjekur në mënyrë konsistente një trajektore rritëse. Në fund të vitit 2012, depozitat në valutë ndaj agregatit M3 shënojnë 40.4%.

DISA FAKTORË ME NDIKIM NË NORMËN E EUROIZIMIT

Euroizimi i lartë dhe shkaqet e këtij fenomeni kanë qenë vazhdimisht në fokus të analizave në shumë vende të botës, sikurse dhe në qendër të materialeve të ndryshme të Bankës së Shqipërisë. Teoria sugjeron se në vijim të episodeve të tilla si regjistrimi i normave të larta të inflacionit ose nënçmimi i papritur i monedhës vendase[1] – kur monedha vendase nuk përmbush plotësisht një ndër funksionet e saj si ruajtëse të vlerës – agjentët ekonomikë si bankat apo klientët e tyre, në mënyrë spontane, bëjnë një zhvendosje të një pjese të biznesit apo mjeteve të tyre financiare nga monedha vendase në monedhë të huaj[2]. Kështu, normat e larta të inflacionit në fillim të viteve '90 kanë qenë përcaktuesit e këtij fenomeni në origjinë. Por, edhe me stabilizimin e normave të inflacionit dhe ekuilibrave të tjerë makroekonomikë, përdorimi i parasë në valutë për arsye transaksionesh pranohet gjerësisht, ndërkohë që faktorë të tjerë kanë marrë rëndësi në rritjen e normës së euroizimit. Në të njëjtën kohë, me hapjen e tregjeve dhe lëvizjes së lirë të mallrave dhe kapitalit, flukset valutore të bilancit të pagesave u rritën me ritme të shpejta. Kështu, një faktor përcaktues në mbajtjen e një pjese të madhe të kursimeve të agjentëve ekonomikë në monedhë të huaj ishin dhe flukset e kursimeve të emigrantëve shqiptarë në vendet fqinje, si Greqia dhe Italia, drejtuar familjeve të tyre në formën e remitancave, të cilat në pjesën më të madhe janë ruajtur në monedhë origjinale. Kreditimi i lartë në monedhë të huaj është një tjetër faktor me ndikim në rritjen e normës së euroizimit, i cili "ushqyer" edhe nga niveli i lartë i depozitave në valutë, ka funksionuar vazhdimisht si një mekanizëm feedback-u në sistem. Nxitja e kërkesës për kredi për shkak të normave të ulëta të interesit në monedhë të huaj në krahasim me ato vendase, pritshmëritë për një kurs këmbimi të qëndrueshëm si dhe sjellja elastike e ofertës për përmbushjen e këtyre nevojave të tregut, janë gjithashtu pjesë e faktorëve me ndikim në këtë fenomen.

Përtej analizës së detajuar të faktorëve në origjinë dhe faktorëve që kanë ndikuar normën e lartë të euroizimit të sistemit bankar në vijimësi, ky material fokusohet kryesisht në tendencën e euroizimit pas përhapjeve të efekteve të krizës financiare globale në vend dhe synon të shqyrtojë në mënyrë përshkruese marrëdhënien midis zgjerimit të depozitave në valutë dhe rënies së parasë jashtë bankave në monedhë të huaj. Duke u bazuar në të dhënat e vrojtimeve mbi përbërjen e portofolit të mjeteve financiare të individëve, është arritur në përfundimin se së fundi, një pjesë e rritjes së depozitave në valutë të ka ardhur si pasojë e hyrjeve në sistemin bankar të një pjese të konsiderueshme të mbajtjeve të cash-it në euro të individëve.

---

[1] *Ose në përgjithësi luhatje të mëdha të kursit të këmbimit.*

[2] *Yeyati (2005) dallon midis euroizimit de jure (përdorimi i monedhës së huaj si mjet këmbimi zyrtar, legal tender) si dhe euroizimi de facto (përdorimi i monedhës së huaj përkrah monedhës vendase kur e para nuk përdoret si mjet këmbimi zyrtar).*

DEPOZITAT DHE PARAJA NË QARKULLIM NË VALUTË

Forcimi i besimit në sistemin bankar vërehet edhe në formën e shndërrimit të kursimeve të agjentëve ekonomikë nga mbajtja në formë cash, pra si para në "dorë", në mbajtjen e tyre si depozita në sistemin bankar. Sasia e saktë e parave në monedhë të huaj në një ekonomi në përgjithësi është e vështirë të përcaktohet (Hellerstein, Ryan 2011)[3], dhe vlerësimi për këtë tregues shoqërohet me një shkallë gabimi. Të dhënat mbi ecurinë e parasë jashtë bankave në monedhë të huaj mund të përftohen nga vrojtime të kryera me agjentët ekonomikë në vend (Luçi, Muço, Sojli 2005) ose me metoda të tjera të përdorura nga ekonomistët si metoda e matjes nga transporti fizik i monedhës (usd) në vende të tjera (Hellerstein, Ryan 2011), metoda e matjes së transfertave të parave nga jashtë (Feige et al 2002) dhe të tjera. Vrojtimet e përdorura në këtë material[4] kryhen rregullisht dy herë në vit, nëpërmjet intervistave me 1088 individë mbi moshën 15 vjeç. Përzgjedhja e kampionit kryhet me anë të procedurës së përzgjedhjes së rastësishme sipas shtresave. Ato përfshijnë vetëm vlerësimet për përdorimin e monedhës euro, si valuta më e përdorur jo vetëm në vendin tonë, por në të gjithë rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Kjo preferencë e individëve për mbajtje të larta të PJB-së në monedhën euro përputhet edhe me të dhënat statistikore të sistemit bankar, ku përgjithësisht stoku i depozitave në euro përbën rreth 80% të stokut total të depozitave në monedhë të huaj.

Grafik 2. Projeksione të parasë jashtë bankave në euro; indeksi i zëvendësimit të monedhës.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Banka e Austrisë.

Pavarësisht luhatjeve brenda vitit, të dhënat tregojnë për një tendencë rënëse të mbajtjeve të parasë në formën cash në euro nga agjentët ekonomikë në terma afatgjatë. Kjo prirje vërehet në ecurinë e raportit të PJB-së në euro

[3] *Autoriteti monetar ka si funksionon ekskluziv emetimin e monedhës vendase dhe si i tillë është në gjendje të përcaktojë dhe të masë vetëm paranë jashtë bankave në monedhë vendase; në rastin e Shqipërisë vetëm paranë jashtë bankave në lekë.*

[4] *Projeksionet për vlerësimin e parasë jashtë bankave në Shqipëri (dhe rajon) gjenden në materialet e publikuara nga banka e Austrisë në serinë e botimeve OeNB Euro Survey.*

për person dhe rrjedhimisht në vlerësimet për stokun total të parasë jashtë bankave në këtë monedhë. Në vjeshtën e vitit 2012[5], paraja në euro e mbajtur në formë likuide nga individët të cilët janë përgjigjur se mbajnë valutë në euro vlerësohet të jetë mesatarisht rreth 363 euro për person. Vlerësimet për mbajtjen e cash-it në euro për të gjithë popullsinë mbi 14 vjeç rezultojnë në 155 euro për person[6]. Në terma afatshkurtër, luhatjet e parasë jashtë bankave në euro reflektojnë nevojat për likuiditet të individëve në periudha të ndryshme gjatë vitit, ku vërehet një kërkesë më e lartë për para euro "në dorë", kryesisht gjatë periudhës së pranverës. Megjithatë, për shkak të historisë së shkurtër të kësaj serie si dhe kryerjes së vrojtimit dy herë në vit është ende i vështirë përcaktimi i një sjelljeje sezonale të PJB-së në euro.

Në fund të vitit 2007[7], indeksi i zëvendësimit të monedhës i matur si raport i parasë jashtë bankave në euro ndaj stokut total të parasë jashtë bankave – përfshirë dhe PJB-në në lekë – rezulton në rreth 39%. Në një periudhë 5-vjecare, ky raport është ulur me rreth 17 pikë përqindje dhe në fund të vitit 2012 paraja në euro e mbajtur në formën cash zë rreth 22% të PJB-së në total[8]. Stoku total i parasë jashtë bankave rezulton me rënie, por reduktimi i parasë cash në valutë të mbajtur nga individët relativisht me reduktimin e mbajtjeve të cash-it në lekë duket të jetë më i shpejtë.

Grafik 3. Ecuria e parasë jashtë bankave në euro dhe depozitave në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Banka e Austrisë* (*OeNB Euro survey).

Prirja në rënie e cash-it në euro duket të shoqërohet me një zgjerim të stokut të depozitave të individëve në valutë dhe nëpërmjet një korrelacioni të thjeshtë vërehet lidhja negative midis këtyre dy treguesve. Teoria sugjeron se norma e matur e euroizimit mund të shënojë rritje kur besimi në sistemin bankar

[5] *Në vrojtim, kjo periudhë përkon me muajt tetor-nëntor, ndërsa pranvera me muajt maj-qershor.*

[6] *Duhet mbajtur parasysh se këto vlerësime mund të kenë një anësi (bias) sistematik në kahun e poshtëm pasi në vrojtime të tilla agjentët ekonomikë për arsye të natyrës së ndjeshme të pyetjeve të pyetësorit janë të predispozuar të raportojnë më pak se vlerat reale.*

[7] *Përkon me periudhën e fillimit të serisë së vrojtimeve.*

[8] *Ky total përfshin vetëm monedhat lekë dhe euro. Përdorimi i monedhave të tjera vlerësohet të jetë i ulët dhe i papërfillshëm krahasimisht.*

është i lartë, duke ndikuar nga njëra anë zgjerimin e peshës së depozitave në valutë dhe nga ana tjetër rënien e parasë cash në valutë (Nicolo et al., 2003). Krahasuar me fundin e vitit 2007, totali i depozitave të individëve në sistemin bankar në monedhë të huaj është shtuar me rreth 210 miliardë lekë. Megjithëse me një ritëm më të ngadaltë, stoku total i parasë në euro që mbahet nga individët në formë likuide si para në qarkullim thuajse është përgjysmuar gjatë të njëjtës periudhë, duke pësuar një rënie me rreth 40 miliardë lekë, ose rreth 20% e fluksit të depozitave.

Përveçse një tregues i forcimit të besimit në sistemin bankar[9], këto zhvillime tregojnë edhe për një tendencë formalizimi të marrëdhënies së agjentëve ekonomikë me sistemin bankar. Rënia e përdorimit të parasë jashtë bankave është një shenjë pozitive pasi mundëson kontrollimin më të mirë të flukseve të parasë likuide, pra parasë me fuqi të lartë[10], në ekonomi. Ndër të tjera, kanalizimi i PJB-së në euro në sistemin bankar ka ndikuar gjithashtu në përmirësimin e likuiditetit valutor në këtë sektor. Një sistem bankar me likuiditet të bollshëm ka mundësi më të mëdha për rritjen e ndërmjetësimit të këtyre fondeve në ekonomi. Ndërmjetësimi financiar është i rëndësishëm për furnizimin e agjentëve ekonomikë me mjete monetare dhe plotësimin e nevojave të tyre për likuiditet, konsum apo investime. Ky "mision" bëhet akoma më i rëndësishëm sidomos pas vitit 2008, ku është vërejtur një ngadalësim konsistent i normave të ndërmjetësimit financiar.

NË VEND TË PËRFUNDIMEVE

Implikimet dhe pasojat e normës së lartë të eurozimit të mjeteve financiare të sektorit bankar në vend janë diskutuar në detaje nga Luçi, Muço Sojli (2005). Megjithatë, një zgjerim i stokut të depozitave në valutë ndikuar pjesërisht prej shndërrimit të një pjese të kursimeve të individëve nga para e mbajtur në formë cash në depozita në sistemin bankar është një zhvillim pozitiv dhe i mirëpritur. Kanalizimi i parasë likuide cash në sistemin bankar përveçse ndihmon në formalizimin dhe gjurmimin e flukseve valutore që janë të vështira për t'u vlerësuar nga ana sasiore, ndikon në forcimin e marrëdhënieve midis agjentëve ekonomikë dhe institucioneve financiare, uljen e informalitetit dhe në të njëjtën kohë përmirëson likuiditetin e sistemit bankar. Për më tepër, përtej avantazheve të zgjerimit të depozitave në valutë nëpërmjet këtij kanali, analizimi empirik i shkaqeve të euroizimit të sistemit bankar shqiptar mbetet një sfidë dhe mision për t'u përmbushur në materialet studimore në të ardhmen.

[9] *Kjo mbështetet edhe nga rënia graduale e raportit PJB/depozita në lekë pas korrik'09, kur shënoi dhe vlerën më të lartë të tij.*

[10] *Baza monetare ose paraja rezervë njihet ndryshe si paraja me fuqi të lartë dhe përfshin paranë jashtë bankave, si komponenti kryesor me një peshë aktuale mbi 60%, dhe rezervën e detyrueshme të bankave tregtare pranë autoritetit monetar.*

REFERENCA

Baliño, Tomas, Adam Bennett, and Eduardo Borensztein. 1999. Monetary Policy in Dollarized Economies. Occasional Paper 171. Washington, D.C.: International Monetary Fund.

Feige, E., Faulend, M., Sonje, V. Sosic, V. (2003): "Unofficial dollarization in Latin America: currency substitution, network externalities and irreversibility" in The Dollarization Debate, Oxford Press, pp. 46-71.

Levy-Yeyati, Eduardo. Financial Dollarization: Evaluating the consequences

Luçi, E., Muço, M., Sojli, E. (2006): "Euroisation in Albania: from spontaneous to consensual". WIIW Working Paper.

OeNB Euro Survey. The Euro in Central, Eastern and Southeastern Europe. Oesterrechische National Bank.

Rebecca Hellerstein, and William Ryan. October 2009. Revised February 2011. Cash Dollars Abroad. Staff report no. 400. Federal Reserve Bank of New York.

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR,

JANAR-QERSHOR 2013

Tryezë diskutimi me sistemin bankar dhe biznesin

Në kuadër të ndërtimit të një dialogu të vazhdueshëm partneriteti me aktorët e tregut, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Shoqatën Biznes Albania, organizoi në datën 4 mars 2013, forumin e radhës me temë: "Kreditimi i ekonomisë dhe shëndeti afatgjatë i sistemit bankar".

Gjatë punimeve të këtij forumi, pjesëmarrësit diskutuan mbi paketën e re të masave të hartuara nga Banka e Shqipërisë, e cila synon nxitjen e kreditimit nga ana e sistemit bankar.

Forumi financiar i Shqipërisë

Në datën 9 prill 2013, në Tiranë, u zhvillua mbledhja e parë e Forumit Financiar të Shqipërisë, një forum për bankat ndërkombëtare i organizuar nga vendi pritës. Mbledhja u zhvillua nën kujdesin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, dhe u organizua së bashku me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Forumi solli në një tryezë të përbashkët grupet bankare kryesore që veprojnë në Shqipëri, filialet e tyre, autoritetet mbikëqyrëse nga Austria, Franca,Turqia dhe Italia. Në këtë forum ishte i pranishëm dhe diskutoi Ministri i Financave Z. Ridvan Bode, si edhe përfaqësues të Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Autoritetit Evropian të Bankave dhe Bankës Qendrore Evropiane.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth perspektivës së ekonomisë dhe të sistemit financiar në Shqipëri, strategjive të bankave lokale, rolin e filialeve shqiptare në operacionet e grupeve bankare, si dhe ndikimin që kanë nismat më të gjera bankare ndërkombëtare. Gjithashtu, të pranishmit diskutuan edhe mbi sfidat me të cilat përballen pjesëmarrësit gjatë veprimtarisë së tyre. Një sesion i veçantë iu kushtua përmirësimit të ndërmjetësimit financiar në Shqipëri.

Mbi zgjedhjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani si anëtar në Komitetin Drejtues të Nismës së Vjenës II

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, duke nisur nga viti 2013, është zgjedhur anëtar i Komitetit Drejtues të Nismës së Vjenës II (Vienna Initiative II).

Duke qenë se Shqipëria, është i vetmi vend jo-anëtar i Bashkimit Evropian, që ka anëtarësi në Komitetin Drejtues të Nismës së Vjenës, është angazhuar të përfaqësojë interesat e vendeve që aspirojnë të bëhen pjesë e familjes evropiane. Në këtë kuadër, Shqipëria do të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Nisma e Vjenës II vijon aktivitetin e saj mbi suksesin e Nismës së Vjenës I, krijuar në kulmin e krizës financiare globale të periudhës 2008/2009. Ajo vazhdon të përdorë platformën privat-publik, që mbledh institucione financiare ndërkombëtare të rëndësishme, Komisionin Evropian dhe institucione të tjera të BE-së, grupet bankare ndërkombëtare kryesore, si dhe autoritetet e vendit të origjinës dhe atij pritës, në plotësim të nismave të tjera.

Shtrirja gjeografike e saj i kapërcen kufijtë e Bashkimit Evropian dhe përfshin vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe asaj Juglindore, me një prani tepër influencuese të bankave perëndimore.

Në këtë kontekst, objektivi i Nismës së Vjenës II, është sigurimi i ndihmës: për të shmangur uljen e ndërmjetësimit të çrregullt financiar (*deleveraging*); për zgjidhjen e çështjeve të stabilitetit financiar në nivel ndërkombëtar, si dhe për nxitjen e veprimeve politike aktive (policy actions), në veçanti në fushën e mbikëqyrjes, të cilat ndërmerren për të mirën e përbashkët të vendit të origjinës dhe të vendit pritës.

Mbi zhvillimin e aktivitetit të "Seminari i së Premtes" në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik

Në datë 16 prill 2013, në ambientet e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, nën kujdesin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, dhe dekanit të Fakultetit Ekonomik, z. Sulo Hadëri, u zhvillua aktiviteti "Seminari i së Premtes".

Në aktivitet morën pjesë pedagogë të Fakultetit Ekonomik, studentë si dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, të cilët prezantuan materialin me temë "Një model financiar për Shqipërinë: Përqasja me të dhënat në panel".

Diskutimet e mëtejshme të zhvilluara mbi modelet e ndryshme makroekonomike, aplikimin dhe rëndësinë e tyre në procesin e vendimmarrjes në rastin e Shqipërisë, përbëjnë tregues të fortë të përmbushjes së qëllimit të këtij seminari, duke shërbyer si urë lidhëse komunikimi midis dy institucioneve.

Aktivitete të Bankës së Shqipërisë dhe punonjësve të saj në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve jetimë

Në datë 27 maj 2013, Banka e Shqipërisë organizoi dy aktivitete me karakter social, humanitar dhe edukues në Shtëpinë e Foshnjës dhe në shtëpinë e fëmijëve "Zyber Hallulli", në Tiranë.

Këto aktivitete, së bashku me atë të organizuar në Shtëpinë e Foshnjës, në Shkodër, gjatë këtij muaji, organizohen në mbështetje të parimeve të Përgjegjësisë Shoqërore Institucionale, që Banka e Shqipërisë, si institucion qendror i vendit synon të reflektojë dhe promovojë. Të tilla kanë qenë: aktiviteti i vjetshëm i organizuar me rastin e 5 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, i zhvilluar në parkun "Rinia", nën moton "Ekonomia e gjelbër: A të përfshin edhe ty?", aktivitetet e ndryshme të organizuara me rastin e përvjetorëve të monedhës shqiptare etj..

Kështu, gjatë muajit maj 2013, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhuruan për fëmijët e shtëpive të foshnjës dhe fëmijëve në Tiranë e Shkodër veshje, lodra dhe kontribut monetar.

Gjatë aktivitetit në shtëpinë e fëmijëve "Zyber Hallulli", fëmijët patën mundësi të bashkëbisedonin me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani mbi konceptet themelore të lidhura me funksionet kryesore të institucionit që ai drejton dhe si Banka e Shqipërisë ndikon në jetën e çdo qytetari shqiptar.

Aktiviteti vijoji me prezantimin e paketës më të re mësimore të Bankës, për fëmijët që ndjekin klasën I, II dhe të III, të shkollës 9- vjeçare "1, 2, 3, ... derrkuci Çufo mëson të kursejë". Kjo paketë, e cila do të shpërndahet falas nga Banka e Shqipërisë në shkollat publike dhe private të vendit përmban një libërth me përralla me në qendër derrkucin Çufo, fletë pune dhe një udhëzues për mësuesit.

Mbi vizitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, z. Erdem Basçi, pranë Bankës Shqipërisë

Në datën 30 maj 2013, një delegacion i nivelit të lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, i kryesuar nga Guvernatori z. Erdem Baþçý, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë.

Gjatë takimit me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, u diskutua rreth zhvillimeve më të fundit në ekonomitë e dy vendeve. Guvernatori Fullani e njohu homologun e tij, me masat e marra nga Banka e Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Gjatë takimit, dy guvernatorët shprehën dakordësinë e tyre për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit dypalësh midis institucioneve, kryesisht në fushën e politikës monetare e të stabilitetit financiar.

Pas këtij takimi, dy guvernatorët morën pjesë në çeljen ekspozitës "Kohë dhe Vende, Stambolli" me piktura nga koleksioni i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë. Ekspozita qëndroi e hapur deri në datën 14 korrik 2013, në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve.

Seminari i të Premtes

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj të ashtuquajturin "Seminarin e së Premtes". Kjo nismë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2013, në aktivitetin "Seminarin e së Premtes", janë prezantuar 10 punime nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhe nga pjesëmarrës të botës akademike nga brenda dhe jashtë vendit. Tematika e materialeve të prezantuara në aktivitetin kërkimor shkencor, gjatë periudhës janar-korrik të vitit 2013, kanë të bëjnë me politikat fiskale dhe ato monetare, ciklet e biznesit dhe performaca e sektorit bankar, perceptimi i kulturës financiar etj.. Në rubrikën më poshtë do të gjeni një përmbledhje më të detajuar të këtyre materialeve.

"Seminari i së Premtes" për 6-mujorin e parë të vitit 2013, u hap me një punim të Gerti Shijakut nga Departamenti i Kërkimeve me temë: " Qëndrueshmëria fiskale në BE dhe vendet e tjera kandidate të mundshme". Ky material, ka në fokus vlerësimin e tipareve të kthimit të raportit të borxhit ndaj PBB-së drejt mesatares historike në afatin e gjatë në rajone të ndryshme për periudhën 2000 – 2011. Punimi shqyrton kushtin e aftësisë së shlyerjes nëpërmjet teknikave të testit të rrënjës njësi dhe vlerëson funksionin e reagimit

të politikës fiskale në 27 vendet anëtare të BE-së dhe ato kandidate, me metodën VAR në panel.

Prezantimi tjetër i mbajtur në këtë seminar është ai me temë: "Sinkronizimi i cikleve të biznesit: Një matje e integrimit për vendet e Evropës Juglindore", nga Endrit Yzeiraj, nga Departamenti i Kërkimeve. Ky material synon të masë nivelin e integrimit të ekonomive rajonale duke u bazuar në treguesit makroekonomik dhe përdor metodologjinë e dekompozimit të krijuar nga Blanchard dhe Quah (1989) nëpërmjet përdorimit të VAR-it strukturor. Gjenerimi i goditjeve nga ana e ofertës dhe e kërkesës në ekonomitë rajonale, tregojnë që lidhjet ndërmjet tyre janë relativisht të dobëta. Gjithashtu, rezultatet tregojnë se goditjet e kërkesës janë më të sinkronizuara se ato të ofertës, ku veprimi i kanalit tregtar, por jo i kanaleve të tjera strukturore mund të jetë faktori shpjegues i këtyre gjetjeve.

Një tjetër prezantim i mbajtur në këtë seminar ishte ai me temë: "Impakti i trendit stokastik të rritjes në fluktancionet ekonomike në Shqipëri", nga Bledar Hoda, nga Departamenti i Kërkimeve. Ky material analizon në kuadër të modeleve të ciklit të biznesit karakteristikat e treguesve kryesorë makroekonomikë nëse ato janë konsistentë me rritjen e balancuar të drejtuar nga produktiviteti, si dhe vlerësimit të rolit që luan cikli dhe trendi stokastik në rritjen ekonomike të vendit. Autori me anë të modelit strukturor të korrigjimit të gabimeve vlerëson se goditjet permanente të drejtuara nga trendet stokasitke shkaktojnë më shumë fluktacione përkundrejt një trendi gjeneruar nga metodat standarde të filtrave statistikorë.

Materiali tjetër i prezantuar është ai me temë: "Efekti i kurbës-J. Ndikimi i kursit të këmbimit në bilancin tregtar dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë tregtarë, nga Alban Pllaha nga Departamenti i Kërkimeve. Ky studim trajton ndikimin e kursit të këmbimit në shkëmbimet tregtare dypalëshe të Shqipërisë me partnerët e saj kryesorë si: Eurozona, Italia, Greqia, Gjermania dhe Turqia me qëllim vlerësimin e ekzistencës së "kurbës-J" në tregtinë bilaterale për periudhën 1998-2012. Nëpërmjet "Metodës së Korrektimit të Gabimit" (Error Correction Model) realizohet evidentimi i efekteve afatshkurtra dhe afatgjata që ka nënçmimi i monedhës vendase në bilancin tregtar dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë.

"Modeli financiar për Shqipërinë: Një përqasje me të dhëna në panel", është një tjetër prezantim i mbajtur në seminar nga Elona Dushku nga Departamenti i Kërkimeve dhe Vasilika Kota nga Departamenti i Stabilitetit Financiar. Ky material ka për qëllim prezantimin e një modeli financiar për Shqipërinë. Modeli bazuar në analizën e detajuar të bilanceve të totalit të bankave që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri, përmban gjithsej 35 ekuacione, nga të cilat 8 janë ekuacione të vlerësuar dhe 27 janë identitete. Variablat e vlerësuara me anë të metodës me panel janë: vëllimi i kredisë (ndarë për individët dhe bizneset), të ardhurat neto nga interesi, rreziku i aktivit të kredisë, norma e kredive të këqija (ndarë për individë dhe biznese), norma e interesit të kredisë, si dhe kostoja e kredisë ku analiza e simulimeve të ndryshme

vlerëson transmetimin e goditjeve kryesore në sektorin financiar dhe impaktin në ekonominë reale të vendit.

Një material tjetër i prezantuar është ai me temë "Globalizimi, regjimet e kursit të këmbimit dhe kontaminimi financiar" nga Branko Urošević, nga Banka Qendrore e Serbisë. Kriza e fundit financiare dëshmoi për brishtësinë e arkitekturës financiare ndërkombëtare, duke nxjerrë në pah dy çështje mjaft të rëndësishme nga pikëpamja e stabilitetit financiar që kanë të bëjnë me: nivelin optimal të ndërlidhjeve financiare midis vendeve, si dhe përcaktimin e regjimit të përshtatshëm të kursit të këmbimit midis vendeve, për të siguruar në këtë mënyrë stabilitetin financiar të shumë vendeve së bashku. Autori, për të kuptuar më mirë dy çështjet e ngritura më sipër, i adreson ato në mënyrë të njëkohshme në kuadër të modelit D-D.

"Duke parë mbi aspekte të tjera të PBC (ciklet politike të biznesit): Ciklet politike të biznesit dhe pritshmërisë" nga Drini Imami, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Holger Kächelein, nga Southeast Europe Center For Economic Development, si dhe Endrit Lami, kandidat Phd në Universitetin e Budapestit, është materiali i radhës i prezantuar në këtë aktivitet. Ky prezantim paraqiti disa nga rezultatet mbi punën kërkimore mbi Ciklet Politike të Biznesit në Shqipëri si dhe impakti i tyre në ekonomitë, duke parë në një fokus të veçantë edhe pritshmëritë mbi tregues të ndryshëm makroekonomikë. Rezultatet tregojnë që pritshmëritë më të mira për rritje ekonomike para zgjedhjeve politike dhe pritshmëritë mbi impaktin e tyre mbas zgjedhjeve mund të ndikojnë vendimet e firmave të sektorit privat.

Materiali i tjetër me temë: "Roli i parasë si një shtyllë e rëndësishme për politikën monetare: Rasti i Shqipërisë", nga Gerti Shijaku nga Departamenti i Kërkimeve, analizon rolin e parasë si një shtyllë e dytë e rëndësishme për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor, atë të stabilitetit të çmimeve. Fokusi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i funksionit të kërkesës për para dhe të shpejtësisë së qarkullimit të parasë së gjerë, M3 në afatin e mesëm dhe të gjatë. Rezultatet tregojnë se kërkesa për para është e qëndrueshme, edhe pas periudhës së krizës financiare dhe ekonomike, si dhe paraja përmban informacion të rëndësishëm për ecurinë e ardhshme të inflacionit.

Një prezantim tjetër është ai me temë "Performanca e parashikimit të inflacionit dhe vendimmarrja e politikës monetare gjatë 2011-2012" nga Evelina Çeliku dhe Genti Hashorva, nga Departamenti i Politikës Monetare. Studimi analizon ecurinë e procesit parashikues të inflacionit dhe të rolit të tij në vendimmarrjen e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës 2011-2012. Në material evidentohen sfidat kryesore me të cilat përballet projeksioni, kryesisht në periudha të pasigurive të larta ekonomike, duke u fokusuar në inflacionin e publikuar kundrejt parashikimeve, pritshmërive dhe formulimit të politikës monetare.

Materiali përmbyllës i serive të "Seminarit të së Premtes" për 6-mujorin e parë të vitit 2013, është ai me temë " Kultura financiare në Shqipëri: Rezultatet

e vrojtimit për matjen e nivelit të njohurive financiare të popullatës, 2011", nga Kliti Ceca, Borana Haxhimusaj nga Departamenti i Kërkimeve, Arlinda Kolenico dhe Egnis Isaku, nga Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit. Ky material prezantoi rezultatet e para marrë nga "Vrojtimi për matjen e kulturës financiare të popullatës në Shqipëri gjatë vitit 2011", organizuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës, financuar nga Bashkimi Evropian. Rezultatet e këtij vrojtimi, paraqesin disa nga tendencat kryesore mbi njohuritë financiare të zotëruara nga individët, mbi sjelljet dhe qëndrimet e mbajtura prej tyre mbi aspekte të ndryshme të administrimit të financave personale apo familjare në Shqipëri.

VENDIMET E POLITIKËS MONETARE

30 janar 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të ulë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interest, në 3.75%.

27 shkurt, 27 mars, 30 prill, 29 maj, 26 qershor 2013

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 3.75%.

NGJARJET JURIDIKE, JANAR-QERSHOR 2013

MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 1 rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka". Objekti kryesor i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për licencimin e subjekteve financiare jobanka, institucioneve financiare të mikrokredisë dhe të institucioneve të parasë elektronike për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja përcakton se e drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë/ve financiare lind vetëm pasi subjekti pajiset me licencë ose merr miratimin përkatës nga Banka e Shqipërisë.

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 2 rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka. Subjekte të saj janë subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike, të licencuar për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 4 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Societe Generale Albania sh.a. me subjektin financiar jobankë Sogelease Albania sh.a". Përmes këtij vendimi jepet miratimi paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Societe Generale Albania sh.a. (shoqëria përthithëse), me subjektin financiar jobankë Sogelease Albania sh.a (shoqëria e përthithur).

Në datën 27.03.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 26 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"". Ndryshimet e parashikuara në këtë vendim prekin, ndër të tjera, formularët e raportimit mbi llogaritjen e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, duke i bazuar klasat në "veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "veprimet me letrat me vlerë" jorezidente në valutë; mbi llogaritjen e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit; si dhe mbi shumën e zërave të aktivit, shumën e zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun përkatës dhe shumën e zërave të tjerë jashtë bilancit.

Në datën 27.03.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 27 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë"". Me miratimin e këtij vendimi, në rregullore ndryshon neni që rregullon kushtet dhe modalitetet e ristrukturimit të kredisë, si dhe mënyrën e klasifikimit të kredisë së ristrukturuar.

Në datën 27.03.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 28 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit"". Ndryshimi i parashikuar në këtë vendim prek nenin e rregullores që rregullon normën e likuiditetit. Kështu sipas këtij vendimi, banka përllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 15% (pesëmbëdhjetë për qind) dhe në total në nivelin minimal 20% (njëzet për qind).

Në datën 30.04.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 33 udhëzimin "Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës". Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave bazë për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, metodës së llogaritjes së ekspozimit ndaj këtij rreziku dhe raportimit në Bankën e Shqipërisë. Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë.

Në datën 29.05.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 37 "Raportin e Mbikëqyrjes për vitin 2012". Ky raport vlerëson se veprimtaria mbikëqyrëse gjatë vitit 2012, është karakterizuar nga një kontroll i shpeshtuar në vend i veprimtarisë bankare duke ruajtur një koordinim sa më të balancuar midis qasjes së bazuar në rrezik, pra rreziqeve të evidentuara, si dhe burimeve në dispozicion. Filozofia mbikëqyrëse e ndjekur gjatë vitit 2012 është mbështetur në elementët kryesorë të përcaktuar në strategjinë afatmesme të zhvillimit të mbikëqyrjes, duke thelluar më tej kuptimin e tyre, për zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, të metodologjisë së analizës dhe të kuadrit rregullator, për bashkëpunimin e ngushtë me autoritetet ndërkombëtare.

SISTEMET E PAGESAVE

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 03 "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për instrumentet e pagesave elektronike". Ndryshimet e parashikuara nga ky vendim, prekin ato nene të rregullores të cilat rregullojnë emetimin e parasë elektronike, riparimin e fondeve, humbjen ose dëmtimin e instrumentit të parasë elektronike etj..

Në datën 26.06.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 42 "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve

të skemave kombëtare të pagesave me kartë". Kjo rregullore synon të garantojë sigurinë, qëndrueshmërinë, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e skemave kombëtare të pagesave me kartë, si element përbërës i sistemeve të pagesave, me vlerë të vogël. Objekti i saj është përcaktimi i kritereve, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për licencimin e operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë në Shqipëri; dhënien e miratimeve paraprake nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe detyrimet për njoftime nga ana e operatorit në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë; si dhe rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së skemave kombëtare të pagesave me kartë.

EMISIONI

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 5 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5000 lekë". Vendimi parashikon rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 5000 lekë dhe me vit emetimi vitin 2013.

Në datën 17.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 6 "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 1 lekë dhe 10 lekë". Vendimi parashikon rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me vlerë nominale 1 Lek dhe 10 Lekë, me kurs ligjor, të shtypura në vitin 1996 dhe të rishtypura në vitin 2000, 2008 dhe 2009. Viti i emetimit, i shtypur mbi këto monedha, do të jetë viti 2013.

Në datën 13.02.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 16 rregulloren "Për kontrollin e autenticitetit dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve për kontrollin për autenticitet, vlerësimin e përshtatshmërisë për qarkullim dhe riciklimin e kartëmonedhave Lekë. Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe klientët e tjerë me status të veçantë që kryejnë veprime në cash me Bankën e Shqipërisë.

Në datën 13.02.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 17 "Për shtyrjen e afatit të këmbimit të disa kartëmonedhave pa kurs ligjor". Përmes këtij vendimi ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim, deri në datën 31.12.2023, një sërë kartëmonedhash pa kurs ligjor dhe t'i dërgojnë ato menjëherë pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saj. Kartëmonedhat pa kurs ligjor, objekt të këtij vendimi, janë të vlerave nominale 100, 200, 500 dhe 1000 lekë dhe janë emetime të viteve 1991-1997.

Në datën 10.04.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 29 rregulloren "Mbi asgjësimin e kartëmonedhave, monedhave metalike shqiptare dhe bonove të privatizimit". Objekti i kësaj

rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mënyrave dhe procedurave për asgjësimin nga Banka e Shqipërisë të kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të tërhequra nga qarkullimi si të papërshtatshme për t'u ricikluar ose si të dëmtuara, të kartëmonedhave të cilësuara si të pavlefshme, si dhe të bonove të privatizimit pas përdorimit.

Në datën 26.06.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 41 rregulloren "Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dyshuara si të falsifikuara". Përmes kësaj rregulloreje, synohet të përcaktohen rregullat dhe procedurat për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare (lekë) të dyshuara si të falsifikuara, me qëllim mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare nga falsifikimi. Subjekte të kësaj rregulloreje janë Banka e Shqipërisë, bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

POLITIKA MONETARE

Në datën 30.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi e vendimin nr. 7 "Deklaratën e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012". Sipas kësaj deklarate, ekonomia shqiptare ka shënuar një përmirësim të lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012. Kjo ecuri është ndikuar nga reflektimi më i plotë i stimulit monetar dhe nga përmirësimi i ambientit të jashtëm ekonomik e financiar. Megjithatë, aktiviteti ekonomik mbetet nën nivelin potencial dhe burimet e rritjes nuk paraqiten të qëndrueshme. Rritja vjetore e çmimeve të konsumit shënoi vlerën 2.4% në fund të vitit 2012, ndërkohë që norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2%. Ecuria e deritanishme e aktivitetit ekonomik dhe projeksionet për vitin 2013, mbështesin vlerësimin për një rritje ekonomike pozitive, të përafërt me atë të vitit paraardhës.

Në datën 30.01.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 8 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes". Ky vendim parashikon uljen me 0.25 pikë përqindje të normës së interesit. Kjo normë, nga 4.00% që është, bëhet 3,75%.

Në datën 27.02.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankë së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 22 "Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012". Raporti vlerëson se ekonomia shqiptare gjatë vitit 2012 u përball me goditje të pafavorshme, të ardhura nga ambienti i brendshëm dhe i jashtëm. Rritja e prodhimit gjatë nëntë muajve të parë të vitit ishte 1.6%, ndërsa punësimi në ekonomi u rrit me 0.33% në terma mesatarë. Deficiti buxhetor u vlerësua në 3.4% të PBB-së, ndërsa borxhi publik vlerësohet të ketë arritur në 61% të PBB-së në fund të vitit. Cilësia e portofolit të kredive vijoi të përkeqësohet, sikurse tregohet nga rritja e peshës së kredive me probleme në totalin e tyre në 22.5%, kundrejt 18.8% një vit më parë. Në përputhje me zhvillimet e mësipërme inflacioni mesatar i vitit rezultoi 2%, duke qëndruar brenda

bandës së tolerancës së Bankës së Shqipërisë. Në këto kushte, në mbështetje të objektivit afatmesëm për inflacionin dhe duke synuar zvogëlimin e hendekut negativ të prodhimit, Banka e Shqipërisë uli normën e saj të interesit 3 herë gjatë vitit, duke e zbritur nga 4.75% në 4.00%.

Në datën 30.04.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 31 "Raportin e politikës monetare për tremujorin e parë të viti 2013". Sipas këtij raporti, pavarësisht kontekstit të zhvillimeve të pafavorshme, treguesit kryesorë të balancave të brendshme e të jashtme të vendit kanë qëndruar brenda parametrave të shëndetshëm. Çmimet e konsumit u rritën mesatarisht me 2.5%, në tremujorin e parë të vitit 2013. Ecuria e treguesve buxhetorë në tremujorin e parë të vitit, tregon për rritjen e stimulit fiskal. Në muajin janar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 3.75%. Nëpërmjet ankorimit të pritjeve inflacioniste, qetësimit të presioneve të likuiditetit dhe uljes së normave afatshkurtra të interesit, politika monetare ka synuar të ulë koston e financimit afatgjatë të ekonomisë dhe të mbështesë rritjen e kredisë, të konsumit dhe të investimeve në vend. Projeksionet tona për vitin 2013 mbështesin vlerësimin për një rritje ekonomike në nivele pranë atyre të vërejtura në vitin e kaluar. Me një probabilitet ndodhjeje 90%, inflacioni vjetor pritet të luhatet në intervalin 0.6% – 3.6% pas 4 tremujorëve.

OPERACIONET MONETARE

Në datën 13.02.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.14 "Për kryerjen e pagesës së rritjes së kuotës së anëtarësisë të Republikës ë Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar". Sipas këtij vendimi, pagesa prej 79,3 milionë SDR e rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, do të kryhet nga llogaria në SDR e Bankës së Shqipërisë pranë Fondit, për 25% të shumës, ndërsa pjesa tjetër, nëpërmjet depozitimit të një note të panegociueshme dhe që nuk bart interes, në llogarinë e titujve të Fondit Monetar Ndërkombëtar pranë Bankës së Shqipërisë.

STABILITETI FINANCIAR

Në datën 10.04.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 30 "Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012". Sipas këtij raporti, gjatë periudhës në analizë, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar u paraqit e qëndrueshme. Sektori bankar përmirësoi më tej rezultatin financiar, treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit. Por vëllimi i aktivitetit u zgjerua me ritme më të ulëta, në kushtet e rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe uljes së ndjeshme të ritmeve të kreditimit. Zhvillimet ekonomike në vend kanë qenë të ngjashme me periudhën e kaluar, duke u karakterizuar nga një ritëm më i ngadaltë i rritjes ekonomike. Sektori bankar përmirësoi më tej rezultatin financiar, treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit. Por vëllimi i aktivitetit u zgjerua me ritme më të

ulëta, në kushtet e rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe uljes së ndjeshme të ritmeve të kreditimit.

POLITIKA EKONOMIKE

Në datën 22.01.2013, Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 3 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar". Këto ndryshime prekin 2.4.6 dhe 2.4.7 të udhëzimit, të cilat rregullojnë shpërndarjen e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësive të qeverisjes vendore. Përmes këtij udhëzimi, ripërcaktohen edhe procedurat që duhen ndjekur nga aktorët e përfshirë në këtë proces si dhe mënyrën e llogaritjes së këtyre të ardhurave.

Në datën 22.01.2013, Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 4 "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar". Këto ndryshime prekin, ndër të tjera, nenet dhe pikat e udhëzimit që rregullojnë operacionet hidrokarbure dhe rastet e veçanta për trajtimin e së drejtës për kreditimin e TVSH-së. Në këtë udhëzim, përcaktohet gjithashtu se kontraktorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga IPA rimbursohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të të tilla projekteve, pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim TVSH dhe dokumenteve të tjera të nevojshme sipas këtij udhëzimi.

Në datën 23.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 47 "Për një shtesë në vendimin nr. 45, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", të ndryshuar". Ndryshimi i bërë përmes këtij vendimi parashikon që procedurat e prokurimit me vlerë më të vogël të zhvillohen me mjete elektronike, me përjashtim të rasteve emergjente dhe prokurimeve me vlerë më të vogël se 10000 (dhjetë mijë) lekë.

Në datën 23.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 60 "Për rritjen e kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar". Sipas këtij vendimi, kuota e anëtarësimit të e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, rritet për shumën 79.3 (shtatëdhjetë e nëntë pikë tre) milionë SDR.

Në datën 23.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 71 "Marrëveshjen e grantit suedez nr. TF012392 TF012392, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), e cila vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, për bashkëfinancimin e projektit të menaxhimit dhe administrimit të tokës". Sipas kësaj marrëveshjeje, granti prej 18 711 000 SEK (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë korona suedeze), do të përdoret për të financuar projektin i cili synon të përmirësojë efikasitetin dhe efektshmërinë e administrimit dhe menaxhimit të tokës përmes forcimit të sigurisë në përdorimin e përkohshëm të truallit dhe planifikimit urban të përmirësuar; si

dhe të rindërtojë asetet fizike dhe rivendosë shërbimet e nevojshme në zonat e prekura nga përmbytjet në Shqipëri.

Në datën 23.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 73 "Kuadrin makroekonomik e fiskal për periudhën 2014-2016". Sipas tabelës së treguesve kryesorë makroekonomikë, në vitet në vijim, norma e inflacionit parashikohet të mbetet në nivelin 3.0%, rritja reale e PBB-së vlerësohet të vijë në rritje, nga 3.1% në vitin 2013, në 4.2% në 2016, ndërsa norma e papunësisë parashikohet të ulet nga 13.2 në vitin 2013, në 12.0% në përfundim të periudhës së marrë në shqyrtim.

Në datën 30.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 78 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunimin ekonomik". Pas miratimit të kësaj marrëveshjeje, qeveritë e dy vendeve angazhohen të kontribuojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre ekonomik me përfitim reciprok, si dhe të bëjnë përpjekje për të zhvilluar bashkëpunimin e tyre dypalësh me bazë të gjerë, veçanërisht në fusha të tilla si industria, bujqësia, pylltaria, arsimi etj..

Në datën 30.01.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 79 "Programin ekonomik e fiskal të Shqipërisë, për periudhën 2013-2015". Ky dokument paraqet një informacion të qartë të politikave ekonomike dhe prioriteteve afatmesme të vendit në kuadrin e reformave strukturore që parashikohen të zbatohen gjatë periudhës 2013-2015, të cilat kanë për qëllim stabilitetin makroekonomik dhe sigurimin e një rritjeje ekonomike relativisht të lartë, si dhe ngritjen e një kuadri rregullator dhe politikave sektoriale në përputhje me standardet evropiane. Sipas këtij dokumenti, rritja ekonomike parashikohet (gjatë 2012-2014) që të vazhdojë të jetë mbi nivelin prej 3%, e kushtëzuar nga rritja e kërkesës së brendshme dhe të jashtme dhe vazhdimi i stimujve fiskalë. Për periudhat e ardhshme pritet që kërkesa e brendshme të luajë rolin kryesor në rritjen e kërkesës agregate.

Në datën 01.02.2013, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri i Financave miratuan udhëzimin nr. 1 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 16.1.2013 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013"". Sipas këtij udhëzimi, fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri "Transferta në buxhetet familjare", të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agro-përpunimit. Sektorët që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ndër të tjerë, janë: prodhimi i frutave, arrorëve, shegës; prodhimi i perimeve në serra; prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit; prodhimi i produkteve organike; nxitja e kooperimit bujqësor etj..

Në datën 06.02.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 124 "Standardet kombëtare për administrimin e masës së falimentimit". Standardet kombëtare për administrimin e masës së falimentimit kanë për

qëllim përcaktimin e procedurave dhe rregullave për ushtrimin e veprimtarisë së administratorëve të falimentimit. Ky dokument përbën tërësinë e rregullave të hollësishme për t'u zbatuar nga çdo administrator, në të gjitha rastet e emërimit të tij për mbulimin e një procedure falimentimi.

Në datën 07.02.2013, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miratoi vendimin nr. 1 "Për financimin e projekteve në zbatim të fondit për zhvillimin e rajoneve". Nëpërmjet këtij vendimi, përcaktohen vlerat që do të likuidohen për projekte të ndryshme të ndara sipas qarqeve të vendit, nga vlera prej 1 677 288 969 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, pjesë e fondit të buxhetit të vitit 2013, për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, për infrastrukturën vendore.

Në datën 20.02.2013, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 138 "Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2014-2016". Në brendi të këtij vendimi paraqiten të detajuara shpenzimet në total sipas zërave të buxhetit për çdo njësi të qeverisjes qendrore për periudhën 2014-2016, duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të ardhurave për tre vitet në vijim. Kështu, duke pasur synim kryesor rritjen e eficiencës në përdorimin e burimeve njerëzore, fondi total i personelit parashikohet në terma realë, nga 5% e PBB-së në 2014, në 4.8% të PBB-së në 2016. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën në fjalë, janë parashikuar me një rritje konstante prej 3%. Ato do të vazhdojnë të orientohen në rritjen e shpenzimeve të funksionimit të sektorëve prioritarë të infrastrukturës, arsimit, shëndetit dhe bujqësisë.

Në datën 21.02.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 89/2013 "Marrëveshjen e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitëse". Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje IBRD, bie dakord t'i japë hua palës tjetër shumën prej 31 000 000 (tridhjetë e një milion) eurosh, për të ndihmuar në financimin e projektit për rehabilitimin e digave,sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, mbështetjen institucionale për ujitjen dhe kullimin dhe për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Në datën 25.02.2013, Ministri i Financave miratoi udhëzimin nr. 10 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Përmes këtij vendimi, ndër të tjera, shtohen edhe dy kategori të tjera te të ardhurat që përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat-përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave apo kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore, si dhe të ardhurat e përfituara nga individët për arritjet në shkencë, sport dhe kulturë, të dhëna nga institucionet buxhetore. Ndryshime pëson gjithashtu edhe neni që përcakton kriteret dhe procedurat për pagimin e tatimit mbi fitimin në formë paradhënieje.

Në datën 27.02.2013, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta miratoi udhëzimin nr. 02 "Për kriteret dhe procedurat e

shpërndarjes së fondit të mbrojtjes sociale". Sipas pikave të këtij udhëzimi, fondet e akorduara në programin "Mbrojtja sociale", si transfertë e kushtëzuar, i shpërndan në mënyrë periodike, për pagesën e dëmshpërblimit të të dënuarve politikë, pagesën për programin e ndihmës ekonomike, pagesën për programin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe financimin e bashkive për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdesjes shoqërore.

Në datën 25.03.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 104/2013 "Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për gazsjellësin Trans-Adriatik (Projekti TAP)". Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, palët synojnë të promovojnë më tej bashkëpunimin e ndërsjellë të favorshëm për garantimin e furnizimit të sigurt me gaz natyror nga burimet e Azisë Qendrore dhe Lindjes së Mesme, përfshirë ato të Republikës së Azerbajxhanit, drejt Bashkimit Evropian nëpërmjet Republikës së Turqisë, duke patur parasysh faktin se zhvillimi dhe ndërlidhja (në përputhje me marrëveshjet e interkonjeksionit të lidhura për këtë projekt) e sistemit të Gazsjellësit Trans Anatolian dhe e sistemeve të transportit të gazit natyror të palëve, me Gazsjellësin Trans Adriatik, do të rrisë sigurinë dhe rezervat e furnizimit me gaz natyror, si pasojë e diversifikimit të itinerareve dhe burimeve të furnizimit me gaz natyror drejt Bashkimit Evropian.

Në datën 27.03.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 239 "Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit". Pas miratimit të këtij vendimi, fondet kundërparti të dhëna nga qeveria japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjenci e pagesave, në shumën 173 095 454 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë, do të trajtohen si të ardhura jashtë limiti dhe do të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit, brenda vitit 2013. Ato do të përdoren nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në formën e kreditimit pa interes, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimin e këtyre produkteve.

Në datën 28.03.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 106/2013 "Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2013 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar". Këto ndryshime, ndër të tjera, parashikojnë që taksa për zënien e hapësirës publike nuk aplikohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor. Në këtë ligj përcaktohet gjithashtu se antenat e telefonisë celulare, si dhe çdo lloj antene tjetër transmetimi, të vëna në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nuk janë subjekt i taksave me karakter të përkohshëm.

Në datën 01.04.2013, Kuvendi i Republikës miratoi ligjin nr. 111/2013 "Për disa shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar". Sipas shtesave të miratuara, furnizimi i lëndëve të para dhe kafshëve të racës që përdoren në bujqësi, të tilla si; plehra kimike, pesticide, farëra, fidanë frutorë, mëshqerra racë e pastër, të imëta racë e pastër, material biologjik për ndërzim, ushqime për kafshë, materiale për

bletarinë, plastmase për bujqësinë, makinat bujqësore të furnizuara fermerit, si dhe furnizimi i rrjetave të peshkimit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Në datën 03.04.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 264 "Për organizimin e punës për përfarimin e legjislacionit në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve". Me miratimin e këtij vendimi përcaktohet metodologjia për identifikimin, shqyrtimin, ndryshimin, shfuqizimin apo hartimin e akteve, ligjore e nënligjore, që lidhen me të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe përafrimi i tyre me legjislacionin e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Në datën 10.04.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 295 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore". Përmes këtij vendimi, parashikohet ngritja e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale. Ai ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atij të shërbimeve shoqërore dhe është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore të punës, sipas legjislacionit të punës, dhe të shërbimeve shoqërore, sipas legjislacionit për shërbimet shoqërore.

Në datën 10.04.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 301 "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të peshkimit"[11]. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social-ekonomike, në kuadër të programit shumëvjeçar, lidhur me sektorin e peshkimit; përdorimin e të dhënave lidhur me sektorin e peshkimit në kuadër të strategjisë Kombëtare të Peshkimit, për qëllime të analizave shkencore; si dhe përmirësimin e këshillimit shkencor, i nevojshëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit.

Në datën 10.04.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 475 "Për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut". Ky vendim parashikon krijimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, si institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë. Ai përcaktohet si struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve, për të gjitha produktet apo grup-produktet joushqimore, me përjashtim të atyre që janë shprehimisht në përgjegjësinë e një inspektorati apo institucioni tjetër shtetëror.

Në datën 11.04.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 113/2013 "Për aderimin në rezolutën e bordit të guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për tregti dhe zhvillim (BSTDB)". Sipas kësaj rezolute, nga rritja në kapitalin e autorizuar të BSTDB-së prej dy miliardë SDR (SDR 2.000.000.000), shuma e ofruar për nënshkrim caktohet një miliard SDR (SDR 1.000.000.000)

të ndarë në një milion (1.000.000) aksione që kanë një vlerë nominale prej një mijë SDR (SDR 1.000) secili. Shuma e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar të Bankës është e ndarë në dy milionë (2.000.000) aksione që kanë një vlerë nominale prej një mijë SDR (SDR 1.000) secili. Numri i aksioneve dhe përqindja e stokut të përgjithshëm të kapitalit të nënshkruar dhe të autorizuar të Bankës që mbahet nga Republika e Shqipërisë është 40.000 aksione (SDR 40.000.000, vlera nominale e plotë) – 2% (dy për qind) e kapitalit të nënshkruar të Bankës.

Në datën 18.04.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 120/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar". Shtesat dhe ndryshimet e parashikuara në këtë ligj, kanë të bëjnë me rregullimin dhe përcaktimin e formulës për llogaritjen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, si dhe me procedurat që ndiqen për shlyerjen e saj nga pronari i mjetit. Në këtë ligj parashikohet gjithashtu, falja e të gjitha detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

Në datën 24.04.0213, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 353 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj". Në këtë vendim, ndër të tjera, parashikohet që punëdhënësit në sektorin privat, të cilët punësojnë të rinj nga mosha 16 - 30 vjeç, që kanë përfunduar arsimin e lartë, arsimin e mesëm të përgjithshëm e profesional dhe kurse të formimit profesional, mund të përfitojnë një financim mujor për tre vjet, në masën 100% (njëqind për qind) të sigurimeve të detyrueshme, shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që në kontratën e punës të jetë 3 (tre) vjet kohëzgjatja e programit dhe 3 (tre) vjet të tjerë pa shkëputje pas përfundimit të programit.

Në datën 25.04.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/partneritete publike private. Ai rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike private, procedurat për dhënien e kontratave të tilla, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare, mbështetjen dhe politikën e këtyre koncesioneve , si dhe autoritetin për zbatimin e tyre.

Në datën 29.04.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 133/2013 "Për sistemin e pagesave". Përmes miratimit të këtij ligji synohet të nxitet siguria, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Ligji përcakton parimet bazë që kanë të bëjnë me licencimin, rregullimin, mbikëqyrjen e elementeve të rëndësishme të sistemit kombëtar të pagesave, si dhe përcakton rregullat për mbrojtjen e sistemeve.

Banka e Shqipërisë, në përmbushjen e detyrave të saj, të përcaktuara në këtë ligj, bashkëpunon me cilindo autoritet vendas dhe/ose të huaj, me qëllim shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e veprimtarive, apo realizimin e marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, nëse gjykohet e nevojshme.

Në datën 02.05.2013, Këshilli i ministrave miratoi me vendimin nr. 382 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për bashkëpunim ekonomik, industrial dhe teknologjik". Kjo marrëvëshje synon asistimin e zhvillimit të bashkëpunimit në fushat e ekonomisë, industrisë dhe teknologjisë në bazë të barazisë, përfitimit të përbashkët dhe reciprocitetit, duke patur parasysh përfitimin që rrjedh nga zgjerimi i mundësive të marrëdhënieve dypalëshe afatgjata dhe të suksesshme. Përmes nënshkrimit të saj, dy shtetet do të nxisin zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik, industrial dhe teknologjik në fushën me interes dhe përfitim të përbashkët në pajtim me ligjet dhe rregulloret përkatëse të brendshme të tyre dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku ato janë palë.

Në datën 02.05.2013, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 2 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme". Ky akt normativ përcakton që të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 31 tetor 2013, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për shitjen e pasurisë të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të dalë nga rivlerësimi.

Në datën 06.05.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 146/2013 "Konventën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore". Kjo konventë e nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), vjen si pasojë e faktit që zhvillimi i lëvizjes ndërkombëtare të personave, kapitalit, mallrave dhe shërbimeve, megjithëse në vetvete është tepër i dobishëm, ka rritur mundësitë e shmangies dhe evazionit fiskal, duke kërkuar në këtë mënyrë bashkëpunim në rritje ndërmjet autoriteteve tatimore. Objektivi i saj është që palët nënshkruese t'i japin njëra-tjetrës ndihmë administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore. Kjo ndihmë mund të përfshijë, sipas rastit, masat e marra nga organet gjyqësore. Pjesë e ndihmës administrative është shkëmbimi i informacionit, duke përfshirë ekzaminime të njëkohshme tatimore; ndihma në kompensimin, masat e ruajtjes dhe dorëzimin e dokumenteve.

Në datën 06.05.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi ligjin nr. 147/2013 "Marrëveshjen e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa S.p.A., për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare". Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, merr përsipër të financojë

programin nëpërmjet një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 15.000.000,00 (pesëmbëdhjetë milionë) eurosh. Kjo hua do të shlyhet në një periudhë prej 16 vjetësh, përmes 16 kështesh të njëpasnjëshme, të shpërndara në mënyrë të barabartë, me normë interesi 0.00% (zero pikë zero përqind .

Në datën 08.05.2013, Këshilli i Ministrave miratoi udhëzimin nr. 1 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013". Përmes këtij udhëzimi miratohet kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë Republike, për vitin 2013, e cila do të jetë 37 806 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë/m2, për sipërfaqe shfrytëzimi. Gjithashtu, në këtë udhëzim përcaktohet edhe kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2013.

Në datën 15.05.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 418 "Për rritjen e aksioneve të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim". Pas miratimit të këtij vendimi, aksionet e Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim rriten për shumën 20 000 000 (njëzet milionë) SDR, nga të cilat 30% do të paguhet në lekë (e barasvlershme me shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) SDR) dhe 70% me notë premtimi.

Në datën 15.05.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 419 "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë". Me miratimin e këtij vendimi krijohet Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, për vitin 2013, me vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh. Fondi parashikohet të zbatohet për një periudhë 3-vjeçare(gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015) me një vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për secilin vit. Prej tij pritet të përfitojnë ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

Në datën 22.05.2013, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 460 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit". Objekt i qiradhënies, sipas këtij vendimi, janë sipërfaqet e tokës bujqësore, në pronësi të shtetit, me origjinë nga ish-Ndërmarrjet Bujqësore (në vijim "tokë bujqësore në pronësi të shtetit"). Në vendim përcaktohen institucionet përgjegjëse, kushtet dhe procedurat që duhen ndjekur për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit.

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 30 QERSHOR 2013

KËSHILLI MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI	Kryetar
ELISABETA GJONI	Zëvendëskryetare
ADRIAN CIVICI	Anëtar
ARJAN KADAREJA	Anëtar
DHORI KULE	Anëtar
ELA GOLEMI	Anëtare
ERMELINDA MEKSI	Anëtare
HALIT XHAFA	Anëtar
PETRAQ MILO	Anëtar

GUVERNATORI

ARDIAN FULLANI

ZËVENDËSGUVERNATORËT

ELISABETA GJONI — Zëvendësguvernator i Parë

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ELIVAR GOLEMI

KABINETI I GUVERNATORIT

GENC MAMANI

DREJTUES PËR KOORDINIMIN PRANË KABINETIT TË GUVERNATORIT

GRAMOZ KOLASI

DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	*Roden Pajaj*
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	*Erald Themeli*
DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	*Altin Tanku*
DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	*Marjan Gjermeni*
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	*Indrit Banka*
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR	*Klodion Shehu*
DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	*Xhilda Deliana*
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	*Diana Shtylla*
DEPARTAMENTI I EMISIONIT	*Dorian Çollaku*
DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS	*Fatos Ibrahimi*
DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE	*Dashmir Halilaj*
DEPARTAMENTI JURIDIK	*Altin Naqe*
DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	*Elivar Golemi*
DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT	*Oneda Andoni*
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	*Agron Skënderaga*
DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	*Eduard Sinani*

DEGËT

Shkodër	*Ermira Istrefi*
Elbasan	*Valentina Dedja*
Gjirokastër	*Anila Thomaj*
Korçë	*Liljana Zjarri*
Lushnje	*Shpresa Meço*

BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË, DERI NË 30 QERSHOR 2013

1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.
Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.
Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Christian CANACARIS*
Adresa: *Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2274 910*
Faks: *+355 4 2275 599*
E – mail: *info@raiffeisen.al*
Website: *www.raiffeisen.al*

2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.
Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.
Çertifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Emina ŠIŠIĆ*
Adresa: *Rruga "Durrësit", sheshi tek Zogu i Zi, Godina Teknoprojekt, P.O. BOX 128, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2404 575*
Faks: *+355 4 2228 460 / 2228 387*
E mail: *info@ubaal.com*
Website: *www.uba.com.al*

3. VENETO BANKA SH.A.
Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.
Certifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Lucio Luigi GAITA*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.*
Telefon : *+355 4 2280 555*
Faks: *+355 4 2280 356*
E – mail: *info@venetobanka.al*
Website: *www.venetobanka.al*

4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.
Certifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Seyhan PENCABLIGIL*
Adresa: *Bulevardi "Zhan Dark" Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2250 955*
Faks: *+355 4 2250 956*
E – mail: *info@bkt.com.al*
Website: *www.bkt.com.al*

5. BANKA TIRANA SH.A.
Licenca Nr. 07,datë 12.09.1996.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.
Certifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Savvas THALASSINOS*
Adresa: *Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2269 616 / 7 / 8, 2233 441*
Faks: *+355 4 2233 417 / 2369 707*
E – mail: *info@tiranabank.al*
Website: *www.tiranabank.al*

6. BANKA NBG ALBANIA SH.A
Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4. datë 14.03.1996.
Certifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Ioannis KOUGIONAS*
Adresa: *Rruga e Durrësit, Godina Comfort, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2274 802 / 2274 822*
Faks: *+355 4 2233 613*
E – mail: *nbgalbania@icc-al.org*

7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996.
Certifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Gideon van den BROEK*
Adresa: *Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2254 372 / 2256 254*
Telfaks: *+355 4 2254 368*
E – mail: *info@icbank-albania.com*

8. BANKA ALPHA ALBANIA SH.A.
Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.01/03/96, datë 27.12.1997.
Certifikata nr.9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Periklis DROUGKAS*
Adresa: *Rruga e Kavajës, G – KAM Business Center, kati II, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2278 500*
Telfaks: *+355 4 2232 102*
Website: *www.alphabank.al*

9. BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.
Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.
Certifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Alexander RESCH*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2248 753 / 4 / 5 / 6, 2276 000*
Faks: *+355 4 2248 762.*
E – mail: *info@intesasanpaolobank.al*
Website: *www.intesasanpaolobank.al*

10. BANKA PROCREDIT SH.A.
Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.
Certifikata nr.11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Flutura VEIPI*
Adresa: *Rruga "Dritan Hoxha", Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake nr. 11, Kodi Postar 1026 Tiranë.*
Telefon: *++355 4 2389 300*
Faks: *++355 4 2233 918*
E mail: *info@procreditbank.com.al*
Website: *www.procreditbank.com.al*

11. BANKA CREDIT AGRICOLE SHQIPËRI SH.A.
Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.
Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Luc BEISO*
Adresa: *Rruga e Kavajës, nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2258 755 / 56 / 57 / 58 / 59 / 60*
Faks: *+355 4 2258 752*
Website: *www.credit-agricole.al*

12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28. 08. 2002.
Certifikata nr.14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Sherine KAMEL*
Adresa *Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë*
Telefon *+355 4 2272 168, 2272 162*
Faks: *+355 4 2272 162*
E-mail: *creditbkalb@icc-al.org*

13. BANKA CREDINS SH.A.
Licenca nr. 16, datë 31.3.2003.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.
Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Artan SANTO*
Adresa: *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2234 096*
Faks: *+355 4 2222 916*
E –mail: *info@bankacredins.com*
Website: *www.bankacredins.com*

14. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004.
Certifikata nr. 16 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Hubert de SAINT JEAN*
Adresa *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 9-të, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2280 442 / 3*

Faks: *+355 4 2280 441*
E-mail: *info@societegenerale.al*
Web site: *www.societegenerale.al*

15. BANKA UNION SH.A.
Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.
Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Gazmend KADRIU*
Adresa: *Bulevardi "Zogu I", pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2250 653 / 2258 081*
Faks: *+355 4 2272 880*
E – mail: *info@unionbank.com.al*
Website: *www.unionbank.com.al*

16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 19, datë 06.07.2007
Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007
Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: *Bozhidar TODOROV*
Adresa: *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14&15, Tiranë.*
Telefon: *+355 4 2276 702 / 3.*
Faks: *+355 4 2280 210*
website: *www.fibank.al*

Përveç bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 31 Dhjetor 2012 edhe subjektet e mëposhtme:

Nr.	Subjekte
21	SUBJEKTE JOBANKA
328	ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR
2	UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT
126	SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT
1	ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2013

Kjo listë përpilohet për të informuar lexuesit mbi botimet e Bankës së Shqipërisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013. Duke vizituar faqen tonë zyrtare të internetit (www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks + 355 4 2419408 dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes së botimeve të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur.

Më poshtë mund të gjeni titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

RAPORTI VJETOR

Raporti Vjetor 2012

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR:

Raporti i Stabilitetit Financiar, Gjashtëmujori i dytë 2012

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2012

RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE:

Raporti i politikës monetare për tremujorin e katërt 2012
Raporti i politikës monetare për tremujorin e parë 2013

BOTIME PËR STATISTIKAT:

Raporti Mujor Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit).

BULETINI ZYRTAR:

Buletini Zyrtar – Vëllimi 15, nr. 1
Buletini Zyrtar – Vëllimi 15, nr. 2
Buletini Zyrtar – Vëllimi 15, nr. 3
Buletini Zyrtar – Vëllimi 15, nr. 4
Buletini Zyrtar – Vëllimi 15, nr. 5

BULETINI I BANKËS SË SHQIPËRISË:

Buletini i Bankës së Shqipërisë - Gjashtëmujori i dytë 2012

BOTIME STRATEGJIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË:

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015

MATERIALE DISKUTIMI:

Politika fiskale dhe kurba e yield-eve në Shqipëri- Esida Abazaj

Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar- Roden Pajaj, Rezart Ferzaj

Një mënyrë alternative e vlerësimit të pozicionit fiskal në rastin e Shqipërisë: Balanca buxhetore e korrektuar për ciklet e biznesit- Anjeza Gazidede

Politika fiskale dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë- Gerti Shijaku

Një indeks i rrezikut sistemik financiar për Shqipërinë- Vasilika Kota, Arisa Saqe

Raporti i anketimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesës – Individët- Kliti Ceca, Alban Pllaha, Valentina Semi

Raporti i anketimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesës – Bizneset- Kliti Ceca, Alban Pllaha, Valentina Semi

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË:

Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë, Nr.9

BOTIME EDUKATIVE-INFORMATIVE:

Broshura "Si prodhohet një kartëmonedhë shqiptare?"